

ENVER HOXHA

VEPRA


58

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SIHQIPERISE**



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH**

ENVER HOXHA

VELLIMI

58

QERSHOR 1976 – TETOR 1976

SHTËPIA BOTUËSE «3 NENTORI»
TIRANË, 1988

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 58-TË

Vëllimi i 58-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban materiale të periudhës qershor-tetor 1976, pjesa më e madhe e të cilave botahen për herë të parë.

Gjithë kujdesi dhe preokupacioni i Partisë për këtë periudhë pesëmujore ishte përqendruar në punën e madhe që kërkonte përgatitja e Kongresit të 7-të të Partisë, si dhe në mobilizimin e komunistëve dhe të mbarë masave punonjëse për plotësimin me sukses të detyrave në të gjitha frontet.

Në disa materiale theksi vihet te rritja e efektivitetit të punës së Partisë në të gjitha hallkat dhe për të gjitha fushat, nëpërmjet forcimit të rolit të saj udhëheqës. Lidhur me këtë tërhiqet vëmendja në domosdoshmërinë e zbatimit të direktivës për shpërnguljen e qendrës së gravitetit të punës së Partisë në trethe nga byrotë në plenumet e komiteteve të Partisë dhe për përmirësimin e përbërjes së forumeve të saj. Udhëheqësi i Partisë ndalet në mënyrë të posaçme në momente kryesore që përbëjnë thelbin e tyre dhe jep këshilla e porosi shumë të vlefshme për mënjanimin e dobësive dhe të metave që ishin dukur në praktikë në zbatimin e këtyre direktivave. Duke vënë në dukje rëndësinë që kishte për momentin dhe për perspektivën

përtëritja e Partisë dhe e udhëheqjes së saj me gjak të ri, që udhëhcqja të jetë kurdoherë e re, e freskët, revolucionare, marksiste-leniniste, e astë për të kryer çdo detyrë, sado e vështirë qoftë, në vëllim vihen në dukje tiparet që duhej të karakterizonin komunistët që zgjidhen në organet udhëheqëse të Partisë.

Me vlera të mëdha mbeten mësimet e porositë për hartimin e planit të ri pesëvjeçar sa më real, të studiuat e të ndërtuar mbi baza shkencore, në përputhje me parimin revolucionar të mbështetjes në forcat e veta, si dhe për kuptimin dhe trajtimin teorik e praktik të çështjeve të planifikimit të ekonomisë socialiste.

Duke e konsideruar planifikimin një mjet të fuqishëm të diktaturës së proletariatit, shoku Enver Hoxha ndalet në karakterin thellësisht klasor të tij dhe orientation që të mbahet kurdoherë ndezur lufta kundër pikëpamjeve e praktikave borgjezo-revisioniste që u munduan të futnin në këtë fushë armiqëtë dhe sabotatorët Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e Kiço Ngjela.

Idetë dhe rrugëzgjidhjet konkrete që jep shoku Enver Hoxha për aspekte të ndryshme të këtij problemi kompleks e të ndërtlikuar, pasuruan më tej mendimin ekonomik të Partisë dhe përvojën e ndërtimit socialist të vendit tonë. Veçanërisht në sjalën e mylljes në Plenumin e 9-të të KQ, në diskutimin në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ më 12 korrik, si dhe në disa materiale të tjera të vëllimit shtrohen detyra për njojjen e për zbatimin e kërkësave të ligjeve ekonomike të socializmit, për përsosjen e organizimit e të drejtimit shkencor, për konceptimin dialektik të ekonomisë si

një e tërë, për thellimin e luftës kundër shfaqjeve të liberalizmit e të burakratizmit etj.

Me kujdes e vëmendje të posaçme trajtohen edhe detyra e probleme konkrete të zhvillimit të degëve e të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë: të industrisë, bujqësisë, minierave, naftës etj. Faktori bazë që duhej mbajtur kurdoherë parasysh, udhëzonte shoku Enver Hoxha, ishte shfrytëzimi në maksimum i të gjitha rezervave e mundësive që kishte krijuar rendi ynë socialist, veçanërisht në sektorë të tillë si nafta e minierat, për të cilat porosiste të shpejtoheshin ritmet e mekanizimit dhe të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese të fabrikave të pasurimit dhe të përpunimit të lëndëve të para.

Duke nënvizuar rolin e madh që ka bujqësia, si dega bazë e ekonomisë sonë, shoku Enver Hoxha tërhiqte vëmendjen për preokupimin me të cilin duhej punuar në zbatimin e direktivës së Partisë për futjen e saj në rrugën e modernizimit dhe për një zhvillim me ritme shumë më të shpejta se gjer në atë kohë. Para bujqësisë shtrohej me forcë kërkesa për realizimin e një hopi të madh në shtimin e rendimenteve të të gjitha prodhimeve bujqësore e blegtorale, duke treguar një kujdes më të madh në kryerjen e shërbimeve, duke zbatuar me rigorozitet të madh metodat shkencore dhe përvojën e përparuar. Por sigurimi i bukës në vend dhe krijimi i rezervës në drithëra, nën vizonte shoku Enver Hoxha, nuk duhej të çonte në lënien e blegtorisë, pemëtarisë, perimeve, ullirit etj. spontaneitetit.

Ide dhe mësime të çmuara gjenden në vëllim edhe

për problemet e forcimit të pavarësisë ekonomike dhe të fuqizimit të mbrojtjes së atdheut, të cilat, si aspekte kryesore të luftës për socializëm, janë të pandara nga përpjekjet për realizimin e planeve e të detyrave ekonomike. Autori shpjegon se zbatimi i direktivave të Partisë për intensifikimin e përgatitjeve politiko-luftarake të popullit për mbrojtjen dhe revolucionarizimin e punës në ushtri kërkon që komisarët të kenë një kuptim më të gjerë për detyrat dhe punën e tyre, që ta shohin veten jo vetëm si komisarë, por edhe si komandantë. Gjithashtu jepen porosi për përmirësimin e punës në shkollat ushtarake që, duke revolucionarizuar më tej programet, kuadrot ushtarakë të pajisen me kulturë të gjerë.

Detyra konkrete përcaktohen në këtë vëllim edhe për organet e Punëve të Brendshme, që krahas forcimit të vigjilencës revolucionare, të thellonin punën për zbulimin dhe për vërtetimin e lidhjeve që armiqtë komplotistë, të zbuluar në atë kohë nga Partia, kishin brenda vendit dhe me agjenturat e huaja.

Në vëllim bëhet e qartë vija e drejtë marksiste-leniniste e ndjekur nga PPSH dhe Qeveria jonë në marrëdhëni me Kinën dhe njëkohësisht vihet në dukje se thelbi i pozicionit armiqësor që kishte marrë udhëheqja kineze ndaj vendit tonë duhej kërkuar në vijën revisioniste të PK të Kinës, në idetë e pikëpamjet e gabuara antimarksiste e oportuniste të Mao Ce Dunit, me të cilat ishte ushqyer kjo parti. Analizat shkencore që u bëhen maocedunidesë dhe teorisë së «tri botëve», në funksion të zhvillimeve të rrezikshme që kishin ma-

rrë ngjarjet në Kinë në atë periudhë, shquhen për thellësinë e mendimit dhe për principialitetin e lartë klasor marksist-leninist.

Në materialet e kësaj periudhe riafirmohet edhe një herë vendosmëria e Partisë sonë për të ecur kurdoherë në rrugën që kanë caktuar Marks, Engelsi, Lenini e Stalini dhe bindja në triumfin përfundimtar të revolucionit e të socializmit.

Materialet e këtij vëllimi, që përbajnjë vlera të mëdha e gjithnjë aktuale, e pasurojnë më tej përvojën e madhe të Partisë. Ato do t'i frymëzojnë e do t'i mobilizojnë komunistët, kuadrot dhe masat punonjëse për t'i çuar përpara e për t'i mbrojtur me vendosmëri fitoret e arritura në atdheun socialist, ashtu si mëson udhëheqësi ynë i paharruar.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

STUDENTËT USHTARAKË TË PAJISEN EDHE ME KULTURE TË PËRGJITHSHME

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

1 qershor 1976

Një ditë më parë u zhvillua aktiv i Partisë në shkollën e bashkuar të oficerëve «Enver Hoxha», për zbatimin e vendimit të Sekretariatit të KQ të Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të punës në shkollat ushtarake¹. Lidhur me këtë aktiv foli.

SHOKU RAMIZ ALIA: Aktualisht, në Shkollën e Bashkuar janë duke u rishikuar programet. Por, është e nevojshme që këto programe të konsultohen gjërësisht jo vetëm me studentë, por edhe me oficerë të trupave në reparte, sepse këta, më mirë se kushdo, e dinë se çfarë cilësie dhe çfarë përgatitje duhet të ketë oficeri i trupës.

Në këtë shkollë, problem akoma më serioz është çështja e teksteve. Lidhur me këtë del problemi i për-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 56, f. 294.

eaktimit sa më të qartë të kërkesave që duhet të kemi ndaj kësaj shkolle. Mendoj se një artilier ose një xhenier me shkollë të lartë, që të jetë një komandant i mirë, duhet të njohë mirë profesionin e vet, pra, të njohë matematikën, fizikën, kiminë dhe ligjet e tyre. Kështu xhenier duhet të jetë një inxhinier i zoti që të ndërtojë urën dhe jo vetëm të dijë si kalohet ura ose si hidhet në erë ura e gatshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, nxënësi dhe studenti i shkollës ushtarake duhet të dinë edhe fizikë, edhe kimi, edhe gjecodezi, edhe matematikë etj.

SHOKU RAMIZ ALIA: Mirëpo, këta nuk bëjnë nga këto lëndë, shoku Enver. Profili i shkollës, siç më thanë, është që të përgatitë komandantë xhenierë, ndërsa për inxhinierë, kur të kenë nevojë, t'i marrin nga universiteti.

SHOKU ENVER HOXHA: Po pse t'i marrin nga universiteti? Komandanti i xhenios të mos ketë fare haber për ndërtimet?! Jo, nuk është e lejueshme dhe ne nuk mund të ecim kështu. Xhenieri duhet të ketë medoemos njohuri për ndërtimet që të jetë xhenier i mirë. Gjithashtu, që të jesh pedagog i mirë i historisë, duhet ta dish medoemos historinë, ndryshe si do ta kryesh detyrën?

Është e domosdoshme që dhe studentët e kësaj shkolle, ashtu si të gjithë nxënësit e studentët e tjerë, ta njohin vendin dhe jo vetëm pedagogun. Pa njohur vendin, pra në qoftë se nuk venë t'i shohin veprat e mëdha që janë ndërtuar, fabrikat, uzinat, muzetë, ekspozitat etj. atëherë ata s'do të dinë se çfarë do të

nibrojnë dhe për çfarë do të luftojnë. Nuk them të bredhin törë Shqipérinë, por në ato më kryesoret mund të venë. Për këtë mendoj se ndoshta është e nevojshme të shikohen programi dhe organizimi i punës mësimore në shkollë. Pas kësaj të diskutojmë konkretisht dhe të vendosim se ç'masa duhen marrë për përmirësimin e mötejshëm të punës.

SHOKU RAMIZ ALIA: Mua më duket që edhe në Shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, edhe në këtë të ushtrisë, meqenëse janë shkolla të larta, duhet t'i jepet rëndësi e madhe përgatitjes së kuadrit me kulturë të përgjithshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, kjo duhet të bëhet në niënyrë proporcionale dhe të zhvillohen ato shkenca të kulturës së përgjithshme që lidhen me profesionin e oficerit. Për shembull, përgatitja e tyre ushtarake lidhet edhe me njohjen e historisë së luftërave. Natyrisht, me këtë nuk dua të them se duhet njohur me hollësi historia e luftërave të kohëve të kaluara, se, kur këndon, ta zëmë Klauzeviçin¹ vë re se ky jep disa parime të përgjithshme edhe për luftën aktuale. Në kohët kur jetonte ai, luftohej me kështjellën, prandaj duhej ndalur edhe te lufta ndaj tyre. Kurse tani, a duhet ngulur këmbë të mësohet se si mund të merret një kështjellë? Është e kuptueshme që këtë mjet e ka lënë prapa koha. Edhe në kohën e Napoleonit mjetet e luftës ishin krejt të tjera në krahasim me ato të

1. Karl von Klauzeviç (1780-1831) gjeneral dhe teoricien ushtarak prusian.

sotmet. Tani ka të tjera mjete dhe në këto duhet ndalur. Megjithatë, njëfarë historie duhet bërë. Me këtë dua të them se të gjitha ndodhitë që kanë ngjarë në historinë e një populli nuk është e domosdoshme të mësohen, por thelbin e tyre, shkaqet përse kanë ngjarrë këto apo ato luftëra, si dhe karakteristikat kryesore të tyre duhen mësuar, se u shërbejnë kuadrove të ardhshëm ushtarakë.

Pse i shohim me interes në filmat për Luftën e Dytë Botërore, të cilët duhet t'ia japim edhe ushtrisë? Sepse janë instruktivë. Ndonjëri mund ta konsiderojë hedhjen e desantit ajror si një operacion tepër të rrezikshëm ose asfare të rrezikshëm. Po kështu edhe zbarkimin apo mbrojtjen në bregdet si shumë të lehtë. Kjo luftë të jep e të mëson shumë gjëra dhe këto dalin edhe në film. Prandaj, duhet të kemi në programet e këtyre shkollave edhe lëndën e historisë, esenca e së cilës jepet në leksione.

SHOKU HYSNI KAPO: Në Shkollen e Bashkuar, këta dy vjetët e fundit, i kanë vënë rëndësi stërvitjes në terren, sepse kishte ankesa për ata që mbaronin këtë shkollë se bënин pak stërvitje e më shumë teori. Kjo e metë në program u korrigjua. Mirëpo tani, mund të jetë kaluar në të kundërtën: të jetë pakësuar shumë ana teorike dhe të jenë lënë jashtë lëndë të tillë si historia e gjeografija, të cilat mendoj se duhen mësuar nga ata që ndjekin shkollën.

SHOKU RAMIZ ALIA: Komandanti i shkollës, kishte mendimin se këto lëndë zhvillohen në shkollën e mesme dhe nuk ka pse të bëhen në shkollën e lartë

ushtarake apo në fakultete të tjera që nuk kanë të bëjnë me to. Unë i shpjegova se ushtaraku ynë jo vetëm duhet t'i mësojë elementet kryesore të këtyre lëndëve, por edhe diçka më tepër, për shembull, ç'pozita strategjike zënë në kohën e luftës malet dhe fushat e vendit tonë etj., domethënë ai duhet t'i mësojë ato në funksion të detyrës së tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Ai drejtor shkolle që flet në këtë mënyrë nuk e ka të qartë rëndësinë e studimit të këtyre lëndëve në shkollën ushtarake. Njerëz të tillë i shikojnë shumë ngushtë këto probleme. Gjithë këto çështje që biseduam këtu për atë shkollë të studiohen dhe të merren masat e nevojshme për t'u dhënë atyre zgjidhjen e duhur.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incluar, që gjendet në AQP

VEPRAVE TË KLASIKËVE T'U RIKTHEHEMI VAZHDIMISHT

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

4 qershor 1976

SHOKU ENVER HOXHA: Unë dhe shumë shokë të tjerë nuk kemi studiuar në mënyrë skolareske. Ne kemi mësuar, studiuar, luftuar dhe kemi nxjerrë konkluzione jo vetëm nga mësimet, por edhe nga lufta që kemi bërë. Kështu ka ndodhur edhe me ju të tjerët. Mirëpo, ka njerëz që kanë mësuar diçka në shkollë dhe e shprechin idenë, të cilën e mbajnë mend të gjymtuar. Është mirë që formulimet e mendimeve të jenë ekzakte. Kjo gjë varet edhe nga njerëzit. Ka njerëz që në shkrimet e tyre futin shumë citate.

Edhe unë përdor citate, megjithëse jo shumë. Kur i përdor të perifrazuara, idenë e tyre e paraqes qartë. Por unë desha të theksoj se nuk e kam praktikuar metodën që t'u them punonjësve të aparatit të Komitetit

Qendror, për shembull: «Më nxirrni se ku ka folur Lenini për disiplinën proletare». Kur kam dashur të trajtoj diçka, jam thelluar duke studiuar vetë literaturë dhe praktikën tonë. Pra, kam lexuar dhe jam përpjekur t'i reflektoj ato që kam lexuar për atë që më është dashur. Por ka shokë që punojnë kryesisht duke ngarkuar të tjerët t'u nxjerrin citate.

Kjo nuk është e mirë. Nganjëherë, duket sikur përdorimi i shumë citateve tregon nivelin e lartë të atij që shkruan, se duket sikur shkruesi ose referuesi janë mbështetur në teori. Po të shikohen ato që kemi shkruar ne më përpara, do të dalë se në fillim jemi referuar në shumë citate.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, po kështu është. Nga nevoja e mbështetjes diku, prandaj ndodhte kjo.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga nevoja e mbështetjes, por në të njëjtën kohë dhe si për të qenë më të sigurt. Edhe kjo ishte një arsyе.

SHOKU HYSNI KAPO: Citati ishte si një argumentim, që ky mendim i shprehur është i drejtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ishte argumentimi që këtë gjë unë e kam drejt. Mungesa e eksperiencës na detyronte të vinim rrötull citateve. Me kohë u zgjerua horizonti ynë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Dhe Partia krijoj një eksperiencë të madhe.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, Partia grumbulloj një eksperiencë të pasur dhe, tok me Partinë, edhe ne fituam një ekspericencë të madhe, zgjeruam njoburitë

tona; në luftë u rrahëm me vaj e me uthull. Për ngritjen e nivelit tonë, ne studiuam në mënyrë individuale, një pjesë e inadhe e shokëve vajtën në shkolla. Na ndihmuam edhe i ndihmuam pér ngritjen e nivelit ideopolitik e kulturor. Kështu u bë kjo punë.

Ja, pér shembull, çfarë shikruhet pér titistët? Ne kemi shikruar shumë kundër tyre. Mirëpo, po të thellohesh në njohjen e tyre, del se ata janë anarkistë dhe quhen «komunistë». Ne e dimë gjithë historinë e zhvillimit të vetadministrimit jugosllav dhe të titizmit, por, në kushtet aktuale, mua më çshtë dashur t'i rikthehem studimit të këtij zhvillimi. U kam hedhur një sy edhe pikëpamjeve të Bakuninit. Nga gjithë ky kompleks, në qoftë se kuptoherët mirë, të del qartë se në ato vija ecën edhe Titoja. Por, po të thuash vetëm që Titoja është anarkosindikaliste dhe të mos shpjegosh arsyet që të çojnë në këtë konkluzion, atëherë nuk i thua asgjë masës, pra, nuk i jep asaj një pasqyrë konkrete të zhvillimit të vetadministrimit.

SHOKU RAMIZ ALIA: Dhe sidomos zhvillimit të anarkosindikalizmit në kushtet e sotme.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, në kushtet e sotme. Klasikët e marksizëm-leninizmit i kanë thënë dhe i kanë sqaruar këto probleme. Detyra jonë është që idetë e tyre t'i aplikojmë drejt dhe njëkohësisht t'ua bëjmë të njohura masave. Pér këtë mirë është t'u kthchemi studimit të veprave të tyre vazhdëmisht. Mund të jenë lexuar këto vepra në shkollë, por duhen rilexuar që të kuptoherët thellë e më thellë e të mos harrohen. Se

vetëm duke iu rikthyer vazhdimisht veprave të tyre,
çështjet do të na bëhen akoma më të qarta.

*Botohet pür herë të parë sipas
telstilit të nxjerrë nga biseda e
incizuar, që gjendet në AQP*

KUR SHIKOHET NË BAZË, TË KUJDESEMI PËR TË ZBULUAR GJENDJEN REALE TË PUNËVE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

14 qershor 1976

Mendoj se aparati i Komitetit Qendror, nga rezultatet e kontrolleve të ekipeve që kemi dërguar dhe po dërgojmë herë pas here në bazë, si dhe nga këto që na ndodhën në Gramsh, duhet të nxjerrë disa konkluzione:

E para, sekretarët dhe instruktorët e Komitetit Qendror të Partisë, si dhe zëvendëskrytarët e Këshij-Hit të Ministrave, ministrat, zëvendësministrat, e të tjërë, kur shkojnë nëpër rrethe, problemet duhet t'i shikojnë jo në mënyrë të sipërfaqshme, po me sy më kritik. Të shikosh problemet me sy kritik, sipas mendimit tim, nuk do të thotë t'i vësh gjërat në dyshim, por as të gjykosh në mënyrë të përciptë ose të kufizohesh në ndjekjen e një ose dy problemeve, për të cilat ka shkuar. Kur ministri i Bujqësisë, fjala vjen, apo dikush tjetër nga qendra, shkon në një rreth për të parë një

ose dy probleme, duhet të bëjë kujdes që të njohë gjendjen reale të punëve dhe, kur ndodhet përpëra një sekretari të parë partie i tipit të Mihal Dodbibës, apo ndonjë shefi të sektionit të bujqësisë, që mund të jetë i këtij tipi, të cilët përpinqen ta futin atë në thes, duke u përpjekur t'i jepin për çdo çështje një pasqyrë joreale, një gjendje të lustruar që ta kënaqin, nuk duhet të vihet në gjumi dhe të bjerë në pozitat e elementeve të tillë, por t'i shikojë punët me sy kritik. Kështu, shoku me përgjegjësi që shkon nga qendra, ta zëmë në Gramsh, kur zbulon gjatë qëndrimit të tij atje se plani nuk është realizuar në këtë ose në atë zë, këtë mos-realizim nuk duhet ta mbulojë, sikundër do të përpinqeshin në këtë rast ata të rrëthit. Ai nuk duhet të jetë i predispozuar as për t'u ia lichtuar fajet e gabimet, por të kërkojë shkaqet përsë kanë ngjarë këto gjëra; të zbulojë ku janë aty anët e dobëta, shkaqet objektive e subjektive, mungesa në fushën organizative etj. dhe të marrë masa për t'i ndrequr ato. Këtë gjë, më duket mua, nuk e bëjnë si duhet të gjithë shokët që venë në bazë.

E dyta, shokët tanë instruktorë, që venë nëpër rrethe për ndihmë dhe kontroll, duhet të kenë parasysh se puna e tyre ka edhe rolin e ndihmës, por edhe të kritikës, të zbulimit të anëve të mira, por edhe të dobësive, të gabimeve dhe të fajeve. Ata kanë një eksperiencë të madhe në këtë drejtim, prandaj kjo duhet t'i ndihmojë që t'u futen më thellë problemeve.

Për shembull, në Gramsh vajti disa kohë më parë një grup shokësh, por nuk zbuloi dot tërë atë punë të

sëmurë që ishte zhvilluar atje dhe që na u bë plotësisht e qartë vetëm kohët e fundit. Po pse nuk e zbuluan dot? Pikërisht për ato që thashë më përpara, se u shkohet problemeve në sipërsaqe, duke mos u thelluar si duhet në vendimin që mori Komiteti Qendror i Partisë përdënimin e Mihal Dodbibës. Shokët shkuan atje, si të thuash, vetëm sa për ta transmetuar këtë vendim, në vend që të kishin folur edhe më gjérë, jo vëtëm në bazë të shumë të dhënave që edhe atëherë njiheshin, por edhe vetë të gërmorin më tej për të zbuluar të gjitha ato të këqija që kishin hedhur rrënjenë të thella e përtë cilat nuk folën as shokët e rrethit, por qëndruan në ato që njihet Komiteti Qendror. Më vonë shokët instruktorë u shqetësuani shumë nga letrat e shumita që po i vinin Komitetit Qendror nga baza, nga njerëz të njobur e të panjohur etj., etj. Kjo bëri shumë efekt tek ata që, në mënyrë autokritike, arsyetuan me vete se përsë nuk u thelluan përtë t'ia bërë të njobur me kohë udhëheqjes kuadrin e plotë të gjendjes. Ky ka qenë një mësim i mirë për instrukturët e Komitetit Qendror.

Vajtja e tyre për herën e dytë (dhe, siç tregoi Hekurani [Isai] këtu ka rëndësi të madhe metoda që përdorën shokët instruktorë përtë t'iu futur në thellësi dhe në gjerësi këtyre problemeve) i bëri ata të mendojnë se kjo punë armiqësore nuk mund të jetë vepër e një ose e dy individëve, por diçka e organizuar dhe e lidhur edhe me armiqëtë kryesorë që zbuluan dhe dënuam, veprimtaria e të cilëve, duke zgjatur rrënjet e veta, kishte arritur deri në bazë. Prandaj, na bie neve për detyrë

që të zbulojmë gjithçka, me qëllim që ta kemi plotësisht të qartë situatën.

Këtë herë konstatojmë se ekipi që u dërgua nuk përbëhej vetëm nga instruktorë të aparatit të Komitetit Qendror. Natyrisht, köta kanë qenë kryesorët, sepse janë shokë me një eksperience të gjerë e të thellë. Metoda e punës që është ndjekur kësaj radhe në Gramsh na ndihmoi që situatën tash ta kemi të qartë. Shokët instruktorë të Komitetit Qendror kanë parë e kanë analizuar se si janë zhvilluar situatat në rrethe të ndryshme, si në Shkodër, në Përmet, në Kolonjë, në Sarandë e gjetkë. Por, në Gramsh, ata morën kësaj radhe edhe një shumicë kuadrosh të tjerë që ndihmuin për zbulimin e gjendjes së vërtetë të gjérave, duke pyetur e duke kontrolluar në një shkallë më të gjerë. Pastaj, të gjithë së bashku, duke i parë çështjet me sy kritik dhe në të gjitha hallkat, nga baza e deri në aparatin dhe në plenumin e komitetit të Partisë të rrethit, kanë nxjerrë qelbësirën në shesh dhe kanë arritur të konkludojnë.

Eshtë fakt se kur një sekretar i parë ndodhet, të mos themi në pozita armiqësore, sepse kjo do të ishte një gjë shumë e keqe, por në pozita të dobëta, kjo do të thotë se normat e Partisë ai, duke mos i pasur të qarla, jo vetëm i zbaton shtrembër, por me këtë influencon negativisht në drejtimin e gjithë punës së Partisë në rreth, që nga vetë komiteli i Partisë dhe deri në organizatat-bazë. Një i tillë sekretar, edhe sikur të mos dojë (dhe s'ka si të mos dojë), do të jetë i predispozuar të krijojë rreth vetes një grup njerëzish të sëmurë.

Faktet që na vure në dukje ti, shoku Hekuran, tregojnë se në krye të gjithë kësaj pune të sëmurë në Gramsh ka qenë vetë sekretari i parë, një njeri me vese të këqija dhe me koncepte ideologjike, politike, organizative dhe morale antiparti. Ky njeri, duke u lënë atje për shumë kohë, me përjashtim të disa njerëzve që kanë qenë të ndershëm, zëri i të cilëve nuk dëgjohej, krijoit në rreth, si të thuash, një udhëheqje krejt të sëmurë: prandaj edhe ngjanë të gjitha ato që u zbuluan, duke krijuar atje një situatë të vështirë.

Ekipi që u dërgua zbuloi jo vetëm gjithë ata që kanë qenë të infektuar nga veprimitaria armiqësore, por dhe të tjerë që kanë gabuar e që nuk janë armiq. Natyrisht, kur situatën e ke të qartë, atëherë edhe ndaj kuadrove do të merren masa të diserencuara, por që nuk do të jenë as liberale, as ekstremiste.

Nga gjithë kjo që zbuluam në Gramsh mund të nxjerrim edhe konkluzionin tjeter se veprimitaria armiqësore e zhvilluar atje mund të ketë pasur lidhje, në mënyrë të organizuar ose të paorganizuar, me grupet e armiqve që kemi zbuluar në qendër. Armiqtë kryesorë në qendër, qëllimin final mundet të mos ua kenë thënë njerëzve të tyre në rrethe, por edhe këta ishin të së njëjtës kategori; ishin «ushtarët» ose «oficerët» e kre-rëve në luftën që po organizohej kundër vijës dhe normave të Partisë, kundër urdhëresave të pushtetit, kundër ngritjes së ekonomisë, për shkatërrimin e unitetit të Partisë dhe për përbysjen e diktaturës së proleta-riatit në vendin tonë. Të gjithë, si ata kryesorët, edhe këta të Gramshit, kanë përdorur metodën e degjenc-

rimit të kuadrove, rrenën, vjedhjet, kanë ngrënë e kanë pirë në kurriz të shtetit dhe të kooperativave bujqësore. Krerët këtu në qendër kanë bërë, gjithashtu, një mijë e një gjëra të ulëta, me të cilat srymëzonin e orientonin në këtë rrugë edhe ata në rrethe. Të tillë njerëz si Mihal Dodbiba janë përpjekur të krijonin një gjendje të kalbur në rreth, që do të ishte parapërgatilja serioze e terrenit për të vënë në jetë qëllimet antiparti dhe antishitetërore të armiqve. Dhe, në momentin kur do të vepronin armiqjtë në qendër, atje ku ishin dhe ku ushtronin funksione partie ose shtetërore, do të vepron edhe ata të rretheve. Prandaj thashë se këta të fundit ishin «ushtarët» e «oficerët» e krerëve të qendrës.

E gjithë kjo na vë për deltyrë që të kemi parasysh se vigjilenca në punë ka kurdoherë rëndësi të madhe. Kur vete për të ndihmuar e për të kontrolluar në bazë, kuadri të mos shkojë sa për të kaluar radhën apo të veprojë në mënyrë të fjetur. Edhe kur shkon për një problem të vetëm, në rast se sheh që po i del përpara një njollë e zezë, ai duhet të ndalet, ta analizojë dhe të marrë masa që këtë njollë ta likuidojë. Kështu duhet kuptuar vigjilenca revolucionare, më duket mua. Por kjo nuk do t'ë thotë se duhet parë çdo gjë me dyshim. Ne nuk mund të pranojmë se një gjendje e tillë kishte ngjarë në të tëra rrethet. Të mos mendojmë sikur të tëra fajet e gabimet e njerëzve janë bërë me qëllim dhe në formë të organizuar. Këto, si të thuash, janë kryer në forma të ndryshme, janë zhvilluar edhe në kohë, edhe në gjerësi dhe nuk kanë arritur kudo në

shkallën e Gramshit. Por, shfaqje të tilla, sigurisht jo të atij niveli, shumë më të kufizuara, deri në kuadrin e një ose të dy individëve, mund të ketë edhe në rdonjë rrëth tjetër.

Për Partinë ka rëndësi çështja që çdo gjë të sinjalizohet me kohë, se kështu është më lehtë, si për të eliminuar punën e sëmurë, ashtu edhe për të shpëtuar njerëzit. Në fillim e keqja kufizohet te një ose dy veta, kështu që edhe për Partinë operacioni është me më pak dhembje. Kjo bën që fajtori të zbulohet nü kohë, të vihet përpëra faktave, të kritikohet, t'i tërhiqet veshi etj., etj. dhe, në qoftë se fajet janë të rënda, të merren edhe inasa kundër tij. Të tilla shfaqje, si në Gramsh, siç thashë, mund të na ngjasin edhe gjelkë. Këto duhet t'i shohim objektivisht, aq sa kanë, as t'i zmadhojnë, as t'i nënveftësojmë.

Nuk e di ç'mendim keni ju, por masat e marra mua më duket se janë të drejta, të matura, jo të ekzagje-ruara. Këtë çështje ne e kemi diskutuar veçanërisht me shokun Hysni. Kemi diskutuar, gjithashtu, bashkë se duhet të bëjmë shumë kujdes në çështjen e qëndrimit ndaj kuadrove, që kanë punuar nü aparatet shtetërore nën drejtimin e clementëve kryesorë armiq, qoftë të Beqir Ballukut e të Petrit Dumes me shokë në ushtri, qoftë të Abdyl Köllezit, Koço Theodhosit e të tjerë në sektorët ekonomikë.

Të bëhet kujdes për t'u ruajtur nga ekstremizmat! Është e qartë se ka kuadro e komunistë që nuk kanë qenë vigjilentë, që kanë vënë re shkelje e veprime të padrejta, por nuk kanë reaguar si revolucionarë, për-

kundrazi, kanë qëndruar indiferentë, kurse për përgjegjësitë që kishin duhet të viheshin në lëvizje, diçka të thoshin osc të sinjalizonin. Por, ka edhe nga ata që kanë folur dhe që u është mbytur zëri.

Në gjithë këtë gamë të metash e gabimesh që janë vërtetuar, duhet të jemi të matur, të tregohemi të pjetur, se puna armiqësore që kemi zbuluar është zhvilluar për një kohë shumë të gjatë dhe nga armiq që kanë qenë në kokë të Partisë, autoriteti i të cilëve ka ushtruar një ndikim negativ në kuadrot vartës. Këtë ta kemi parasysh jo si një faktor shfajësues, por se vartësit, duke pasur besim në udhëheqjen e Partisë, kanë ushqyer dashuri dhe respekt pör këta njerëz që bënин pjesë në udhëheqje. Megjithatë, ka pasur edhe kuadro me koncepte e botëkuptime mikroborgjeze, të cilët nuk i kundërshtonin ato anë negative që shikonin te këta armiq, duke menduar se gjoja udhëheqja i dinte pikëpamjet dhe veprimet e tyre, se ata flisnin në emër të udhëheqjes. Por, të marrim tash masa ekstreme, duke përjashtuar nga Partia njerëz që s'duhen përjashtuar, do të bënim gabim, pse të tillë njerëz, që ne i kemi emëruar në punë me përgjegjësi, si drejtore, zë-vendësministra e të tjera, i kemi zgjedhur vetë dhe ata kanë punuar dhe kanë luftuar atje ku kanë qenë caktuar. Rrallë ka qëlluar të na kenë shpëtuar nëpër dikastere kuadro të pakontrolluar, sepse të tërë ata kryesorët i kemi shkuar vetë në shoshë. Pastaj, të kemi parasysh se çdonjëri nga këta ka pas vetes edhe një rreth të gjerë, një fis të tërë, që janë njerëz të mirë e besnikë të Partisë.

Partia nuk na mëson që për t'u bërë qejfin njërzve të një fisi të mos dënojmë disa elementë armiq të rrezikshëm si Abdyl Köllezi, Kiço Ngjela, Vasil Kati, ndonjë kusar që ka vjedhur apo ndonjë spiun. Jo! Njerëz të tillë Partia jo vetëm do t'i ndëshkojë, duke i përjashtuar nga radhët e veta, por edhe duke i dënuar sipas shkallës së fajit. Por, edhe njerëzve të fisit Partia duhet t'ua bëjë të qartë arsyen e dënimit. Prej tyre, ata që do të mbajnë qëndrim me partishmëri, nuk duhet t'i përbuzim, sepse familja, motrat, vëllezërit, hallat, tezet, dajat etj., etj. të këtyre njerëzve, janë tanët. S'ka dyshim që këta ndiejnë një dhimbje dhe dëshpërim të madh, kur dëgjojnë që një i afërt i tyre, djali i tezes, i xhaxhait, i dajës apo i hallës doli tradhtar; megjithatë nuk duhen parë me sy të shtrembër, kur e dënojnë armikun dhe i qëndrojnë besnikë vijës së Partisë.

Si konkluzion, nuk duhet të lejojmë as opinionin, as anëtarët e Partisë të mbajnë qëndrimin ekstreme. Ne duhet ta përpunojmë opinionin që ta shikojë drejt dhe në rrugë partie këllë mori njerëzish që janë tanët, ndryshe do të na krijohet një situatë jashtëzakonisht e vështirë dhe armiku pikërisht këtë dëshiron, që ne të humbasim njerëzit dhe bazat tonë, të na ikin nga dora të afërmit e tyre që janë njerëzit tanë. Edhe Kiço Ngjela ishte yni dikur, por ai u bë tradhtar, sikundër u bë tradhtar Abdyl Köllezi, apo kohë më parë Tuk Jakova e të tjerë. Kështu, nga pjesëtarët e rrëthit familjar të armiqve, në qoftë se vërtetohet që ndonjëri ka faj, duhet të mbahet qëndrim kundër tij. Të tjerët që nuk

kanë saj, dhe që vazhdojnë të ecin në rrugën e Partisë, t'i mbrojmë. E them këtë, sepse ka tendencë drejt sektarizmit, drejt goditjes nga ana e disave, pa marrë parasysh qëndrimet individualë të secilit. Mirëpo qëndrimet sektare i sjellin dëm Partisë, ashtu si edhe qëndrimet liberale e oportuniste. Ne duhet të jemi vigjilentë kur është fjala për fëmijët e armiqve, që kanë qenë drejtpërdrejt të lidhur ngushtë me prindërit e tyre, por djalin e hallës apo të tezes, osc një kushëri të tretë, përsë t'i përziejmë me köta tradhtarë, kur s'kanë pasur asnjë lidhje me ta?! Në këto çështje duhet kujdes, se në jetë vërtetohen qëndrime jo të drejta.

Më ankohej, para ca kohe, me një letër një person se e kishin përjashtuar nga Partia, apo nuk dî ç'masë kishin marrë kundër tij, se djali i dajës së babait ka pasë qenë me Ballin! Nuk mund të ecet kështu, shokë! Ne duhet të shikojmë nëse vetë ky, nipi i nipit, mban qëndrim të drejtë partie dhc mbi bazën e qëndrimit të tij të gjykojmë e të mos veprohet si me atë rastin që na tregoi shoku Hekuran, që njërit përpinqeshin t'i zbulonin ndonjë kleçkë pér gjyshin se s'paskësh qëndruar në irregull në kohën e Austrisë, në vitin 1914 (!).

Kur na dalin të tilla probleme, si në Gramsh, mirë është të organizojmë ekipe. Kurse kur ka ngjarje më të kufizuara, instruktorët mund të venë edhe vetë ose të dërgohen ekipe më të vogla, të kryesuara prej tyre.

Ne themi ngahera që ta dëgjojmë me kujdes bazën e, në radhë të parë, Partinë në bazë, si dhc të vlerësojmë çdo të dhënë që na del përpara. Jo vetëm të marrim kontakt me njerëzit, por të lexojmë me kujdes

edhe protokollet e mbledhjeve të organizatave të Partisë, pse, me siguri, edhe nëpërmjet tyre do të zbulojmë me kohë të palarat dhe do të pastrojmë situatën. Gjërat që na dalin përpara në asnje rast nuk u duhet vënë kapaku!

Lidhur me këtë që thashë të kemi shumë kujdes edhe për mbajtjen e protokolleve në Parti. Në këtë drejtim duhet të ketë përmirësimë dhe jam i bindur për këtë. Megjithatë, këtij problemi le t'i rikthehem i edhe një herë, pse protokollet janë jeta e organizatave të Partisë, në to pasqyrohen problemet që shqyrtohen, diskutimet e debatet që zhvillohen gjatë mbledhjeve dhe qëndrimet e shokëve.

Për këtë qëllim, shoku Hekuran, pa u ngarkuar shumë, mendoj të gjesh një kohë dhe të tërheqësh nga çdo rrëth protokollin e një organizate-bazë. T'u thuash, fjala vjen, shokëve të organizatës së Tiranes se dëshiron të lexosh protokollet e organizatës së Partisë të muajit mars, ta zëmë, të kombinatit të tekstileve «Stalin». Merrini ato, shikojini me dy-tre shokë që ke në vartësi. Shikoni sidomos kanë apo nuk kanë bukë këto protokolle, nga ç'boshllëqe e të meta vuajnë, e janin idenë e vërtetë se ç'probleme të rëndësishme e kanë preokupuar atë organizatë, a u kanë hyrë thellë atyre apo jo dhe nëse i kanë zgjidhur drejt ato etj.

Nga të gjitha këto që do të studioni, ju mund të nxirri një sërë konkluzionesh. Pastaj, mendej unë, shokët që do të ngarkosh dhe që kanë eksperiencë në këtë drejtim (se ata kanë e duhet të kenë kënduar protokolle para se të kenë shkuar nëpër mbledhjet e orga-

nizatave) të përgatisin një material kritik dhe edukues për Partinë, ku të silitet për rëndësinë e protokolleve, çfarë dobësic konstatohet në punën me to dhe si duhet të ndërtohen. Kjo është një punë që, natyrisht, nuk bëhet me një të rënë të shkopit. Ai që ngarkohet të mbajë protokollin në mbledhjen e organizatës së Partisë duhet të jetë nga shokët më të mirë e më të aftë, jo në kuptimin që të dijë të ndërtojë fraza, por të jetë në gjendje të konceptojë përnjëherë problemin, debatin, zgjidhjen dhe konkluzionin e, në mënyrë të përmbledhur, t'i pasqyrojë këlo në protokoll. Në këto drejtime duhet të ketë zotësi ai dhe jo të përpinqet për të shkruar fjalë përfjalë gjithçka që thuhet, se nuk e bën dot. Ai ta ndjekë e ta dëgjojë diskutantin me vëmendje kur flet e, pastaj, të shënojë qartë në protokoll esencën e diskutimit, të propozimit, të debatit apo të konkluzionit. Me një fjalë, ai që mban protokollin duhet të përpinqet që ta konceptojë drejt atë që silitet, pasi të ketë dëgjuar thelbin e çështjes. Në protokoll duhet të figurojnë përbledhtas të gjitha mendimet e diskutantëve dhe, në fund, vendimi që merret. Një protokoll i mbajtur kështu do të jetë një ndihmë e madhe, në radhë të parë përvetë organizatën-bazë, e cila do ta ketë atë si orientim. Por, ai do të jetë një ndihmë e madhe edhe për komitetin e Partisë të rrëthit edhe për nekëtu, në Komitetin Qendror, kur do të kemi nevojë përtë dhe mund ta kërkojmë.

Ne, anëtarët e Byrosë Politike dhe të Qeverisë, lexojmë me vërejtje të madhe letrat që na dërgojnë njerezit e popullit. Po sa rëndësi do të ketë për punën e

Partisë që çdo javë të kemi përpëra edhe dy ose tre protokolle organizatash-bazë, ose nga një në çdo ditë. Sikur ta vëmë këtë në praktikën e punës sonë, do të na shërbejë shumë, pse do të jemi në dijeni se si luftojnë organizatat-bazë, sepse mënyra se si punojnë dhe si luftojnë ato tash, na vjen në mënyrë shumë-shumë të përmbledhur ose të pjesshme, ose s'na vjen fare. Ashtu si edhe ju, shokë, unë lexoj çdo ditë përbledhjen e dhjetëra letrave që më bëjnë shokët e aparatit çdo ditë. Mbi këto materialc unë bëj edhe shënim. Atëherë, përsë të mos lexojmë ne herë pas here edhe procesverbale të mbledhjeve të Partisë? Prandaj, mendoj të kërkojmë nga rrëthet që të na dërgojnë nga një procesverbal nga disa organizata që do t'u caktojmë ne, të cilat pastaj mund t'ua kthejmë përsëri.

Mendoj të bëjmë edhe një tjetër: të kërkojmë të na dërgojnë për të lexuar edhe protokolle të byrove të komiteteve të Partisë. Ndonjë mund të jetë shumë i madh. Por, në këtë rast, të ngarkojmë shokë që të na përgatitin një material të reduktuar, sa për të pasur një ide mbi çështjet që shtrohen.

Në komitetet e Partisë në rrëthe këtë punë e kemi mirë, se në mbledhjet mbahen shënimet me stenogram, por çështja është të bëhet kujdes në organizatat-bazë që protokollet të mbahen sa më të rregullta e të sakta. Shokët e bazës duhet ta dinë se ato mund të kërkohen edhe nga Komiteti Qendror i Partisë, prandaj të tëra organizatat-bazë jo vetëm të vihen në dijeni për këtë, por edhe të instruktohen se si të punojnë. Kjo është një punë me përgjegjësi, veçanërisht e shokut që ngar-

kohet me mbajtjen e protokollit, prandaj ai duhet të jetë në gjendje ta mbajë atë sa më në rregull. Për këtë qëllim nëpërmjet një instruktori mund t'u jepet edhe ndihmë konkrete duke i udhëzuar se si duhet mbajtur protokolli.

Neve na dërgohen këtu rendet e ditës të mbledhjeve të byrove të komiteteve të Partisë të rretheve dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Këto le të vazhdojmë t'i marrim. Por, të mos kufizohemi me kaq. Kur shikojmë se një problem i intereson një sekretari të Komitetit Qendror, apo ndonjë tjetri e kështu me radhë, secili, sipas nevojës, mund të kërkojë nga komiteti i Partisë që të shikojë edhe raportin, edhe diskutimet. Atëherë, rrethi, mund të ngarkohet që, për problemin e naftës, fjala vjen, të dërgojë në aparatin e Komitetit Qendror raportin që është mbajtur në byro, si dhe diskutime fërashësore të një ose dy shokëve. Këtë ju mund që e bëni, por kini kujdes që të mos ngarkoheni shumë, se pastaj po të bëhet kjo punë vazhdimit të çdo ditë, do t'ju zënë këmbët gjithë këto materiale. Prandaj, të kërkojmë për të parë ato materiale që gjykojmë se duhen shikuar.

Tash, përvëç të tjerave, mendoj që shoku Hekurran, të gjitha këto që na raportoi këtu, në një mbledhje me gjithë instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror, t'ua bëjë të njohura edhe atyre e t'ua shtjellojë kështu si na foli neve, sepse janë kuadro me eksperiençë. Këtu, mendoj unë, ka rëndësi t'u vihet në dukje mënyra e përgatitjes së programit, të metodës dhe të stilit të punës që u ndoq për zbulimin e kësaj veprimtare.

rie arimiqësore, e cila kishte marrë përpjesëtime shqetësuese dhe se si qe organizuar konkretisht kjo veprimtari. Është e nevojshme ta dinë, ta njohin dhe ta kenë parasysh këtë eksperiencë të hidhur kuadrot tanë kryesorë në punën e tyre të rëndësishme që kanë.

Atëherë, shokë, t'i kemi parasysh këto që thamë!

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

PA PROJEKTE E STUDIME PARAPRAKE, NUK KA PLANIFIKIM SHKENCOR

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

16 qershor 1976

Për veprat që do të ndërtohen në këtë pesëvjeçar¹ a janë bërë preventivat për të parë se sa na kushton secila dhë, mbi këtë bazë, të caktojmë fondet? Nëse janë caktuar këto fonde, në ç'bazë i keni parashikuar? Po ashtu, edhe për veprat që i ndërtojmë tërësisht me forcat tona duhet të kemi projekte dhe, nëse nuk kemi, t'i bëjmë. Atëherë, fordin e këtyre si e përcaktioni ju në Komisionin e Planit të Shtetit? Mos ia paraqitni mië parë Qeverisë dhe kjo na e paraqet neve më pas? Sa është tërë fondi që keni caktuar për ndërtimet në gjithë Republikën, pra, sa investime janë parashikuar?

E di pse e kërkojmë ne këtë? Për arsyec se fondet për ndërtime kurrrë nuk kanë qenë parashikuar ekzaktësisht dhe kjo ka sjellë vazhdimisht tejkalim të fonde-

1. Fjala është për pesëvjeçarin e gjashë (1976-1980).

ve, gjë që ka rrjedhur nga parashikimi i gabuar ose për arsy se kanë livadhisur ndërtuesit, investitorët e planifikuesit. Këto dy gjëra na kanë ngjarë dhe kanë shkaktuar çrregullimet që dihen, prandaj, duhen mbajtur mirë parasysh në projektplanin që ju i paraqitni Partisë dhe Qeverisë lidhur me përpjesëtimet e priorititetet e investimeve sipas degëve, për vleftat e plota të objekteve etj. Pasi të miratohen, dihet që ato pastaj u jepen dikastereve për saktësime e për studimet e nevojshme.

Siq e dimë, na vijnë kërkesa edhe nga baza. Posi na vijnë këto: brenda kufijve që kemi caktuar, jashtë tyre apo më pak? Këto çështje kanë rëndësi të madhe në hartinin e planit pesëvjeçar sepse edhe planet vjetore në bazë të tyre do të hartohcen. Po ashtu edhe çështja e përllogaritjeve për investimet konkrete që bëjmë bie fjala, për Uzinën e Përpunimit të Naftës në Ballsh, duhet llogaritur drejt, që ato të mund të realizohen në kohë e me saktësi. Neve na intereson që caktimi i fondeve për veprat të bëhet me projekte e preventiva dhe jo me analogji me veprat e ndërtuara më parë. Ajo që u tha këtu se për shumë vepra nuk ka projekte e preventiva, duhet ndrequr. Po munguan këto, atëherë ndodh ajo që për të gjitha veprat tejkalojen fondet e caktuara. Po pse të tejkalojen? Derisa ne kemi eksperiencën e një veprë që është mbaruar, për të cilën janë bërë preventivat dhe projektet, atëherë nuk ka përsë të tejkalojen fondet. Pse janë tejkaluar shpenzimet për azotikun, duhet medoemos të tejkalojen edhe për të tjerat?! Ne kështu po shkojmë vazhdimisht

misht drejt asaj që i tejkalojmë fonde për veprat. Kështu si po veprohet, plani është formal e nuk është ligj. Tash ne, me këto pasuri që kemi, do të vazhdojmë të bëjmë shumë ndërtime. Por, si mendohet ta orientojmë zhvillimin e ekonomisë me këta punëtorë, me këtë akumulim, me këto fonde dhe me këto mjete që kemi në dispozicion? Si është bërë shpërndarja e gjithë këtyre veprave në drejtime të ndryshme të ekonomisë sonë?

SHOKU PETRO DODE¹: Këto janë bërë në bazë të studimit paraprak që iu paraqit Byrosë Politike dhe që u shqyrtua nga ministritë, Komisioni i Planit të Shtetit dhe Qeveria, në muajin shkurt. Pra, janë bërë në bazë të kuotave që u caktuan duke pasur për bazë orientimet e Byrosë Politike.

SHOKU ENVER HOXHA: Dikasteret mund të vendosin si u vjen më për mbarë, drejt ose me ekzagjerime etj. Pastaj, këto parashikime ju erdhën juve të Komisionit të Planit. Atëherë në ç'mënyrë, me ç'forma e ç'metoda i përpunuat ju këto kërkesa të dikastereve? Fjala vjen, një dikaster, ai i Bujqësisë, për shembull, ka dërguar në Komisionin e Planit propozimin se dëshiron ta zhvillojë ekonominë bujqësore në këtë dhe atë drejtim; për këto do kaq fonde për ujitjen, kaq për mekanizmin, kaq për plehërim etj. Për t'i realizuuar këto, i duhet të ndërtojë këtë dhe atë objekt etj.

1. Në këtë takim merrete pjesë edhe shoku Petro Dode, në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.

Ta marrim një çikë shtruar këtë çështje, se është e rëndësishme dhe shumë e kockavitet. Ju thatë se kuotat që miratohen nga Byroja Politike janë bazë për hartimin e pesëvjeçarit. Duhet kupluar mirë se çdo të thotë të japësh kuotat. Të japësh kuotat do të thotë të dish sa para ke në dispozicion, të dish, bie fjala sa çimento mund të prodhosh gjatë pesëvjeçarit, duke u mbështetur në aftësitë prodhuese ekzistuese, sa makina metalprerëse ke dhe sa prodhim mund të jepin, sa hektarë panxhar do të mbjellësh etj., etj. Këto në fund të planit pesëvjeçar sjellin të ardhurat që llogariten edhe si materiale, edhe si mjete monetare etj. Natyrisht, këto bëhen në mënyrë të përafërt, meqenëse, në vitin e fundit të pesëvjeçarit që përfundon, nuk është bërë akoma mbyllja e llogarive. Për katër vjetët e parë llogaritë kanë përfunduar, kurse për të pestin akoma. Kjo do të thotë se Komisioni i Planit të Shtetit e di që gjatë katër vjetëve të tjera janë prodhuar, për shembull, kaq sheqer, por janë konsumuar më tepër se edhe kemi importuar: por ai e di, gjithashtu, se vitin tjetër do të prodrojmë edhe kaq. Prandaj nga fushat e mbjella me panxharsheqeri do të sigurojmë kaq prodhim në pesë vjetët e ardhshëm.

Pra, Komisioni i Planit të Shtetit, duke i pasur të tëra këto të dhëna për planin e ardhshëm pesëvjeçar dhe duke i përpunuar ato, do të jetë në gjendje të dijë se ç'pasuri ka shteti, ç'makineri, sa do të jenë të ardhurat neto, nxirret edhe kapaciteti prodhues i fabrikave, tatimi mbi xhiro, fitimet etj. Pastaj, nga të tëra këto, studiohen të dhënrat dhe të gjitha së bashku

i venë Qeverisë. Domethënë, mbi këtë baza i keni studiuar e i keni caktuar ju shifrat? Të marrim, për shembull, industrinë që është një kapitull i tërë më vete. Për këtë Qeverisë do t'i luhet se ç'ka realizuar ajo dhe ç'kapacitet ka; mbi këtë bazë, po të investojmë edhe kaq (dhe për këtë i kemi mundësitet se llogaritë i kemi bërë), mund të arrijmë këtë shtesë. Për ta bërë këtë, ju ndihmojnë edhe statistikat, pra, për të investuar atje ku ka më shumë nevojë populli dhe jo, ta zëmë, në tekstil, por edhe në drejtime të tjera. Ju, në këtë mënyrë, e ndihmoni Qeverinë për t'u orientuar sa më mirë, për arsyse se e keni ndjekur realizimin e planit në proces.

Kjo punë a bëhet në këtë mënyrë apo është gjetur një formë shumë sempliste dhe në vija të përgjithshme, domethënë Qeveria ju komunikon se ka aprovuar propozimet tuaja e ndryshimet që ka bërë dhe pastaj ju njoftoni çdo dikaster. Këshlu, ministritë punojnë brenda «jorganit», për hartimin e planit, në pjesë të veçanta të të cilit, nganjëherë, bëjnë ndryshime se nuk është e lëhen që ju të planit, i keni studiuar mirë, ekzaktisht të gjitha problemet. Këlu duhet të mbahen mirë parasysh edhe propozimet e bazës, e cila jep mendimin e vet.

Këto procedura, duhet të ndiqen jo vetëm nga ana formale, por në thellësi, në substancë, të bazuara në të dhëna, në fakte dhe në orientimet që jepen.

Unë nuk u futa këtu as në projekte, as në preventiva, se ky është një problem tjetër. Por, me projekte apo pa projekte ne tash e kemi përfurquar planin

pesëvjeçar. Shifrat e katër vjetëve të parë ne i kemi të dokumentuara, vetëm për vitin 1975 i kemi parapra-ke. Tasli në këto baza duhet të hartojmë ne planin e ri, pra, duhet t'i bëjmë ekzakte, natyrisht në mënyrë re-lative, por të bazuara. Për shembull, ju i thoni Qeverisë se do të ndërtohet ky ose ai objekt. Por të keni parasysh se a disponohen materialet e nevojshme? Në qoftë se del që nuk ka, duhet diskutuar se nga do të nxirren. Atëherë, Komisioni i Planit duhet të gërmojë mos ka fonde gjékundi, në ndonjë qoshe, si, për shembull, në sektorin komunal, për ndonjë punim jo të dorës së parë që mund të mos e bëjmë tani për tanit dhe ta heqim nga plani, për t'ia dhënë objektit që po diskutojmë, sepse ky ka interes të madh për shtetin, ose se na sigu-ron valutë etj. Një diskutim i tillë më duket mua, ka rëndësi të madhe.

Rezultatet e pesëvjeçarit të kaluar (si ato që janë realizuar dhe ato që priten për vitin 1975 etj.), ju, si Komision i Planit dhe drejtore përkatëse që keni atje, si e industrisë, e bujqësisë etj., duhet t'i keni së bazë mbështetëse dhe, duke pasur të qarta edhe orientimet e dhëna, të nxirrni konkluzionin se mund të merrej më shumë prodhim, se mosrealizimi i planit ka shkak-tuar këto humbje etj. Drejtoria e industrisë që është te ju, fjala vjen, propozon që në industri të bëhen apo të mos bëhen këto investime; masat që duhet të merren ose të mos merren studion se sa mund të jenë afërsisht shifrat e pesëvjeçarit të ardhshëm për industrinë dhe disa konsiderata të tjera.

Të tëra këto përbëjnë kështu punën përgatitore të

Komisionit të Planit. Mund të thërritet për shembull, ministri i Industrisë dhe të pyetet nëse kanë menduar e kanë diskutuar gjë për pesëvjeçarin e ardhshëm, në dikasterin që drejton ai, se dhe ata duhet të shqetësohen për planin, kështu si ju. Ai mund të përgjigjet se këtë çështje nuk e kanë parë sarc, ose që kanë parashikuar të bëjnë aq c'kaq investime dhe në ç'drejtime. Se dhe ata mund të kenë bërë llogari se sa do të kushtojnë objektet e të kenë parashikuar edhe se sa akumulime parashikojnë t'i jepin shtetit, të kenë analizuar humbjet që kanë pasur etj., etj. Atëherë, po dha edhe ai shifrat, jemi më në gjendje të diskutojmë për problemet që kemi përpala dhe, po qe e nevojshme, mund t'i bëjmë edhe vërejtje.

Ministri i Industrisë, për shembull, mund të mos jetë dakord me pikëpamjet tuaja, ashtu sikundër mund të mos jeni edhe ju dakord me ato të tij. Por ama idetë e tij ju i dini, sikurse dini edhe idetë e gjithë të tjera. Atëherë, pas një diskutimi të tillë, me të gjitha dikasteret, ju i bëni raportin Qeverisë. Në këtë raport ju vini në dukje se jeni në dijeni edhe të pikëpamjeve c' të kërkesave të ministrive. Ju mund të theksoni aty se për industrinë, duke marrë parasysh këta dhe ata faktorë, mundësitë materialec dhe finanziare që disponojmë etj., nuk kemi qenë dakord me Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave në këto e ato drejtime, sepse i ka parashikuar ca si të tepërtë kërkesat që përsaqësojnë një shumë prej kaq milionësh. Këto shpenzime, nën vizoni ju, nuk do të na jepin ato të ardhura që do të na jepnin, po t'i investojmë këto

fonde materiale dhe monetare në disa drejtime të tjera. Pastaj, po qe e nevojshme, i bëni Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave edhe një kritikë, duke i vënë në dukje se kanë qenë të tëra mundësitet për të realizuar planet dhe ajo nuk e ka arritur këtë. Qeveria mund të marrë parasysh mendimet tuaja, por mund të bjerë dakord edhe me mendimet e ministrit të Industrisë e të Minierave. Veçse ajo duhet të ketë parasysh se këto që po i parashtroni ju janë të dhëna që bazohen në të ardhurat e gjithë republikës, se ju, si Komision i Planit të Shtetit, keni bërë studime dhe llogari për gjithë ekonominë e vendit, kurse secili ministër shikon vetëm «shtëpinë» e vet.

Kam mendimin se, kështu si po e bisedojmë ne, nuk punon gjithë «truri» i Komisionit të Planit. Në kemi thënë vazhdimisht se atje statistika nuk punonte siç duhej e prej saj nuk dilnin studime që të pasqyronin, në shifra, realizimet e planeve. Nga këto studime duhet të dalin edhe konkluzionet pse ndodhin këto, qysh, tek etj. Statistika disponon të gjitha të dhënat për sasinë e cilësinë e prodhimeve, për rezervat materiale të prodhimit, për stoqet e për çdo gjë tjetër që të ndihmon të orientohesh në shumë gjëra. Të gjithë treguesit e planeve tona, të ekonomisë, të kulturës etj. grumbullohen në Komisionin e Planit. Ky duhet të funksionojë si një makinë elektronike, ku, në vend të elektroneve pa ndërgjegje, punojnë njerëz me logjikë, të orientuar nga politika e drejtë e Partisë. Në qoftë se nuk ekziston të ne një aparat i tillë, që të ndërmarrë studime prej të dhënavë statistikore, ky

duhet krijuar; këtë na e kërkon tani stadi i zhvillimit të ekonomisë. Nevojat duhet të krijojnë aparatet dhe jo t'i ngremë ato kot. Por, kur del një detyrë për ta kryer, këtë do ta bëjë dikush. Atëherë, këtë ose ia jepim aparatit ekzistues ta kryejë ose do të krijojmë një aparat tjetër të ri. Pra, që të bëhet kjo që them unë, duhet të punojë i tërë «truri» i Komisionit të Planit dhe të japë mendime mbi të dhënrat. Mua më duket se një punë e tillë tani për tani nuk po bëhet.

Në Komisionin e Planit duhet të bëhet një punë e organizuar mirë studimore që të arrijë në konkluzione të arsyeshme për të gjitha problemet, sidomos në momente të caktuara kyç. Të tilla statistika i duhen detyrimisht aparatit tuaj për të hartuar planin e çdo viti që vjen, të një pesëvjeçari ose për të bërë ndryshime në strukturën e një zëri që do t'ia paraqitë për aprovim Qeverisë.

Tash të rikthehem i teplani i ri pesëvjeçar. Gjatë gjithë kohës që ka mbetur, ky duhet të bëhet objekt i një diskutimi të gjerë e të thellë në Komisionin e Planit, i cili të dalë me konkluzione për çdo degë të ekonomisë, në bazë të të dhënave të pesëvjeçarit të realizuar. Materiali më parë se të vejë në Qeveri, mendoj se duhet të shikohet me ministritë përkatëse. Ky është një diskutim pa angazhime përfundimtare për projektplanin. Pasi diskutohet edhe me ministritë, Komisioni i Planit ia jep studimin Qeverisë, e cila e analizon atë në mënyrën që thashë. Pas kësaj Qeveria ia paraqet Byrosë Politike, e cila e shqyrton dhe konkludon për investimet kryesore që mendohet të bë-

hen për nivelet e prodhimeve etj. Ne marrim ato vendime që kemi për të marrë dhe ia kthejmë Qeverisë, e cila mblidhet, bën të njohura vendimet që ka marrë Byroja Politike dhe komunikon se cilat fonde ka pranuar ajo. Dikasteret i ristudiojnë këto dhe ia dërgojnë përsëri Komisionit të Planit ku shqyrtohet puna e kryer siç po bëhet tash etj., etj. Këto plane i shkojnë Qeverisë dhe atje gjyket se kush i ka tejkaluar kuotat, e kush jo, kush jep prodhim kaq sa është parashikuar e kush më pak; cili dikaster kërkon punëtorë më shumë dhe cili nuk kërkon etj., etj. Pas diskutimeve, arrijmë pak a shumë në një plan të detajuar, i cili vjen prapë te ne, në Byronë Politike, ku marrim vendimin përkatës përfundimtar për planin, të cilin ia paraqesim Komitetit Qendror. Ky është «marshruti»¹ që bëhet. Por, brenda gjithë kësaj rruge, si kryhet kjo punë?

SHOKU PETRO DODE: Si formë, si procedurë, si rregull ajo çshtë bërë, ashtu siç thatë ju, shoku Enver. Por, në përbajtjen e punës që bëjmë, është shumë e drejtë vërcjtja që bëni.

SHOKÙ ENVER HOXHA: Komisioni i Planit të Shtetit duhet t'i përpunojë me kujdes të gjitha të dhënat e kohës e të perspektivës, të nxjerrë konkluzione e probleme për të ndihmuar Qeverinë dhe Byronë Politike në momente të caktuara ose kur hartohet plani. Abdyl Këllezi i ka lënë mënjanë këto çështje dhe ky është një sabotim i madh. Ai ka krijuar një frymë të

1. Këtu është përdorur në kuptimin: rruga e ndjekur.

sëmurrë në kuadrot e Komisionit të Planit, shumica e të cilëve nuk kanë qenë të këqij. Ai e quante veten njeri të plotfuqishëm. I vihej rëndësi objektit, pa se sa kushtonte ai, që është kryesorja, kjo anë as që shihet! Kjo ka bërë që të gjitha të dhënata tjetra të domosdoshme të planit të shiheshin me një sy tjetër: «Le të bëhet si të bëhet një vepër; le të realizohet si të realizohet ajo; le të ndërtohet kur të ndërtohet me vleftën aproksimative që kemi caktuar ose, fundja, edhe po të rritet ajo, nuk prish punë; të gjitha këto mungesa e vështirësi ne i rregullojmë në Qeveri», thoshte ai. Këtë takтикë përdorte Abdyl Këllezi. Dhe, në Qeveri, ai mbante tjetër qëndrim, duke sulmuar ministrat: «Ti nuk ke bërë këtë, ti nuk ke bërë atë!». Por, në fakt, ishte kryesisht ai që nuk e kryente detyrën, që çrre-gullonte drejtimin e planifikuar të ekonomisë. Objek-tivi i tij ishte vendosja e decentralizimit, domethënë t'i hapej rrugë anarkisë. Pra, nga një anë disa kërkesa të padrejta i mbështeste e i propagandonte dhe, nga ana tjetër, krijonte anarkinë.

Por, këtu nuk ishte çështja vetëm te Komisioni i Planit që drejtonte ai. Sipas tij, ai ishte «koka» e ekonomisë sonë dhe e studimeve për të. Por, kjo ekonomi ka degët e saj, që kërkojnë planifikime të vecanta, si në dikastere, në komitete ekzekutive, në ndërmarrje, në kooperativa e kudo ku prodhohet.

Janë dhënë disa udhëzime e direktiva, mund të jenë botuar edhe dokumente e broshura, por, nuk është punuar në një formë të tilla që Komisioni i Planit, si organ kyç, t'i kuptonte si duhet këto probleme teo-

rikiti, politikisht e organizativisht dhe të bënte një punë partie e shtetërore me të vërtetë serioze. Kjo ka bërë që në të gjitha hallkat e prodhimit të mos ndihej disiplina e planit, i cili është ligj.

Kur ndaleni në problemet e planit e të realizimit të tij, në qoftë se nuk bini dakord me ministritë, gjykimin dhe masën e jep Qeveria. Një gjë e tillë nuk bëhej kështu, po bëhej e kundërtat. Megjithatë Abdyl Këllezzi nuk ia arriti qëllimit, sepse nuk ishte e organizuar puna ashtu siç donte ai, pasi ne nuk mund të themi që gjithë planoviköt tanë ishin për anarkinë. Pjesa më e madhe e tyre ishin për këto probleme siç po i themi këtu, por te disa nga ata spikatnin pikëpamjet e decentralizmit dhe të anarkisë.

SHOKU HYSNI KAPO: Po të mos kërkohet vazhdimisht një disiplinë e rreptë, siç thoni ju, shoku Enver, ka rrezik të krijohet përsëri një gjendje e tillë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të mos kërkosh një disiplinë të rreptë dhe nga ana tjeter të kultivosh prepotencën, duke bërë që vartësit të mos i qëndrojnë përballë ministrit, zëvendësministrat, drejtoret, njërit apo tjetrit, do të thotë të shohësh që shkelet e shtrembohet via e Partisë dhe të bësh lëshim. Një qëndrim i tillë i bëri ata që ishin në kyçet e ekonomisë, si: Koco Theodhos, Abdyl Këllezzi, Kiço Ngjela e të tjerë që të vendosnin sipas dëshirës e jashtë rregullave dhe të tjerët të mos pyteshin fare. Ju e dini se çfarë bënte Abdyl Këllezzi: vente nëpër rrëthe dhe prenitonte: «Të jap unë këtë apo atë», thoshtë, megjithëse ato nuk

ishin parashikuar në plan. Po si do t'i jepte ai këto, pa u parë një herë nga organi përkatës?

Organizimi i punëve shtetërore, ana teknike dhe politika e drejtimit të tyre nuk durojnë shabllonizëm e formalizëm në një vend socialist e me një ekonomi të madhe si ky yni, përndryshe ne do të kemi luhatje, do të na vërtetohen gabime e do të na prishen kuadrat.

Tash të vijnë te çështja e projekteve e të preventivave të veprave të cilat, gjithashtu, kërkojnë zgjidhje. Shokët e Byrosë Politike si Hakiu, Hysniu dhe Hekurani e kanë bisceduar këtë edhe me shokë të tjerë, prandaj këtij problemi i duhet shkuar deri në fund. Ne duhet të kuptojmë mirë e të kërkojmë edhe nga të tjerët që pa projekte e preventiva të mos bëhet gjë. Kur caktojmë kuotat parashikojnë që brenda saj do të jenë edhe vlefstat e objekteve sipas preventivave për çdo vepër. Por, që të bëhet preventivi, duhet të bëhet më parë projektin.

Preventivi mund të dalë baras me vlefshen e caktuar, më shumë apo më pak. Ai që ka bërë studimin mund të ketë më shumë të drejtë se investitori, prandaj midis tyre duhet të ketë debate. Pastaj ministrit i lihet njëfarë kompetence, por deri në njëfarë mase, i cili mund të heqë ndonjë zë dhe t'ia japë veprës në diskutim, por në asnjë mënyrë të mos veprohet si tashtri. Nuk mund të lejohet investitori që të shpenzojë për një uzinë dy-trefishin e vlefshës që kemi caktuar. Në qoftë se ndodh një gjë e tillë, kjo vjen sepse të dhënët nuk duhet të kenë qenë të sakta, gjë që tregon se nuk janë bërë mirë studimet etj. Vlefshës së caktuar

për ndonjë objekt, ta zëmë prej 25 milionësh, i duhet përmembatur; fundja, mund të japim edhe 5 milionë, por që të jepen edhe 45 milionë të tjerë, një shpenzim i tillë është i papranueshëm. Kështu nuk mund të ecet. Nuk ka si të kemi plan të rregullt, në qoftë se nuk kërkojmë më parë projektet. Kurse ne këtë nuk e bëjmë gjithmonë dhe nuk e kuptoj përsë nuk e bëjmë. Ne për shembull, kemi bërë gjithë këta rezervuarë, kanalizime dhe fabrika të vogla, por përsë edhe për këto të na dalin gjithë ato diferenca? Në këtë çështje duhet të ketë pikëpamje e prirje të gabuara.

SHOKU PETRO DODE: Si rregull, fillimi i ndërtimit të një objekti duhet të bëhet patjetër duke pasur projektin. Ne duhet të arrijmë që në planet vjetore të mos kemi asnjë vepër pa projekt dhe pa preventiv.

SHOKU ENVER HOXHA: Për çfarëdo vepër që do të ndërtosh duhet llogaritur edhe koha që nevojitet për përgatitjen e projekteve. Për këtë mund të vësh edhe afate që projekti, ta zëmë, të mbarojë brenda një viti, në mos i tërë, një pjesë e tij. Por të caktohet një grafik që brenda kësaj kohe do të jepet kjo pjesë, në një fazë të mëvonshme do të jepet tjetra dhe kështu me radhë.

Konkretisht, mendoj që objektet e parashikuara në planin e vitit 1977 të mos fillojnë pa projekte. Ne mund të pranojmë edhe një sakrificë që ato mund të mos bëhen qind për qind, qysh në fillim, por tetëdhjetë apo nëntëdhjetë për qind mund të bëhen. Për ndonjë objekt të veçantë mund të fillohet puna me projekte e preventiva të pëjesshëm. Por, ama ne nuk mund të

hartojmë një plan të tërë pesëvjeçar me analogji. Gjëra të tilla nuk mund të pranohen!

Për këtë të mendojmë edhe ne, të mendojë edhe Komisioni i Planit të Shtetit, në bazë të të gjitha studimeve që i vijnë nga baza, për të përmirësuar e për të zgjeruar, fjala vjen, ndonjë fabrikë ekzistuese, apo për t'i bërë rikonstruktionin këtij apo atij objekti.

E kemi thënë edhe më parë që investitorët duhet t'u dalin për zot objekteve të tyre e të kontrollojnë investimet në bazë të planit dhe të vlefshave që u janë caktuar. Në qoftë se një dikaster do të ndërtojë një fabrikë, ai duhet t'i bëjë studimet dhe llogaritë në bazë të fondit që i është dhënë. Për këtë njoftohet edhe Instituti i Projektimit duke i thënë se nuk lejohet t'i shtohet asnje lek më tepër veprës, prandaj projektit të përgatitet me këto të dhëna, jashtë këtyre nuk pranohet asgjë. Por investitori mban edhe një rezervë prej 10 për qind për ndonjë gjë të papritur. Po kështu dhe projektuesi e mban një 5 për qindësh. Praktika ka treguar se ata jo vetëm mbajnë rezerva, por ndodh që nuk i bëjnë as llogaritë mirë, po me hamendje.

Dua të pyes edhe për një çështje. Për industrinë mekanike ka përparime dhe nëse ka, ku paraqiten më shumë ato, në veglat e ndërrimit apo në pajisje e makineri të bujqësisë ose të industrisë?

SHOKU PETRO DODE: Ky është problemi më i vështirë për t'u trajtuar, sidomos lidhur me llojet e pjesëve të këmbimit, se shumë prej tyre hezitojnë t'i prodhojnë. Këtë e vështirëson edhe fakti që ne kemi

sjellë shumë tipe makinash, të cilat kërkojnë lloje të ndryshme pjesësh këmbimi.

SHOKU HYSNI KAPO: Mund të veprohet edhe siç u praktikua për makinat transportuese të hidrocentraleve, që përshtatëm një linjë posaçërisht për to.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam dëgjuar nga shoku Pilo Peristeri që thoshte se ne e bëjmë këtë ose atë pjesë këmbimi për traktorët, por jo siç na e kërkon sot për nesër Pirro Dodbiba, se sot për nesër nuk e bëjmë dot.

Po për sektorin e minierave si punohet? (Flas gjithmonë për ndihmën mekanike.) Se duhet të shkojmë nga ky parim: të climinojmë sa të jetë e mundur më shumë forcat e punës, se për këtë problem, në miniera, kemi gjetur vazhdimesh vështirësi, prandaj kemi marrë forca pune edhe nga fshati. Po për këtë arsyenë miniera ka një fluktuacion të madh të fuqisë punëtore. Ne duhet ta forcojmë e ta rritim mekanizimin atje; një kjo.

E dyta, mekanizimi ndikon për punë më të shpejtë, më pak të kushtueshme dhe më të pastër, prandaj Ministria e Industrisë dhe e Minierave këtë gjë duhet ta mbajë mirë parasysh sidomos në miniera, se kjo i sjell të ardhura të mëdha ekonomisë.

Në lidhje me zhvillimin e bujqësisë dhe përpunimin e lëndëve të para a parashikohet të bëhet gjë? Edhe fabrika, mund të ndërtojmë vetë, por e kam fjalën sidomos për të shtuar kapacitetet e atyre që kemi.

Veprat për ujitje të keni kujdes që të mos ndërtohen atje ku sipërfaqja nën ujë është e madhe, po atje

ku është e ulët. Pastaj, ne duhet t'u vëmë detyrë të gjithëve që ta shfrytëzojnë në maksimum dhe me nikoqirllék gjithë sasinë e ujit që kanë në dispozicion dhe jo njërit t'i japim me luhare dhe tjetrit me pika. Ato vepra ujitetëse që kanë filluar, të punohet që të mbarojnë. Popullit atë kontribut që ka për të dhënë në këtë drejtim, t'i vihet detyrë ta kryejë, ndërsa shteti të japë gjithë ndihmën dhe materialet e nevojshme. Këto vepra të përfundojnë sa më parë. Të mbarojë edhe rezervuari i Mallakastrës dhe jo të tirret e të tirret, po të mobilizohet populli; shteti të japë ato që ka për të dhënë dhe brenda një kohe sa më të shkurtër, të vihet në shfrytëzim.

Mirë, le ta lëmë tash shokun Petro, se e lodhëm.

SHOKU PETRO DODE: Jo, shoku Enver, ju u l�ët.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë fitova shumë.

SHOKU PETRO DODE: Unë fitova shumë dhe përkëtë ju faleminderit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ditën e mirë!

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e inciuar, që gjendet në AQP

PA ORGANIZIMIN E VOGËL, NUK MUND TË KEMI NË RREGULL AS ORGANIZIMIN E MADH

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

17 qershor 1976

SHOKU HEKURAN ISAI: Ishim në seminarin që organizuam me sekretarët e organizatave-bazë të sektorit të naftës për të diskutuar rrëth konkluzioneve të nxjerra nga shokët e ekspertëve që kishim dërguar atje dhe për të përgjithësuar eksperiencën e mirë të Partisë në këtë sektor.

SHOKU ENVER HOXHA: Qenë shokët e ekspertëve që organizatën e Drejtorisë së Institutit të Studimeve të Naftës dhe a e kontrolluan punën e saj?

SHOKU HEKURAN ISAI: Po, i kontrolluan dhe i ndihmuani.

Në seminar u fol edhe për organizimin e punës politike. U kritikua globalizmi dhe u vu në dukje se ajo nuk lidhet si duhet me punën konkrete, për edukimin e masave.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ç'karakter i jepet atje punës politike?

SHOKU HEKURAN ISAI: Në shumicën e organizatave-bazë që u kontrolluan nga shokët e ekipoit, u konstatua se në to zhvillohen tema për diktaturën e proletariatit, për rolin udhëheqës të Partisë, për qëndrimin e revizionistëve etj., por këto nuk zërthchen konkretisht dhe nuk lidhen me detyrat konkrete.

SHOKU ENVER HOXHA: Bëjnë dallime dhë ka unitet midis punës politike dhe asaj ideologjike? Dua të them se nga ana politike Partia duhet të nxjerrë mësimë ideologjike osc, duke shtruar probleme ideologjike, duhet parë se ç'politikë ndjekim ne karshi kësaj osc asaj situate që lind. Për shembull, të flitet për diktaturën e proletariatit është një çështje ideologjike. Mirëpo, në praktikë kjo reflektohet në aspekte të ndryshme. Kështu, duke e njobur mirë bazën teorike të diktaturës së proletariatit, Partia ndjek një politikë të caktuar për ta zbatuar në jetë këtë parim të madh mbi të cilin mbështetet pushleti ynë. Shteti i diktaturës së proletariatit nuk i shtyp të tërë, por vetëm mbeturinat e klasave të përmbyshura. Por, edhe ndaj këtyre, si pas rastit, ka edhe marrje krahësh, por mund të veprohet dhe drejtpërdrejt, sepse diktaturën tonë të proletariatit e sulmojnë lloj-lloj njerëzish. Edhe ata, qofshin armiqtë e brendshëm, qoftë të jashtmit, përdorin kundër nesh një taktkë të caktuar politike.

Puna është që, kur flasim për çështje politike, mund të themi, për shembull, që këtu, në zonën tonë të naftës, vepojnë elementë, të cilëve nuk ua dimë ekzaktesisht gjithë veprimtarinë, por që duhet të përpinqemi ta njohim. Ne vetëm konstatojmë se disa qëndrime,

disa opinione, kanë një karakter politik antishtetëror, kundër direktivave të Partisë dhe të shtetit. Pra, në gjithë politikën e rrethit ekziston një politikë, nga ana e disa njerëzve, për të goditur politikën tonë, e cila bazohet në parimet që thashë.

Komunistët kurrë nuk duhet të harrojnë që kur shtypi, radioja e televizioni, trajtojnë probleme që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të shteteve të ndryshme borgjeze e revizioniste ose me metodat dhe strategjitet e tyre, ata këto probleme nuk duhet t'i marrin lehtë-lehtë, si disa lajme të thata, si njoftime sa për t'i dëgjuar. Jo, se vlerësimi i tyre kërkon një punë më të madhe. Flet shtypi që kjo po ndodh në Azi, por, kur të vjen në derë afër vendit tënd, duhet të bisedohet me shokët e Partisë nëse kanë marrë vesh gjë për këto ngjarje. Atëherë, duhet t'u tërhiqet vëmendja se, si komunistë, që rrojnë të rrethuar nga një pellg i rrezikshëm armiqësor, duhet të interesohen për këto ngjarje e vçprimtari armiqësore se ato ushtrojnë influencë edhe tek elementët armiq brenda vendit tonë. E them këtë se në mbledhjet e organizatave të Partisë, dhe për këtë jam i sigurt, çështjet e politikës së jashtme jo vetëm që trajtohen, si një slogan i rastit, por besoj se edhe janë zhdukur fare nga rendet e ditës.

SHOKU HEKURAN ISAI: Keni shumë të drejtë, shoku Enver, se edhe kur flitet për situatën e jashtme, ajo nuk bëhet ashtu si thoni ju, me një nuhatje politike. Këto ne duhet t'i shikojmë që raporti i punës politike me atë ideologjike të jetë sa më i drejtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këtë fushë kërkohet nuhatje dhe një propagandë e zgjuar. Kjo duhet bërë duke u bazuar kurdoherë në ideologjinë tonë. Kur mbështetesh fort në këtë ideologji për një çështje të caktuar, do t'i shohësh edhe politikisht vijën e drejtë dhe mundësitë e veprimeve të armikut. Këto mundësi, kur ke një formim të mirë, mund t'i parashikosh. Pastaj shikon se si zhvillohen ato në praktikë dhe, kur i ke parashikuar drejt, duke pasur parasysh edhe ideologjinë e armikut, atëherë je në gjendje t'i luftosh edhe në praktikë. Por, që ta bësh mirë këtë punë, problemin duhet ta ngresh politikisht në organizatë, ose në formën e edukimit të Partisë. Po e bëre këtë në organizatë dhe në formën e edukimit, atëherë mund të themi se e ke kuptuar si duhet ideologjinë dhe politikën e Partisë dhe se je i armatosur mirë për t'i zbatuar ato në praktikë.

Njerëzit tanë punojnë, por çështja qëndron në këtë që duhet të dimë ta organizojmë punën sa më mirë, duke pasur parasysh edhe specifikën e çdo ndërmarrjeje. Për shembull, ndërmarrja e sizmikës, që të jetë si ndërmarrjet e tjera, duhet të ketë një bosht organizimi. Ajo, flas për sizmikën, si çdo ndërmarrje do të ketë degë, në bazë të funksioneve që do të kryejë dhe sektorëve që do të studiojë. Ajo nuk mund të veprojë kuturu, por do t'i përqendrojë forcat në ato drejtime që na interesojnë. Drejtoria e ndërmarrjes, si një shtab i gjithë punës, duhet të caktojë edhe priorititet e studimeve. Këto prioritetë caktohen në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës e

me Institutin e Studimeve të Naftës, si edhe me Ministrinë e Industrisë dhe të Minicerave. Vetëm atëherë kur janë diskutuar gjërësisht të dhënrat e Institutit të Studimeve të Naftës dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës, ministria jep urdhra se ku duhet studuar më parë e ku më pas. Nga ana e saj, ndërmarrja urdhëron degën e caktuar që t'i marrë me radhë apo me prioritet të gjitha pikat ku duhet të veprojë sismika.

Këtë gjë ministria duhet ta zbatojë njëloj edhe me drejtoritë e ndërmarrjeve të tjera, duke bërë korrigjimet e nevojshme për vendet, për kohën e veprimeve etj. Mua më duket se nuk bëhet kështu kjo punë, prandaj edhe vërtetohen herë pas here pengesa e vështirësi. Dhe na ndodh pastaj që për çdo veprim të vijnë e të pyesin këtu apo në ministri, gjë që nuk është e drejtë.

Konkretilisht; për ta çimentuar apo për të mos e çimentuar një pus, nuk është e drejtë që të merret ministria. Ku e di ai në ministri nëse duhet ta çimentosh pusin apo jo? Këtë duhet ta thonë ata të ndërmarrjes, se fundi i fundit, drejtori i Drejtorisë së Naftës në ministri nuk mund të vejë në të gjitha puset dhe të gjykojë nëse duhen apo nuk duhen çimentuar disa prej tyre. Këtë e dinë ata të ndërmarrjes përkatëse, të cilët duhet të mbajnë edhe përgjegjësi për të tilla veprime.

Në Drejtorinë e Shpimeve po, mund të venë e të konsultohen. Mund të kërkojnë edhe ndihmën e gjeologëve e të inxhinierëve. Kur është ndonjë çështje më e komplikuar, mund të vijnë edhe deri në ministri.

Por, si rregull, që të vijnë këtu në qendër, për të apro vuar çdo veprim që bëhet në një pus, kjo nuk është një praktikë e rregullt. Prandaj, mendoj se, pa organizimin e vogël, nuk mund të kemi në rregull as organizimin e madh. Në përgjithësi, pa organizim ka anarki.

SHOKU HEKURAN ISAI: Po, çështja e organizimit qëndron. Problemi shtrohet që këto organizime janë bërë edhe nga ministria. Po ta bëjnë këtë punë drejtoritë qendrore, ndërmarrjet e tjera gjejnë karar, por ato nuk e bëjnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet ta bëjnë jo vetëm drejtoritë qendrore, por edhe drejtoritë e veçanta, deri në sektorët më të vegjël.

Mundet që komunistët çahen duke punuar pa u lodhur; po Partia atje ka të drejtë t'u thotë: «Pse s'e bëtë kështu? Pse s'e bëtë ashtu?» dhe, me këto gjëra, mund të vazhdohet ditë e natë, me vite. Çështja është që komunistët të përpiken e të përmirësojnë organizimin e koordininin e punëve. Po nuk vepruan kështu, le të bëhen sa të duash vërcjtje e qarje, do t'u jepet e drejta atyre, duke përdorur gjithfarë justifikimesh. Kur themi se sizmika, në këtë ose në atë pus, të fillojë sot dhe të mbarojë për një muaj, të gjithë komunistët dhe punëtorët duhet të mobilizohen për ta zbatuar këtë objektiv. Për këtë qëllim, ata të organizojnë punën në një mënyrë të tillë që, brenda muajit, kjo punë të kryhet në kohë dhe si duhet.

Për këtë qëllim duhet të llogaritet mirë çdo gjë, deri edhe te udhëtimet, pse, po s'u organizua mirë

çdo punë, do të kemi çrregullime, mosrealizime, vonesa etj. Anarkinë, sado e vogël që të jetë, ta reduktojmë sa të jetë e mundur në minimum. Dhe kjo arrihet vetëm duke organizuar mirë çdo gjë, ndryshtë s'mund të ecet.

SHOKU HEKURAN ISAI: Detyrat e pesëmujorit i kanë realizuar. Por, meqenëse i pastruam armiqjtë, vihet re njëfarë mungese vigjilence. Kjo duket edhe nga një shembull që na u tha aty. Kur në sektorin e naftës drejtonin armiqjtë, u shpuan dy puse dhe s'dhanë gjë. Tani do të shponin pusin e tretë, mbi bazën e një studimi kompleks, të cilin e ka projektuar një inxhinier. Thonë se ky, kur bëri projektin, nuk i ka përfillur fare të dhënat e sizmikës, por ka përdorur të tjera të dhëna, nga mendja e tij. Projekti ka shkuar edhe në këshillin shkencor të institutit, ku bëjnë pjesë rrëth 40 veta dhe anëtarët e këtij këshilli kanë thënë se janë dakord. Më pas, projekti ka ardhur në ministri dhe këtu njëfarë Mynyr Arapi¹, që më parë ka punuar në Qytetin Stalin, ka thënë se ky projekt nuk është bërë në rregull.

SHOKU HYSNI KAPO: Mendoj se kjo çështje është një çikë delikate se vihet në dyshim puna e tërë këtyre shokëve: janë 40 veta të institutit; 14 veta të grupit të punës e nja 14 të tjerë, me të cilët u konsultuan, bëhen rrëth 70 veta, ndërsa Mynyri, që është një njeri, na i nxjerr kështu fishek të gjithë këta?! Mendoj që të kërkohen edhe një herë shpjegime se ku u bazua ai inxhinieri në përgatitjen e këtij projekti.

1. Më vonë u dënuar nga gjyqi i popullit për veprimitari armiqsore e sabotime në sektorin e naftës.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe mua më duket si e zorshme që gjithë këta gjeologë, të cilëve u ka rënë bretku atje, të mos njohin shtresat ku do të shpohet pusi dhe t'i njohë ato njëfarë Mynyr Arapi. Për këtë nuk më mbushet mendja; të paktën në këto situata nuk mund ta besoj këtë gjë. Gjithë këta të tjerët i njohin më mirë sesa Arapi shtresat, se, përndryshe, vaj halli si do të venin punët!

Tani, në qoftë se do të pranojmë që këta 70 veta, që kanë jetuar tërë jetën në naftë, nuk njohin shtresat e asaj zone, do të thotë që, ose të gjithë këta nuk janë në rregull dhe vetëm ky është i mirë, ose që ky është një njeri mendjemadh. Mua më duket si e pamundur që ai inxhinieri projektues t'i hedhë poshtë, në mënyrë kategorike, të gjitha të dhënat. Nuk mund t'i ketë hedhur! Se si është raportuar për këtë problem, unë nuk e di, por që të mos i marrë parasysh ai në bërjen e projektit, nuk ma merr mendja, se, gjëja e parë që do t'i thonë ata që ka mbi kokë, është nëse këto të dhëna janë apo nuk janë?!

Ndonjëri, mund të mos e ketë parë si duhet një të dhënë, fjala vjen, prandaj duhet t'i hapin sytë. Por, ja: ndodhi që edhe gaboi! Por ai nuk gaboi që të sabotojë. Duhet ta shikojmë çdo gjë me syrin kritik.

SHOKU HEKURAN ISAI: Edhe për organizatën e Partisë të sektorit të naftës, del problemi i organizimit. Shqetësimi që kanë ata, siç doli edhe në seminar, është se jeta e Partisë nuk ka një organizim të centralizuar. Në fakt, edhe aty kemi grupin, organizatën, byronë dhe komitetin e Partisë, por ky organizim,

në këtë sektor, prishet me organizimin shtetëror. Ne do t'ia përshtatim organizimit të Partisë edhe organizimin e prodhimit, por shqetësimi qëndron këtu që shumë komunistë, gjithë kohën, na mbeten provizorë nëpër organizatat ku militojnë, se shkojnë nga një rreth në tjetrin. Komitetet e Partisë të rretheve që nuk kanë detyrë kryesore naftën, s'kanë as instruktor e asnjeri që të ndjekë jetën e këtyre organizatave.

SHOKU ENVER HOXHA: Ta shohim këtë çështje konkretisht. Për shembull, njëri ka qenë naftëtar në Qytetin Stalin dhe dërgohet në Vlorë. Rregullat Partia i ka kudo njësoj; detyrat shtetërore janë të gjitha njësoj; normat e Partisë janë të gjitha njësoj; organizimi i punës me instruktorë ashtu siç është në Berat, është edhe në Vlorë. Atëherë, komunisti që dërgon Partia dhe shteti në Vlorë menjëherë duhet të inkuadrohet në organizatën-bazë atje dhe të vazhdojë punën sikur të ishte në rrethin e Beratit. Në vendin e ri të punës vërtet se nuk ka atë njohje që e kishte atje ku ka pasë punuar për një kohë të gjatë; iksin e epsilon nuk i njoh mirë, por, ai është komunist dhe e ka të qartë se të tërë janë shokët e tij, edhe në vendin e ri; edukimi njëlloj bëhet edhe atje; disiplina si kudo, është po ajo; detyrat janë të caktuara; problemet që do të shtrohen e do të diskutohen janë njëlloj, si atje ku ishte etj. Atëherë, pse ta ngremë këtë çështje? Po mund të thuhet që na janë larguar disa dhe ne kemi mbetur këtu shtatë veta. Ju të shtatë që jeni këtu, bëni punën për ata shtatë të tjerët që shkuan në Vlorë. Atje ku vajtën qenë tetë. Shkuan dhe shtatë të tjerë, u bënë pesëmbë-

dhjetë, pra, u shtuan; le të bëjnë punën për aq sa janë. Pas gjashtë-shtatë muajve ata mund të vijnë prapë këtu, në Qytetin Stalin, po mundet edhe të mos vijnë fare, se prej andej mund të dërgohen në Divjakë. Këtu mund të diskutohet vetëm çështja e jetës familjare për këta shokë, se janë vazhdimisht me plaçka në krahë. Kjo gjë, po, mund të shihet. Por s'ka të bëjë fare me jetën e Partisë, prandaj nuk ka pse ta ngremë këtë çështje.

Të dërguarit të varen organizativisht nga komiteti i Partisë që i ka në territorin e vet. Për shembull, shpohet një pus në Kavajë, që lidhet me Durrësin, instruktoret e Komitetit të Partisë të Durrësit, që njerren me çështjet ekonomike, duhet të interesohen edhe për pusin dhe të dinë se për çfarë të interesohen. Sigurisht ata nuk janë specialistë të naftës, po detyrat do t'i ndjekin në rrugë partie.

U tha këtu se komiteti i Partisë, mund tū mos e dijë se në territorin që mbulon po shpohet një pus. Si tū mos e dijë?! Nuk duhet të di unë se kush më futet në shtëpinë tuine? Unë duhet të di medoemos se kush futet në territorin e organizatës sime, pra, në rrethin tim. Nëse aty është duke u zbuluar naftë dhe po shpohet një pus, komiteti i Partisë i rrethit duhet të lajmërohet se nga vijnë këta njerëz. Ndryshe, ne duhet t'i themi komitetit të Partisë që të shikojë se nga i kanë hyrë këta «të panjohur» që kanë shkuar, ta zëmë, për të hapur një pus. Po pse, atje ku po bëhet kjo punë me rëndësi, s'paska njerëz për ta lajmëruar komitetin përkatës të Partisë? Po tū ndodhë kështu, ky, atëherë, është një gabim tjetër, se, po të dijë komiteti i Partisë që

është duke u hapur një pus në territorin e vet, atëherë puna e parë që duhej të bënte ishte që të dërgonte një shok të vinte për të parë se a ka komunistë atje për të krijuar një organizatë apo s'ka. Përveç kësaj, ai duhet të mendojë edhe se me kë mund ta lidhë këtë grup, që puna të marrë gjallëri; të gjykojë se ç'mund t'i shtojë kësaj organizate partie dhe a mundet t'i bëjnë mbledhjet tok me organizatën që është atje etj.

Këto çështje nuk bëhen në mënyrë formale. Unë, po të jem sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit, do të interesohem për pusin që hapet në territorin e rrethit tim që të shkojë mbarë. Në qoftë se atje ka komunistë, unë mendoj se duhet të formohet organizaña e Partisë dhe të varet nga rrethi i Durrësit. Kjo nuk e pengon atë që është drejtor i ndërmarrjes që të vijë në pikën ku është duke u hapur pusi e të kontrollojë punën nga ana teknike dhe shtetërore me një, me dy apo dhe me më tepër inxhinierë e naftëtarë, po të jetë nevoja. Pra, për çështje partie, ka përgjegjësi rrethi që e ka në juridikcionin e vet, kurse, për çështjet e tjera çdo gjë duhet të varet nga organet shtetërore përkatëse, si nga Drejtoria e Naftës, nga Instituti i Studimeve të Naftës, si dhe nga vëtë Ministria e Industrisë dhe e Minierave. Të gjitha këto e dinë që komunistët e këtij pusi janë nën drejtimin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit. Kjo formë organizative më duket mua, është më e përshtatshme; janë të papjekura mendimet e kundërtta që shfaqen.

SHOKU HYSNI KAPO: Ne, shoku Enver, mund ta shikojmë këtë. Por, po kaloi gjashtë muaj lëvizja

e forcave nga një rreth në tjetrin, atëherë ato duhen marrë në lidhje, që t'i atashohen atij rrethi. Po të jetë më pak se gjashtë muaj, do t'i mbajë në lidhje rrethi që i ka, sepse ata do të kthehen pas gjashtë muajve. Këtë udhëzim kanë rrethet. Në qoftë se duhet, ta shikojmë këtë, megjithëse më duket se nuk e kemi keq, ne e shikojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, unë mendoj se mund ta lëmë me kaq sa e kemi. Por, rrethi, si komitet parti, duhet ta ketë lejën nga Komiteti Qendror që të shkojë në këtë objekt, megjithëse nuk lidhet organizativisht. Pra, edhe ai duhet të shkojë se çfarë bëhet e çfarë nuk bëhet atje.

SHOKU HYSNI KAPO: Ato çrregullime janë bërë deri dje edhe për arsyen e bëhcj lëvizja e sondave me vend e pa vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Çrregullimet duhet t'i evitojmë. Por, nga ana e Partisë nuk ka asnjë pengesë, edhe sikur vajtjet në vend të bëhen të shpeshta, se nuk lëvizim gjëkafshë. Ta zëmë se erdhi te pusi njëri dhe lidhjen si komunist nuk e merr, se do të largohet shpejt, por, jetën e Partisë e kontrollon komiteti përkatës. Por edhe ai tjetri mund të vijë njëkohësisht në organizatë dhe t'i thotë tjetrit të dhënat dhe mendimet që ka, vërejtjet që ka tërhequr, këshillat që i ka dhënë këtij apo atij etj., kurse vendimin do ta marrë ai atje. Nuk na pengon asgjë kjo punë, shokë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Bëmë një vizitë edhe në Teknikumin e Naftës, ku keni qenë edhe ju, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa veta ka ky teknikum?

SHOKU HEKURAN ISAI: Ka mbi 750 veta. Pas porosive që keni dhënë ju, ata kanë bërë një punë të madhe. Çdo klasë është kthyer në kabinet prodhimi, që i kishin ngritur në bazë të klasave dhe të profileve.

SHOKU ENVER HOXHA: Ata që mbarojnë këtë shkollë, pasi kryejnë shërbimin ushtarak, a kthchen të gjithë në sektorin e naftës?

SHOKU HEKURAN ISAI: Jo, shoku Enver, një pjesë e tyre kalojnë në profile të tjera, një pjesë nuk kthehen më në sektorin e naftës.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë praktikë ne e njo him dhe e kemi dënuar. Bile, kemi dhënë edhe udhëzime që köta njerëz askush të mos i marrë në punë, por të venë në sektorin e naftës. Mirëpo, si ndodh në praktikë?

SHOKU HEKURAN ISAI: Konkretisht, një studim të tillë nuk e kanë. Ky teknikum furnizohet me nxënës nga e gjithë Shqipëria.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk jam dakord që të trajtohet në këtë mënyrë kjo çështje. Përse duhet të ketë të rinj e të reja nga Korça, fjala vjen, në teknikumin e naftës?

SHOKU HYSNI KAPO: Sikur është shkollë bujqësore, që duhet të ketë nxënës nga të gjitha rrethet ose për përgatitje arsimtarësh. Jo, kjo shkollë është për naftën, s'ka nevojë të vijnë nga të gjitha rrethet.

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se deri tani

janë bërë të tilla veprime, paskëtaj nuk duhet të veprohet më kështu.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

KUR SHKOKIET PËR NDIHMË E KONTROLL, SYTE NË RADHË TË PARË TË DREJTOIHEN TE NJEREZIT

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë
të Partisë¹*

21 qershor 1976

Dëshiroj të theksoj se jam dakord me mendimet e shprehura në raportin e përgatitur nga shokët e organizatës sonë. Në bazë të tyre dhe të shpjegimeve që na u dhanë këtu, mendoj se shokët kanë punuar mirë. Ata janë thelluar në problemet që kanë kontrolluar, kanë nxjerrë të metat e punës, kanë dhënë edhe udhëzime të drejta për korrigjin e tyre. Jam dakord, gjithashtu, edhe me diskutimet e shokëve që folën para meje.

Të gjitha sa u thanë vërtetojnë që në punën e bërë

1. Në këtë mbledhje të organizatës-bazë u mor në shqyrull raporti mbi punën e një ekipi të përbërë prej disa komunistësh nga sektori i kuadrit i aparatit të Komitetit Qendror që vajti për ndihmë e kontroll në organizatën e Partisë të rrethit të Elbasanit.

për drejtimin e organizatave-bazë të Partisë, krahas anëve pozitive, ka edhe të meta. Në ato raste ku iu çështë bërë një trajtim i gabuar problemeve të rëndësishme të kuadrit, kanë përfituar elementët armiq, që, nën hundën e shokëve të Partisë, kanë arritur të kryejnë veprime të dëmshme. Kjo ka ndodhur se përgjithësi, nga organizatat e Partisë nuk çështë kuptuar si duhet rëndësia e zbatimit pa asnjë lëshim të të gjitha normave të Partisë për kuadrin. Për vënien në jetë me saktësi të këtyre normave duhet të luftohet sikurse na ka mësuar Komiteti Qendror dhc të mbahet qëndrim ndaj cilidit që u shmanget ose i shkel ato.

Rëndësi, në radhë të parë, ka kuptimi i drejtë i direktivave të Partisë, por, gjithashtu, ka po aq rëndësi që edhe t'i zbatojmë këto në jetë. Për këtë kërkohet një organizim i shëndoshë, në mënyrë që elementët armiq ose të pandërgjegjshëm të mos kenë mundësi të përfitojnë nga të metat që të depértojnë nëpërmjet të çarave që mund të krijohen. Një punë organizative e shëndoshë ndihmon që të ecet në rrugën e caktuar, sipas direktivave.

Drejtimi kolegjial dhe marrja e mendimit të masave nga organizata-bazë e Partisë për punën e kuadrit, çështë një problem që na preokupon vazhdimesh. Të mos marrësh mendimin e organizatës-bazë të Partisë dhe të masave për ngritjen apo për uljen e kuadrove në përgjegjësi do të thotë të bësh një politikë personale kuadri, të nxitesh në këtë drejtim jo nga nevojat dhe interesat e Partisë, por nga prirje dhe ndjenja mikroborgjeze, nga hatëret, nga liberalizmi etj. Duhet

të zbatohet rregulli, sipas të cilit, për kuadrot që ngrihen ose ulen në përgjegjësi, që ndëshkohen ose lavdërohen, të merret edhe mendimi i masës. Kjo normë e Partisë sonë të vihet në jetë realisht e në çdo rast dhe jo të zbatohet formalisht e në mënyrë burokratike, siç është vepruar disa herë.

Gjykimet dhe vendimet kolegjiale kanë rëndësi të madhe, pse kolegjialiteti, siç e provon jeta, është metoda kryesore pür shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të problemeve. Të vepruarit sipas kësaj metode nuk ia ul aspak personalitetin drejtucsit të ndonjë institucioni apo dikasteri, përkundrazi, ia rrit atë. Kjo çështje duhet të thëksohet me forcë dhe të zbatohet, ndryshe do të veprohet në kundërshtim me parimet e Partisë për kolegjialitetin dhe vijën e masave. Shkelja e këtyre parimeve është e dënueshme dhe nuk i lejohet askujt.

Konstatojmë se kulti i disa kuadrove drejtues në rrethe e në ndërmarrje e ka çuar në rrugë të gabuar ndonjë organizatë-bazë partie. Kjo tregon se nuk është kuptuar nga të gjithë ajo që ka theksuar vazhdimisht Komiteti Qendror: Të gjithë anëtarët e Partisë janë njëlloj përpara organizatës-bazë: në mbledhjen e Partisë mund të kritikohen pa dallim veprimitaria dhe sjelljet e çdo komunisti, pavarësisht nga vendi dhe nga përgjegjësia që ka. Por, siç del, ka ndonjë organizatë-bazë në të cilën ka munguar kritika ndaj disa drejtuesve të punës në Parti ose në pushtet. Kjo është shumë e rrezikshme, prandaj na vihet detyrë ta zhdukim një të keqe të tillë. Po nuk e bëmë këtë, masat organizative që merren përmirësimin e gjendjes dhe

për heqjen e ndonjërit nga puna, duke vendosur në vend të tij element më të përshtatshëm, nuk do të kenë shumë efekt.

Të jemi të vëmendshëm për edukimin e kuadrove që kanë punuar në aparatet e atyre dikastereve që ishin nën drejtimin e elementeve armiq, si Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos me shokë në ushtri, apo të Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit, Kiço Ngjelës e të tjera në sektorët ekonomikë. Është e qartë se ka nga ata që nuk kanë qenë vigjilentë, që kanë parë shkclje e veprime të padrejta, por kanë qëndruar indiferentë, nuk kanë reaguar si revolucionarë, kurse pozita që kishin duhej t'i vinte në lëvizje që tū paktën diçka t'i thoshin Partisë. Ka edhe nga ata që kanë folur, por u është mbytur zëri. Në gjithë këtë gamë të metash e gabimesh që janë vërtetuar, duhet të jemi të matur e të tregohemi të pjekur.

Është e gabuar pikëpamja e atyre që kujtojnë se shokët që ka vënë Partia në poste drejtuese janë kurdoherë mendime të drejta dhe të padiskutueshme. Kuadrot drejtues e kanë për detyrë të bëjnë përpjekje dhe të qëndrojnë kurdoherë drejt në vijën e Partisë, por është absolutisht e nevojshme që pikëpamjet dhe veprimet e tyre t'i gjykojë masa e komunistëve, ajo të thotë nëse e kanë me vend apo jo një mendim që shprehin ose një veprim që kryejnë.

Kur vendoset diçka për një kuadër, duhet t'i raportohet me hollësi për të mirat dhe të metat e tij organit kompetent të Partisë ose të pushtetit. Të thënët se këtë ose atë e njch sekretari i parë i komitetit të Par-

tisë të rrethit, prandaj është njeri i mirë, nuk mund të jenë argumente bindëse. Në një kohë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, ose ndonjë shok tjetër me përgjegjësi, mund ta ketë njohur dikë si njeri të mirë, megjithatë nuk përjashtohen raste që ky të mos ketë qenë ashtu si e ka njohur ai. Ky konkluzion është i provuar në jetë.

Para 10 -15 vjetësh Partia ka mbajtur qëndrim ndaj një mjeku me pikëpamje armiqësore, të cilin e dërgoi nga Tirana në një rreth për riedukim. Mirëpo ish-sekretari i parë i komitetit të Partisë, si dhe ndonjë kuadër tjetër kryesor i atij rrethi, duke e marrë mjekun për t'u vizituuar dhe për të kuruar pjesëtarët e familjes, pa përfillur faktin që Partia e njihte atë për të keq, se kryente veprimtari armiqësore dhe ishte afér burgut, flitnin mirë për të, e vlerësonin kështu nga pozita liberale mikroborgjeze. Ky njeri i pandërgjegjshëm nuk ishte i predispozuar t'u shërbente si mjek, me të njëjtin kujdes, edhe të tjerëve, siç bënte për sekretarin e parë apo edhe për ndonjë tjetër, me të cilët kishte interesa dhe intimitet. Kur diskutohej për mjekun në fjalë, shokët e Partisë kishin të drejtën absolute t'i thoshin me këtë rast ish-sekretarit të parë: «Kemi dëgjuar që ky njeri nuk ka ardhur për të mirë këtu, prandaj, mund të na flitet pak për biografinë dhe karakteristikën e tij, se nuk na duket kaq i mirë sa e bëni ju!».

Mendimi personal për një person, për një problem apo për një ngjarje ka rëndësi, por rëndësi të dorës së parë duhet të kenë mendimi i masave, i organizatës-bazë dhe të dhënrat e pasqyruara drejt në kartotekën

e Partisë. Këto të përbëjnë pikëpamjen e Partisë dhe të masës për një çështje ose për një person, pse masat në përgjithësi, si edhe Partia kanë folur dhe flasin kurdoherë drejt.

Masat, që Partia i vë në dijeni dhe i këshillon të shprehen lirisht për gjithçka, të flasin pa frikë, t'i tre-gojnë asaj drejt çfarë shohin dhe ç'mendojnë për punën dhe për njerëzit, ngrenë drejt probleme edhe për kuadrot. Partia ka këshilluar me kohë, që masat të hapin sytë, të jenë vigjilente, se armiku punon. Këtë të mos e harrojnë kurrë, se nuk kemi të bëjmë me çështje personale të njërit apo të tjeterit, por me mbrojtjen e interesave të lartë të atdheut dhe të popullit, prandaj t'i vlerësojmë kurdoherë mendimet e drejta dhe sinjalizimet që na japid masat.

Çështjet e ngritura në letrat që më dërgojnë masat, në një përqindje të konsiderueshme, janë të drejta. Një person më ka informuar se në ndërmarrjen ku punonte ishin duke u kryer veprime të paligjshme dhe asnjeri nuk kujdesej për t'i vënë punët në udhë të drejtë. Kur u dërgua kontrolli për të parë gjendjen, rezultoi se të tëra sa ngrinte ky njeri ishin të vërteta, prandaj u morën masa duke pushuar drejtorin, kryeinixhinierin dhe disa kuadro të tjerë që mbanin përgjegjësi të drejtpërdrejtë për gjendjen e krijuar. Këtë informim do të ishte më mirë ta kishin bërë shumë më parë punëtorët dhe kuadrot e kësaj ndërmarrjeje, siç ndodh zakonisht në qendrat e tjera të punës që vazhdimisht, me sinjalizimet që dërgojnë në kohë, i japid një ndihmë të madhe Partisë. Kur themi që masat i japid

një ndihmë të madhe Partisë, atëherë çfarë mund të flasim për organizatën-bazë të Partisë të një ndërmarrjeje, institucioni ose kooperative? Komunistët, si elementë pararojë të masave, duhet të jenë në ballë të luftës për të vënë në dukje me guxim si revolucionarë çdo gjë që nuk ecën në rrugën e Partisë dhe ta bëjnë problem të organizatës-bazë.

Në mbledhjen e organizatës-bazë anëtari i Partisë e ka për detyrë të flassë e të japë mendim për çështjet që shtrohen. Ai nuk ka pse t'i mbajë fshehur ato që kanë ngjarë dhe të ketë frikë, për shembull, nga ministri, nga drejtori ose nga kryetari i kooperativës, ca më tepër kur të deleguarit e komitetit nuk mungojnë të vënë në dukje gabimet e këtij apo të atij drejtuesi. Një drejtues nuk mund të marrë masa arbitrale kundër komunistit që e kritikoi, se, po të veprojë kështu, ky atëherë e ka të hapur rrugën të ankohet në komitetin e Partisë, i cili do t'i kërkojë llogari dhe do ta vëré në vendin që meriton një përgjegjës të tillë hakmarrës.

Sikurse shkruajnë shokët e ekipit në raportin që na kanë paraqitur, del se shokët e byrosë dhe të sekretariatit të Komitetit të Partisë, si dhe ata të kryesisë së Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Elbasanit, nuk i kanë parë si duhet disa çështje të punës me kuadrin. Ata kanë lejuar të emërohen në poste të rëndësishme disa njerëz me përbërje të keqe politike. Kjo na shtyn të mendojmë thellë: Si është e mundur të merren kolegialisht vendime të tillë nga forume të përbëra prej shokësh kryesorë? S'mund të mendohet kurrë që këta shokë, të cilët nuk janë të rinj në fun-

ksionet që krycjnë, nuk i njohin normat e Partisë. Për më tepér është për t'u habitur se të tilla veprime kryhen pas gjithë këtyre plenumeve që ka bërë Komiteti Qendror i Partisë. Në të tilla raste indiferentizmi, liberalizmi, hatërlleqet, puna pa asnje përgjegjësi përmbrojtjen e Partisë e të pushtetit popullor mbijnë si bari i keq. Na thuhet gjithashtu se kryesia e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrrohit i kishte rehabilituar pa të drejtë disa njerëz, të cilët ishin larguar një herë nga vendet e punës së tyre me përgjegjësi se nuk plotësonin kushtet politike. Kryesia e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrrohit nuk është një organ i njohur me ligj dhe, si e tillë, mendoj që nuk ka të drejtë të marrë vendime.

Shumë negativ, sikurse na raportohet, është fakti që shokë drejtues të këtij rrathi me zor i kanë pranuar kritikat e ekipit në adresë të punës së tyre. Bile këta nuk paskan folur për të metat e tyre në organizatën-bazë ku bëjnë pjesë, sepse donin t'i zvogëlonin gabimet dhe kishin pikëpamje jo të drejta mbi të metat në punën e kuadrit që u vunë në dukje anëtarët e ekipit. Ky qëndrim flet për mendjemadhësi dhe mospranim të kritikës që bëri ekipi i aparatit të Komitetit Qendror, flet për nënveftësim të punës së kuadrove që kishte dërguar Partia për të ndihmuar dhe për të kontrolluar punën në atë rreth. Në praktikë mund të ketë raste që ndonjëri të mos jetë dakord me një konkluzion apo mendim të tjegrit. Kështu mund të ndodhë edhe me pikëpamjet e një anëtarë të ekipit, por, kur faktet janë të pakundërshtueshme dhe flasin vetë, nuk është e drej-

të të mendohet e të thuhet që «kritikat kundër meje janë shumë të rrepta». Në rastin konkret kritika nuk ishtë «e rreptë», se në Elbasan janë kryer veprime jo të rregullta, janë vërtetuar shkelje. Herë tjetër mendoj se për këto çështje ata që gabojnë duhet të japid medoemos llogari edhe përparrë organizatës-bazë dhe jo vetëm përparrë ekipit të dërguar nga Komiteti Qendror ose para byrosë së komitetit të Partisë të rrethit. Edhe kuadrot, si të gjithë komunistët, duhet të përgjigjen më parë se kudo përparrë organizatës-bazë, se kjo ua di yçklat më mirë se kushdo.

Mund të jem i gabuar, por vihen re raste që aparatet e Partisë nuk i pasqyrojnë kurdoherë në dokumentacion kritikat që u bënën kuadrove. Për këtë dëshiroj të shpreh disa mendime:

Kuadrot e aparatave të Partisë në qendër dhe në rrethe jo gjithnjë e kryejnë mirë e pa të meta detyrën, sepse si sekretarët edhe instruktorët e Partisë nuk kërkojnë si duhet llogari nga njëri-tjetri. Vërtet ne që punojmë në aparatet jemi ngarkuar nga Partia për të ndjekur dhe për të zgjidhur probleme të caktuara, por, si komunistë, edhe për ne, si për të gjithë të tjerët, nuk mund të ketë asnjë kufizim në kritikat që duhet të na bëhen. Kritikat për cilindo kuadër, deri edhe për cilindo udhëheqës të Partisë të çdo niveli qoftë, duhet të janë kurdoherë të drejta, të faktuara dhe konstruktive. Me këto ne duhet të arrijmë që, pasi ta kritikojmë shokun, atë ta vrasë ndërgjegjja për gabimin e kryer, që punën nuk e pa me syrin e Partisë. Shoku i kritikuar duhet të mendojë: Pse ndodhi kështu me mua? Ku i kisha unë

sytë dhe mendjen, përse nuk i pashë këto gjëra përtë cilat kam porosi vazhdimisht nga Partia? Dhe i kritikuari të vërë mend për herë tjetër. Kështu në aparatet e Partisë të krijohet mendimi i vërtetë marksist-leninist për çdo problem dhe në këtë rrugë të zgjidhet. Në radhë të parë, punëtori i Partisë t'i kërkojë llogari vetes nëse e ka kryer mirë apo jo detyrën, pastaj t'i kërkojë llogari edhe shokut, duke i folur hapur në organizatë.

Po të veprohet në këtë mënyrë, atëherë mund të themi se aparatet punojnë dhe veprojnë mirë, ndryshe, punët nuk mund të ecin ashtu sikurse dëshiron Partia. Në qoftë se nuk ecet në këtë rrugë, në rast se kufizohet liria e kritikës, disa nga kuadrot e aparatave do të bien në pozita oportuniste ndaj eprorëve. Kjo do të thotë se ata, duke u përpjekur të ruajnë postin që kanë zënë, në vend që të mbrojnë mbi çdo gjë interesat e Partisë, do të mendojnë: «Le të preken interesat e Partisë, mjaf-ton që interesat e mia të mos pësojnë gjë. Unë varem nga sekretari i komitetit të Partisë, prandaj le ta kem mirë me tū». Sado të paktë të jenë kuadro të tillë në aparatet e Partisë, ne duhet të punojmë shumë për edukimin marksist-leninist të tyre.

Partia në kongreset e saj ka theksuar vazhdimisht që edukimi i kuadrit është një nga problemet më të rëndësishme për mbarëvajtjen e punës. Duhet të punohet me kujdes për zbulimin si të anëve të mira edhe të atyre negative në kuadrot, me qëllim që të mirat të shërbejnë si eksperiencë për t'i shtyrë punët përparrë, kurse nga të metat e gabimet të nxirren mësimë. Këtë

punë duhet ta bëjmë medoemos dhe vazhdimesht, në radhë të parë, ne, punëtorët e Partisë, se qëndrimi ynë në këtë çështje ka rëndësi të madhe. Ne, punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror, japim ndihmë dhe kontrollojmë punën e Partisë në rrethe e në bazë, por të kemi parasysh që vetë të japim shembullin personal edhe në vlerësimin e drejtë dhe objektiv të punës dhe të qëndrimeve të çdo kuadri.

Për sa u përket plotësimit dhe administrimit të dokumenteve të kuadrove në kartotekat e Partisë tash nuk jemi më në gjendjen e dikurshme. Në krahasim me të kaluarën janë bërë përparime në këtë drejtim, megjithatë ka akoma shumë dobësi që ju, shokë, i konstatoni vazhdimesht, sidomos në drejtim të kuadrove me përgjegjësi, në dokumentet e të cilëve nuk pasqyrohet kurdoherë gjithçka që ka lidhje me ta. Prandaj edhe shokëve drejtues të një rrethi ku bëhet kontrolli, pasi këta t'i pranojnë gabimet në punë, këto duhet t'u formulohen edhe me shkrim dhe t'u jepen shokëve të sektorit të kuadrit. Në dokumentet personale të ndonjërit që, bie fjala, është treguar liberal për sa i përket zhvillimit të luftës së klasave, që ka bërë këtë apo atë gabim të zbuluar gjatë analizës që bën ekipi i Komitetit Qendror dhe organizata-bazë e Partisë ku ai bën pjesë, duhen shënuar saktësisht konstatimet. Të negligohet në këtë drejtim, do të ishte shkelje. Nuk është aspak e drejtë që tjetri të bëjë gabime të rënda dhe këto të mos i shënohen në dokumente, le të jetë ai me çfarëdo lloj përgjegjësie në Parti. Ca më keq akoma është që, kur ndonjëri transferohet për të meta në punë, e për-

cjellin si triumfator, duke shtruar darka të mëdha. Më të thjeshtë duhet të jenë kuadrot tanë në punë dhe në jetë! E them këtë se edhe kur thirren këtu për të raportuar për punën, disa kuadro na mburren, duke vënë në dukje vetëm sukseset, por jo edhe dobësitë e të metat. Prandaj në këtë drejtim duhet të punohet më shumë. Biografitë dhe karakteristikat e shokëve pa përjashtim, duke përfshirë edhe ato të kuadrove drejtues, është e detyrueshme të plotësohen rregullisht dhe të azhurnohen si duhet e jo të bëhen veprime në dokumentet e tyre vetëm kur përgjegjësit bëjnë ndonjë gabim të rëndë dhe ndëshlikohen. Kjo nuk është e drejtë. Kriteret e vëna duhet të zbatohen njëloj për të gjithë.

Partia duhet të dijë në çdo kohë përsë eshtë marrë kjo apo ajo masë, përsë eshtë bërë kjo apo ajo kritikë, se nesër kuadri mund të përsëritë një gabim tjetër të së njëjtës natyrë, nga i cili duhen nxjerrë konkluzione. Në një rast të tillë, duke lexuar shënimet e vëna më parë në dokumentet e kuadrit, Byroja Politike ose Sekretariati i Komitetit Qendror, për kuadrot e nomenklaturës së tyre, po kështu byrotë dhe sekretariatet e komiteve të Partisë në rrethe etj., do të konkludojnë që ky ose ai shok, në mënyrë të përsëritur, vazhdon të qëndrojë në të njëjtat pozita të gabuara.

Kur punët ecin mirë në një ndërmarrje, do të thotë se atje njerëzit punojnë si duhet. Kuadri i Partisë e ka për detyrë ta pasqyrojë edhe me shkrim këtë realitet pozitiv që zbulohet gjatë një kontrolli, duke vënë në dukje, për shembull, se drejtori ishte energjik, punëtor i palodhur, i lidhur me njerëzit, të cilët thoshin fjalë

të mira për të, e donin etj. Ose, në rast të kundërt, të shkruhet se drejtori ishte dembel, i ftohtë në marrëdhëniet me njerëzit, prandaj propozojmë që ky njeri të lëvizë, se është i papërshtatshëm për këtë detyrë. Kur një punëtor partie kthehet nga shërbimi, mendimin e tij të bazuar për çdo kuadër duhet t'ia japë edhe instruktorit të kuadrit, që ky t'ia vendosë në dokumentet personale. Sikurse u tha këtu, pasurimin e dosjeve të kuadrove nuk e bëjmë në çdo rast. Kështu, kur lind nevoja që na duhen kuadro të rinj, nuk i gjejmë dot lehtë, se s'ndiqet vazhdimisht ky problem. Prandaj, në dokumentet duhet të pasqyrohen mirë puna dhejeta e njerëzve, se janë me vlerë të madhe për Partinë.

Problemet e kuadrit nuk mund të zgjidhen mirë në qoftë se do të vazhdohet të ecet edhe në të ardhmen me të meta e dobësi si këto që u thanë në këtë mbledhje. Prandaj orientimet që kemi dhënë është e domosdoshme të zbatohen drejt, në mënyrë që, kur t'i thuhet, për shembull, komitetit të Partisë të një rrathi se nevojiten dy-tre brigadierë të zotë, me biografi të pastër etj., këta të zgjidhen duke u mbështetur në normat dhe në rregullat që janë vendosur, pse organi i interesuar, duke qenë i sigurt për karakteristikat e tyre, do të mund t'i caktojë me ndërgjegje të qetë atje kund nevoja të punojnë. Kjo siguri do të arrihet jo duke i zgjedhur njerëzit sipas mendimit personal të ndonjërit ose të lidhjeve të gjinisë apo të miqësisë së sëmurë. Në raste të tillë punën, qëndrimet dhe aftësitë e kuadrove duhet t'i çmojnë organizatat-bazë të Partisë, masat dhe aparatet dhe jo një njeri i vetëm.

Përveç anëve pozitive që thashë për ekipin, kisha edhe një vërejtje: koha e qëndrimit të tij prej një muajë në këtë rreth m'u duk ca e gjatë, por, duke marrë parasysh se përbëhej prej 14 vetash (e jo prej 30 vetash sa kujtoja unë) dhe në pjesën më të madhe nga shokë të rrethit, nuk kam kundërshtim të qëndrojë edhe kaq gjatë, se në këtë mënyrë krijohen mundësi për një punë më të kualifikuar. Megjithatë, duhet pasur kurdoherë parasysh që herë tjetër të ekonomizohet sa më shumë koha e punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror, jo në kuptimin që këta, kur dërgohen për ndihmë dhe kontroll, të kthehen sa më parë në aparat dhe të qëndrojnë nëpër zyra, por atje të bëjnë një punë të pastër, të mirë dhe të shpejtë për t'u dhënë mundësi që të shkronjë gjetkë, se për ndihmën e tyre kanë nevojë rrethet e tjera. Nuk përjashtohet që ju të shkoni prapë në Elbasan, por shokët e këtij rrethi të mos mbeten duke pritur që t'u venë gjithnjë për ndihmë nga lart, sepse duhet të bëjnë përpjekje e të mësohen që kryesisht të punojnë vetë. Në një rast të tillë ka rëndësi që, kur të shkoni përsëri në Elbasan, atje nuk duhet t'i gjeni më ato dobësi e gabime që u vutë një herë në dukje.

Edhe instruktorët e Komitetit Qendror, kur kthehen nga rrethet, duhet të sjellin të dhëna të sakta e me vlerë, si për çdo problem, edhe për punën e kuadrit. Këto të dhëna të nxirren nga përpjekjet e kuadrove në terren që luftojnë për të vënë në jetë vijën e Partisë. Kështu do të ndihmohet udhëheqja për të njojur konkretilisht ato probleme, për të cilat ka më tepër nevojë.

Kështu ndihma dhe kontrolli do të lënë gjurmë në rreth dhe në bazë. Motoja juaj (dhe këtë lypset t'u thoni shokëve të rretheve), të jetë kjo: Konkluzionet që jepen dhe detyrat që rrjedhin prej tyre të mbahen parasysh dhe të gjithë të mobilizohen për t'i vënë sa më parë në jetë.

Ju, si ekip ndihme dhe kontrolli, atje ku shkonit nuk mund të diktoni për çështje që janë në kompetencën e organit që kontrolloni. Por ju keni të drejtë dhe detyrë të ngulni kömbë për mbrojtjen e parimeve të Partisë dhe, kur kthheni së andejmi, të informoni Sekretariatin e Komitetit Qendror për anët pozitive dhe për dobësitë e kuadrit, puna e të cilit është kontrolluar dhe Sekretariati, pasi ta shqyrtojë informacionin, po taaprovojë, do të porositë që të dhënat e bazuara të vendosën në dosjen personale të kuadrit të nomenklaturës së vet ose të asaj të komitetit të Partisë të rrethit.

Të çudit fakti që na u tha kötu se një kuadër me përgjegjësi në Ministrinë e Financave mendon se nuk qenka punë e tyre të merren me kuadrin, bile në takimin që u bë me ta u tha shokëve të aparatit të Komitetit Qendror: «Nuk na ka shkuar në mendje kjo çështje»?! Po përsë të mos u shkojë mendja në një çështje kaq të rëndësishme dhe të gjykojnë aq ngushtë se me kuadrin u dashka të merret vetëm dega e kuadrit? Kur shkohet për të kontrolluar një objekt, sytë, në radhë të parë duhet të drejtohen te njerëzit, të puna e tyre dhe jo vetëm te makinat, te fondet, te shifrat etj.

Organizatat-bazë të Partisë kur gjenden përparrë disa momenteve që kërkojnë rrugëdalje, si në rastin

konkret, duhet të futen edhe në debate ideologjike. Unë mendoj se në organizatat-bazë duhet të zhvillohen debate edhe për një gjë që mund të duket e vogël, për të cilën ka paqartësi. Kështu mbledhja me një rend dite për një problem ekonomik, kur është rasti, mund të kthehet në një mbledhje ku të zhvillohet një debat ideologjik revolucionar. Kjo punë vlen për korrigjim dhe për sqarim të një pikëpamjeje të padrejtë të shprehur me qëllim të keq apo pa ndërgjegje. Organet dhe organizatat e Partisë, shpeshherë, nuk e praktikojnë sa duhet në jetën e tyre të përditshme një të tillë metodë të vërtetë lufte revolucionare që ndihmon për edukimin e kuadrit. Kuadrin, që ka pikëpamje të gabuara ose të meta, të përpinqemi ta bindim, me qëllim që të korrigjohet, por në qoftë se vërchet që nuk përmirësohen dhe i përsërit gabimet, në bazë të Statutit, Partia kundër tij duhet të marrë sipas rastit dhe shkallës së fajt këtë ose atë masë ndëshkimore me karakter edukimi.

Mendoj se shokët e aparatit të Komitetit Qendror duhej të qëndronin dhe të kërkonin që të analizohej monjëherë pikëpamja se kuadrot me përgjegjësi në dikaster nuk duhet të merren me problemet e kuadrit dhe, me këtë rast, të bëhej një debat i zjarrtë. Në këtë debat mund të sqarohej edhe çështja që ngritët këtu lidhur me këshillin e Bankës së Shtetit, për të cilin thoni se paska pesë-gjashtë muaj që e kanë suprimuar. Është për t'u çuditur si kanë vepruar kështu «me iniciativë», kur vetëm ditët e fundit i kanë dërguar propozimin Presidiumit të Kuvendit Popullor për ndry-

shimin e ligjit «Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar», që ka lidhje me këtë çështje.

Natyrisht banka jonë ndryshon rrënjesisht nga banka kapitaliste për sa i përket natyrës së vet, qëlli-meve që ndjek dhe detyrave e funksioneve që kryen, por unë mendoj se edhe ajo duhet ta ketë një këshill të përbërë nga përfaqësues të dikastereve që janë investitorët më të rëndësishëm. Në rast se paraqitet propozimi për t'i dhënë, fjala vjen, Ministrisë së Bujqësisë disa milionë lekë kredi, këshilli i bankës, në bazë të gjendjes dhe të mundësive që ekzistojnë, përpala se propozimi t'i kalojë për diskutim dhe aprovim Qeverisë, jep mendim që t'i akordohet këtij dikasteri kredia në masën e kërkuar, apo më shumë ose më pak, duke e argumentuar mendimin e vet. Njëri prej anëtarëve të këshillit mund të kundërshtojë, fjala vjen, për t'i dhënë kësaj ministrie jo aq të holla sa është menduar, po më pak, sepse ajo akoma nuk ka shpenzuar fondet që iu akorduan vitin e kaluar, kurse një tjetër mund të vërejë se, po t'i jepet kaq shumë kredi bujqësisë, do të mbetet pa u financuar një sektor tjetër që ka, gjithashtu, rëndësi etj. Me pak fjalë, në këtë këshill do të bëhen debate dhe, nëpërmjet tyre, do të dilet me sugjerime të vlefshme mbi ushtrimin e rregullt të funksioneve që i janë ngarkuar Bankës së Shtetit Shqiptar. Prandaj kam mendimin që ky këshill mund të funksionojë, duke u përbërë jo vetëm nga punonjës të bankës, siç ka qenë gjer tani, por edhe nga përfaqësuesit e atyre dikastereve që bëjnë më tepër investime. Ky këshill, siç e përfytyroj unë, do ta ndihmojë Bankën

e Shtetit tonë me mendime të drejta, që kjo të jetë, veç të tjerave, edhe një organ studimor për problemet që hyjnë në sferën e veprimitarisë së saj. Për të gjitha arsyet që parashtrova, si anëtar i Presidiumit, kërkova të kthehej për rishikim projekti që përbante propozimin për suprimimin e këshillit të Bankës së Shtetit. Drejtori i përgjithshëm i Bankës së Shtetit ka nevojë të ketë një organ këshillues.

Ashtu sikundër ka shfaqje të burokratizmit dhe të teknokratizmit në drejtime të tjera të punës së Partisë, ka edhe në sektorët e kuadrit, ku vërehet një punë rutinë, jo kurdoherë e lidhur me jetën dhe me luftën që bën Partia në terren. Po erdhën të japid ndonjë të dhënë për punët e kuadrit punëtorët e Partisë që shkojnë në bazë, mirë, po nuk erdhën, nuk u kërkohet gjë në këtë drejtim nga punonjësit e kuadrit. Kjo nuk është e drejtë. Interesim duhet të ketë edhe nga shokët instruktorë. Këta, kur kthehen nga baza, kanë të drejtë dhe detyrë t'u thonë punonjësve të sektorit të kuadrit: «Përse ju, shokë, nuk na pyetni për njërin apo për tjetrin, punët e të cilët i pamë kur shkuam në bazë? Ju për këtë punë ju ka ngarkuar Partia, prandaj i merrni këto të dhëna me shkrim dhe i studioni!».

Këtu u fol edhe për diçka tjetër me shumë rëndësi. Kur ngrihen kuadrot e rinj, disa nga të vjetrit mendojnë për ta se «nuk janë shumë të përshtatshëm!». Mund të ketë edhe ndonjë rast kur kuadri i ri të mos jetë zgjedhur si duhet, por kjo zgjedhje jo e mirë, që buron nga puna e dobët, të cilën e kritikon Partia, nuk është tipike te ne. Dëshiroj t'i referohem kësaj çështjeje për të

vënë në dukje se mendimi përqmues i disave për kuadrot e rinj nuk është aspak i drejtë.

Përse mendojnë kështu, sikurse u diskutua këtu, disa nga kuadrot tanë? Sepse këta nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme që të ambientohen sa më shpejt me të ardhurit rishtas. Kur u ngarkojnë këtyre të fundit detyra, disa shokë nuk e vrasin shumë mendjen se si do ta bëjnë të rinjtë këtë punë. I vjetri do të ambientohet shpejt me kuadrot e rinj, në rast se, kur i vijnë një apo dy shokë të rinj, do të punojë jo 8 orë, po 10-12 e më shumë dhe do të intensifikojë përpjekjet që t'i mësojë, në mënyrë që brenda dy-tre muajve i riu ose e reja t'ia marrë mirë dorën punës. Por vihet re se, në vend që të veprohet kështu me kuadrin, ka shokë që i kanë në majë të gjuhës fjalët: «Zgjedhja e këtij që na erdhi nuk është bërë mirë». Këto gjykime krejt subjektive vijnë nga tendenca mikroborgjeze që i vjetri të lodhet sa më pak për vete. Pastaj nuk përjashtohet që ndonjë shok me stazh të gjatë në punë të ketë nostalgjinë e thurjes së lëvdatave nga ana e vartësve. Ka ndonjë përgjegjës, bile shumë i mirë, që është mësuar me ndonjë kuadër rrëth vetes dhë, megjithëse ky mund të ketë shumë të meta, vazhdon ta mbajë asër për 10-15 vjet me radhë. Pse ndodh kështu? Sepse një vartës i tillë me karakter të dobët, mund të jetë mësuar të thotë për çdo gjë: «Si urdhëron, ke të drejtë, shoku shef».

Kuadri që vjen rishtas në një punë, natyrisht, nuk mund të ketë eksperiencën e atij që ka vite atje, mirëpo Partia e ka sjellë atë jo vetëm pse ka biografi të mirë,

se është i hedhur dhe i papërtuar në punë, por edhe sepse aparatet duhen pëtérirë me gjak të ri. Duke e kuptuar këtë domosdoshmëri, më të vjetrit në qendrën e punës e kanë për detyrë të bëjnë përpjekje që ta ngrënë nivelin e të rinxve dhe jo akoma pa zënë vend mirë këta, të thonë se «të rinxjtë nuk janë zgjedhur si duhet!».

Te disa njeröz ekziston një mentalitet i tillë që fsheh në vetvete mjaft mbeturina, të cilat i pengojnë të mendojnë e të punojnë si revolucionarë. Ndonjë mund të mos i kushtojë shumë rëndësi qëndrimit ndaj një nëpunëseje të re, të cilën, në vend që të komunikojë përzemërsisht që në fillim, ta trajtojë me ngrohtësi, ta përshëndetë: «Mirë se na erdhe!» etj., nuk e pyet fare nga ka ardhur, ç'punë bënte, çfarë pjesëtarë të familjes ka, ku i ka, si i ka etj. Këto të dhëna përgjegjësl duhet t'i marrë nga vartësi që porsa ka ardhur, t'i bëjë një-kohësisht të qarta detyrat që i takojnë, ta mbajë afër dhe ta inkurajojë që brenda një kohe të shkurtër të arrijë nivelin e të tjerëve. Të ndihmohen me përzemërsi të rinxjtë e jo të përfitohet nga mungesa e eksperiencës së tyre për të thënë: «Nuk bëjnë!». Trajtimi i ngrohtë dhe shumë i përzemërt i të rinxve duhet pasur parasysh kudo, si në organet qendrore edhe në ndërmarrjet, në kooperativat bujqësore dhe në kantieret e ndërtimit, ku kanë vajtur dhe do të venë mjaft të rinx e të reja për të punuar. Kuadrot e rinj të mbahen afër, për ta dhe për jetën e tyre të tregohet shumë kujdes.

Partia ka sjellë dhe do të sjellë akoma punëtorë në vende drejtuese dhe me përgjegjësi, se kjo është poli-

tika e saj, por s'duhet harruar se në radhët e punëtorëve ka edhe nga ata që nuk e kanë të zhvilluar ndër-gjegjen klasore dhe janë të molepsur me ndjenja mikroborgjeze. Është me të vërtetë punëtor i formuar jo ai që vetëm punon në prodhim, por që ka edhe ndjenja proletare. Ta gjykosht tjetrin me sy të shëndoshë partie, me zemrën e normat e Partisë dhe me ligjet e shtetit, do të thotë ta peshosh objektivisht, ashtu siç është, me të mirat dhe me të metat që ka.

Në zbatimin e direktivave të Partisë nuk duhet të jemi as sektarë, as liberalë. Të dy këto qëndrime janë negative, të huaja për Partinë, prandaj ajo ka luf-tuar me rreptësi në të dyja anët kundër tyre. Kur ndodhemi para qëndrimesh të tilla, është e domosdoshme të marrim menjëherë masa të përshtatshme për eliminimin e tyre, pra të luftojmë që të mos jemi as sektarë, as liberalë, por as t'i lëmë të kalojnë çështjet, duke gjykuar me mendjelehtësi se «kjo është një gjë e vogël». Të mos nënveftësojmë «të voglat», shokë, se këto pjellin të mëdhatë. Edhe një gjë e vogël e komprometon tjetrin. Po iu la shteg një ose dy komunistëve dhe kuadrove që të kridhen në disa dobësi të punës, edhe pse për një kohë mund të jenë të mirë, ka rrezik që ata të futen thelli, të prishen dhe të marrin një rrugë të rrezikshme, të dënueshme nga Partia. Prandaj është detyrë e Partisë, e çdo organizate-bazë, t'uа vërë në dukje në kohën e duhur shokëve gabimet, të metat e dobësitë, ndryshtë ato do të trashen dhe ne mund të humbasim nga radhët tona njeröz të mirë.

Në momente të acarimit të luftës së klasave, kur

zbulohen clementë me fryshtë liberalo-oportuniste dhe armiqësore, është e natyrshme që të ketë një mobilizim nga ana e kuadrove dhe e gjithë njerëzve tanë revolucionarë e patriotë, veçse ky mobilizim duhet të jetë me të vërtetë revolucionar. Por të bëhet kujdes që të mos shihet çdo veprim me syrin e dyshimit dhe jo për çdo njeri me një njollë të vogël të thuhet: «Ky është armik», Ata që i shohin çështjet kështu, nuk mund të janë revolucionarë të vërtetë, por elementë sektarë.

Kohët që jetojmë janë me të vërtetë revolucionare, por në këtë revolucionarizim të situatës dhe të njerëzve, duhet të njohim se ka edhe qëndrime sektare. Për shkak të punës së thickuar armiqësore, ka kuadro që janë komprometuar dhe s'kanë qenë vigjilentë. Partia duhet të përpinqet tash që këta t'i shpëtojë. Në këtë situatë ka rrëzik që disa kuadro ose anëtarë partie të paformuar mirë të mbajnë qëndrime sektare ose oportuniste ndaj tyre. Disa të tjerë, elementë jo të shëndo-shë, duke u hequr sikur janë me Partinë, mund të spekulojnë në mënyrë të fshchtë për ta goditur dhe për ta dobësuar atë. Oportunizmi dhe liberalizmi në këto momente fshihen, por nuk zhduken, prandaj në qoftë se në këtë situatë nuk zhvillojmë një veprimitari të gjallë revolucionare, ato si shfaqje të ideologjisë së huaj, mund të ringjallen përsëri.

Momentet që kalojmë kërkojnë të jemi revolucionarë dhe jo sektarë. Ai që tregohet sektar shumë herë e mban këtë qëndrim në mënyrë të pandërgjegjshme, por për oportunitet ndaj Partisë. Një njeri i tillë hiqet

sikur qëndron me shpatë në dorë për të krijuar përshtypjen se gjoja është revolucionar i madh, ashtu sikurse u përmend këtu. Të tilla qëndrime janë shumë të rrezikshme. Duhet ta dënojmë një shok, motra e të cilit ka qenë martuar prej kohësh me një njeri, që njihet nga Partia si njeri i mirë, kurse tani na del që qenkësh element armik? Këtë shok, që është besnik i Partisë, që gruan e ka patriote, që ka në rrethin e vet të ngushtë familjar tre-katër anëtarë partie dhe kunatin Hero të Punës Socialiste, nuk do ta ndëshkojmë vetëm se burri i motrës së tij u zbulua që është armik. Ky qëndrim nuk do të përputhej me vijën e Partisë. Një shok si ky, që morëm sa për shembull, duhet ta thérresë të motrën dhe t'i thotë: «Unë të kam pasur dhe të kam motër, por burri yt është armik. Për këtë gjë ti ke faj, se duhej të kishe nuhatur diçka për veprimtarinë e tij, por nuk kuptove, se nuk u tregove e zgjuar. Unë do të mbaj qëndrimin tim revolucionar». Organizata-bazë e Partisë nuk mund ta dënojë këtë shok që mban qëndrim të drejtë.

Duke lexuar një ditë letrën që më dërgoi një kuadër, mësova se e kishin hequr nga puna si përgjegjës të financës, për arsy se një kushëri i tij kishte qenë me Ballin! «Ç'po bëhet kështu me mua, shoku Enver, — më shkruante ai, — duke më hequr nga puna, sepse një kushëri e kam pasur ballist dhe nuk merret para-sysh që babai im ka qenë partizan dhe është komunist, nëna ime, gjithashtu, ka qenë partizane dhe komuniste sa ishte gjallë, se dy vëllezërit dhe tre dajat i kam anëtarë partie?». Një radhë komunistësh në rrethin

familjar ka ky kuadër, megjithëkëtë, sipas letrës së tij, del që e kishin pushuar nga puna për arsyen të një kushërimi ballist! Këta njerëz që ngrihen në organizatën-bazë dhe bëjnë propozime për masa të tillë ekstreme, nuk gjykojnë me partishmëri. Edhe organizata-bazë e Partisë ku bëjnë pjesë këta, duke vepruar në mënyrë sektare dhe duke u konformuar me propozimin e tyre, tregohet oportuniste në zbatimin e direktivave të Partisë.

Pse ndodh kështu? Sepse ekziston njëfarë ngurrimi i pajustifikuar për të gjykuar drejt, objektivisht, me fryshtësi partisë dhe me përgjegjësi. Organizatën-bazë të Partisë duhet ta forcojmë, por, duke vepruar kështu, ajo dobësohet.

Për njerëzit që gabojnë të tregohet interesim, t'u gjendet punë, kur të vijë rasti të pyeten nëse janë të kënaqur me punën, si shkojnë, si sillen shokët me ta etj. Në rast se dikush ankohet për ndonjërin, çështja të shikohet drejt. Me një të tillë punë ndoshta nuk ka kohë dhe mundësi të merret personalisht vetë sekretari i parë apo një sekretar tjetër i komitetit të Partisë, prandaj ka rëndësi që këto çështje t'i kuptojnë të tërë anëtarët e Partisë që ta kenë të qartë qëndrimin që duhet mbajtur në çdo rast. Mbajtja afér e këtyre njerëzve duhet të bëhet me qëllim që këta të mos armiqësohen as me Partinë, as me pushtetin, të mos demoralizohen, të punojnë me shpresë, ta kenë kurdoherë të qartë gjendjen për vete, të njojin gabimet dhe ta dinë si sillet Partia me ta. Kur një sekretar partie ose një kuadër tjetër i njojur qëllon të ndodhet pranë një nje-

riu të tillë që ka gabuar dhe i jep dorën në sy të të tjetërve, ky qëndrim ka për atë një vlerë të madhe, se e ngroh, e frymëzon, e inkurajon dhe e aftron me Partinë. Një qëndrim i tillë e forcon situatën dhe e nxit të punojë që t'ia shlycjë Partisë gabimet që ka bërë. Dëshiroj të them me këtë rast se nuk është aspak e drejtë të shprehë dyshime për atë që i jep dorën një njeriu të përjashtuar nga Partia për mefshtësi. Të tillë njerëz, që arrijnë t'u shmangen takimeve e bisedave me ish-komunistë që kanë gabuar, por që s'janë armiq, janë frikacakë. Rreziku i këtyre shfaqjeve më duket se qëndron në të kuptuarit teorikisht të përciptë të këtyre problemeve nga ana e disa komunistëve.

Marrja e masave ekstreme deri në përjashtim nga Partia e disa komunistëve në dikastere dhe gjetkë që kanë punuar, kanë luftuar dhe Partia i ka bërë kuadro me vlerë, kur këta kanë edhe një rreth miqësor besnik të Partisë, do të ishte gabim. Rrallë ka qëlluar të na kenë shpëtuar nëpër dikastere dhe në rrethe kuadro të pakontrolluar, ish-ballistë, elementë armiq, sepse, para se t'i vendosim në këto vende, ne i kemi shkuar në shoshë.

Partia nuk na mëson që, për t'i bërë qejfin fisit, të mos dënohen disa elementë armiq si Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e të tjerë, apo ndonjë spiun ose kusar. Jo! Partia këta do t'i dënojë, jo vetëm duke i përjashtuar nga radhët e saj, por edhe duke i dërguar në gjyq për të dhënë llogari, për t'i dënuar sipas ligjit dhe shkallës së fajit. Në këto raste farefisit do t'ia themi arsyen e dënimit, prandaj, të gjithë e kanë për detyrë

të mbajnë qëndrim partie, por nuk duhet t'i përbuzim pa dallim e në çdo rast njerëzit e rrëthit fainiljar të të dënuarve, motrat, völlezërit, hallat, tezet, dajat etj., etj. që në luftë e në punë kanë provuar se janë me Partinë. S'ka dyshim që ata ndiejnë një dhimbje dhe dëshpërim të madh kur mësojnë se djali i tezes, i xaxhait, i dajës apo i hallës doli tradhtar, po kjo nuk do të thotë që ne t'i shikojmë me sy të shtrembër kur ata e dënojnë dhe jo formalisht këtë armik. Për pjesëtarët e rrëthit familjar të të dënuarit duhet të mbahet qëndrim në qoftë se vërtetohet që edhe ata vetë kanë faj, por, në qoftë se nuk kanë faj dhe vazhdojnë të ecin në rrugën e Partisë, t'i mbrojmë. Prirja e disave është që të ecet drejt sektarizmit, drejt goditjes, pa u mbështetur në qëndrimet individuale të secilit. Qëndrimet sektare i bëjnë dëm Partisë. Partia nuk duhet të lejojë as opinionin, as anëtarët e saj që të mbajnë qëndrime ekstreme, por ta përpunojë opinionin që ky ta shikojë drejt dhe në rrugë partie këtë mori njerëzish që s'janë të armikut. Ndryshe do të na krijohet një situatë që dëmton unitetin e Partisë me popullin, ashtu siç do të dëshironë armiku.

Krejt ndryshe qëndron puna kur kemi të bëjmë, për shembull, me të birin e një tradhtari, që nuk ka dhënë prova se ka luftuar e lufton qëndrimin armiqësor të babait. Megjithatë as këtë Partia nuk do ta lërë pa punë, po ama nuk do ta vëré në vende me përgjegjësi, për arsyen se na qenka, ta zëmë, inxhinier i dalluar. Një gjë të tillë s'duhet ta bëjmë. Këtë njeri Partia ta dërgojë në një punë të thjeshtë, punëtor, ku

të japë prova se dëshiron të ecë në rrugën e Partisë dhe t'i shërbejë popullit.

Çështjen e kuadrit Partia e ka parë dhe e shikon kurdoherë drejt. Në radhë të parë, pür vlerësimin e çdo kuadri duhet të shihet besnikëria politike, pastaj aftësitë e tij tekniko-profesionale. Një njeri mund të jetë shumë i zoti, por, po të ketë tre daja ballistë dhe babanë të pushkatuar nga organet e pushtetit të diktaturës së proletariatit, nuk mund ta bëjmë nënkyetar të komitetit ekzekutiv të këshillit populor të rrethit ose kryeinxhinier të një ndërmarrjeje me rëndësi. Partia as e ka lejuar dhe as do ta lejojë ndonjëherë një qëndrim të tillë oportunist.

Le të jetë i zoti si teknik, ne nuk mund ta bëjmë ministër, zëvendësministër ose drejtor, por si teknik e lëmë të punojë. Çelësat e dyerve të pushtetit as ua kemi dhënë dhe as do t'uaj japim njerëzve të tillë.

Gjyki i kuadrove nga ana e Partisë duhet të bëhet me gjakstohtësi. Është skandaloz përjashtimi nga Partia i drejtorit të një ndërmarrjeje në një rreth, që e kanë akuzuar se kishte ndërhyrë pér t'i dhënë shtëpi një kuadri në një kooperativë bujqësore, jashtë ndërmarrjes që drejtonte. Gjithashtu, atij i kishin ngritur se, kur kishin shkuar punonjësit e radiotlevizionit pér të marrë pamje nga puna në këtë ndërmarrje, ky, pér t'u dukur, paska dalë para punonjësve të tjerë. «Po përsë të mos dilja edhe unë, — kishte thënë ai, — derisa isha drejtor dhe, si gjithë punonjësit e tjerë të kolektivit, isha ballëlart se ndërmarrja jonë i kishte realizuar detyrat?». Këtij shoku që punonte pa u lodhur

dhe prandaj organizata-bazë e Partisë, kolektivi dhe dikasteri përkatës e kishin vlerësuar për mirë punën e tij, në vend që të mjaftoheshin t'i bënин një kritikë apo t'i jepnin një vërejtje për gabime apo dobësi që ka pasur në punën e tij si kuadër drejtues, i dhanë dënimin kapital, përjashtimin nga Partia dhe e shkarkuan nga përgjegjësia. Kjo masë ekstremë u mor edhe nën pretekstin se në vend të tij duhej të sillnin një punëtor. Nuk mund ta pushkatosh politikisht një njeri përgabime që nuk e vlejnë këtë dënim, si në rastin e përmendur më lart.

Duke spekuluar në vërejtjet që bëhen nga Partia për të mbajtur ekuilibrin në zbatimin e drejtë të vijës së saj revolucionare, ai që ka prirje për të qenë sektar, por që në fakt është oportunist, do të mendojë: «Ja, Partia më hapi tash dritën jeshile» dhe do të fillojë të bëjë punën e tij të mbrapshtë. Ka njerëz që kujtojnë se i bëjnë mirë Partisë me qëndrimet e me veprimet e tyre sektare, por në të vërtotë ata e dëmtojnë kështu unitetin e saj me popullin. Ju, shokë instruktorë, që shkoni në rrethe e në bazë, si punëtorë partie, ashtu edhe kuadrot drejtues të Partisë në rrethe, të keni kurdoherë parasysh mësimet e Partisë që sektarizmi është vëlla me oportunizmin, prandaj të bëhet kujdes që, nën petkun e luftës kundër sektarizmit, të mos u hapen portat oportunizmit dhe oportunistëve. Kuadrot e shëndoshë të Partisë duhet të ruhen nga sektarizmi, por, në të njëjtën kohë, të bëjnë kujdes që të mos kalojnë në oportunizëm, të mos bien në asnje rast në rrugën e rrezikshme të pajimit me armikun e klasës, i cill

duhet luftuar pa kompromis e gjer në fund. Kjo lëkundje edhe ndodh në këtë situatë, prandaj syrin ta kemi kurdoherë vigjilent për të ndrecurr luhatjet që mund të vihen re, qoftë nga e majta ose nga e djaththa.

Mendoj se duhet punuar shumë, në të gjitha drejtimet që përmenda, për punën me kuadrin. Si konkluzion mund të them që tërë Partia, dhe ne si një organizatë-bazë e saj, duhet të punojmë me hov të madh revolucionar për zbatimin e normave të vendosura. Po të thoshim se paskëtaj nuk do të kemi kurrë më të meta, as të tilla shfaqje e qëndrime që kritikuam, nuk do të ishim realistë. Lufta e klasave vazhdon dhe mbeturinat e ndryshme shfaqen ku më shumë e ku më pak. Detyra e Partisë është që të punojë fort për t'i edukuar njerëzit, për t'i futur dhe për t'i angazhuar në punë. Në revolucion, në luftë dhe në punë ata korrigojnë të metat e dobësitë dhe ecin përpara.

Të gjitha detyrat që keni marrë përsipër ju, shokë, që veni vazhdimisht në bazë, i zbatoni me kujdes, se këto japid rezultate të mira. Nga konstatimet, për disa rrethe mund të nxirren konkluzione duke vënë në dukje se këto dobësi që vërehen atje janë karakteristike vetëm për to, apo shikohen edhe në organizata partie të rretheve të tjera. Të metat shfaqen për të njëjtat probleme dhe në të njëjtat forma apo për probleme të ndryshme dhe në forma të tjera më të ashpra ose më pak të ashpra? Si përfundim, të dilet me propozime konkrete se çfarë duhet të bëjmë, çfarë masash duhet të marrë Partia për përmirësimin e punës dhe për të eliminuar në shkallën më të madhe dobësitë në këto

rrethe si dhe situatat e ngjashme që mund të krijohen në rrethe të tjera. Këtë mendim kisha unë. Shokët le të japid gjykimin e tyre ashtu si e çmojnë më të arsyeshme.

Puna e mirë që bëhet tregon se, në përgjithësi, kuadrot e aparatit të Komitetit Qendror kanë fituar eksperiencë, ata e kanë ngritur nivelin e punës së tyre, i kanë thithur si duhet direktivat e Partisë dhe bëjnë përpjekje për t'i zbatuar me përpikëri, duke ndihmuar, duke kontrolluar e duke korrigjuar shokët e Partisë në rrethe e në bazë.

*Botuar për herë të parë, me
dissë shkurtore, në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1976-1977», f. 102*

*Botohet i plotë sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

QE ULLIRI TE JAPE SA ME SHUME PRODIHM KERKOHET PUNE E PALODHUR DHE SILKENCE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

23 qershor 1976

SHOKU HAKI TOSKA: Dje ne kishim thirrur sekretarët e komiteteve të Partisë të zonave të ullirit, për t'i vënë në dijeni me konkluzionet e mbledhjes së Sekretariatit mbështetur në fjalën tuaj¹, shoku Enver, për ullirin.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'probleme të reja ngritën shokët e rretheve?

SHOKU HAKI TOSKA: Në diskutimet e tyre ngritën këto çështje: Si është gjendja, sa ullinj keni në rrelj, sa kemi mbjellë gjatë vitit dhe sa kanë zënë; si është gjendja e fidanishteve, si dhe për gjithë këtë situatë të rëndë që ka pasur ulliri.

SHOKU ENVER HOXHA: Duke ditur se çdo vit janë mbjellë fidanë të rinj, do të ishte më mirë sikur të informoheshim me shisra se sa prej tyre kanë zënë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepër, v. 57, f. 205.

SHOKU HAKI TOSKA: Këto ne i kemi. Ata na i thanë që të gjitha se sa kanë mbjellë këtë vit e sa kanë zënë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po a është verifikuar se sa kanë mbirë prej tyre nga ky vit e deri në këtë vit?

SHOKU HAKI TOSKA: Po, i kanë me shifra dhe me vite.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo vetëm me vite, po edhe konkretisht me rrënje, domethënë, se sa vjet ka që i kemi mbjellë, si dhe sa prodhim ullinjsh marrim prej tyre. Ndryshe, po të flitet në përgjithësi, është fare veresie.

SHOKU HAKI TOSKA: Në raportet që mbajtën tregonin se ç'shërbime u kanë bërë ullinjve dhe se sa kanë dhënë këta. Por, pjesa që u kanë bërë shërbime është fare e vogël në krahasim me sasinë e ullinjve që ata kanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu, duhet të kujdosemi ne për detyrat e planit që do t'u japim. Mundet që këto detyra ju ua keni dhënë, por tani duhet ndjekur zbatimi i tyre. Prandaj, të dhënat ua kërkoni me shkrim, me shifra, ndryshe do të na thonë fraza.

SHOKU HYSNI KAPO: Duhet të thoshin se në ç'vit ishte menduar që të futeshin në prodhim, sa do të jepnin etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Po t'ju thoshin këto dhe se çfarë masash do të marrin, atëherë ne mund të llogaritnim se sa do të merrnim për çdo rrënje edhe nga fidanët e rinj. Për shembull, nga ky vit deri në këtë vit parashikojmë të marrim 2 kg, nga ky vit deri në

këtë vit 8 kg, nga ky vit në këtë vit 15 kg, e kështu me radhë, po në këtë mënyrë, se çdo vit rendimenti duhet të rritet në mënyrë progresive. Pra, të dimë se sa e kërthi rezultatin e prodhimit për çdo vit. Atëherë, kur të merret prodhimi, ne do të shikojmë nëse përputhen fjalët që na thonë se do t'u bëjnë më shumë shërbime, se do të harxhojnë një ditë e gjysmë pune për çdo rrënje, se do t'i plehërojnë etj., me rezultatet konkrete që arrijnë, ndryshe, të gjitha ato janë vetëm fjalë.

SHOKU HAKI TOSKA: Nuk është bërë kështu, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ama, kështu duhet bërë.

SHOKU HAKI TOSKA: Edhe ne për këtë këmbëngulim, se ato shifra, që na dhanë ata, i takojnë situatës së tanishme, si çshtë tani gjendja e ullinjve, kështu që nuk janë të planifikuara as puna, as investimet.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë mendoj se mbledhja duhej bërë pasi të shikohej situata dhe pastaj të cakttonim detyrat. Ju i caktuat detyrat, por këto duhet të jenë të planifikuara dhe me përgjegjësi. Fjala vjen, në vitin 1978 nga kaq millionë rrënje që kemi, do të marrim mesatarisht kaq kilogramë ullinj për rrënje. Këtë t'ia themi Komisionit të Planit të Shtetit: «Morëm në raport gjithë rrethet dhe sekretarët na dhanë gjendjen. Atëherë, bëni llogarinë se sa prodhim duhet të merret mesatarisht më 1978, se vendimi u mor që për çdo rrënje ulliri të futen kaq ditë-punë, kaq për vjet-

jen dhe kaq për punime të tjera». Ndryshe, po nuk u veprua kështu, çdo gjë që thuhet e merr era.

T'ju them tanj një shembull konkret timin, një punë prej diletanti, që e vazhdova nga tre vjet, se çështja e ullinjve ka tërë jetën që na ka preokupuar. Në Pallatin e Brigadave ka disa ullinj, për të cilët pata ngarkuar Sterjo Gjokorecin¹, që të më bënte listat e tyre. Një grupi ullinjsh, prej 6 rrënjos, u vumë nga një tabelë. Caktuam si detyrë që të punohen dhe për secilin do të shënoheshin se sa prodhim dha çdo rrënjos. Tre vjet e bëmë këtë punë dhe shikoja që kishte ndryshime. Por, në katër milionë e ca rrënjos që kemi ne në tërë vendin, nuk bëhet dot kjo gjë për çdo rrënjos; ndoshta për kaq millionë rrënjos llogaria bëhet me mesatare. Rëndësi ka që ullirit që mbjell, t'i bësh shërbime.

SHOKU HYSNI KAPO: Lexova në gazeten «Bashkimi» se diku, në Shkodër, kishin filluar të merrnin prodhim nga ulliri qysh në vitin e gjashtë. Një gjë është e vërtetë që nuk kemi ç'të qahemi për ullirin, por për punën që i bëjmë atij, se ulliri ta jep.

SHOKU ENVER HOXHA: Të jep, sidomos, po t'i japësh.

Partia duhet të kuptojë mirë se ka një indiferentizëm të theksuar ndaj ullirit. Një qëndrim i tillë nuk duhet të lejohet! Mundet, deri në njëfarë shkalle të neglizhohet fiku, kumbulla etj., po ulliri jo, se është një ushqim i domosdoshëm, është edhe yndyrë, që i sigu-

1. Ka qenë punonjës në shërbimet pranë udhëheqjes së Partisë e të shtetit.

ron organizmit të njeriut kalori të mëdha. Në fund të fundit, po nuk pate kumbulla, mos ha, po ulliri është një pemë nga më të rëndësishmet, bile do të thosha, më i rëndësishmi. «Portokallet kanë vitamina», thonë mjekët. Dakord, edhe portokalle duhet të hash por, ama, gjella nuk hahet pa vaj, pa vajin e ullirit etj. Vaij është një artikull i domosdoshëm dhe, ta blesh jashtë, na kushton shumë.

SHOKU HYSNI KAPO: Në mbledhjen e byrosë të Komitetit të Partisë në Shkodër, një agronom tha se kanë filluar t'i mbjellin ullinjtë në distanca më të vogla nga ç'l kanë mbjellë më parë dhe, nga shërbimet që u bëhen, prapë ata japid një rendiment të madh.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, drejt e ka ai. Duhet ta shikojnë edhe punën e dendësisë; ullinjtë mund të mbillen edhe më dendur.

SHOKU HAKI TOSKA: Kryesorja është indiferentizmi dhe mungesa e kujdesit. Për ullirin nuk planifikohen detyra, ashtu siç veprojnë për të gjitha bimët e tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa thërrisni një çikë Pëllumb Çipin që e njeh këtë problem: jepini shifrat që morët dhe ngarkojeni të bëjë një studim për ullirin. Rezultatet e studimit t'ua bëjë të njoitura shokëve të Komisionit të Planit të Shtetit e t'u thotë se, duke u mbështetur në konkluzionet e aktivit që u bë në Komitetin Qendror për ullirin, si dhe në bazë të llogarive që kam bërë vetë, mendoj se duhet të planifikojmë që për këtë vit të marrim kaq prodhim, vitin tjetër aq etj. Atë që keni thënë në Komitetin Qendror duhet ta konkretizoni në plan, ndryshtë nuk bëhet.

SHOKU HYSNI KAPO: Edhe atë që thamë në Sekretariat, për t'i dhënë ullirit pleh kimik, duhet t'ia japim.

SHOKU ENVER HOXHA: T'ia japim, si të mos ia japim ullirit? Të planifikohet dhe të zbatohet me rrep-tësinë më të madhe! Nga sasia e planifikuar për të, asnje grusht të mos i jepet grurit, apo mlsrit, siç edhe ka ndodhur. Ne e kuptojmë pse bëhen këto veprime, se ekziston mentaliteti i vjetër që t'i vëmë rëndësi drithit, pa për të tjerat, s'prish shumë punë. Dakord, t'i vëmë rëndësi drithit, por Partia ka porositur që kjo të mos bëhet në kurri të detyrave të tjera, se, përndryshe, kri-jojmë shqetësimë të mëdha, populata po shtohet, prandaj duhet që krahas drithit, të prodhojmë edhe ullinj më shumë.

Në këtë sektor kemi bërë investime të mëdha. Por duhet t'i bëjmë edhe të gjitha shërbimet: edhe pleh t'i hedhim e të kujdesemi për të. Për të gjitha punët duhet të kujdesemi. Byroja Politike e ka theksuar vazhdimisht që bujqësia jonë duhet të jetë një bujqësi moderne, e planifikuar dhe të gjitha prodhimet të janë të harmonizuara e të jepin rendiment çdo vit e më të lartë. Dhe, që të jepin rendimente çdo vlt e më të larta, kërkohet punë e palodhur dhe shkencë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga hiseda e incizuar, që gjendet në AQP

NGA REALIZIMI I PLANEVE VARET MIREQENIA E POPULLIT

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

24 qershor 1976

Për planin që na vjen nga Qeveria është e nevojshme të punojë edhe aparati i Komitetit Qendror, i cili duhet të nxjerrë konkluzione nga studimet e mëparshme e të bëjë vërejtjet përkatëse. Këto, të bisedohen në mënyrë paraprake me shokun Petro [Dode] pasi shumë gjëra, para se të vijnë këtu, mund të sheshohen që në mbledhjen e Qeverisë, pa qenë nevoja të ngrihen edhe në Byronë Politike.

Lidhur me planin pesëvjeçar mendoj që thicks: duhet vënë:

Së pari, në synimin që deri në vitin 1980 ne të arrijmë të ecim drejt balancimit të importit me eksportin. Them drejt balancimit, sepse, ndoshta, do të jetë e vështirë që eksport-importi të balancohen plotësisht. Që të arrihet ky objektiv është e domosdoshme që planifikimet tona për importet të jenë shumë të shtrën-

guara dhe për nevojat më të domosdoshme. Bilc, të mendohet seriozisht dhe të bëhen përpjekje të mëdha për të shkurtuar sa më shumë nga importi, se, po ta marrim nga pikëpamja që këto ose ato gjëra ne nuk i kemi dhe na duhen, atëherë nuk do të ketë kurrë shkurtim importi.

Për mallrat që sjellim nga importi duhet të caktojnë disa prioritete. Në listën e importit vihen kërkesa për makineri, pajisje, pjesë këmbimi etj., dhe këto jo me një e me dy, por me qindra. Unë mendoj se në këto kërkesa duhet të përcaktohet se kush do të ketë prioritet: vetëm gjërat më të domosdoshme dhe që nuk i prodhojmë dot vetë, kurse ato që kemi mundësi t'i bëjmë vetë, të hiqen që tash nga importi. Me një fjalë, në këtë çështje duhet të zhduket fryma e vjetër. Pra, në këtë drejtim, të bëjmë përpjekje që të ecim drejt balancimit. Kjo hyn në atë që përmendim vazhdimisht, që të ecim me forcat tona. Këtej e tutje perspektiva është e atillë që këtë parim ta kemi akoma më mirë parasysh, pse nuk do të ketë më ndihma, kredi e gjëra të tilla nga jashtë. Prandaj të luftojmë që të ecim me këmbët tona. Kur themi të ecim me këmbët tona, këtë ta kuplojmë drejt, se në autarki ne nuk biem dhe as nuk mund të mendohet për autarki për vendin tonë.

Çështja është që të shfrytëzojmë në maksimum mundësitë e brendshme; makineritë të ngarkohen kudo në maksimum; të shfrytëzohen mirë minierat; të ndërtohen sa më parë fabrikat e pasurimit të mineraleve etj. Këto kanë rëndësi të jashtëzakonshme ekonomike për

arsye se u rritet vlera edhe më shumë pasurive të vendit, lëndëve të para, me qëllim që të stabilizohet eksporti, i cili ka nevojë për kromin e për bakrin tonë të pasuruar etj., etj. Këto drejtime, më duket mua, janë parimore e duhet të mishërohen në planin që do të hartojmë e jo të kënaqemi duke thënë se plani ynë i katërt ose i pestë pesëvjeçar ka qenë në këtë nivel dhe ky që vjen rritet më tej. Analogji ne duhet të bëjmë, por mendoj të jemi shumë prudentë, për arsyen e vetëkënaqësitë nuk na nxjerrin në rrugë të mirë. Fakt është se ne kemi bërë analogji dhe, po të vazhdojmë të bëjmë, do të na dalë që kemi tejkalime, kemi rritje të mëdha në ekonomi. Këto kisha lidhur me eksport-importin.

Së dyti, ne duhet të luftojmë për shtimin e prodhimeve që lidhen me përmirësimin e jetës së popullit. Por, përmirësimi i jetës së popullit duhet të bëhet jo sipas dëshirave, por duke ecur me kujdes, me qëllim që niveli i arritur të ngrihet relativisht, aq sa janë mundësitat reale dhe të mos lejojmë rënien e tij.

Gjithashtu, shtroj problemin: Do të bëjmë ne riprodhim të zgjeruar apo nuk do të bëjmë? Sigurisht që do të bëjmë, por, ky riprodhim ka një kufi. Duhet të kemi parasysh se ka ëndërrime, ka edhe realitet. Ne duhet të ndjekim realitetin dhe të mos bëjmë parashikime jashtë mundësive tona. Planet e mëparshme, në të cilat, duke dashur të realizojmë shumë gjëra, kemi bërë parashikime jashtë mundësive, duhet të na japid një mësim të madh pse, në fakt, shumë parashikime edhe nuk i kemi realizuar. Ne kemi dashur të

ndërtojmë shumë vepra, të cilat nuk i kemi ndërtuar dot në kohë dhe kemi qenë të detyruar t'i futim me vonesë në shfrytëzim. Fjalën e kam gjithnjë në lidhje me riprodhimin e zgjeruar, të cilin duhet ta realizojmë, se na duhet medoemos, mbasi pa të nuk mund të ecë përparrë ekonomia popullore dhe të përbushen nevojat e popullit. Cilat janë këto nevoja? Në radhë të parë mirëqenia e popullit dhe çështja e mbrojtjes së atdheut. Por, të dyja këto lidhen me zhvillimin e gjithë ekonomisë sonë. Prandaj, këtë riprodhim të zgjeruar duhet ta bëjmë realitet lidhur gjithmonë me mundësitë tona.

Flasim që kemi një industri mekanike të zhvilluar dhe, në fakt, ashtu e kemi, moderne. Kjo industri prodhon kryesisht vegla ndërrimi dhe, në qoftë se nuk gabohem, në vitin 1980 do të arrijmë të prodrojmë në vend deri 95 për qind të të gjitha nevojave për to. Kjo nuk është keq, bile shumë mirë dhe do të thotë se na mbenet vetëm rrëth pesë për qind për të sjellë nga importi, të cilat duhet të sillen në fryshtë që thashë më parë.

Ne duhet të jemi shumë dorështrënguar me devizën tonë pse, siç thashë, na krijon mundësitë e balancimit të import-eksportit. Me kinezët, ndonëse haptazi nuk jemi prishur, por brendapërmbenda jemi hiq e mos këput. Në këto kushte, na duhet t'i bëjmë llogaritë që në një të ardhme edhe importet e tyre mund t'i paguajmë, ashtu siç ua paguajmë të tjerëve. Mirëpo, nga do të dalin të gjitha këto? Kjo na imponon të kemi një ekonomi të tillë të studiuar, të balancuar, që të na japë mundësi të sigurojmë pavarësinë tonë, se vartësia ekonomike, sado e vogël që të jetë, është një minus. Pran-

daj, kur ke valutën, çdo hall që të kesh, vete blen çfarë të nevojitet.

Por, gjithë kjo industri mekanike ekzistuese, si dhe Kombinati Metalurgjik që po ndërtojmë na ka krijuar neve mundësi që të ndërtojmë vetë makineri dhe fabrika, natyrisht jo shumë të mëdha, por të atilla që të na ndihmojnë dhe të na japin dorë për të shtuar prodhimin, për të siguruar riprodhimin e zgjeruar, për të rritur eksportin dhe për të realizuar kështu ngritjen e mirëqenies së popullit. Të tilla fabrika ne tash kemi mundësi t'i bëjmë. Për to ne kemi edhe lëndë të para. Kjo do të thotë që kur themi të prodhojmë sodë në vend, kjo të realizohet dhe jo të mbetet në kartë; kur themi të prodhojmë çimento me mundësitë tona, edhe këtë ta bëjmë. Në një kohë shumë të vështirë, kur s'i kishim tërë këto mundësi si tani, ne kemi ndërtuar një fabrikë çimentoje pranë kombinatit «Josif Pashko», kurse tashti me tërë këto mundësi që kemi mund të ndërtojmë vetë fabrika çimentoje shumë më të mëdha.

Tash ne kemi mundësi të ndërtojmë, gjithashtu, me forcat tona një sërë fabrikash të tjera të vogla si për përpunim qumështi, prodhim djathi etj. Të tilla vepra industriale për përpunimin e prodhimeve, për të cilat kemi në vend lëndë të parë, ekstraksione e të tjera t'i planifikojmë për t'i realizuar. Këto gjëra ne mund dhe duhet t'i bëjmë vetë. Të ndërtojmë, gjithashtu, vetë fabrika për pasurimin e mineraleve tona atje ku akoma nuk kemi, kurse ato që kemi sjellë nga jashtë, t'i ndërtojmë me një temp shumë të lartë. Kjo lidhet me atë që thashë më parë, me ngritjen e vlerës

së lëndëve tona të para, të cilat shtojnë eksportin dhe stabilizojnë tregun tonë.

Së trcti, sektor me rëndësi të madhe për ne është bujqësia. Ky ritëm që kemi filluar këtë vit në bujqësi duhet të jetë si pikënisje që bujqësia jonë të arrijë në një nivel më të lartë. Në këtë drejtim ne duhet të jemi shumë ekzigtentë, shumë vigjilentë dhe njëkohësisht edhe organizatorë të mirë, për të mos thënë të përsosur, pse, në radhë të parë, nga realizimi i planeve në bujqësi varet mirëqenia e popullit. Në qoftë se nuk do ta zhvillojmë bujqësinë me një ritëm vazhdimit në rritje, çdo vit e më të lartë, këtë objektiv nuk do ta realizojmë dot. Ne mund të caktojmë dhe duhet të caktojmë se ku do të arrijmë në vitin 1980, por të përpinqemi që objektivat e vitit 1980 t'i arrijmë që më 1979 dhe shifrat e vitit 1979 t'i arrijmë që në vitin 1978 etj. Këtu tregohet forma e kuptimit të drejtë të vijës së Partisë dhe të detyrës për plotësimin e nevojave të popullit për prodhime bujqësore e blegtorale, si dhe të tepricave që nevojiten si rezerva për mbrojtjen e atdheut dhe për eksport.

Çështjet duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që të shfrytëzohen të gjitha mundësítë që ekzistojnë jo vetëm për bukën, për lulediellin, për ullirin etj., por edhe për blegtorinë, edhe për pemëtarinë etj. Me një fjalë, nuk duhet të kënaqemi me një rritje çfarëdo, me kuota që tashmë i kemi arritur e i kemi kapërcyer. Çështja është që në situatat që jetojmë, si kurdoherë, Partia jonë lufton për të ruajtur pavarësinë e atdheut edhe në ekonomi. Por, që ta ruash pavarësinë e atdheut, duhet të kesh edhe rezerva për të përballuar

vështirësitë e mungesat që dalin. Dhe këto rezerva nuk mund të krijohen veçse nga ne, duke realizuar planet që duhet të jenë reale, duke studiuar të gjitha mundësitë tona për ta zhvilluar prodhimin në kufijtë e mundshëm maksimalë.

Në lidhje me realizimin e detyrave të bujqësisë duhen marrë edhe një sërë masash, siç është, përveç të tjerash, mekanizimi. Në këtë pesëvjeçar ne nuk do të kemi perspektivën e sjelljes nga importi të makinave të mëdha. Ndërsa makina të vogla, si për shirje, për korrje, për prashitje, kultivatorë etj., ne kemi mundësi t'i bëjmë vetë. Por këto duhet të parashikohen në plan, të prodhohen e të shfrytëzohen dhe jo të na thuhet se nuk i dashka kooperativa, sepse ato i do socializmi. Mbase ka kooperativistë që duan të ecin me të vjetrën dhe të prashitin me shatë, por ne duhet t'i mësojmë të prashitin me kultivatorë dhe Partia duhet të punojë që këtë detyrë ta vërë në zbatim. Në këtë drejtim ne kemi forca disponibël që t'i përdorim për rritjen e prodhimit, pra, për të sigruar kudo riprohimi të zgjruar, por, njëkohësisht, kështu plotësojmë më mirë edhe nevojat e popullit, që është gjithmonë në këmbë i gatshëm për çdo detyrë që i caktojmë. Vetëm në qoftë se do të punojmë me një plan të tillë shkencor, do të mund të ecim ashtu siç themi, me këmbët tona.

Rritja e prodhimit kërkon edhe rritjen e transportit, prandaj këtë kapacitet transporti që kemi duhet ta administrojmë dhe ta përdorim mirë, sepse ka disa prodhime, si: për shembull, domatja, që nuk presin.

SHOKU HYSNI KAPO: Më thanë se në Durrës

ishin grumbulluar gjithë ato makina, nga të gjitha anët e Shqipërisë, për domate dhe nuk po i ngarkonin. Duke vepruar kështu, le që domatet do të prishen, por edhe makinat që kanë ardhur nga kooperativat rrinë pa punuar, në një kohë kur kanë gjithë ato punë për të bërë, si transport gruri e prodhimesh të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk është as e drejtë, as ekonomike të vejë të rrrijë makina kot në Durrës; ajo të vejë atje në momentin e caktuar, ose domatet të transportohen në Durrës me tren dhe nga treni drejt e në vapor. Por as ky nuk duhet të rrrijë e të presë në port, se, në bazë të kontratës, dihet se në ç'ditë do të vijnë domatet, prandaj edhe vaporë s'ka pse të mos niset në kohën e duhur.

Pra, duke i pasur parasysh të gjitha këto, plani ynë duhet të jetë i shtrënguar, ekonom, në vlera materiale dhe financiare e, krahas tij, kërkohet një mobilizim i madh revolucionar për ta realizuar.

Së katërti, krahas këtyre, me gjithë këtë eksperiencë të gjatë që kemi në zhvillimin e ekonomisë, që nga Çlirimi e deri tash, të punojmë edhe përgatitjen e planeve prognozë, që na mëson Marks. Diku ai thotë që plani prognozë duhet të parashikohet në vija të përgjithshme, por jo në erë. Edhe në këto plane të kihet parasysh zhvillimi proporcional i gjithë ekonomisë sonë socialiste se, në qoftë se nuk shikohet kjo, atëherë do të ecim me hope; bujqësia do të shkojë në rënje, industria do të na cenohet e kështu me radhë edhe të tjerat. Ta zëmë se kemi në plan të ndërtojmë 40 shkolla, por për këto duhen kohë dhe sonde që t'i

bëjmë. Atëherë, ato duhen përfshirë në planin prognozë që parashikon zhvillimin e ekonomisë sonë në vija të përgjithshme dhe harmonizon të gjitha degët.

Me këtë mënyrë, nga plani prognozë që ke hartuar më parë shumë gjëra i ke të gatshme, kur të përgatitësh planet e ardhshme pesëvjeçare. Në qoftë se në pesëvjeçarin e ardhshëm nuk e ke parasysh planin e përgjithshëm prognozë, do të ecësh kuturu. Po të mos zhvillosh, ta zëmë, kromin, atëherë në të ardhmen nuk ke se si të shkosh me një prodhim të zgjeruar. Këtu e shikoj unë domosdoshmërinë e rezervave.

Të mos mjaftohemi me ato që kemi tash, por të shikojmë edhe perspektivën, se, në prognozën e vitit 2000, për shembull, duhet të parashikojmë të bëjmë kërkime të tillë në sektorin e naftës që të na sigurojnë një sasi rezerve të caktuar. Nuk mund të themi se edhe deri tash nuk kemi ecur kështu. Por, realiteti është që plane prognozë të mirëfillta nuk kemi bërë. A duhet t'i bëjmë ne këto? Jam i mendimit se duhet t'i bëjmë. Komisioni i Planit të Shtetit nuk duhet të trajtohet si deri tani, duke u marrë edhe me vogëlima, për të rregulluar këtë ose atë çështje, për të autorizuar dhënen e disa tonëve grurë apo të ndonjë materiali tjetër. Për gjëra të tillë t'i jepen kompetenca kryetarit.

Një ministër, ta zëmë ai i Industrisë, ka planin, ka planovikët dhe specialistët e tjera të dikasterit, si dhe ndërmarrjet vartëse. Me të gjithë këta ai duhet të luftojë që të realizojë planet dhe për këtë do të kontrollohet nga Komisioni i Planit të Shtetit, I cili, nga ana e vet, po për këto realizime, do t'i raportojë Qeverisë.

Por, njëkohësisht nga ky kontroll, duke pasur para-sysh realizimet dhe të metat (se do të ketë edhe të meta e mosrealizime), si edhe tejkalimet, Komisioni i Planit të Shtetit përgattit me kchë edhe planin e ardhshëm pesëvjeçar, bën prognozën e këtij pesëvjeçari. Për plotësimin e këtij plani prognozë punon edhe më vonë dhe nuk e harron kurrë këtë detyrë, mban shënimë dhe bën vërejtje, se këtë Komisioni i Planit të Shtetit tashmë e ka si detyrë të veçantë.

Edhe shokët e udhëheqjes, herë pas here, në mbledhje u japid mendime drejtuesve të këtij organi, u kërkojnë shpjegime se si po ecën kjo çështje, pse nuk eci ashtu e pse eci kështu; çdo të bëjmë në të ardhmen etj. Kështu, për shembull, do t'i themi ministrit të Industrisë: «Pse, me këto rezerva nafte do të ecim ne? Ç'do të bëjmë në të ardhmen? Ne mendojmë të shtohet kjo, apo të shtohet ajo sasi» etj. Pra, një detyrë të tillë duhet të ketë Komisioni i Planit të Shtetit, po këtë ai nuk e bën. Kështu duhet ta kuptojmë këtë çështje dhe jo si thotë ndonjëri: «Nuk kemi plan për këto gjëra!». Ne duhet të mendojmë edhe për këto plane, ndryshe, po nuk menduam ne, kush do të mendojë?! Të mendojmë të gjithë, se kemi gjithë këta njerëz e aparate që jo vetëm të mendojnë, por edhe t'i ndjekin këto probleme.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kjo çështje është ngritur që në Kongresin e 6-të, shoku Enver. Dhe, është karakteristike se, menjëherë pas Kongresit, sa e shtruat ju çështjen e planit prognozë, Abdyl Këllezi filloi të thotë: «Kjo nuk bëhet, është e vështirë, kërkon ashtu e kërkon kështu». Dhe, në fakt, kjo lde u sabotua.

Ata u detyruan të bëjnë disa gjëra, sikur gjoja paraqitën disa materiale, por kjo hiçgjë nuk ishte.

SHOKU HAKI TOSKA: Ato ishin disa shifra të shkruara nga zyrat, pa studime dhe vëzhgime në vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj për këto edhe për gjëra të tjera, që do të na dalin gjatë studimit të këtij plani, mendoj të nxjerrim në pah disa parime kyç, bazë, që Partia i ka shtruar edhe përpara. Disa prej këtyre parimeve janë zbatuar e kanë dalë me sukses në disa drejtime, por në disa drejtime të tjera nuk kanë pasur sukses e nuk janë zbatuar.

SHOKU HYSNI KAPO: Një gjë tjeter shumë e rëndësishme, për të cilën keni tërhequr vëmendjen edhe ju, ka lidhje me Kombinatin Metalurgjik. Komisioni i Planit të Shtetit na informon se ky objekt nuk do të përfundojë në afatin e parashikuar. Pse e bëjnë këtë dhe çfarë arsyesh nxjerrin? Ata nxjerrin vështirësitë e ndërtimit. Mirëpo, në qoftë se ne nuk do të marrim masa të realizojmë ndërtimet sa më shpejt në këtë kombinat, në një kohë kur i kemi makineritë, atëherë nuk do të realizojmë atë detyrë që i kemi vënë vetes.

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se kemi vëshfirësi për makineritë që vijnë nga jashtë, është tjetër punë; por vëshfirësi nga brenda nuk duhet të ketë. Si mund të pranohet kjo?! Ndryshe ne duhet të pranojmë haptazi se janë bërë gabime shumë të rënda. Ne kemi caktuar investimet në limit dhe kemi realizuar vetëm një pjesë të vogël të tyre. Atëherë, përsë patëm parashikuar aq? Këto, me frymë të shenjtë bëhen? Jo, këto

bëhen me punë, me lëndë, me makineri, pra, kjo do të thotë se janë bërë Mogaritë gabim, domethënë, gjithë ai fond njerëzish, makinerish dhe forcash financiare e materiale që ua kemi dhënë ndërtuesve, duke i shpërndarë në të tërë vendin, nuk është realizuar. Njëkohësisht ne kemi vënë në plan ndërtimet të mëdha dhe askëto nuk i kemi realizuar. Këto forca krahu, financiare e materiale që destinoheshin në investimet nën limit, ku vanë? Këto shkuan në tejkallimin e shpenzimeve për ndërtimet e mëdha, të cilat, me gjithë këtë forcë të madhe që u vajti, përsëri nuk po realizohen. Kështu duhet bërë deduksioni. Në qoftë se Qeveria do të bëjë autokritikë, duhet ta bëjë pikërisht në këtë drejtim.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në qoftë se për metalurgjikun ndodh ajo që thotë shoku Hysni, atëherë bie po shtë Ideja e precedencës që thatë ju, shoku Enver. Ne duhet t'i japim medoemos precedencë ndërtimit të metalurgjikut; me të ka të bëjë shumë industrija mekanike, nga e cila varet ndërtimi i veglave të këmbimit, prodhimi i makinave, shfrytëzimi i lëndëve të para etj., etj. Është një politikë e tërë kjo.

SHOKU HYSNI KAPO: Kisha një gjë tjeter unë. Kur isha në Shkodër, shokët atje, më thanë se u ka shkuar një fond për Komanin dhe për digën e Spatharës. Sot më erdhi edhe përgjigjja me shkrim nga Kryeministria. Ata më informojnë se meqë diga ekzistuese për ujitjen e fushës së Zadrimës ka qenë e përkohshme, mendojnë të bëhet definitive dhe për këtë kanë filluar ndërtimin e digës së Spatharës.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne nuk kemi marrë vendim për të ndërtuar digë të re për Zadrimën, prandaj, para se të fillohej puna për ndërtimin e saj, duhej të ishte diskutuar më parë. «Po tani, pse e shtrojnë ata këtë çështje?» pyes unë. «Ne jemi nisur me një mendim të mirë, për arsyen ekonomike», mund të na thuhet. Nuk janë të drejta të tilla veprime!

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

TE SHTOJMË KUJDESIN PËR MEKANIZMAT NE BUJQËSI, SIDOMOS PËR NJEREZIT QE I PERDORIN ATA

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

25 qershor 1976

Çështja është që raporti mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë, të mos ketë fraza stereotipe dhe të mos futet në një mijë e një shifra, të cilat do të përmenden në raportin mbi direktivat e Kongresit të 7-të për planin e gjashtë pesëvjeçar. Mendoj se në raportin që do të mbaj unë, duhet të bëjmë analizën e faktorëve që kanë ndikuar në realizimin e planit dhe të shkaqeve që kanë sjellë mosrealizime në pesëvjeçarin e pestë. Ne duhet t'i raportojmë Kongresit se për hartinin e këtij plani, që paraqet Komiteti Qendror i Partisë për miratim, jemi udhëhequr nga parimet politike, ideologjike dhe ekonomike marksiste-leniniste. Gjithë kjo rrugë e ndjekur për hartinin e planit të shtetit tonë socialist dhe të ekonomisë sonë të centralizuar, duhet të dalë, se, po i dobësuam sadopak këto parime bazë, po i shkelëm ose i shtrembëruam këto në ekonominë

tonë të përgjithshme apo në degë të veçanta të saj, do të kemi perturbacione.

Për çdo ide, të marrim shembuj ilustrues konkretë, e të themi, fjala vjen: Shikoni, në ndërtim na ngjet që investimet nuk kanë qenë të studiuara, prandaj, ky fenomen duhet goditur, se, në qoftë se nuk e përcaktojmë drejt orientimin dhe nuk organizojmë mirë punën në këtë drejtim, atëherë investimet e tepërtë, jashtë kufijve, jashtë planeve në ndërtim, do të kenë reperkusione edhe në zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë.

Kjo që thashë më lart nuk do të thotë që raporti i Komitetit Qendror të jetë pa shifra. Përkundrazi, të vëmë edhe shifra, por shifrat kryesore, disa tregues për bujqësinë, për industrinë, për minierat, për arsimin e kulturën, për rritjen e mirëqenies etj.

Pas kësaj u kalua në diskutimin e problemeve të tjera. Kur po flitej për bazën mekanike të bujqësisë, shoku Enver Hoxha tha:

Mendoj se drejtoria e SMT-ve duhet të jetë një drejtori e fortë, sepse «armët», «topat», «raketat» e bujqësisë janë mekanizmat. Në qoftë se mekanizmat, qoftë edhe të vegjlit, por që janë të nevojshëm, nuk do t'i kemi në gatishmëri të plotë dhe nuk do t'i shfrytëzojmë si duhet të dhënat natyrore, njerëzore etj., për nevojat e kooperativave, nuk do të kemi bujqësi të përparuar dhe nuk do të ecim përpara.

Duhet të bëjmë përqendrimin më të drejtë të oficinave. Për këtë qëllim të caktohet një afat minimal, që përqendrimi të bëhet sa më parë. Ajo që ka bërë

Koço Theodhosi, duke i ndarë makinat metalprerëse në tërë kooperativat përnjëherësh, të përblyset. Të tëra këto probleme duhen studiuar, por të studiohen me syrin e vërtetë të centralizmit socialist, domethënë as të mos lihen zbuluar nevojat e kooperativave, por as të mos u lihen makina metalprerëse që s'presin kurrë metale ose presin një herë në hënë. Po kush duhet ta bëjë këtë? Këtë duhet ta bëjë në cdo rreth një komision i përbërë prej shumë ekspertësh, nën drejtimin e një drejtorie që duhet të krijojmë dhe pastaj të vendoset një disiplinë e hekurt, se nga këto që thuhen unë kam përshtypjen që kombajnat kanë defekte, sepse nuk ka asnjë kontroll partie apo shtetëror; në oficinë shpesh mungon disiplina e hekurt proletare.

Plani i oficinave, sigurisht, bëhet nga rrethi, por sa kontrollohet? Unë jam i sigurt që ky plan as nuk bëhet si duhet dhe as nuk kontrollohet. Atëherë, lind problemi: Do t'i mbajmë në eficiencë kombajnat apo s'do t'i mbajmë? Do t'i kemi në gatishmëri, apo nuk do t'i kemi? Do t'u bëjmë një shpërndarje racionale, apo nuk do t'u bëjmë? Ndoshta, kemi dërguar në Tropojë mjete që nuk duhet dhe kemi lënë Myzeqenë pa to. Kështu, fjala vjen, atje ku është e nevojshme duhet të ketë një oficinë të shëndoshë që të përballojë numrin e traktoreve, të kombajnave e të makinave korrëse, në kohën e duhur dhe punimet t'i kryejë me kualitet të lartë.

Prandaj, më duket mua, këtë çështje, përveç të tjerave, duhet ta marrë në dorë seriozisht Ministria e Bujqësisë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Duhen apo nuk duhen, për shembull, të gjitha ato autokombajna në Skrapar? Mos duhen makina më të vogla, se këto s'ka ku t'i përdorë?

SHOKU ENVER HOXHA: Besoj se nuk i duhen Skraparit autokombajnat; atje duhen makina korrëse.

SHOKU HYSNI KAPO: Është edhe një gjë, shoku Enver. Oficinat e mekanikës bujqësore nuk shfrytëzohen sa duhet. Në to zakonisht bëhet vetëm riparimi i vogël.

SHOKU ENVER HOXHA: Ta planifikojmë më mirë punën në oficina dhe të punohet me njerëzit. «Po pse, more djalë, e bën punën kështu», t'i thuhet atij mekanikut të oficinës; «A e di ti se me këto defekte kombajna i lë prodhimet pa i korrur? Pse nuk merr masa për ta kryer siç duhet këtë gjë?». Por, me sa duket edhe kombajnerët janë të papërgatitur. Një kombajne i thonë afro baras me një avion. Atëherë, këto kombajna që kushtojnë kaq shumë, ua japim në dorë atyre që kanë mbaruar vetëm një kurs?! Nuk janë të drejta këto veprime.

SHOKU HYSNI KAPO: Aty duhet të jenë traktori-stët më të mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, më të mirët duhet të jenë, si Shyqyri Kanapari. T'i rrinë mbi kokë kombajnës, të bëjnë çdo gjë, që ka nevojë ajo dhe jo të mbulojnë neglizhencat, duke thënë «jam i ri, unë tashti sa hipa në kombajnë»! Bëhet mirë që kontrollohet shitësja e një dyqani kinkalerie. Për këtë, kur vërtetohen dëmtime, bëhet problem, po përse nuk bëhet

problem edhe qëndrimi i kombajnerit? Këtu është çështja, mendoj unë, se nuk punojnë si duhet sëksionet e bujqësisë të komitcteve ekzekutive të rretheve. Ato nuk kanë parasysh këto çështje të rëndësishme që u përkasin atyre t'i drejtojnë. Seksionet nuk duhet t'ia hedhin të tërë fajin për këtë gjë ministrisë, sepse oficina «mitralozët» dhe «topat» e saj i ka në juridiksin e rrelshit, në drejtim e lidhje të seksionit të bujqësisë, që duhet të interesohet për edukimin e njerëzve, për të gjetur «topçiu» më të mirë, se ndryshe, fushata e korrjeve, që është «beteja» e të korrave, nuk përfundon me sukses. Të mos dërgohen atje që të përdorin «topin» ose kombajnën njerëz që nuk janë të zotë.

Nuk ka bujqësi moderne pa mekanikë të zhvilluar, pa mjetet e punës, që kanë nevojë të kalojnë edhe në oficinë për riparim. Pra, duhet interesim edhe për prodhimin, edhe për «shërimin e sëmundjeve», edhe për bagëtinë, edhe për frutat, edhe për mekanizmat, edhe për plehun etj. Kjo do të thotë të kihen parasysh të tëra këto probleme, duke mobilizuar të gjithë ata që punojnë në bujqësi. Është kështu apo jo? Atje kemi organizatën-bazë, drejtorin, nëndrejtorin, inxhinierët, teknikët e plot të tjerë. Seksionet e bujqësisë duhet të drejtojnë, të organizojnë, të mobilizojnë, të kontrollojnë, të njohin detyrat që kanë, të dinë çfarë mungon etj. Në qoftë se kontrollohen kështu oficinat dhe magazinat ku janë veglat e ndërrimit nga kompetentët që duhet të ketë në sëksionet e bujqësisë, mua më duhet se do të kemi një ekonomizim të madh të ve-

glave të ndërrimit dhe një përdorim racional të këtyre veglave. Veglat e ndërrimit nuk shpërndahen kurdoherë drejt. Të tëra këto janë të lidhura.

Ne, në qoftë se nuk gabohem, kemi edhe oficina lëvizëse. Çdo SMT ka karrofisicinë, që u vete nga pas mekanizmave bujqësorë për t'i ndrequr në vend kur prishen. Ne pra, kemi mjete mjaft të mira dhe të shumta për këtë punë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e Incluar, që gjendet në AQP

REALIZIMI I PLANIT KËRKON VETËMOHIM, SAKRIFICA E DISIPLINË SHEMBULLORE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

12 korrik 1976

Jam dakord, në përgjithësi, me projektplanin pesëvjeçar që na paraqitet dhe kam bindjen se ai është hartuar e është përpunuar nga baza dhe nga qendra, duke u mbështetur në direktivat që u dhanë nga Byroja Politike. Në hartimin e tij janë pasur parasysh edhe anët pozitive të punës së Partisë, të pushtetit, të klasës punëtore e të punonjësve, si dhe dëmet që na shkaktuan grupet tradhtare e sabotatore. Po ashtu janë pasur parasysh, deri në njëfarë shkalle, edhe të metat e gabimet e aparateve të Partisë, të pushtetit dhe të njërezve që punojnë në to. Them deri në njëfarë shkalle,

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti që do t'i paraqitej Plenumin të 9-të të KQ të PPSH për projektdirektivat e planit të gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH për vitet 1976-1980.

sepse puna e sëmurë e së kaluarës ka lënë gjurmë si në mjaft njerëz, ashtu dhe në metodën e punës së tyre, gjurmë këto që zhduken vetëm me një punë këmbëngullëse në rrugë partie dhe shtetërore. Të tilla gjurmë duken edhe në projektiplan, por Partia dhe Qeveria, gjatë zbatimit të tij, duhet të bëjnë një punë edukuese dhe kontrolluese, pse në praktikë ngrenë veshët të pandreqshmit, naivët, optimistët pa baza dhe sektarët.

Jam dakord, gjithashtu, me të gjitha vërejtjet që bënë shokët, të cilat i konsideroj shumë të vlefshme për Qeverinë, për ministritë, për Plenumin e Komitetit Qendror që do të mblidhet, për aparatet e Partisë e deri për vetë organizatat-bazë. Këto vërejtje të shikohen me sy kritik, në interes të ekonomisë sonë dhe të mos mendohet se gjatë dy-tre muajve që do të shtrojmë direktivat, do të bëjmë vetëm një dandana, «urra, urra!». Përkundrazi, ne duhet të organizojmë punën dhe të thellojmë mendimet e Byrosë Politike, të Qeverisë dhe të Komitetit Qendror për problemet kyç, të cilat të përmirësohen e të zgjidhen sa më drejt. Kjo është detyra jonë kryesore, më duket mua, sesa të fillojmë propagandën dhe ngreu e fol: «Jam dakord, jam dakord!». Ajo «jam dakord» ka rëndësi, edhe entuziazmi ka rëndësi, por kur bëhen me bindje dhe në baza të shëndosha, sidomos kur zbatohen ato që thuhen.

E kemi theksuar dhe po e theksojmë përsëri, në këtë plan, si dhe në të tjerët, duhet të mbajmë parasysh mbështetjen në forcat tona. Prandaj të mos çuditin kurrikënd detyrat e shtruara për zhvillimin intensiv të ekonomisë, për rritjen e akumulimit, për zhvillimin e

zgjeruar të prodhimit, për shtimin e të ardhurave kombëtare dhe për kursimet deri në santinin e fundit. Plani që po studiojmë nuk e ul, por e ngre nivelin e jctesës të punonjësve, ai vërtet nuk parashikon ulje çmimesh, por ama siguron stabilitet çmimesh; parashikon përpjekje për të arritur suksese të sigurta, duke mos lejuar as inflacion, as papunësi. Populli do të jetë kështu vazhdimisht i kënaqur dhe mbrojtja e atdheut kurdoherë e sigruar. Natyrisht, të gjitha këto kërkojnë një punë politike dhe organizative të madhe, një ngritje ideologjike marksiste-leniniste të lartë, kërkojnë vetëmohim, sakrifica dhe disiplinë proletare shembullore në punë dhe në jetë.

Për industrinë kisha vërejtjet e mëposhtme:

1. — Jam dakord me parashikimet që bëhen për naftën. Kam mendimin se gjatë pesëvjeçarit do të na hapen perspektiva më të gjera dhe më të mira, veçse duhet punuar në mënyrë shkencore, me disiplinë e kontroll të përsosur, që nga fillimi dhe deri në fund të punës, në të gjitha hallkat.

a) Duhen inkurajuar drejt e në rrugë partie punonjësit e naftës, sidomos kuadrot me arsim të lartë, sepse, ka prej tyre, që me dashje ose pa dashje, kanë bërë gabime. Sabotatorët armiq që u zbuluan dhe u dënuan, na dëmtuan si në zbulimin e prodhimin e naftës, ash-tu dhe të njerëzit që punojnë në këtë sektor. Në të dy këto drejtime duhet t'i ndreqim e t'i normalizojmë punët.

b) Nafta është me shumë të panjohura dhe me shumë harxhe. Për të dy këta faktorë duhet të punoj-

më dhe të kemi përmirësimë, se në këto dy rrugë u përpoqën të përfitonin edhe armiqjtë për të na sabotuar. Por në këto rrugë prapë ka rreziqe.

c) Nevoja e madhe që kemi për naftë nuk duhet të dobësojë vigjilencën në përdorimin e mirë të mjetevc materiale dhe të fondeve monetare që vëmë në dispozicion në këtë sektor.

ç) Studimet shkencore të specialistëve duhet të respektohen nga punëtorët tanë të naftës, por edhe përvoja e këtyre të fundit duhet të mbahet medoemos parasysh nga të parët. Diskutimi revolucionar dhe kritik shkencor të zhvillohet më tej për përmirësimin e punës në sektorin e naftës, si kudo, dhe jo për ta penguar atë.

2. — Për nxjerrjen e mineraleve të tjera jam dakkord me parashikimet, por kam disa vërejtje që do t'i bëj kur të flas për veprat e pesëvjeçarit. Këtu do të them vetëm se minierën e hekur-nikelit dhe të nikeli-silikatit në Korçë nuk duhet ta hapim dhe ta vëmë në shfrytëzim pa siguruar më parë eksportin e këtij minerali dhe përdorimin e hekur-nikelit të tij nga Kombinati Metalurgjik.

3. — Industria mekanike ka qysh tani një të ardhme të madhe jo vetëm në drejtim të zgjerimit të mëtej-shëm të prodhimit të veglave të ndërrimit, por edhe për prodhimin e disa fabrikave të vogla e të mesme. Në këtë sektor të industrisë sonë mendoj të kemi parasysh disa probleme:

- a) Ngarkesën e plotë të industrisë mekanike.
- b) Perfeksionimin në maksimum dhe të kontro-

lluar të kuadrit, jo thjesht për të ngritur punëtorët në kategori e për t'u rritur rrogën, por për t'i përgatitur ata si mjeshtër të zotë, të aftë për të prodhuar çdo gjë mirë, lirë dhe shpejt.

c) Përdorimin me ekonomi të lëndës së parë në mënyrë që të ketë sa më pak humbje e sa më shumë rikupero. Prodhimet e kësaj industrie të janë sa më rezistuese; dhe të mos lejohen stoqe e prodhime skarco.

ç) Në industrinë tonë mekanike të punohet kudo me norma teknike.

d) Kooperimi në këtë degë të industrisë të jetë sa më i organizuar dhe të mos lejojmë më shpërndarjen vend e pa vend të «armëve» të uzinave tona mekanike.

dh) Të përpinqemi për të kaluar në specializimin e studiuar të industrisë mekanike.

Për zërat e tjerë nuk kam vërejtje.

Për bujqësinë, në përgjithësi, jam dakord me shifrat që kanë ardhur si përfundim i diskutimit që është bërë.

Orientimi të jetë për të bërë të gjitha përpjekjet që çdo prodhim ushqimor, si për nevojat e popullit, ashtu edhe për rezervat, ta sigurojmë në vend. Siç duket, në disa drejtime, këtij qëllimi nuk do t'ia arrijmë as gjatë këtij pesëvjeçari.

Nuk shfaq vetëm një dëshirë, por mendoj se duke e studiuar, mund të bëjmë realitet një diçka të madhe: stabilitetin e prodhimeve bujqësore. Në fakt, ne kemi suksese të pamohueshme, sidomos këtë vit. Duke u bazuar në këtë realitet, në ngritjen politike, ideologjike dhe teknike të punonjësve tanë të bujqësisë, në inves-

tinet e mëdha që kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë në këtë sektor, në forcën e ekonomisë sonë, shtetërore e kooperativiste, në mekanizimin bujqësor, si dhe në industrinë tonë mekanike e kimike që prodhon për bujqësinë, s'ka asnjë shkak objektiv, që ne të mos e stabilizojmë prodhimin bujqësor.

Ne tash kemi filluar të planifikojmë çdo vit përrethet në bazë të rendimentit mesatar më të përparuar. Megjithëse kjo është një gjë e mirë, prodhimi akoma nuk është stabilizuar. Meqë ai shtohet çdo vit na duhet të presim rezultatet e vitiit në vazhdim që të planifikojmë për vitin tjetër. Unë propozoj që projektplani i rendimenteve dhe i prodhimeve bujqësore për vitet 1977, 1978 dhe 1979 të ndërtohet njësoj me arritjet më të mira të deritanishme, që në mjaft raste, barazohen me shifrat e vitiit 1980. Po të shikohet me vend, mund të pyeten edhe kooperativistët. Këtë ide ma dha brigadierja e kooperativës bujqësore të Gorresë që u zotua të realizojë qysh këtë vit prodhimin që ka parashikuar kooperativa bujqësore e Këmishtajt për vitin 1980. Pse, nuk mund të përgjithësohet kjo përvojë e përparuar?

Të gjithë e kemi parasysh atë që na ngjau me rrerethet këtë pesëvjeçar, duke na planifikuar me rezerva të mëdha. Por, kur i kritikuam për një planifikim të tillë, ata i rritën shifrat. Po kështu, edhe kur ra breshëri në Lushnjë, u morën kudo zotime të reja për shtimin e prodhimit. Ku u gjend mundësia për këto shtesa? A nuk tregon kjo për rezervat e mëdha që ekzistojnë?

Ne çdo vit shkojmë duke i ngritur shtesat që para-

shikojmë në plan dhe këtë e bëjmë me arsyen. Megjithatë mendoj se prapë mbahen rezerva. Atëherë, këto rezerva duhet t'i vëmë në dukje duke organizuar punën, njerëzit dhe mjetet për të arritur qysh në vitin 1977 prodhimin e parashikuar për vitin 1979 ose 1980. Kjo mund të bëhet sidomos në bimët njëvjeçare dhe në foragjeret. Gjatë këtij pesëvjeçari nuk ka ndonjë objekt shumë të rëndësishëm, pa të cilin prodhimi bujqësor nuk mund të realizohet; çdo gjë disponohet, veç duhet mobilizim dhe gjithë faktorët e tjerë që i dimë.

Për blegtorenë jam dakord si për orientimin, ashtu edhe për konkretizimin me shifra të bagëtisë së imët, të lopëve, të qeve, të zogjve e të dosave, të rendimenteve. Të ardhurat nga ky sektor duhet të rriten, se janë të ulëta.

Ne konstatojmë se qetë janë braktisur, prandaj të bëhen përpjekje që t'i shtojmë. Kjo braktisje ka ndodhur edhe pse çështë rritur mekanizimi i bujqësisë, por edhe për shkak se direktiva që kemi dhënë nuk është kuptuar dhe nuk është zbatuar drejt. Megjithatë, rritja e qeve duhet të jetë e proporcionuar dhe e harmonizuar me lopën, prandaj të mos kalojmë në ekstremin tjetër: të neglizhojmë lopën dhe të zhillojmë qetë. Mbështetje gabohem, por e them këtë, se parashikimi për rritjen e qeve m'u duk ca i madh kur dihet se qumështi dhe riprodhimi i kafshëve të trasha është i lidhur me lopën. Në përgjithësi, shtimi i qeve duhet të inkurajohet në malësi dhe në zonat kodrinore, kurse shtimi i lopëve në fusha.

Meqenëse jemi duke folur për sektorin e blegtori-

së, dua të vë në dukje se është shumë i drejtë theksit që vihet për qumështin, mishin dhe vezët. Jam dakord me të gjitha masat që propozohen dhe me veprat që parashikohen të ndërtohen për prodhimin e këtyre artikujve. Vetëm ritheksoj se në ndërtimin e veprave duhet të kemi parasysh kurdoherë leverdinë ekonomike dhe kursimet. Prodhimet jo vetëm t'i shtojmë, por të bëjmë kujdes që të ulim sa më shumë koston e tyre që populli t'i marrë me çmime sa më të lira, për të përballuar sa më mirë objektivin për rritjen e pagës reale të punonjësve.

Kurdoherë që kemi folur për blektorinë kemi theksuar rëndësinë e sigurimit të bazës ushqimore për bagëtinë, por në këtë drejtim vazhdimi shërbim pasur dhe kemi boshllëqë të mëdha. Është e domosdoshme që ky problem jetëk të kuptohet sa më mirë dhe siç duhet nga të gjithë punonjësit e bujqësisë, sepse kafshët janë në shërbim të njerëzve; prodhimet që merren prej tyre ndihmojnë për ngritjen e mirëqenies së punonjësve. Populli thotë: «Ç'të japësh, do të marrësh!». Prandaj, pa siguruar masën e nevojshme ushqimore për bagëtitë, nuk mund të merren rendimentet që priten prej tyre dhe, si pasojë, nuk realizohet prodhimi i atyre artikujve me të cilët do të ushqehet populli.

Pemëtaria ka ngelur relativisht prapa. Për këtë degë të bujqësisë ka një nënvleftësim të dënueshëm dhe qëndrime antiekonomike. Është e vërtetë se në projektplanin e pesëvjeçarit të ri parashikohen rritje, por mendoj se këto parashikime nuk janë shumë të bazuara dhe nuk janë bërë me shumë llogari. Mund të

them i sigurt se në rrethe për pemëtarinë ekzistojnë pikëpamje të vjetra e të gabuara. Është ky shkaku që këtij sektori nuk i kushtohet kujdesi që kërkohet nga ana praktike e shkencore. Këto koncepte të gabuara dhe ky kujdes i pamjaftueshmë gjejnë shprehje edhe në planet që bëjnë rrethet për pemëtarinë.

Pikëpamje jo të drejta ka dhe vazhdon të ketë edhe për perimet. E vërteta është se në këtë sektor ka përmirësimë, por këto kanë ardhur vetëm pas një këmbënguljeje të madhe e të vazhdueshme nga ana e Partisë dhe e Qeverisë. Edhe në perimet shumë herë shihet më tepër leverdia financiare e hershmërisë së disa prodhimeve, sesa rëndësia e pallogaritshmë që kanë ato për shëndetin e popullit. Prandaj e theksoj edhe një herë me të madhe që Partia, pushteti dhe punonjësit e bujqësisë t'i marrin mirë në dorë këta sektore të prapambetur dhe të mos kujtojnë aspak se duke u marrë me ta u hahet «buka» sektorëve të tjera, drithërave dhe blegtorisë. Çdo sektor ka rëndësinë e vet. Që të gjithë u shërbejnë masave të gjera punonjëse, prandaj asnjë neglizhencë nuk justifikohet. Në mënyrë të veçantë për ullirin nuk lejohet nënvylerësim. Ai duhet ndjekur në mënyrë sistematike që nga sigurimi i fidanëve dhe mbjellja e rregullt e tyre, kryerja e të gjitha shërbimeve të nevojshme agroteknike dhe deri në futjen e tyre në prodhim, në periudhat e caktuara. Lufta për shtimin e prodhimit të ullirit është luftë për të siguruar yndyrnat, një luftë e vazhdueshme për të arritur deri në heqjen e kötyre nga importimi.

Të kemi parasysh, shokë, kohët që po kalojmë;

të kemi, gjithashtu, parasysh sforcon që do të bëjnë klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe gjithë punonjësit tanë për realizimin e këtij plani të madh e të ngjeshur. Prandaj na vihet si detyrë imperative që t'ua kompensojmë forcat e mëdha fizike që ata do të harxhojnë, dhe të mos kënaqemi me sasinë e kalorive që marrin aktualisht.

Bimët e tjera industriale: pambuku, panxharsheri e lulledielli, mendoj se janë parë drejt dhe rritjet e parashikuara duhet t'i konsiderojmë të mira.

Ujitja në formë shiu, për të cilën parashikohet të Investojmë dhjetëra milionë lekë, mendoj se është një gjë e mirë, por me disa kushte, në qoftë se do ta aprovojmë:

Së pari, për realizimin e saj të mos përdorim asnje material importi.

Së dyti, rendimentet e tokave që do të ujiten në këtë mënyrë duhet të jenë shumë të larta, më të larta se ato që kemi caktuar për vitin 1980. Me fjalë të tjera, ky investim duhet të lahet shpejt, ndryshe është i palverdishëm. Ne, edhe pa ujitjen në formë shiu, po ta përdorim si duhet ujin, me siguri që do të marrim rendimente të mira. Por, siç e dimë, ujitja nuk është i vemi faktor për arritjen e rendimenteve të larta. Shokët mund të kenë mendime të tjera për këto çështje; ato le t'i studiojë Qeveria.

Për problemin e ndërtimeve do të flas më poshtë, prandaj nuk do të zgjatem këtu, por desha të theksoj se forma e paraqitjes në Byronë Politike me tërë atë material aq voluminoz, nuk është për ne. S'ka pse të na

vihet në dukje se këto vepra ndërtohen nga kjo apo ajo ministri, këto të tjerat nga rrethet, se cilat janë nën limit etj. Një paraqitje e tillë e hollësishme u duhet Qeverisë, ministrive dhe ndërmarrjeve të interesuara, kurse neve na interesojnë shumat dhe drejtimet, të bëra me projekte dhe me preventiva të saktë. Se kush do t'i ndërtojë ato, këtë e di Qeveria, e cila cakton dhe detyrat përkatëse. Do të theksoja, gjithashtu, se Qeveria e ka pasur parasysh shkurtimin e investimeve nën limit. Por të mos harrojmë kontrollin që duhet ushtruar në këtë drejtim, se mund të vazhdohet të ngjasin karambole. Të zihen të gjitha shtigjet e mungesës së disiplinës në planifikim, në projektim dhe në zbatim. Çdo vepër të realizohet në kohë dhe me cilësi të mirë. Shkelësit duhen kritikuar, bile edhe dënuar, pa hezitim.

Vëllimi i investimeve të pesëvjeçarit të gjashtë, për mendimin tim, është një shifër e fuqishme. Ai duhet të shfrytëzohet drejt për zhvillimin e ekonomisë dhe për plotësimin në vazhdim e kurdoherë e më mirë të nevojave të punonjësve tanë. Nga këto investime 2 millardë e 70 milionë lekë janë të kooperativave bujqësore. Ne nuk jemi në gjendje të gjukojmë për nivelin e këtij kontributi të fshatarësisë, se nuk na thuhet sa do të jetë akumullimi ose fondi i paprekshëm i kooperativave, i cili shërbën pikërisht për investime.

Vëllimi i ndërtimeve shtetërore në këtë pesëvjeçar është më tepër se një e treta e gjithë investimeve. Për këto investime kaq të mëdha duhet të mendohemi shumë kur t'i përdorim, duke parë nevojën e objekte-

ve që ndërtojmë, rentabilitetin e tyre, nëse është situata e përshtatshme aktualisht, kohën e shpejtë të futjes në shfrytëzim dhe, më në fund, koston e tyre, me qëllim që kjo të jetë sa më e ulët. Të gjitha këto çështje na kanë dalë gati në çdo pesëvjeçar dhe pothuajse asnjëherë ne nuk kemi përsituar sa duhet dhe si duhet, si nga eksperienca e mirë, ashtu edhe nga gabimet e rënda që janë vërtetuar, pasojat e të cilave po i heqim akoma. Jemi prirë më shumë nga objektivat dhe nga qëllimet që do të arrinim dhe nuk kemi llogaritur si duhet mjetet materiale e financiare që nevojiteshin për realizimin e tyre. Por dëshirat duhet të mbështeten në realitetin ekzistues, e pjesshmja në të tërën, e veçanta në të përgjithshmen. Çdo investim në çdo sektor që të bëhet, duhet të jetë i harmonizuar në planin e përgjithshëm të shtetit.

Dikasteret dhe rrethet mund të kenë shumë mendime e dëshira dhe, të themi, edhe shumë mundësi, të cilat i shfaqin dhe kërkojnë t'ua plotësojmë. Por shpeshherë e bëjnë këtë pa pasur parasysh kuotat e caktuara nga qendra dhe, çka është më e rrezikshme nga ana e tyre, investimet që kërkojnë nuk i llogaritin mirë, por në të shumtët e herës i bëjnë llogaritë aproksimativisht e me hamendje. Ndodh që nuk nxirret si duhet as leverdishmëria ekonomike dhe as koha e futjes në shfrytëzim e veprës që propozojnë. Ata nisen vetëm nga dëshira apo mendimi se ky investim është i nevojshëm dhe duhet bërë! «Ta vëmë njëherë, — mendohet, — pa po doli, doli!».

Edhe në këtë projektplan pesëvjeçar në eksport-

-importin kemi një disbalanc, importet i tejkalojnë eksportet tona. Mua më duket se kjo llogari nuk na del mirë. Shifrat flasin qartë, prandaj deficiti që krijohet, duhet mbuluar. Po me se? Me realizimet që do të kemi? Kjo është e drejtë. Por, edhe importi duhet të realizohet plotësisht, kurse eksporti duhet ta mbulojë atë. Eksporti varet edhe nga importi dhe këtij të fundit duhet t'i qëndrosh përbalë, pse kemi të bëjmë me një botë kapitaliste e revizioniste të kredhur në një krizë të thellë dhe që politikisht është armike e Shqipërisë socialiste.

Koniunktura e çmimeve bën që të prishen edhe kontratat që ne mund të kemi nënshkruar me këto shtete, të cilat, sipas «rregullit», paguajnë gjobën dhe të lënë në mes të rrugës. Neve nuk na lejohet as të futemi në borxhe tek ata, as të na krijohet inflacion e papunësi dhe as të na ulet niveli i jetesës së punonjësve. Këto fenomene janë të mundshme, në rast se nuk realizojmë planet tona, në rast se nuk planifikojmë drejt e në mënyrë të sigurt, në rast se nuk marrim parasysh të gjitha konsekuençat që rrjedhin nga rrethimi kapitalisto-revisionist dhe në rast se nuk kuptojmë e nuk zbatojmë drejt moton «të mböshtetemi në forcat tona!».

Kurdoherë, kur përcaktojmë shifrat e pesëvjeçarit, planifikojmë edhe një zë: «Uljen e shpenzimeve të prodhimit, të qarkullimit etj.». Në këtë pesëvjeçar ky zë përfaqëson 1 miliard e 444 milionë lekë. Nga ç'burim dalin këto kursime të planifikuara?! Nga ky dhe nga ai, mund të na përgjigjet ndonjëri. Kjo do të

thotë se ne pranojmë se kemi rezerva dhe jemi të sigurt se këto do të realizohen, bile disa herë edhe të tejkalohen. Atëherë ne duhet të vëmë pyetjen: «A është e drejtë kjo që bëjmë?». Mua më duket se jo! Ne nuk planifikojmë shtrënguar dhe, në kushtet e një planifikimi të tillë, uljet e shpenzimeve dhe të kostos realizohen pa shumë përpjekje. Ne gjoja ulim shpenzimet nga një anë, por paguajmë shuma kolosale në anën tjetër, nga mungesa e projekteve, nga gabimet që bëhen në përgatitjen e tyre dhe të preventivave. Nuk ka pse të gënjejmë veten dhe as punëtorët të mos i mësojmë të notojnë në bollëk, qoftë në materiale, qoftë në financime. Prandaj, si konkluzion, mund të them që shuma prej 1 miliard e 400 e ca milionë, e planifikuar si ulje e shpenzimeve, të futet në rezervë të Qeverisë dhe në plan të caktohen 600 milionë ose 700 milionë lekë përt'i realizuar si kursime. Këtu do të shohim me të vërtetë përpjekjet dhe nikoqirllëkun e masave tona punonjëse. Kursime të bëhen kudo, por mbi një plan shumë të shtrënguar, si në financim, ashtu dhe në materiale. Kjo është detyra që na vihet. Po të veprojmë kështu, bilanci finanziar nuk mund të dalë me një suflit vetëm prej 250 milionë lekësh. Ky është një suflit i vogël që ne duhet ta shtojmë. Ai i lihet Qeverisë që ta ketë rezervë përtë papritura. Por kjo shtesë nuk duhet të rezultojë nga lënia jashtë e disa veprave, por nga një planifikim i drejtë dhe i shtrënguar që t'u përgjigjet edhe situatave politike nëpër të cilat po kalojmë.

Sipas mendimit tim, kjo formë e paraqitjes së planit pesëvjeçar Byrosë Politike nuk është më e përshtat-

shmja. Më duket se edhe planet që i paraqiten Qeverisë, pa le Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror, duhet të jenë më të përbledhura, më sintetike dhe më të kuptueshme. Secila nga ministritë ka planet e veta të detajuara. Kjo paraqitje, më duket mua, duhet të jetë një formë e tillë që të na lejojë të gjykojmë mbi të dhëna: kryesore dhe jo të mbytemi në lista të tëra shifrash, krahasimesh e përqindjesh.

Këto të dhëna kryesore që na vijnë këtu, mendoj se duhet të ndjekin një sistem paraqitjeje më të qartë, më të lidhur dhe më të rrjedhshëm e konsekuent. Ne, disa herë, vazhdojmë të punojmë me format e vjetra të huazuara, të cilat koha ka provuar se janë të gabuara. Vallë, a duhet të thellohet Qeveria në këtë problem? Unë mendoj se po, se nuk është vetëm çështje forme, por sidomos përbajtjeje dhe kjo përbajtje duhet të na paraqitet sa më e qartë dhe sa më e kuptueshme. Komisioni i Planit të Shtetit duhet t'i paraqesë Byrosë Politike sintezat e problemeve dhe të shifrave, ndërsa për Qeverinë ato, natyrisht, mund të janë ca më të gjera.

Ne morëm për të studiuar dy lloje materialesh, një shumë të zgjeruar e voluminoz dhe një më të shkurtuar. Natyrisht, ne i studiuam të dyja, por, të them të drejtën, ato më lodhën shumë. Sistemi i vjetër i paraqitjes së materialeve duhet hedhur tej. Të mbahet parasysh se Byroja Politike dhe Qeveria jo vetëm që janë në dijeni të orientimeve kryesore të planit, pse ato vetë i kanë dhënë direktivat, por kanë caktuar edhe kuotat në përgjithësi me të dhëna të përafërtë. Prandaj them se kur na paraqitet plani neve, duam të na jepen

vetëm shifrat kryesore dhe jo që «nga tenxherja dhe deri tek tigani». Për shembull, neve na duhet të dimë se si u llogariën dhe si u ndanë të ardhurat kombëtare në pesëvjeçar dhe në çdo vit të tij; cilat janë investimet kryesore dhë në ç'drejtime do të përdoren ato (veprat kryesore në industri, në bujqësi, në arsim e kulturë, në ushtri etj.). Në paraqitjen e fillimit, më duket mua, fìgurojnë shumë zëra, jo prodhimi shoqëror, të ardhurat kombëtare, grupi A, grupi B etj., etj.

Këto përcaktime na jepen të ngatërruara, në një metodë të vjetër, një këtu e një njëzet radhë më poshtë. Nuk do të jetë më mirë që këto përcaktime të na paraqiten në një formë të re që të kenë lidhje dhe konsekuençë njëra me tjetrën? Krahasim me pesëvjeçarin e kaluar mund të bëhet, por jo për çdo shifër e për çdo zë. Po ashtu mund të jepet edhe rritja e prodhimit në krahasim me pesëvjeçarin e mëparshëm.

Një çështje tjeter e ndërlikuar në paraqitje është se herë flitet dhe barazohet pesëvjeçari i parë me të tashmin, herë viti i njërit me atë të tjegrit, pra, herë flitet globalisht, si pesëvjeçar, e herë merret ky apo ai vit i tij, një rrëmujë e madhe! Përse këto ngatërresa? Nga një paraqitje e tillë ne, shumë herë, duhet të vrasim mendjen, të bëjmë mbledhje e zbritje që shpesht na çorientojnë, pse edhe nëpunësit e planit, që punojnë me makina llogaritëse, ndodh që gabojnë në përqindje dhe në shifra.

Duke studiuar listën e veprave kryesore kam këto mendime:

Jam dakord me të gjitha objektet e filluara në

pesëvjeçarin e pestë, të cilat nuk janë pak, jo vetëm si numër, por edhe si rëndësi, për zgjerimin e prodhit apo edhe si investime që hanë fonde të mëdha financiare e materiale. Shumicën e tyre ne mund t'i kishim realizuar, por kinezët na i vonuan.

Dëshiroj të theksoj se, edhe duke hequr kredinë e dhënë për makineritë nga Kina, vlerat e ndërtimit përsaqësojnë shuma kolosale. Kjo duhet të na bëjë të mendohemi mirë për thjeshtimin e projekteve kineze, pa prishur teknologjinë e tyre, por duke rishikuar normat e materialeve, të punonjësve e të organizimit. Në këto vepër është treguar liberalizëm i madh. Prandaj mendoj se duhet krijuar një komision i fortë kontrolli, me prirjen që të shkohet drejt uljes së shpenzimeve dhe të kostos, në të gjithë zërat e veprave të filluara, për të cilat nuk ka si të nxirren justifikime.

Veprat e reja, që parashikohet të fillojnë dhe të mbarojnë në pesëvjeçarin e gjashtë, duhet të ndërtohen që në krye me projekte dhe me preventiva shumë ekzaktë, sipas vendimit që ka marrë me të drejtë Qeveria. Asnjë vepër të mos fillohet pa to. Rezerva duhet të lihet në një përqindje shumë më të vogël se ç'li-hej më parë në tejkalimet, se, për mendimin tim, ka qenë një rezervë mjaft e madhe: në qoftë se nuk gabohem, në ndërtime ishte 25 për qind mbi projektin. Prapëseprapë ata e kanë tejkaluar edhe këtë. Përgjegjësia për ndërtimin e veprave duhet të jetë e dyfishtë: investitor dhe ndërtues. Sipas rastit kjo përgjegjësi mund të jetë edhe penale.

Nxjerrja e qymyrit ka shumë rëndësi, po kjo është

nënvlerësuar. Për nxjerrjen e këtij minerali janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen shpenzime të mëdha. Është e domosdoshme të bëhen përpjekje që qymyri të na vijë me një kosto sa më të ulët. Pra, si hapjen e minierave, ashtu edhe transportin e qymyrit, ta bëjmë me sa më pak harxhime. Përveç këtyre, kujdesi për qymyrin ka qenë i keq, por ai, duke mos u trajtuar mirë, humbet kaloritë, gjë që s'duhet të ngjasë më në të ardhmen. Leverdia e hapjes së minierave të qymyrit na krahasohet me naftën, gjë që na vë, si të thuash, me shpatulla në mur. Megjithatë, unë them se mund të bëhen kursime fondesh, si në nxjerrjen e qymyreve, ashtu edhe në përdorimin e tyre. Duke u bazuar në sa thashë më sipër, jam i mendimit të mos hapim miniera të vogla me jetë të shkurtër, me rrugë e pa rrugë, se ato janë të kushtueshme. Rekomandoj të investojmë në minierat e njohura, për të zgjeruar prodhimet e për të plotësuar nevojat dhe, krahas kësaj, të bëhen studime të mira për perspektivën.

Minierat e bakrit mendoj të hapen, pse janë të nevojshme dhe jo shumë të kushtueshme. Ndryshe është puna me fabrikat e pasurimit, të cilat, gjithashtu, janë të nevojshme, por tepër të kushtueshme. Unë nuk jam që të mos ndërtojmë fabrika pasurimi, po këto të bëhen me mend në kokë, jo si na ndodhi në atë të Burrelit, ku, siç më kanë informuar, ujët na kushtoi gati sa edhe fabrika. Fabrikat e pasurimit të ndërtohen pranë minierave me jetë të gjatë dhe të mos na tërheqë mania e ndërtimit të tyre vend e pa vend, edhe atje ku «kanë pak miell», lëndë të parë.

Ka një sërë fabrikash që venë disa milionë, siç është ajo e miellzimit të fosforiteve etj. Mua më duket se për këto punë mund të bëhen ndërtime të thjeshta e të lira dhe jo përnjëherë fabrika, të cilave nuk u dihet mirë e ardhmja. Bëcmë një impiant primitiv përrerat dhe e neglizhuam. Nuk mund të bëjmë dhjetë të tilla e të na kushtojnë shumë më lirë, për të nxjerrë këto minerale? Si këto ka edhe disa të tjera që i përmendën shokët. Qeveria le t'i shikojë nga ana e leverdisë ekonomike.

Shumë milionë janë grumbulluar në kapitullin «ndërtime në vendburimet e reja të naftës». Ç'janë këto «ndërtime»? Nuk besoj se është fjala për shpime. Do të bëjmë ne ekonomi në këtë sektor, apo do të vazhdojmë si më parë: «Oburra, investime, që të vëmë në vend, pa mend dhe pa ekonomi, ato që na sabotuan!»? Edhe në investimet për naftën, që i keni vënë në plan, duhet të bëjmë kujdes të madh. Ato që janë të domosdoshme, t'i bëjmë absolutisht, por, si në çdo sektor tjeter, edhe këtu duhet të ecim me ekonomi. Rëndësia e investimit shumë herë na ka bërë të harrojmë shpenzimet financiare.

Veprat që do të fillojnë, por që nuk do të mbarojnë në këtë pesëvjeçar, kapin vlera të mëdha, prandaj, përsëri, edhe për ato, duhet të bëjmë kujdes të madh. As gjë të mos ndërtohet pa projekt dhe pa preventiv.

Edhe në sektorin e bujqësisë do të investojmë, por duke pasur parasysh disa kritere:

1. — Investimet në ujitje të bëhen të studiuara mirë dhe jo si më parë. Domethënë, për çdo vepër të

përgatiten më parë projektet, preventiva të saktë dhe të leverdishëm. Në të tilla objekte kooperativat bujqësore të investojnë nga fondet e tyre të paprekshme e të ndihmojnë dhe me punë vullnetare.

2. — Duhet llogaritur që investimet në ujitje të ndikojnë menjëherë për të ngritur rendimentet në tokat që do të përfitojnë prej tyre, domethënë jo vetëm të amortizohen shumë shpejt, por në këto toka të ujitura të stabilizohen prodhimet dhe rendimentet të jenë nga më të lartat.

3. — Rrethet që kanë një sipërsfaqe të madhe nën ujë, tash për tash, të mos favorizohen në investimet për ujitje. Atyre t'u kërkojmë ta përdorin mirë ujet që disponojnë, të ngrenë rendimentet dhe t'i stabilizojnë këto.

Për sa u përket bonifikimeve, në rrethet me sipërsfaqe të gjera nën ujë, të bëhen përpjekje që t'i mbrojnë veprat e filluara, por jo duke u caktuar shuma të mëdha dhe, për pasojë, duke mos u kérkuar rendimente të larta. Të dyja këto, investime dhe rendimente të larta, duhet të ecin paralel.

4. — Në vendet malore ne mund të bëjmë investime për ujitje, por jo të harxhojmë për këtë qimet e kokës. Çmimi i ujitjes, për çdo hektar tokë, duhet të ketë një kufi të arsyeshëm ekonomik. Unë nuk jam që për ujitjen të investojmë njësoj si në fushë edhe në mal, sepse mali, duke qenë shumë i pjerrët e i ash-për, ka më pak tokë arë, kurse fusha është ndryshe. Prandaj atje mund të investojmë më shumë. Orientimet dhe shifrat që caktohen për ujitjen në rrethe, në

përgjithësi, mund të pranohen, por duke menduar për uljen e fondeve.

Ka edhe shumë probleme të tjera, si për përmirësimin e tokave, për sistemimin e drenazhimin e tyre, për mirëmbajtjen e kanaleve etj. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për bujqësinë tonë, por nuk shoh se ku janë futur e ç'fonde parashikohen për realizimin e tyre? Sa investon shteti dhe sa kooperativat? Apo këto çështje lihen në dëshirën e rretheve? Asgjë nuk duhet lënë në dëshirën e njërit apo të tjetrit. Çdo gjë duhet planifikuar, ndryshe nuk do të prodhohet ajo që kërkojmë. Problemi i sistemimit të tokës e i drenazhimit është njësoj i rëndësishëm sa edhe ai i ujiljes, prandaj këtu duhet vendosur disiplinë.

Lidhur me hekurudhat unë jam për ndërtimin e hekurudhës Fier—Vlorë, por kjo t'i shërbejë portit të ri e të madh të Vlorës, se vetëm për transportimin e sodës dhe të PVC-së nuk na leverdis. Portin e madh të Vlorës, e kam thënë edhe herë tjeter, ne e neglizhojmë dhe vazhdojmë të investojmë shuma të mëdha në Portin e Durrësit, i cili po fryhet sa s'ka ku vete më. Kjo nuk është rruga e drejtë e zgjidhjes. Sa kohë që e vonojmë ndërtimin e Portit të Vlorës, aq më shumë vështirësi do të hasim, jo vetëm tani, por dhe në të ardhmen. Transporti detar te ne ka perspektiva të mëdha. Deti duhet të shërbejë për ne si një rrugë e madhe transporti, jo vetëm për në portet e jashtme, por edhe në portet e vendit tonë, duke lehtesuar kështu rrjetin rrugor automobilistik.

Nuk e kuptoj pse na kushtojnë kaq shumë rrugët

në përgjithësi. Ne kemi shkuar duke i mekanizuar ndërtimet e rrugëve, si edhe gjetkë, në sektorët e tjerrë. Gurë kemi kudo, kurse kostoja e tyre ngrihet në qiell. Ka llogari e kontroll këtu apo merren fondet përrugë dhe përdoren për qëllime të tjera? Nuk duhet të planifikojmë dhe të hapim kudo rrugë, gjithashtu s'është e thënë që të gjitha rrugët të janë të një kualiteti. Në këtë vështrim, me sa gjykoj unë, ka rrugë që nuk duhen. Disa qendra malore mund të bëjnë edhe me rrugët ekzistuese.

Duke lexuar materialin më tërhoqi vëmendjen edhe diçka tjetër: megjithëse shumë hekurudha ndërtojmë, vazhdohet të sjellim nga jashtë shumë kamionë. Përse duhen gjithë këta kamionë? Mos ka lëvizje paralele, për të cilat kemi folur kaq herë se nuk duhen lejuar?

Tani po kthehem te ndërtimet. Të jemi të ndërgjegjshëm se ndërtimet te ne kryhen akoma dobët dhe janë tepër të kushtueshme.

Në këtë sektor ka pasur shumë hallakatje; fondet, forcat dhe mekanizmat shpërndaheshin nëpër objekte pa kritere të shëndosha; s'kishte organizim të mirë, për të mos thënë se ai qe fare i dobët; mungonte disiplina në punë e në normat e përdorimit të fondeve dhe të materialeve; në ministri nuk zbatohet centralizmi demokratik; shkelej hozrashot i ndërmarrjeve; planifikimi, projektimi dhe preventivimi ishin domen i ministrisë; ndodhë që preventivat ajo i jepte në fund, kur mbaronte vepra, e cila le të kushtonte sa të ku-shtonte se i paguante shteti. Investitori, që nga fillimi

dhe deri në mbarim, as që interesohej për veprën e tij. Siç u tha këtu, kërcoheshin paratë pa pasur fare idenë e veprës që do të bëhej, pra, pa pasur fare siguri për investimet, për projektet, për vlerën e plotë të veprave etj.

A mund të lejohet më një gjendje e tillë? Kurressi! Ç'duhet bërë? Le të thellohen në këtë drejtim Qeveria e veçanërisht Ministria e Ndërtimit dhe të merrën masa. Këto të meta serioze dhe faje të rënda duhet të marrin fund, ndryshe do të kemi humbje të mëdha. Në Ministrinë e Ndërtimit duhet të bëhet një shkundje e madhe, një rishikim i çdo gjëje deri edhe i tabelave të vjetruara të kostos së materialeve, të cilat, në qoftë se s'gabohem, kanë mbetur standarde, të pandryshueshme, në një kohë që shumë gjëra kanë ndryshuar. Këto metoda konservatore dhe rutinë lejojnë abuzime në zbatim, krijojnë mundësi për pagesa jashtë normave reale, u japid rast njerëzve të këqij që të grabitin, se notojnë në shpenzime të pakontrolluara, lejojnë transferime fondesh nga një zë në një zë tjetër pa aprovimin e Qeverisë e jashtë rregullave që ka vendosur ajo. Autorët e këtyre veprimeve, duke qenë të sigurt se s'ka kush i pengon e s'ka kush u kërkon llogari, paraqesin shtesa të tjera, të cilat, me hir apo me pahir, aprovohen, se vepra mbetet në mes. Të gjitha këto shkelje të rënda, e të tjera si këto, na kanë ngjarë dhe vazhdojnë të na ngjasin. Është absolutisht e domosdoshme që atyre t'u japim fund.

Prandaj, siç e thashë edhe më lart, çdo gjë duhet të shikohet me sy kritik në Ministrinë e Ndërtimit.

Ideja që dëgjohet se «ndërtimi është sektor i madh e i vështirë» etj. ka për qëllim të shfajësojë të metat dhe gabimet që janë vërtetuar. Prandaj, pa e nën-vlerësuar këtë sektor, dhe s'ka se si të nën-vlerësohet, të mos harrojmë se aty kemi me mijëra e me mijëra kuadro me arsim të lartë dhe të mesëm, kemi punëtorë me ekspericencë të madhe e mekanizma moderne. Prandaj Komiteti Qendror e Qeveria duhet të jenë shumë rigorozë në zbatimin drejt dhe me ekonomi të lekëve të dalë nga djersa e popullit. Si konkluzion, përkështë pikë, them se përkohësisht ne mund t'i pranojmë fondet që janë parashikuar për objektet që do të ndërtojmë, por, sigurisht, me ndryshimet që mund të pësojnë. Por, kostoja e tyre, e caktuar «për analogji» nuk është ekzakte, prandaj duhet parë me prirjen që të pësojë ndryshime në minus.

Më sipër fola për eksperiencën e fituar nga realizimet dhe nga gabimet e bëra gjatë pesëvjeçarit të pestë. Por, më në fund, dëshiroj të thiksoj disa mendime, në formë të përbledhur, që ne duhet t'i kemi parasysh në punën tonë të ardhshme:

Mungesa e kontrollit dhe e vigjilencës revolucionare na shkaktoi dëme të mëdha. Ka mjaft shokë, bile dhe organizata partie e shtetërore, që i quajnë ato «të shkuara e të harruara». Të mendosh kështu është gabim i pafalshëm. Republikën dhe socializmin te ne, përveç armiqve të brendshëm, e kërcënojnë rreziqe të mëdha, që nuk duhen harruar për asnjë çast: sulmi i armatosur i armiqve të jashtëm, agresioni ideologjik dhe kriza e madhe ekonomike botërore. Kundër

këtyre rreziqeve ne duhet të jemi të përgatitur, sepse do të jemi vetë ne që do t'i përballojmë.

Për krizën e madhe botërore disa mendjelehtë mendojnë se ajo nuk ndikon te ne. Sa na prek, kjo varret nga ne. Në qoftë se komunistët, në radhë të parë, dhe masat e kuptojnë dhe e zbatojnë si duhet politikën ekonomike të Partisë, atëherë mund t'i zvogëlojtmë efektet e krizës botërore. Në fushën e marrëdhënieve ekonomike ne s'jemi një vend i mbyllur, prandaj, po nuk u realizuan planet tona në çdo zë, në kohë, në sasi e në cilësi dhe me kosto të ulët, me siguri që do të ndiejmë vështirësi serioze dhe prishje të ekuilibrit në ekonomi. Këto janë ligje që na i mëson ekonomia politike e socializmit. Këto ligje duhen mësuar jo vetëm teorikisht, por ato edhe duhen mbajtur parasysh e të zbatohen drejt në jetë.

Prandaj të bëjmë kujdes që të gjithë zërat e planit t'i nxjerrim me rentabilitet. Subvencionimi duhet të konsiderohet diçka e jashtëzakonshme. Është e nevojshme të kuptohet se subvencionet e padrejta rrjedhin nga organizimi i keq, nga puna e dobët e njerëzve etj., që, po të mos merren masat e duhura nga Partia dhe shteti, çojnë në inflacion dhe në ngritje të çmimeve.

Kërkimet gjeologjike, shpim-kërkimet dhe shpim-shfrytëzimet, po ashtu, na marrin shuma kolosale, prandaj ndjenja e kursimit dhe kujdesi për të shmanqur mungesat teknike në këta sektorë, janë të domosdoshëm, ndryshe do të kemi dëme të pallogaritshme. Ne duhet të realizojmë planet në naftë dhe në minerale të tjera, por me çmime të ulëta, në kohë e me cilësi

të mirë. Të mos harrojmë se mineralet janë artileria jonë e rëndë për zhvillimin e ekonomisë kundër ndikimit të krizës botërore. Të mos harrojmë, gjithashtu, format, mënyrat, stilin dhe metodën që përdorën sabotatorët në këtë sektor jetik. Të mos themi me mendjelctësi se «nuk mund të na ngjasin më». Po e fjetëm mendjen, mund të na ngjasin përsëri.

Kooperimi dhe specializimi nuk zhvillohen si duhet. Në këto drejtime synimi i armiqve, si Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi, ka qenë evident. Konceptet e praktikat e tyre vëtadministruese, krijimi ku mundnin, pa asnje kriter konstruktiv, i një mijë e njëqind linjave e reparteve, nën pretekstin se futeshin njerëz në punë për të marrë rroga, ishte një metodë që çonte në decentralizimin e industrisë, në kthimin e saj në format artizanale të prodhimit, në ngritjen e kostos së mallrave industriale dhe në rrezikun e lindjes së inflacionit.

Koordinimi i planeve të sektorëve të ndryshëm është i dobët. Nuk është normale që gjithkush të veprojë për vete pa menduar për tjetrin. Ky koordinim mungon edhe në zbatimin në praktikë të planeve, sepse nuk realizohen ato në të gjithë zërat dhe në kohën e caktuar. Kështu shkelen kontratat e brendshme dhe të jashtme, krijojen stoqe të mëdha me mallra të demoduara e të produara keq, gjë që na detyron t'u ulim çmimet, të mos marrim akumulimin e caktuar dhe fitimet që janë planifikuar për zëra të tjerë. Pra, mund të lindë rreziku i inflacionit. Kjo qe për brenda vendit, se për eksportin puna ka pasoja edhe më të rënda:

Po theve kontratën me blerësit e jashtëm, e humbe tregun, humbe kleringun; i huaji nuk të livron mallrat për të cilat ti ke nevojë dhe mbi të cilat ke bazuar planin tënd.

Në sektorin e tregtisë, flitet për tregti të kulturuar, por në praktikë ka munguar koordinimi i punës ndërmjet prodhuesit, shitësit dhe konsumatorit. Pak mendohej se si të prodrohej sa më shumë, me cilësi sa më të mirë dhe me kosto sa më të ulët. Nuk u shërbehej dikastereve të tjera, me të cilat ajo kishte lidhje. Të gjitha këto krijonin çrregullime të mëdha. Tregtia e jashtme ishte pothuaj krejt pa kontroll ose nën mbi-këqyrjen e Kiço Ngjelës e të Vasil Katit. Ne themi se i pamë këto faje të rënda, por rekomandoj të mos e flemë mendjen e të nxitohejni, duke thënë se i mposhtëm të këqijat, si në prodhimin e mallrave, ashtu edhe në tregtimin e tyre. Prodhitet nuk po realizohen si duhet, por edhe tregtia nuk po e merr veten akoma.

Gjithashtu, të punojmë që të bëjmë realitet atë që kemi thënë vazhdimisht dhe që është e drejtë: «Ta sigurojmë në vend bukën dhe ta kursejmë atë». Kjo është e domosdoshme dhe me rëndësi strategjike.

«Të shtojmë perimet, se ato kursejnë bukën», flasim vazhdimisht, por planet e tyre nuk i realizojmë. Na thuhet se dyqanet janë plot me zarzavate. Por si qenkan plot, kur nuk shohim që ato të zëvendësojnë as makaronat, as orizin, si në qytet, ashtu edhe në fshat?! Tash, së fundi, lexojmë se me mijëra kuintalë patate po prishen, ashtu siç na u prishën me mijëra kuintalë spinaq para ca kohësh. Pse nuk i konsumojnë

fshati dhe qyteti, apo pse nuk merren masa për t'i eksportuar menjëherë dhe me çmime të larta, në vende të Evropës, që i ka pllakosur thatësira dhe të lutin për një kokërr patate?!

Si është e mundur të ecim kështu, shokë? Ne thajmë zarzavate dhe themi se do të ndërtojmë edhe fabrika të tjera të vogla për këtë qëllim dhe mirë do të bëjmë. Po para se t'i ndërtojmë këto, të mendojmë që populli t'i konsumojë të njoma, pastaj edhe të thata.

Këto përbëjnë probleme serioze ekonomike dhe s'janë të vetmet. Ne po zhvillojmë konfekzionet. Edhe kjo, gjithashtu, është një gjë e mirë. Por, në rast se nuk bëjmë kujdes të madh, do të na krijohen stoqe në mallra dhe s'do të na i blejë kush, as brenda, as ja-shtë. Kjo të çon pastaj në pakësimin e vendeve të punës.

Të evitojmë gabimet e së kaluarës në krijimin e hallkave të tepërtë burokratike dhe në shtimin e njerezve në to. Por, po aq e dëmshme është, gjithashtu, të shkurtosh «për të shkurtuar» dhe të mos kesh njerezit e domosdoshëm për të kryer punën. Masa të drejta janë ato që studiohen mirë lidhur me nevojat objektive.

Kompetencave nuk u duhet rënë me thikë, por ndaj tyre kërkohet që të veprohet me pjekuri, të zbatohen drejt e me efikasitet dhe ta ndjekësh këtë deri në fund. Çdo kompetencë jepet për mbarëvajtjen e punës, për të vënë në jetë së më shpejt vendimet e direktivat dhe jo për lavdinë dhe «fuqinë» e atij që

është ngarkuar t'i ushtrojë këto kompetenca, duke thënë: «S'pyes njeri». Cilido ka të drejtë të ndërhyjë e të kritikojë ashpër ata që abuzojnë me kompetencat.

Të mbahet mirë parasysh disiplina e planit, disiplina në punë, në jetë dhe në shoqëri. Në përgjithësi, disiplina e planit dhe ajo në punë nuk ka qëndruar në vend, por, përsëri, në këtë drejtim na mbetet shumë për të bërë. Ky është një problem me rëndësi, që ka të bëjë, në radhë të parë, me ndërgjegjen dhe me edukatën socialiste. Duhet ta kemi të qartë se akoma nuk e kemi kapërcyer plotësisht stadin e vjetër të ndërgjegjes individuale mikroborgjeze të të kënaqurit me pak, të të fituarit sa më shumë në kurriz të shoqërisë dhe të kuptimit mikroborgjez të qëndrimit ndaj punës e pronës. Ndërgjegjja socialiste duket në punë, me vepra e jo në diskure e slogane.

Më në fund, tok me të gjitha këto kërkohet edhe një kontroll rigoroz dhe jo lëshime e liberalizëm i dënueshëm, sikurse po na ndodh disa herë edhe tash. Prakticizmi i ngushtë në punët e Partisë e të shtetit ka çuar, në mjaft raste, në mungesën e kontrollit, në mosstudimin thellë të problemeve kapitale dhe në mosorganizimin si duhet të këtyre studimeve.

Duhet të na preokupojë shumë edhe zënia e njerezve me punë. Asnjëherë të mos e neglizhojmë dhe as ta marrim lehtë këtë problem, se po nuk e patëm mirë parasysh, në të ardhmen ai mund të na bëhet më akut. Me dhjetëra mijë të rinj e të reja do të na duhet t'i futim në punë për çdo vit. Ne jemi një vend i vogël; ato fabrika e uzina të reja që po ndërtojmë

do të na tërheqin vetëm një pjesë të tyre. Po të tjerët ç'do të bëhen? Kemi vendosur t'i drejtojmë sidomos në bujqësi. Kjo të përbëjë një nga rrugët kryesore. Por Partia dhe pushteti në rrethe e kanë marrë vallë në dorë si duhet këtë problem kaq preokupant? Unë mendoj se nuk bëhet gjithnjë sa duhet në këtë drejtim. Ne duhet të kemi orientime dhe parashikime të sakta për forcat e qytetit që duhet të venë në fshat. Është tjetër problem ai që ne, krahas kësaj, duhet të punojmë me rrethet dhe me individët që t'i çojmë forcat e punës atje ku ka nevojë atdheu se, po nuk punuam kështu, do të na krijohen vështirësi të mëdha. A janë bërë llogaritjet dhe a është parashikuar se sa të rinj e të reja nga qyteti do të shkojnë në fshat brenda pesë-vjeçarit? Krahas kësaj, a merret parasysh rritja e popullsisë së vetë fshatit gjatë këtyre pesë vjetëve? Pra, përveç shtesës natyrore të fshatit, që është më e madhe se në qytet, atje do të shkojnë edhe punëtorë nga qyteti. Këtu u tha se gjatë pesëvjeçarit në ndërmarrjet bujqësore është llogaritur të shtohen edhe dhjetëra mijë veta. Po a duhen aq shumë punëtorë në këto ndërmarrje? Në qoftë se do të na mbushen ato me punëtorë në një kohë që shumë procese i kemi edhe të mekanizuara, kjo gjë nuk do të jetë e leverdishme. Siç shihet, kjo është çështje e madhe dhe e vështirë; llogaritjet duhen bërë mirë e saktë në lidhje edhe me mekanizimin e me ngritjen e rendimentit. Të mos nisemi nga pari-mi se, meqë na duhen vende pune, s'prish punë se ulet rendimenti. Shikojeni këtë çështje me kujdes. Unë mendoj se forca të reja pune duhen çuar edhe në koo-

perativa bujqësore, bile jo vetëm në ato të afërtat, por edhe në të largët. Vështirësi do të ketë, por të rinjtë duhet t'i përballojnë ato. Në qoftë se nuk zhvillohet një propagandë intensive nga Partia, në qoftë se nuk merren masa për ndërtim baneshash të këtyre njerëzve, që do të venë në fshat përgjithnjë nga qyteti, nuk zgjidhet drejt ky problem.

Partia duhet të punojë shumë edhe për zhdukjen e shfaqjeve të psikologjisë mikroborgjeze të disa qytetarëve që përcmojnë fshatin, si edhe të disa fshatarëve që shprehin njëfarë mosbesimi ndaj qytetarëve. Kjo duhet bërë duke pasur parasysh jo vetëm nevojat ekonomike, por, në radhë të parë, për të vënë në jetë parimin e madh të Partisë për ngushtimin e dallimeve në mes fshatit dhe qytetit, për forcimin e aleancës në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste, si dhe për të rritur më tej dashurinë e vëllazërimin e qytetarëve me fshatarët.

Si të gjithë ju, edhe unë jam i bindur se orientimet që dha Byroja Politike për hartimin e këtij plani do të zbatohen drejt e në kohën e caktuar. Diskutimet që bëmë këtu dhe ato që do të bëhen në Plenumin e Komitetit Qendror, si dhe diskutimi me masat e popullit do të ndihmojnë për përmirësimin e mëtejshëm të këtij projektplani që do t'i paraqesim Kongresit të 7-të të Partisë. Ne do të vëmë të gjitha forcat për të zbatuar me nder ashtu si edhe herët e tjera detyrat që do të na ngarkojë Kongresi.

Sic e thamë edhe më lart, tani ne nuk do të marrim vendim. Të gjitha mendimet që u shtruan këtu do të

shërbijnë si objekt studimi për Partinë dhe Qeverinë që nga qendra e deri në rrethe, në komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive. Pastaj projektdirektivat do të punohen në popull dhe më vonë do të vijnë prapë në Qeveri, e cila do t'i shikojë dhe do të bëjë konkluzionet që do t'ia paraqesë Byrosë Politike dhe pas kësaj do të venë në Kongres.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

NË KËTË PESËVJEÇAR TË MBAHET PARASYSH EDHE MË FORT ORIENTIMI BAZË I MBËSHTETJES NË FORCAT E VETA

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 9-të
të KQ të PPSH¹*

20 korrik 1976

Si gjithë shokët edhe unë jam dakord me raportin e paraqitur në Plenum mbi plotësimin e pesëvjeçarit të kaluar, si dhe me detyrat që shtrohen për planin e gjashtë pesëvjeçar dhe projektdirektivat e tij. Jam, gjithashtu, dakord, në përgjithësi, edhe me diskutimet e mira të shokëve.

Për përgatitjen e projektplanit të ri pesëvjeçar, organet dhe organizatat-bazë të Partisë në rrethe dhe në qendër, organet e pushtetit dhe ato të ekonomisë, mbi bazën e orientimeve të Byrosë Politike, kanë bërë

1. Ky Plenum, që i zhvilloi punimet nga data 19-20 korrik 1976, shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi projektdirektivat e Kongresit të 7-të të PPSH për planin e gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RPSH për vitet 1976-1980».

një punë të mirë dhe të gjerë politike dhe ideologjike me punonjësit për të kuptuar thellë detyrat që shtrohen në kushtet tona konkrete.

Në hartimin e projektpolin të ri pesëvjeçar janë pasur parasysh si anët pozitive dhe eksperiencia e pasur e punës së Partisë, të pushtetit, të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve tanë, ashtu edhe dëmet që na u shkaktuan si pasojë e veprimtarisë sabotuese të armiqve të Partisë e të popullit në disa sektorë jetikë, që nga Fadil Paçrami, Todi Lubonja e kompani, Begir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e Kiço Ngjela me shokë, si edhe të metat subjektive me natyrë liberale e burokratike në drejtmin e ekonomisë dhe sidomos në kontrollin e dobët të zbatimit të detyrave.

Me gjithë rrethimin dhe bllokadën imperialisto-revizioniste, me krizën e rëndë ekonomiko-financiare që vazhdon të përshkojë botën imperialisto-revizioniste, si dhe me gjithë faktorët negativë të përmendur më lart, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia jonë popullore, nën udhëheqjen e Partisë, në përgjithësi, i plotësuan detyrat themelore të zhvillimit ekonomik që caktoi Kongresi i 6-të i Partisë. Gjatë pesëvjeçarit të kaluar u zhvilluan forcat prodhuese në çdo degë të ekonomisë, u fuqizua më tej baza materialo-teknike e socializmit dhe u shënuan suksese me rëndësi në rrugën e shndërrimit të atdheut tonë nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrial-bujqësor.

Puna dhe lufta e masave tona punonjëse, me ko-

unistët në krye; gjatë pesëvjeçarit të pestë u përqendrua në zhvillimin e një ndeshjeje të ashpër klasore të brendshme dhe të jashtme për mbrojtjen dhe për zbatimin e vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë, në përpjekjet për realizimin me sukses të detyrave në çdo lëmë, duke përfshirë ekonominë, kulturën dhe mbrojtjen e atdheut. Pesëvjeçari i kaluar siguroi zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e kulturor dhe fuqizoi më tej aftësinë mbrojtëse të vendit. Rezultatet e arritura eksperienca e madhe e fituar, gatishmëria dhe patriotizmi i zjarrtë i popullit tonë, janë pa dyshim një bazë e mirë për të ecur akoma më përpara në plotësimin me sukses të planit pesëvjeçar që po hartojmë.

Mendimet që u shprehën, vlerësimet, vërejtjet dhe propozimet që u bënë nga shokët në këtë Plenum, në përgjithësi, i konsideroj të drejta e shumë të vlefshme për vetë Komitetin Qendror, për Këshillin e Ministrave, për dikasteret qendrore, për organet dhe organizatat e Partisë dhe ato të masave. për organet e pushtetit dhe të ekonomisë në rrethe e në bazë. Është detyrë e organeve të Partisë dhe të shtetit që këto mendime, vlerësime, vërejtje dhe propozime të studiohen me shumë kujdes e vëmendje në interes të ekonomisë.

Nuk e gjykoj të tepërt të theksoj përsëri që, në kushtet e ashpërsimit të luftës klasore në aspektin e brendshëm dhe ndërkombëtar, në këtë plan pesëvjeçar, është imperative të mbahet parasysh edhe më fort, në parim dhe në praktikë, orientimi bazë i mbështetjes në forcat e veta i Partisë sonë. Lufta për zhvillimin intensiv të ekonomisë, për rritjen e akumulimit e për-

zhvillimin e riprodhimit të zgjeruar socialist, për shtimin e të ardhurave kombëtare dhe për kursime në të gjitha drejtimet, kanë të bëjnë pikërisht me zbatimin e këtij orientimi themelor.

Duke plotësuar me këmbëngulje parashikimet e projektit që po studiojmë dhe që do të vendosim në Kongres, s'ka dyshim se populli ynë do të jetë vazhdimi i kënaqur, sepse niveli i jetesës nuk do t'i ulet, por do të ngrihet. Vërtet projektplani nuk parashikon ulje çmimesh, por, me gjithë kushtet e vështira të kri-zës ekonomike botërore dhe thellimin e kontradiktave midis shteteve kapitaliste e revizioniste, ai parashikon stabilitet në këtë fushë. Ka rëndësi të theksohet se projektplani parashikon, gjithashtu, mjetet e nevojshme për detyrën kryesore, sigurimin e mbrojtjes së atdheut.

Të gjitha këto detyra kërkojnë, në radhë të parë e mbi të gjitha, të kuptohet thellë rëndësia politike, ideologjike dhe ekonomike e realizimit të planit të ri pesëvjeçar.

Për arsyen e shumë nga kërkesat që përmenda janë trajtuar në materialet e Partisë, si dhe në këto që po shqyrtohen në këtë Plenum lidhur me projektplanin, në fjalën time kam menduar të përqendrohem vetëm në dy aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me organizimin dhe me drejtimin e ekonomisë së planifikuar:

Së pari, në kujdesin dhe në ndjenjën e përgjegjësisë që duhet të na karakterizojë për një planifikim me baza të shëndosha shkencore;

Së dyti, në përpjekjet për zbatimin me rreptësi dhe pa asnjë lëshim të planit të miratuar.

Planifikimi i zhvillimit ekonomik e shoqëror, si ligj i përgjithshëm i ndërtimit socialist, në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, ka qenë kurdoherë një mjet i fuqishëm në duart e Partisë e të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit për ndërtimin me sukses të socializmit. Komiteti Qendror i Partisë ka dhënë herë pas here orientime e ka caktuar detyra konkrete për përsosjen e vazhdueshme të sistemit të planifikimit të ekonomisë dhe për ngritjen e nivelit të tij shkencor. Në bazë të tyre, në tërësinë e vet, ai është përmirësuar vazhdimesht, është ruajtur fryma e shëndoshë revolucionare dhe karakteri klasor në hartimin dhe në zbatimin e planeve tona. Orvatjet e goditjet e herëpasherë shme që kanë ndërmarrë elementët armiq, duke përfshirë këtu edhe grupin tradhtar shumë të rrezikshëm të Abdyl Kellezit, Koço Theodhosit e Kiço Ngjelës në shokë, si në gjithë fushat e tjera, edhe në fushën e planifikimit të ekonomisë, për t'i ndërruar drejtimin dhe për ta zhveshur atë nga përmbajtja e tij klasore, Partia i ka goditur ashpër dhe nuk ka lejuar të hedhin rrënje e të lëshojnë degë pikëpamje e praktika të huaja borgjezo-revisioniste.

Në këtë kujdes të madh e të vazhdueshëm për planifikimin ekonomik e shoqëror të vendit, Partia ka mbajtur kurdoherë parasysh mësimin e Leninit, i cili thoshte:

«Programi i partisë sonë nuk mund të mbetet vetëm program i partisë. Ai duhet të bëhet programi i ndërtimit tonë ekonomik, përndryshe

ai nuk vlen as si program i partisë. Ai duhet të plotësohet me një program të dytë të partisë, me planin e punimeve për rimëkëmbjen e gjithë ekonomisë kombëtare dhe për vënien e saj mbi bazën e teknikës moderne»¹.

Këtej kuptohet ç'rëndësi të madhe jetike ka për zhvillimin ekonomik e shoqërор hartimi i një plani të studiuar thellë dhe të ndërtuar drejt, ku të gjejnë materializim e konkretizim sa më të plotë politika ekonomike e Partisë, orientimet dhe direktivat e saj për zhvillimin e vendit në rrugën e socializmit, për zhvillimin e pandërpërre të forcave prodhuase e për përsosjen në rrugë revolucionare të marrëdhënieve socialiste në prodhim. Në të kundërtën, lejimi i të metave e i gabimeve në planifikim e në zbatim, mosmbajtja parasysh nga baza në qendër e kërkesave të ligjeve ekonomike objektive të socializmit, mund të shkaktojë lindjen e fenomeneve, të prirjeve e të kontradiktave të padëshiruara ekonomike e shoqërore me pasoja shumë të rrezikshme për fatet e socializmit.

Këto probleme marrin një rëndësi akoma më të madhe sot, kur bota kapitaliste e revisioniste që na rrethon po kalon kohët më të vështira që nga periudha e Luftës së Dytë Botërore. Radioja, televizioni, shtypi dhe tërë propaganda e tyre flasin e botojnë çdo ditë lajme mbi fenomenet dhe pasojet e rënda të krizës së përgjithshme që i ka zënë përfyt. Ritmet e prodhi-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 594.

mit industrial e bujqësor vazhdojnë të bien. Inflacioni, rritja e çmimeve, ngritja e kostos së jetesës së masave nuk kanë të krahasuar me asnjë nga periudhat e 20-30 vjetëve të fundit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi revizionist Sovjetik, për të dalë nga kjo gjendje ku janë kredhur, përvçë shtypjes dhe shfrytëzimit të egër të popujve që sundojnë, përdorin një mijë e një makinacione, shantazhe e presione ndaj partnerëve për të hedhur mbi shpatullat e tyre barrën e rëndë të krizës. Dhe kjo gjendje, pavarësisht nga ndonjë luhatje, do të vijë gjithnjë duke u rënduar.

Kjo situatë nuk duhet të njihet nga ne, si i thonë, «sa për kulturë», por për t'u pasur parasysh në çdo hap të punës e të luftës për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit. Republikën dhe socializmin te ne, përvçë armikut të brendshëm, i kërcënojnë edhe rrëziqe të mëdha nga jashtë, siç janë sulmi i armatosur i armiqve, agresioni ideologjik i botës kapitalisto-revisioniste dhe presioni i krizës së madhe ekonomike botërore. Asnjë prej këtyre rrëziqeve nuk duhet harruar për asnjë çast, përkundrazi na vihet detyrë të jemi mirë të përgatitur dhe të armatosur kundër tyre, pse do të jemi ne vetë që do t'i përballojmë.

Dihet se nga natyra e vët, vendet me të vërtetë socialiste, sikurse është Shqipëria, nuk njojin kriza dhe fenomene të tjera shkatërrimtare që rrjedhin prej tyre. Por ky nuk është një imunitet i fituar *a priori* dhe i garantuar një herë e përgjithmonë, siç mendojnë shumë mendjelehtë. Na prekin apo nuk na prekin fenomene të veçanta të krizës, që janë tipike për botën

kapitaliste e revisioniste, kjo varct nga ne. Në qoftë se komunistët, në radhë të parë, dhe masat qëndrojnë kurdoherë në këmbë, e kuptojnë dhe e zbatojnë si duhet politikën ekonomike të Partisë, atëherë mund t'i shmangim csektet negative të krizës botërore. Përndryshe ato mund të na kanosen edhe ne. Ne s'jemi një vend i mbyllur në marrëdhëni ekonomike, por shesim e blejmë në një botë kapitaliste e revisioniste të kredhur në një krije të madhe, që politikisht është armike e Shqipërisë socialiste.

Koniunktura e çmimeve prish edhe kontratat që ne mund të kemi nënshkruar me shtete të ndryshme, të cilat, sipas «rregullit», paguajnë gjobën dhe të lënë në mes të rrugës. Neve nuk na lejohet as të futemi në borxhe tek ata, as të na krijohet inflacion, as të na ulet niveli i jetesës i punonjësve dhe të na fillojë papunësia. Por të tilla fenomene mund të na ndodhin, në rast se nuk planifikojmë e nuk bashkërendojmë drejt gjërat dhe nuk realizojmë planet tona në çdo zë, në kohë, në sasi, në cilësi dhe me çmime të ulëta, në rast se nuk kuptojmë pasojat që rrjedhin nga rrethimi kapitalisto-revisionist dhe nuk e zbatojmë si duhet moton «të mbështetemi fuqimisht në forcë tonë». Këto fenomene mund të na ndodhin në rast se në planifikim e në zbatim lejohet të shkelen kontratat brenda e jashtë vendit, në rast se na krijohen stoge mallrash të zhvleftësuara e të produara keq, gjë që na detyron t'u ulim çmimet, të mos marrim akumulimin e parashikuar, fitimet e planifikuara për zëra të tjerrë dhe për çeljen e fronteve të reja të punës. Po shkele kontratën me blerësit e huaj,

e humbe tregun, humbe kleringun, i huaji nuk të livron mallrat pör të cilat ke nevojë dhe mbi të cilat ke bazuar një pjesë të planit tënd.

Të metat në planifikim e në zbatim, subjektivizmi e voluntarizmi, veprime të tillë si neglizhenca, mungesat e organizimit dhe mosrespektimi i centralizmit demokratik në ekonomi, do të bënин që disa elemente të krizës të shfaqeshin edhe te ne. Në qoftë se nuk do të jenë në krye Partia dhe shteti ynë i diktaturës së proletariatit që të mos lejojnë shfaqje të tillë ose të mos marrin masa të shpejta e të drejta, atëherë mund të na krijohen perturbacione. Këto janë ligje që i dimë nga ekonomia politike e socializmit. Teorikisht këto ligje duhen mësuar, por ky mësim duhet të vlejë për t'i zbatuar drejt në jetë.

Në këto kushte, na vihet detyrë që të tregojmë një kujdes të jashtëzakonshëm, që nga baza deri në qendër, pör të përsosur më tej karakterin shkencor të planeve tonë të zhvillimit ekonomik e shoqëror. Ato duhen hartuar e përpunuuar në mënyrë sa më shkencore në të gjitha drejtimet. Kjo kërkesë buron nga fakti se gjithëjeta jonë ekonomike e kulturore zhvillohet në bazë të planit. Në rast se planifikojmë drejt dhe i zbatojmë deri në një e me përpikëri direktivat e orientimet e Partisë, atëherë edhe proceset ekonomike e shoqërore do të ecin në rrugë të drejtë, ekonomia do të forcohet pa ndërprerje dhe qëndrueshmëria e saj do t'i bëjë ballë çdo të papriture. Por, në qoftë se do të lejojmë të hartohet një plan me të meta, shumë të këqija e të papritura do të na dalin rrugës.

Pra, problemi që shtrohet nuk është, siç mund të duket, një çështje me karakter thjesht ekonomik. Për kundrazi, ai mbi të gjitha është një problem politik e ideologjik, në të cilin gjen shprerje një luftë e ashper klasore, sepse çështja shtrohet kështu: do të hartohet një plan që nga të gjitha pikëpamjet të çojë në forcimin e pandërpërre të rendit tonë ekonomiko-shoqëror, në pavarësinë dhe në qëndrueshmërinë e ekonomisë sonë përballë çdo situate apo, me dashje pa dashje, do të lejohen të meta e gabime, shpërpjesëtime e mospër-puthje të ndryshme, që, në një mënyrë ose në një tjetër, të çojnë me siguri në shfaqjen e fenomeneve e të proceseve që janë tipike për ekonominë kapitaliste e re-visioniste dhe, që, po të lejohet të trashen, do të sjellin pasoja të rënda për fatet e socializmit në vendin tonë.

Ashtu siç u shprehën shokët e tjerë të Plenumit, edhe unë jam dakord që projektplani që po diskutojmë është më i bazuar se ai i çdo pesëvjeçari të mëparshëm, sepse në hartimin e tij organet dhe organizatat e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë kanë qenë më mirë se asnjëherë më parë në lartësinë e detyrave dhe është zbatuar më mirë vija e masave.

Megjithatë, as shenja më e vogël e vetëkënaqësisë nuk na lejohet. Të mos themi me mendjelehtësi se ato që ndodhën «nuk mund të na ngjasin më», osc siç thonë mjaft shokë, organizata partie e organe shtetërore, se ato që na ngjanë janë «të shkuara e të harruara». Të mendosh kështu, është gabim i pafalshëm. S'ka dyshim se po fjetëm mendjen, medoemos që do të na vërtetohen ngjarje të papëlqyeshme.

Veç kësaj, do të ishte, gjithashtu, gabim i madh po të harrojmë e të lëmë mënjanë të metat e paaftësinë e organeve të Partisë, të shtetit dhë të ekonomisë për të organizuar si duhet punët dhe për të ushtruar me rreptësi kontrollin e zbatimit të detyrave. Nuk duhet të nënvleftësojmë, gjithashtu, të metat, gabimet e boshllëqet që vazhdojnë të ekzistojnë në planifikim e në zbatim. Mes shumë e shumë problemeve të tjera, që na vihen përpara për të zgjidhur në fushën e përsosjes së planifikimit shkencor të ekonomisë, kërkon të bëhet një kujdes më i madh në disa probleme kyç.

Duke qenë se prodhimi ynë ka për qëllim plotësimin e nevojave të ekonomisë popullore dhe të masave punonjëse me sasi të caktuara vlerash përdorimi, llogaritja e saktë e tyre, në qytet e në fshat, në fushë e në malësi, kërkon që të bëhet një planifikim sa më i plotë e i drejtë i asortimenteve të prodhimit, sipas nevojave të ekonomisë dhe të radhës së domosdoshme të plotësimit të tyre. Mirëpo, në qoftë se te ne vihen re akoma fenomene të tillë negative, si krijimi i mbinormativave të mëdha, mospërputhja e anës financiare me atë materiale, mungesa e disa artikujve në treg dhe tprica e disa të tjerave etj., mendoj se një pjesë e mirë e tyre e kanë fillimin që në planifikim.

Me këtë lidhet edhe problemi tjetër, nevoja e një bashkërendimi më të mirë të planeve të degëve, të ndërmarrjeve e të sektorëve të ndryshëm për të siguruar përpjesëtime sa më të drejta, sepse ekonomia socialiste është një e tërë, unike dhe e harmonizuar. Mirëpo pikërisht kjo çështje në praktikë ka boshllëqe të ndje-

shme. Akoma nuk kuptohet në shkallën e duhur shikimi në kompleks i gjithë ekonomisë, çështjet zgjidhen në mënyrë të pjesshme, të izoluar, pa u nisur nga e tëra dhe pa marrë parasysh të tërën. Në ekonominë tonë nuk mund të lejohet që gjithkush të mendojë e të punojë në kuadrin e sektorit apo të «punës së vet», pa menduar edhe për tjetrin.

Duhet të bëhen përpjekje, gjithashtu, që plani të realizohet me cilësi, me sasi dhe me asortimente, probleme këto shumë serioze, si për degët e industrisë që prodhojnë për nevojat e brendshme, ashtu edhe për eksport. Një gjë e tillë është shumë e rëndësishme për ekonominë, ndryshe ç'kuptim ka vendosja e përpjesëtimeve të drejta dhe bashkërendimi në periudhën e planifikimit? Shpërpjesëtimet janë njëlloj të rrezikshme, si kur vijnë nga një planifikim i dobët, ashtu edhe kur vijnë nga përpjekjet e pamjaftueshme për realizimin e planeve në të gjithë zërat dhe në kohën e caktuar. Këto shfaqje janë të papajtueshme me natyrën e ekonomisë sonë socialiste, prandaj duhen luftuar me vendosmëri. Duke ndjekur rrugën e futjes së ekonomisë sonë në një sërë kontradiktash, nëpërmjet zhvillimit jopërpjesëtimor të saj, për të krijuar vështirësi sa më të mëdha dhe për të sabotuar ndërtimin socialist të vendit, armiqtë e Partisë dhe të shtetit tonë socialist u përpinqën ta kthejnë atë drejt decentralizmit liberal, që të hiqej dorë nga plani unik e i përgjithshëm shtetëror dhe t'i hapej kështu rrugë e gjerë zhvillimit anarkik e spontan, vetadministrimit revisionist-titist. Prandaj këtë rrezik dhe këto pasoja shumë të dëmshme

të zhvillimit jopërpjesëtimor të ekonomisë në duhet t'i mbajmë mirë e vazhdimisht parasysh.

Se ku mund të na çojë një planifikim jo i kujdes-shëm duket qartë edhe në problemin e zënies në punë të forcave të afta për punë. Asnjëherë të mos e neglizhojmë dhe të mos e marrim lehtë këtë problem.

Me dhjetëramijë të rinj e të reja do të na hyjnë në moshën e punës. Kjo kërkon një kujdes të madh për shpërndarjen e tyre të drejtë në industri, në bujqësi, në ndërtim dhe në degët e tjera të ekonomisë. Ky problem ka, gjithashtu, lidhje me vëllimin e investimeve dhe me strukturën e tyre.

Karakteristike edhe për këtë pesëvjeçar janë investimet prej dhjetëra miliardë lekësh. Shumica e tyre kalojnë në industri, megjithëse rritje të ndjeshme kanë edhe fondet për bujqësinë. Por ne po ndërtojmë vepra të tilla të industrisë së rëndë që kërkojnë fonde të mëdha investimesh, ndërsa për shfrytëzimin e tyre angazhohen pak njerëz, sepse ato janë të një niveli të lartë teknik. Edhe fabrikat e uzinat e tjera që po ndërtojmë do të angazhojnë vetëm një pjesë të forcave të reja që hyjnë për herë të parë në punë, disa mijëra prej tyre. Atëherë, si do të bëjmë me të tjerët? Ne kemi vendosur që t'i drejojmë në bujqësi dhe kjo është rruga jonë kryesore. Prandaj Partia dhe pushteti duhet të zhvillojnë një propagandë të dendur, të planifikojnë mirë e të marrin masa për ndërtim baneshash dhe për probleme të tjera për gjithë këtë mori njerëzish që do t'ë venë nga qyteti në fshat.

Plani duhet të parashikojë edhe kooperimin e spe-

cializimin midis degëve e ndërmarrjeve, si procese të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe të organizimit shkencor të prodhimit. Në këto drejtime armiq-të, si Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e të tjerë janë përpjekur të vënë gurë në rrota.

Në qoftë se nuk planifikojmë shtrënguar shpenzimet e prodhimit e të qarkullimit, në qoftë se vazhdojmë të hartojmë preventivat e ndërtimit me norma të vjetruara të harxhimit të materialeve e të mjeteve në përgjithësi dhe, akoma më keq planifikojmë përvite me radhë prodhimin e produkteve ose lejojmë pa kriter daljen e ndërmarrjeve me humbje etj., atëherë do të kemi si pasojë pakësimin e akumulimit, gjë që vështirëson mbajtjen e ritmeve të larta të zhvillimit dhe ngritjen e parashikuar të mirëqenies së popullit. Në këtë rast duhet t'i vëmë vetes pyetjen: A duhet të lejojmë çrregullime të tillë në planifikim? Mua, më duket se jo dhe mendoj se dhe ju do të jeni dakord. Në kushtet e një planifikimi të tillë nuk mund të ketë mobilizim të forcave, të energjive mendore e fizike nga të gjithë.

Kursinë është e domosdoshme të bëhen kudo, por mbi një plan shumë të shtrënguar. Kjo është rruga dhe detyra që na vihet! Të gjithë zërat e planit duhet t'i nxjerrim ekonomikë, ndërsa subvencionimi të konsiderohet si diçka e jashtëzakonshme.

Me pasoja mjaft të rrezikshme, ekonomike dhe politike, është planifikimi me të meta i fuqisë blerëse të popullatës dhe mbulimi në global i saj, siç ndodh shpesh në praktikë. Kjo çon në atë që ndërsa dyqanet janë plot, blerësit të mos gjejnë mallin që kërkojnë! Me-

gjithëse këpucët, konfeksionet, enët e kuzhinës mbushin depot, ndodh nganjëherë që punonjësit vijnë rrotull për rroba e këpucë për fëmijë dhe vetë janë të detyruar të shkojnë në punë me veshmbathje të shtrenjta, sepse nuk prodhohen sa duhet këpucë e rroba punë me çmime të arsyeshme. Ne duhet ta luftojmë luksin.

Për këtë duhet të mendojnë më shumë edhe vetë punëtorët, sepse ata janë prodhuesit e mallrave të tilla. Nuk është e drejtë të zërë vend tek asnje punëtor qëndrimi i gabuar që, pasi është sistemuar mirë në një vend pune, të mos bëjë përpjekje të mjaftueshme për të prodhuar assortimente të reja, për të përmirësuar pa ndërprerje cilësinë, pavarësisht se ato çka ai prodhon mbushin depot. Ç'do të thotë të prodhosh basma ose konfeksione të tilla? Përveç harxhimit të kotë të punës, blokohet një pjesë e mirë e valutës që shteti ka harxuar për pambukun që importon, sepse, siç e dini, ne nuk sigurojmë akoma plotësisht gjithë sasinë e cilësinë e pambukut që na nevojitet si lëndë e parë për industrinë tonë të tekstileve. Kështu ndodh edhe me disa enë të kuzhinës, makineri, lëndë të para etj. Po pse kaq shumë valutë kemi ne sa ta blokojmë e ta nxjerrim atë nga qarkullimi ekonomik? Pa lëre pastaj kur ndodh që një organ vendos prodhimin, një tjetër vendos shpërndarjen e këtij prodhimi, një i tretë furnizimin për këtë prodhim etj.

Këto çrrregullime apo kontradikta që shfaqen në planifikim, nö marrëdhëniet midis prodhimit dhe konsumit shprehin çrrregullime apo kontradikta që kanë lindur në fazë të ndryshme të procesit të riprodhimit

të zgjeruar socialist, të cilat, po të mos mënjanohen në kohën e duhur, mund të çojnë në pasoja të dëmshme me karakter ideopolitik, ekonomik dhe shoqëror.

Undala ca në këto probleme që kanë të bëjnë me dëmet që mund të na shkaktojë një planifikim jo i kujdeshëm nga baza deri në qendër, jo se ekonominë tonë e karakterizojnë fenomenet që përmenda, përkundrazi, ne kemi një ekonomi të fortë, të qëndrueshme, por me qëllim që atë ta shëndoshim e ta forcojmë akoma më shumë, se atdheu dhe socializmi kanë nevoja të mëdha.

Problemet që trajtova nuk janë të vogla dhe anësore, por të rëndësishme, ato kanë të bëjnë me gjithë ecjen tonë përpara, me luftën dhe me punën e përdershme të masave të gjera punonjëse për të shpejtuar ndërtimin e socializmit dhe për të mos lejuar që ekonomia jonë të infektohet nga fenomene e shfaqje të kri-zës që ka pushtuar botën që na rrethon.

Një rol i posaçëm u takon në këtë drejtim Komisionit të Planit të Shtetit dhe gjithë organeve të tjera të drejimit e të planifikimit të ekonomisë. Në mënyrë që këto organe t'i kryejnë më mirë detyrat, është e domosdoshme të mbajnë kurdoherë parasysh orientimet bazë marksiste-leniniste të Partisë në planifikim dhe të shkëputen me vendosmëri nga disa forma shablonë të vjetruara e të huazuara, të cilat në mjaft raste, siç e ka provuarjeta, kanë qenë të gabuara. Kjo shtron nevojën që, me gjithë përmirësimet e vazhdueshme që janë bërë në metodologjinë e planifikimit, duhet të bëhen përpjekje që, mbi bazën e përgjithësimit të përvojës pozitive të arritur nga mjaft ndërmarrje, koope-

rativa bujqësore e institucionë të ndryshme, të gjenden aspektet më revolucionare që do të çojnë në përmirësimë konstruktive të praktikave të derisotme.

Siq e kam theksuar edhe herë tjetër, një punë me cilësi më të lartë duhet të bëjë në këtë drejtim Komisioni i Planit të Shtetit. Fjalën e kam sidomos për një punë më përgjithësuesc, për të nxjerrë më shumë konkluzione për udhëheqjen dhe drejtimin më shkencor të ekonomisë, për të sinjalizuar me kohë dhe për të parandaluar shpërpjesëtimet që mund të vërtetohen. Kjo kërkon që, të mbështetur fuqimisht në forcat tona, të depërtohet më thellë në proceset e brendshme të riprohimit të zgjeruar socialist. Ky riprodhim, i cili edhe në ekonominë socialiste realizohet në bazë të skemave të njobura të Marksit, duhet të pasqyrohet në mënyrë harmonike në planin unik e të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe në bilancin e përgjithshëm të ekonomisë populllore. Stalini e ka shtuar me forcë nevojën e hartimit të këtij bilanci si një instrument shumë të rëndësishëm, që sintetizon gjithë treguesit më kryesorë të zhvillimit të ekonomisë në shkallë kombëtare.

«Skemën e bilancit të ekonomisë populllore ..., — shkruante ai, — duhet ta përpunojnë marksistët revolucionarë, në qoftë se ata kanë ndër mend të merren me studimin e problemeve të ekonomisë së periudhës tranzitore»¹.

Prandaj hartimi i këtij bilanci nga Komisioni i Planit të Shtetit, në bashkëpunim me institute të tjera studimore, siç kam folur edhe më gjerë për këtë problem me shokun Petro Dode, do të jetë një nga çështjet që do të ndihmojë për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave që shtron Partia.

Paraqitja e planit pesëvjeçar ose e planeve vjetore dhe e realizimit të tyre në Qeveri, në Byronë Politike ose në Komitetin Qendror të Partisë, mendoj se duhet të jetë më e përbledhur, më sintetike dhe më e kuptueshme. Ajo duhet të ketë një formë të tillë që të na lejojë të gjykojmë mbi të dhënat kryesore dhe jo të mbytemi në libra të törë shifrash, krahasimesh e përqindjesh. Këto të dhëna kryesore duhet të ndjekin një sistem paraqitjeje më të qartë, më të lidhur, më të rrjedhshëm e konsekuent. Kjo nuk është vetëm çështje forme, por sidomos përbaltjeje, e cila në të ardhmen duhet të na jepet sa më qartë dhe kuptueshëm.

Por, siç dihet, puna për hartimin e planit është vetëm hapi i parë. Sipas parashikimeve, detyrat e këtij pesëvjeçari janë të ngjeshura e shumë të mëdha për të gjitha degët e ekonomisë, po veçanërisht në gjeologji, në industrinë e naftës, të qymyrqurit e atë minetrare, në industrinë mekanike, në bujqësi e në ndërtim. Prandaj kërkonët një mobilizim i përgjithshëm në të gjithë sektorët dhe degët e ekonomisë e të kulturës. Por, në pesëvjeçarin që po shqyrtojmë, sektori i bujqësisë ka detyra më të rënda. Në qoftë se do t'i përvishemi punës pa rezerva për të përgjithësuar shembullin dhe eksperiencën e përparuar që ekziston në

shkallë të gjerë jo vetëm në gjithë vendin, por edhe në çdo rreth dhe ekonomi bujqësore të marrë veças, atëherë plani bujqësor jo vetëm do të realizohet, por janë të gjitha mundësitë që ai të tejkalohet çdo vit.

Nuk kam ndër mend të përsëris këtu mendimet që kam shfaqur për përmirësimin e punës në fushën e investimeve e të ndërtimeve, si dhe ato që prekën shokët në këtë Plenum, duke filluar që nga hartimi i projekteve e i preventivave sa më ekonomikë dhe deri te lufta që duhet bërë për të mos u përsëritur më ajo që na ndodhi në pesëvjeçarin e kaluar, duke u shpërndarë në shumë objekte, gjë që na kushtoi shumë dhe ishte me pasoja të rrezikshme.

Përpjekje shumë të mëdha duhet të bëjnë punonjësit e tregtisë e të transportit, në mënyrë që prodhimi të shkojë te konsumatori sa më parë dhe me cilësi.

Detyra të mëdha parashikon ky pesëvjeçar edhe në fushën e arsimit, të kulturës, të shëndetësisë dhe të shërbimeve të tjera për popullin. Realizimi i tyre kërkon kujdes e vëmendje të vazhdueshme nga organet përkatëse shtetërore nën drejtimin e organeve e të organizatave-bazë të Partisë.

Që ky plan pesëvjeçar të realizohet plotësisht, kërcohët mobilizim i përgjithshëm i forcave mendore e fizike nga ana e klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste dhe inteligjencies popullore, kërcohët organizim e kontroll i vazhdueshëm nga poshtë e nga lart, nën udhëheqjen e Partisë. Këtu ka rëndësi të kuptohet nga të gjithë se lufta për realizimin e planit është, në radhë të parë, luftë ideologjike, luftë klase. Këtë e

vërteton gjithë praktika e ndërtimit tonë socialist, por më qartë akoma e tregoi këtë puna për realizimin e planit të pestë pesëvjeçar, gjatë të cilit na u desh të ndeshemi me armiqëtë e sabotatorët, me bllokadën e presionet e imperialistëve e të revizionistëve, me burokratizmin e liberalizmin dhe me shfaqje të tjera e qëndrime antisocialiste.

Me gjithë luftën e madhe që është bërë kundër sëmundjes së liberalizmit, pas Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë e këtej, shfaqjet e përditshme negative tregojnë se te ne ka akoma liberalizëm dhe prirje të theksuara burokratizmi. Pa luftuar me konsekuençë revolucionare këto dy të këqija shumë të rrezikshme, që gërs hetohen e ushqejnë njëra-tjetren, punët nuk mund të çohen përpara me hapin që kërkohet dhe i lihet shteg punës armiqësore, minimit nga brenda të rendit socialist.

Duhet bërë punë bindëse e sqarucse për të treguar se ku të çon praktika e mosrealizimeve jo vetëm për ato çështje që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të prodhimit apo të konsumit të popullit brenda vendit, por edhe për rastet e mosrealizimit të kontratave të eksport-importit, ku lufta dhe përpjekjet duhet të jenë shumë të mëdha.

Në këtë frysë duhet të bëhet edhe diskutimi i planit të ri pesëvjeçar nga masat e gjera të popullit. Problemi i planit është detyrë partie, prandaj në ballë të gjithë kësaj veprimtarie, si kurdoherë, të vihen organet dhe organizatat e Partisë, për të udhëhequr drejt orga-

net shtetërore dhe ekonomike në organizimin e në drejtimin konkret të punës së tyre.

Gjatë periudhës së diskutimit të projektdirektivave është e domosdoshme të punohet seriozisht dhe të merren masa për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të masave punonjëse, me qëllim që të përcaktohen sa më qartë detyrat kyç, të thellohen sa më shumë direktivat e Partisë. Kjo do të thotë se gjatë kësaj kohe duhet të bëhet kujdes që të mos kënaqemi vetëm me propagandimin e asaj që duhet bërë për solidarizimin e popullit me projektdirektivat dhe me ngrijtjen e entuziazmit të tij për to. S'ka dyshim që solidarizimi dhe entuziazmi kanë rëndësinë e vet, por të mos harrojmë domosdoshmërinë e tërheqjes së mendimit populor, që do të jetë një kontribut i madh në përpjekjet që po bëhen për shpejtimin e ndërtimit socialist dhe për mbrojtjen e atdheut tonë.

Organizatat e Bashkimeve Profesionale, të Rinisë, të Gruas, të Frontit, nën udhëheqjen e Partisë, të mobilizohen, gjithashtu, me të gjitha forcat për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme.

Eshtë e domosdoshme që mobilizimit e gatishmërisë së punonjësve tanë t'i përgjigjet një nivel më i lartë organizimi dhe kontrolli i fortë, vendosja kudo e një disipline të rreptë proletare në punë dhe në jetë, në mënyrë që mundi, djersa dhe sakrificat e punonjësve, harxhet që bën dhe do të bëjë shteti të shkojnë të gjitha në dobi të zhvillimit ekonomik socialist dhe të pa-thyeshmërisë së mbrojtjes së vendit tonë socialist, de-tyrës sonë kryesore. Vetëm kështu ngrihet në një shka-

llë më të madhe ai entuziazëm i madh e optimizëm revolucionar që karakterizon punonjësit dhe mbarë popullin tonë e që do të shprehet me mobilizimin e tyre në punë, me gatishmërinë e shpirtin e tij revolucionar.

Si gjithë shokët që morën fjalën në këtë Plenum të Komitetit Qendror, Byroja Politike dhe unë jemi të bindur se diskutimi me masat e popullit do të jetë faktor shumë i rëndësishëm për përmirësimin e mëtejshëm të këtij projektplani që do t'i paraqesim për diskutim dhe aprovim Kongresit të 7-të të Partisë dhe ne vetë të tërë së toku do të vëmë të gjitha forcat që detyrat që do të na ngarkojë ai t'i zbatojmë me nder, siç i kemi zbatuar me sukses edhe herë të tjera.

Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në AQP

DUKE ZBATUAR POROSITË E PARTISË ARRIHET ÇDO GJE

*Nga biseda me kuadro drejtues të Partisë e të
pushtetit të rrethit të Pogradecit¹*

1 gusht 1976

Rrethi i Pogradecit ka rezultate të mira dhe kjo tregon për dy gjëra: që Partia këtu është e shëndetshme dhe masat punonjëse janë të mobilizuara mirë. Të kuptohet thellë nga komunistët dhe nga masat punonjëse se, kur organizohet si duhet puna, atëherë sukseset arrihen.

Dëshiroj t'ju theksoj diçka: entuziazëm në punë duhet të ketë kudo, por vetëkënaqësi, që sjell uljen e mobilizimit në punë dhe të hovit revolucionar, nuk duhet të ketë. Rrojmë në situata të atilla të brendshme dhe të jashtme që kërkojnë mobilizim, organizim, edukim dhe ngritje politiko-ideologjike. Këtë gjë do ta kryejë Partia me organizatat e masave që ka rreth saj,

1. Shoku Enver Hoxha e zhvilloi këtë takim në Pogradec në kohën e pushimeve.

me organet e pushtetit që ajo ka krijuar dhe drejton. Duhet ta kuptojnë të gjithë se çdo problem, i çdo natyre qoftë, i çdo madhësie qoftë, është i lidhur me disa çështje që duhen njojur, duhen analizuar dhe duhet organizuar zbatimi i tyre sa më drejt, që të japë rezultate të kënaqshme për popullin dhe për forcimin e socializmit.

Shumë herë disa çështje duken si të rastit, si të shkëputura nga të tjerat, por asgjë nuk ekziston e vemuar. Çdo gjë ka lidhje me të térën, çdo gjë rrjedh nga një problem ose nga një ndodhi e mëparshme, ose është rrjedhim i zhvillimit të jetës dhe të problemeve të saj që kërkojnë zgjidhje. Prandaj një udhëheqje e mirë jo vetëm duhet të njohe problemet e rrethit, por këto të mos i shkëputë kurrë nga problemet e gjithë atdheut dhe nga problemet e zonave, të ndërmarrjeve, të kooperativave, të shkollave dhe të ushtrisë. Udhëheqja kryesore në rreth, me shembullin e vct, të bëjë të ndërgjegjshme dhe aktive bazën; kjo, nga ana e saj, të njohe problemet dhe t'i zgjidhë ato në kohë dhe me cilësi. Vetëm, udhëheqja kryesore nuk mund të zgjidhë asgjë.

Vijën e Partisë ju e keni të qartë. Ju dini rolin udhëheqës dhe rëndësinë ekonomike të industrisë në zhvillimin e vendit, por duhet të mos harroni edhe rolin e bujqësisë socialiste, si bazë e ekonomisë.

Ju në rrethin tuaj keni dy miniera të rëndësishme: të qymyrgurit dhe të hekur-nikelit. Për këtë të fundit po ndërtohet këtu edhe një fabrikë pasurimi me rëndësl. Këtu ka, gjithashtu, dhe disa fabrika dhe punishte

të vogla. Kudo duhet ta organizoni mirë punën, por në fabrikën e pasurimit të hekur-nikelit, si dhe në ndërtimin e hekurudhës¹ e të tunelit², nga do të kalojë ky mineral, që si lëndë e parë do të furnizojë Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit, kërkohet kujdes i veçantë. Këtë jua theksoj, pse, po të mos kishte ndërhyrë Byroja Politike, këto objekte nuk do të mbaronin në kohën e caktuar, për gabimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe tuajin. Këto punime duhen mbaruar medoemos në afat dhe me cilësi të lartë. Që tash duhet të organizoni drejtimin dhe ta merrni mirë në dorë këtë punë.

Rëndësia e drejtimit ekonomik të rrethit nuk duhet kuptuar dhe përcaktuar vetëm nga shumat që investohen, por edhe nga rëndësia e prodhimeve që do të merren prej tyre. Me këtë duhet pasur parasysh të mos harrohet dhe të mos neglizohet bujqësia. Hekur-nikeli është me rëndësi kolosale për ekonominë e vendit tonë. Ai kërkon kujdes të veçantë dhe duhet t'i kushtohet ky kujdes, prandaj ngul këmbë që të organizohet shtabi i minierës, i cili, tok me komunistët dhe me punëtorët, të bëjnë që puna atje të ecë si sahat. Ju, s'ka dyshim se do të interesoheni për çdo gjë që lidhet me këtë çështje, por bujqësinë të mos e neglizhoni.

Bujqësia për rrithin tuaj dhe për gjithë rrethet e tjera të Shqipërisë, në këto vite që po kalojmë, ka një

1. Eshtë fjala për Hekurudhën Përrenjas—Guri i Kuq. Punimet për ndërtimin e saj filluan më 1975 dhe përfunduan më 1979.

2. Tuneli i Qafës së Thanës.

rëndësi shumë të madhe. Vija e Partisë qëndron e patundur, por, në këto furtuna politike që kanë mbuluar botën, na vihet detyrë e ngutshme ta zhvillojmë nje hapa të mëdhenj bujqësinë.

Si rrëth bujqësor, megjithëse keni fabrika e miniera, për të cilat, siç thashë, duhet të interesoheni, bujqësia është për ju kryesorja; kësaj duhet t'i vini kujdesin më të madh. E them këtë, pse ka rrethe që vënë në radhë të parë industrinë e vogël të tyre dhe me këtë duan të hiqen se jo vetëm e kanë kuptuar vijën, por me përqindjet e tejkalimeve në këtë sektor, kërkojnë të mbulojnë deficitet në bujqësi dhe në blegtori, që janë përtta sektorët më të rëndësishëm. Planet duhet të realizohen dhe të tejkalojen në të gjithë sektorët, por kurdoherë të mbahet parasysh cili është sektori më i rëndësishëm, më i vështiri, më i koklavituri dhe që kërkon kujdesin më të madh sipas rr Ethanave. Aktualisht sektori i bujqësisë është më i madhi, më i rëndësishmi, për rrëthin tuaj.

Neve na vihet detyrë ta prodhojmë medoemos bukën në vend, jo vetëm për të plotësuar nevojat imediate të popullit, por dhe për të shtuar rezervat. Bukë të mos sjellim më nga jashtë. Neve na bie detyrë të shtojmë prodhimin e mishit, të vezëve, të zhvillojmë dhe të shtojmë prodhimin e panxharit të sheqerit, të pambukut, të lulcediellit dhe të çdo bime tjeter vajore për sigurimin e yndyrnave. Këtë rrugë në ngjitje duhet ta ndjekim absolutisht me këmbëngulje.

Bujqësia jonë socialiste ecën përpara, por të mos kënaqemi me çka kemi arritur. Rezervat në këtë sek-

tor janë të mëdha dhe akoma të pashfrytëzuara. Provat e këtij fakti janë të prekshme. Sivjet janë arritur nga kooperativistët rendimente të larta në grurë, po kështu paraqitet edhe misri. Po lexoj me kujdes çdo ditë gazetat dhe shoh se me qindra brigada të dalluara po tejkalojnë rendimentet në grurë që kemi caktuar për vitin 1980. Këto parcela përfshijnë me mijëra e me dhjetëra mijë hektarë. Rendimentet e grurit kudo kanë bërë një hop cilësor. Nga asnjë kooperativist, me të cilin kam biseduar, nuk kam dëgjuar të thuhet se «kjo u arrit pse bëri koha». Jo, ata nuk e zënë në gojë këtë, po numërojnë proceset e punëve që kanë kryer në zbatimin e agroteknikës, si dhe kujdesin e veçantë që i kanë kushtuar tokës mëmë, e cila prodhon këto të mira. Ja pse u arriten këto rezultate! Tash është krijuar besimi se, duke zbatuar si duhet porositë e Partisë, arrihet çdo gjë, kapörcehet çdo vështirësi. Kjo është një fitore e madhe.

Tash nuk thuhet dhe nuk duhet të thuhet më që «bujqësia është fabrikë pa çati» që, ajo «kryesisht varret nga elementet atmosferike». Elementet atmosferike luajnë rol, por jo kryesorin në kushtet e këtij stadi të lartë zhvillimi dhe fuqizimi të shumanshëm në çdo drejtim që ka arritur bujqësia jonë socialiste. Këto dy fitore duhet t'i konsolidojmë çdo ditë e çdo vit. Asgjë të mos i lihet spontaneitetit.

Angazhimet që merren në bujqësi në brigadat, në kooperativat të futen në plan dhe t'i jepet rëndësi organizimit të mirë të punës. Çdo brigadë duhet ta ketë parasysh angazhimin që ka marrë dhe ta realizojë këtë

përditë. Të gjitha shërbimet që duhen kryer, si: plehërimi, triorimi, zgjedhja e farës dhe sasia që duhet mbjellë për njësi të sipërfaqes, në kohën më të mirë për këtë proces, prashitja, lesimi, ujitja, përdorimi i herbicideve, kujdesi gjatë korrjeve etj., etj., duhet të shënohen në tabelë.

Sigurisht, të gjitha këto që po them, dihen, me gjithatë nuk zbatohen si duhet nga të gjithë. Çdo gjë e zbatuar mirë, shkencërisht dhe në kohën e duhur, jep rezultatet e mëdha, për të cilat luftohet. Prandaj asgjë nuk i duhet lënë spontaneitetit. Me komunistët në ballë, të punohet me sistem, të kontrollohet çdo ditë puna dhe njerëzit që e kryejnë atë. Asgjë nuk duhet lënë për nesër. Rreth kësaj çështjeje duhet të përqendrohet puna e Partisë, dituria, organizimi, edukimi, kontrolli, kritika dhe autokritika.

Eshtë e nevojshme, bile e domosdoshme të veprohet në këtë mënyrë, pasi kështu janë arritur rezultatet e mira të brigadave pararojë.

Ne kemi pasur një të keqe, që duhet ta zhdukim: duke u vënë rëndësi të madhe drithërave, harrojmë blegtorinë, perimet dhe pemëtarinë. Në këto drejtime vazhdohet të mos tregohet kujdesi i duhur. Ka ende ndonjë kooperativë bujqësore që e nënveftëson blegtorinë, bagëtinë e trashë dhe atë të imët, prej të cilave popullit i sigurohen ushqime nga më të rëndësishmet, siç janë mishi, qumështi e nënproduktet e tij, si edhe leshi e lëkurët. Po perimet? As këtyre nuk u kushtohet ajo vëmendje që kërkohet. Ato janë ushqim për popullin, por janë, gjithashtu, produkte për eksport, të njo-

ma dhe të thata. E njëjta gjë duhet thënë edhe për frutat, prandaj nuk na lejohet të ecet më kështu. Edhe me bimët industriale dhe vajore bujqësia jonë jo vetëm duhet të ushqejë mirë popullin dhe t'i krijojë shtetit rezerva, por të prodhojë edhe për eksport. Nga bujqësia mund të krijohet devizë e fortë, që, po t'i shtohet asaj të industrisë, na lejon të përballojmë mjaft vësh-tirësi që mund të na krijohen.

Në Kinë, me të cilën kemi nënshkruar disa marrëveshje për këtë pesëvjeçar, siç mund ta dini, gjendja nuk është e qartë. Atje ekziston kaos politik dhe ideo-logjik, prandaj ajo mund edhe të na nxjerrë pengesa në realizimin e tyre. Kjo po duket edhe në faktin që kinezët po na pengojnë edhe për veprat në ndërtim. Mjaf-ton tërmeti që ra atje, që të fillojnë të na thonë se do të reduktojnë investimet brenda, por edhe ndihmat që kanë akorduar jashtë. Kjo nuk është thënë ende zyrtarisht, por mund të thuhet nesër. Prandaj duhet të parashikojmë çdo gjë dhe t'u bëjmë ballë të papriturave. Nga të gjithë kërkohet mobilizim total e disiplinë e hekurt në punë, të marrim angazhime të guximshme dhe t'i realizojmë ato; t'i vëmë shumë rëndësi bujqësisë se, fundja, pa një fabrikë mund edhe të bëjmë, por pa bukë s'bëjmë dot.

Një udhëheqje e mirë, siç është Partia jonë, duhet të interesohet për mbarëvajtjen e gjithë ekonomisë. Ligjet e ekonomisë politike të socializmit duhen njojur dhe zbatuar drejt, ndryshe krijohen perturbacione dhe jo vetëm ekonomike, por, si rrjedhim, edhe politike, siç janë, për shembull, papunësia dhe inflacioni etj.

Të kihet kujdes për të parën, po unë po tërheq pak vëmendjen tek inflacioni. Ky ka lidhje me hedhjen në qarkullim të parasë më tepër se ç'duhet. Këto para duhet të qarkullojnë shpejt, por për këtë qëllim tregu jo vetëm duhet të ketë mallra, por edhe të mbulohet me ato mallra që kërkon populli. Ndryshe, në rast se nuk tërhiqet paraja, atëherë monedha zhvlejtësohet dhe sjell perturbacione në ekonomi. Për këtë çshtë e domosdoshme të mendohet mirë nga ju dhe nga ne. Populli ynë ka shprehinë e kursimit, ai çshtë patriot dhe ka besim në monedhën e tij, por me kusht që të mos i rriten shumat në dispozicion. Mirëpo këto shuma janë në rritje dhe do të ndodhë kurdoherë kështu, sepse të gjithë punojnë, të gjithë kanë të ardhura, të gjithë krijojnë rezerva. Ne veprojmë drejt që nxitim prodhimin, qoftë atë industrial, qoftë atë bujqësor, por shteti ynë mendon e duhet të mendojë që t'i japë popullit sa më shumë mallra të konsumit e fshatarëve sa më shumë lëndë ndërtimi dhe të gjithëve sende të fabrikuara të shumëllojta.

Dëshiroj t'ju theksoj edhe një të keqë që ekziston: stoqet e mallrave në depo. Këto janë mallra të shumëllojta që populli nuk i tërheq, se s'janë të mira. Ato përfaqësojnë vlera të mëdha. Kjo e keqë vjen se nga disa ndërmarrje prodhohet sa për të prodhuar, pa kriterë cilësic, pa kontrolluar prodhuesit, pa ndryshuar drejtimet e prodhimit të mallrave, kur disa nga këto nuk shkojnë më.

Të gjithë të mendojmë seriozisht për këto probleme kyç dhe të marrim masa të shpejta e të drejta që as

të prodhojmë për të prodhuar dhe për të mos shitur, as të pengojmë prodhimet, të cilat duhet të jenë të cilësisë së mirë dhe të shiten. Ekonomia jonë socialiste, e planifikuar dhe e centralizuar, nuk do të thotë të ecë «si kali i araba-së», por të ndjekë në çdo moment të dhënrat e problemeve dhe të marrë masa të drejta në rrugën e ekonomisë socialiste dhe të ligjeve të saj, që nuk mund të shkelen dhe as të manipuloher si të duan liberalët ose njerëzit me horizont të ngushtë. Udhëheqja duhet të shikojë gjerë.

*Bëtoret për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

**NË SEKTORIN E BUJQËSISE TË FORCOHEN
ORGANIZIMI, PUNA EDUKUESE
DIIE KONTROLLI**

Shënime

3 gusht 1976

Bujqësia paraqitet mirë sivjet, sidomos në drithërat e bukës, por ne duhet t'i stabilizojmë rendimentet e tyre dhe të mos ecim duke shtuar çdo vit nga një ose tre kuintalë për hektar. Tash nuk mund dhe nuk duhet të ecet më në mënyrën e vjetër, kur nuk kishim mekanizm, nuk kishim plehra kimike, kur nuk kishim bonifikuar dhe nuk ujtnim shumë toka, kur nuk kishim as kuadro me arsim të lartë dhe as me arsim të mesëm bujqësor sa duhej. Aktualisht çdo gjë ka ndryshuar, ka ndryshuar edhe kooperativisti. Ai është ngritur politikisht, ideologjikisht dhe ka përvetësuar agroteknikën moderne.

Në këto kushte ne duhet të planifikojmë për çdo vit rendimente më të larta, duke pasur parasysh rendimentet më të larta në republikë, të cilat arrihen në brigadat pararojë. Këtij i thuhet stabilizim, që duhet

realizuar jo vetëm në drithërat e bukës, por edhe në blegtori, në ushqimin, prodhimtarinë dhe në shtimin e bagëtisë, në bimët industriale dhe në pemëtari, pa lënë pas dore pyllëzimin e vendit me drurë industrialë, si dhe popullimin e pyjeve me kafshë dhe me gjithfarë zogjsh pyjesh.

Këta sektorë të rëndësishëm të bujqësisë, që përmenda, janë prapa. Kjo vjen se ata nënvleftësohen keqas. Te mjaft njeröz ekziston mendimi i vjetër se mund të rrrosh vetëm me bukë, se pa qumësht, pa lesh, pa yndyrna dhe pa lëndë druri mund të bëhet si të bëhet. Kjo është një e keqe që duhet hequr me darë të madhe nga thellësitë e padukshme të ndërgjegjes së fshatarësisë sonë. Kështu, po t'u flasësh, të gjithë e kuptojnë këtë arsyetim të pakundërshtueshëm, por, kur vjen puna në praktikë, në punën e përditshme, atëherë ka tërheqje. Pse vjen kjo? Për mungesë organizimi, mendoj unë, për mungesë edukimi, për mungesë kontrolli dhe kujdesi nga kuadrot drejtues dhe veçanërisht, për mungesë kuadri të specializuar për perimet, për pyjet etj. Edhe nga këta kuadro që kemi, shumë janë në ardhë më pak në pyje. Ata nuk drejtohen dhe nuk organizohen si duhet. Pirro Dodbiba dhe Petraq Magjistari përpinqeshin t'i bënин si vetja e tyre këta kuadro, vetëm sa të jepnin këshilla dhe të mos ngjishnin këpucët me baltë.

Kam solur me ministren e re të Bujqësisë, por do të flas përsëri që të gjitha këto probleme kapitale të mbahen ngritur në ministri e në bazë dhe të kërkohet me këmbëngulje e të kontrollohet zbatimi i tyre që të

arrihen rezultatet e caktuara. Do ta këshilloj përsëri atë, do të shkundim gjithë Partinë, në qendër e në bazë. Duhet të shkunden fort edhe komitetet ekzekutive, sektionet e bujqësisë dhe kuadrot e tyre, t'u kontrollohen planet e punës dhe të ndiqet si zbatohen këto plane. Kontrolli i tyre të bëhet efektivisht në fushë, në arë dhe jo në zyra e me raporte. Ministria e Bujqësisë duhet t'i ngjasë një koshereje bletësh që të ziejë nga punët, ajo edhe të planifikojë, edhe të udhëzojë, edhe të kontrollojë e të ndihmojë.

Përveç detyrave të prodhimit, Ministria e Bujqësisë duhet të interesohet veçanërisht për sistemimin e tokave, për drenazhimin e tyre në mënyrë stabile, për kanalet ujitëse dhe për metodën moderne të ujitjes; të interesohet për investimet në bonifikime, në pyllëzime, në pemëtari dhe në shtimin e bagëtisë dhe të bazës ushqimore të saj. Ka edhe shumë probleme të dyta e të treta që varen prej tyre. Për këto probleme kam pasë folur edhe me Pirro Dodbibën, por ai asgjë serioze dhe sistematike nuk bëri. Për të realizuar problemet bazë duhen organizim dhe kontroll i fortë, duhen dituri dhe shkencë, duhet shpjeguar çdo gjë politikisht dhe teknikisht që të kuptohet domosdoshmëria e tyre. Prandaj ministria të organizojë një sërë mbledhjesh me shkencëtarët e agroteknikës e të studimit të tokave. Të njihet gjendja për këto probleme në çdo rrëth dhe të dihet nga secili se ç'duhet të bëhet, se kjo është kryesorja. Prandaj me rrëthet, Ministria e Bujqësisë duhet të planëzojë qartë dhe në mënyrë precize ç'duhet të bëjë cilido rrëth, të caktojë kohën, prioritetin, të marrë

masat organizative, të organizojë njerëzit e mjetet dhe pastaj të gjithë t'i përvishen seriozisht punës. Të kontrollohet puna jo kur mbaron dhe të gjenden pastaj shumë justifikime, po kontrolli të ushtrohet vazhdimisht gjatë zbatimit të detyrave.

Ministria e Bujqësisë duhet të matë dhe të shpërndajë në mënyrë të studiuar mirë forcat e saj teknike, t'i japë këto në kohën e duhur dhe në gjendje të mirë, atje ku janë caktuar. Unë mendoj se Ministria duhet të shikojë fondin e mekanizmave në ndërmarrjet bujqësore, pse këto atje janë me shumicë, shpërdorohen, janë dhënë pa kritere të drejta, ose me kritere politike të shtrembra, pse janë ndërmarrje shtctërore dhe duhet të kenë mjete mekanike më shumë. Rezultatet e këtyre botëkuptimeve s'janë të mira, ndërmarrjet bujqësore, në përgjithësi, qëndrojnë pas kooperativave. Deri dje punonjësit e bujqësisë punonin me norma dhe paguheshin sipas tyre, pa e realizonin ose jo prodhimin, atyre aq u bënte, rrogën e merrnin njësoj, edhe kur prodhimi nuk realizohej.

Ministria e Bujqësisë duhet të llogaritë për këto punime bazë forcën e madhe të vullnetarëve të qytetit dhe jo ta përdorë keq këtë edhe për punë të vogla. Vullnetarët e rinj kanë bërë vepra kolosale të pavdekshme në historinë e vendit, edhe puna e tyre në bujqësi duhet të duket dhe të organizohet ashtu si në ndërtim, në hekurudha etj., etj.

Prandaj shoqja ministre, Themije Thomai, dhe shokët e saj në ministri dhe në bazë, të ndihmojnë fuqimisht njerëzit atje. Organizatat e Partisë, kuadrot dhe

komunistët e sektorit të bujqësisë, jo vetëm duhet t'i kuptojnë këto probleme, por edhe të qëndrojnë në ballë të punëve për zgjidhjen e tyre.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

ORIENTIMET E BYROSE POLITIKE PËR PËRMIRËSIMIN E PËRBËRJES SË FORUMEVE TË KUPTOHEN TIIELLË, JO NË MËNYRË MEKANIKE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

16 shtator 1976

Nexhmija [Hoxha] kishte shkuar në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit. Kur u kthye në mbrëmje, e pycta si shkoi kjo mbledhje dhe filloi të më jepte përshtypjet e saj. Ndër çështjet që më informoi, njëra ka të bëjë me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të udhëzimeve që janë dërguar nga Komiteti Qendror, në lidhje me përqindjet e me tregues të tjerë të përbërjes së forumeve të komiteteve të Partisë të rretheve.

Sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Durrësit i kishte thënë Nexhmijes se gjenden në vështirësi lidhur me përbërjen e forumeve të Partisë në rreth, sepse, sipas udhëzimeve nga lart, duhet të bëhen shumë ndryshime që udhëheqja e Partisë në rreth, në një për-

qindje të lartë, të përbëhet nga elementë me origjinë dhe gjendje punëtore. Për të qenë në rregull me këto orientime, sipas shokëve të Durrësit, duhet të ndryshohet gati 50 pür qind e udhëheqjes së Partisë në rreth.

Të them të drejtën, ky informacion më bëri që të diskutojmë si janë kuptuar e si po zbatohen orientimet e Byrosë Politike për përbërjen e komiteteve të Partisë të rretheve.

Ju e dini se pikëpamja ime pür përqindjen, nuk ka qenë që të ecet në mënyrë mekanike dhe insistoj që kriteret e përaktuara pér përbërjen e forumeve të Partisë t'i mbajmë mirë parasysh. Udhëzimet e Komitetit Qendror janë të drejta, prandaj duhen kuptuar e zbatuar drejt. E them këtë sepse, siç del, në praktikë ka edhe ndonjë paqartësi.

Eshtë e njojur që njerëzit në Parti, sipas origjinës apo gjendjes shoqërore, kategorizohen në punëtorë, kooperativistë, nëpunës etj. Tash çështja shtrohet që Partia të punojë pér të ardhur në udhëheqje, në përpjeshëtime më të mëdha, elementë të klasüs punëtore, natyrisht pa neglizhuar kategoritë e tjera. Këta punëtorë, me origjinë ose me gjendje, që vijnë në udhëheqje, në byro e në komitete, Partia i ka nga njerëzit më të mirë. Atëherë, përderisa janë të tillë, ata nuk duhet të qëndrojnë tornitorë të thjeshtë. Një komunist i kësaj kategorie merr kuptimin e udhëheqësit dhe, duke qenë në prodhim, të luajë rolin e drejtuesit kudo që është. Këtë e kërkon interes i Partisë.

Mirëpo ç'ndodh? Ndodh që sa bëhet drejtues një punëtor, disa e futin këtë në kategorinë e nëpunësit.

Këtu qëndron gabimi, sepse punëtori konsiderohet vetëm nëpunës dhe kështu nxirren përqindjet. Po të kuptohet e të veprohet në këtë mënyrë, ne duhet të themi që edhe në Byronë Politike nuk kemi asnje punëtor, pse të gjithë janë «nëpunës», njerëz të inteligjencies, prandaj duke e gjykuar çështjen në këtë prizëm të gabuar duhet ta përtërijmë Byronë Politike! Po të vlerësohet çështja kështu, u dashka vepruar edhe përpërtëritjen e Komitetit Qendror, mbasi shumica e anëtarëve të Plenumit të KQ që janë në detyra me përgjegjësi, figurojnë «nëpunës», pavarësisht se ka nga ata me prejardhje punëtore dhe vetëm një pakicë është në prodhim. Do të ecim ne në këtë rrugë? Në asnje mënyrë, shokë.

Një punëtor, kur e sjellim në udhëheqje, vërtet bëhet nëpunës, por ai kudo që vete e ruan fryshtën e klasës. Ti, për shembull, shoku Hekuran¹, ke qenë punëtor dhe tash në dokumente figuron nëpunës, sepse je sekretar i Komitetit Qendror, por fakti është se ti ke fryshtën e punëtorit, prandaj Partia të ka sjellë këtu, në Byronë Politike, që ta ruash këtë fryshtë. Pavarësisht nga kjo, me origjinë ose prejardhje ti nuk e humbet atë cilësi që e ke pasur dhe e ke, ja punëtor. Por, në qoftë se kapemi formalisht nga përqindjet, atçherë ty duhet të të thonë: ik këtej, se do të sjellim në vendin tënd këtu, në Byronë Politike, një tornitor. Po mund të sjellim ne vetëm për hir të kësaj një tornitor në Byronë

1. Shoku Hekuran Isai.

Politike? Në asnje mënyrë! Kështu duhet gjykuar çështja edhe për komitetet e Partisë.

Dy vjet më parë, në një komitet partie janë sjeillë, ta zëmë, 10 veta me origjinë ose me gjendje punëtore dhe tani ata janë bërë me gjendje nëpunës. Atëherë duhet të lëvizen këta, se nuk na del përqindja, duke u marrë vetëm gjendja «punëtor»? Ç'rëndësi ka kjo gjendje kur, në fakt, janë marrë masa dhe është përmirësuar përbërja e udhëheqjes së Partisë në rreth?

Orientimet, fjala vjen, kërkojnë që 25 për qind e plenumit të komitetit të Partisë të rrëthit të jetë me punëtorë në prodhim. Brenda katër vjetëve të fundit një pjesë nga këta mund të janë ngritur e të janë bërë udhëheqës të mirë, atëherë ka arsyet largohen, të lëvizen nga komiteti sepse përqindja na del e lartë me gjendje nëpunës? Po të nisemi e të gjykojmë thjesht nga kartelat, kështu del, por të mos harrojmë se këta janë njerëz të ardhur nga radhët e klasës punëtore. Në qoftë se midis këtyre ndonjëri ka të meta, ka degjeneruar, ose nuk punon mirë etj., atëherë ai hiqet dhe në këtë rast zëvendësohet me një element tjetër punëtor nga prodhimi. Kështu përmirësohet më tej edhe përbërja. Megjithatë, mund të ndodhë që edhe me këtë përmirësim të mos arrihet në atë përqindje që parashikohet në orientimet, sepse shumica e plenumit të mbetet prapë me gjendje nëpunës. Sidoqoftë, kur udhëheqja është me një të tillë përbërje, jemi të bindur që ajo është e shëndoshë. Po të kuptohej ndryshe kjo çështje, mendoj se do të ishte gabim.

Të jetë plotësisht e qartë, se për hir të shifrave

nuk mund të luhet me orientimet e Partisë, ndryshe nuk kuptohet në thelb çështja e përmirësimit të përbërjes së organeve të udhëheqjes së Partisë. Ne nuk jemi për atë që të futen në udhëheqje punëtorë për punëtorë, të sillen aty njerëz që nuk vlejnë! Kur nuk ka mundësi të sillet një punëtor me të vërtetë i atij niveli që kërkohet të jetë në udhëheqje, atëherë më mirë të sillet në vend të tij një intelektual revolucionar, besnik i Partisë, që lufton me vendosmëri e konsekuençë për zbatimin e mbrojtjen e vijës së saj. Pra, të shkohet nga parimi për të futur punëtorë për punëtorë, është e gabuar.

Një anëtar plenumi mund të jetë edhe intelektual, por kur është me të vërtetë bolshevik, kur lufton mirë për zbatimin dhe mbrojtjen e vijës, përsë të hiqet nga plenumi? Në rast se një shok e meriton të jetë anëtar i plenumit ose i byrosë së komitetit të Partisë të një rrjeti, ai nuk mund të hiqet pse aktualisht është në-punës. Një gjë e tillë nuk është në interesin e Partisë. Neve as që na ka shkuar ndër mend ndonjëherë që të heqim nga udhëheqjet shokë, pse janë me origjinë ose me prejardhje intelektuale kur ata janë të aftë dhe luttëtarë të paepur të çështjes së Partisë, përkundrazi, komunistë të tillë mbahen në udhëheqje. Ata që tregohen aktivë e besnikë nuk mund të futen në atë kategori që mund të diskutohet të hiqen apo të mos hiqen, paravësisht se është punëtor, intelektual apo fshatar. Në këtë kategori do të hyjnë ata që, pasi bëhet bilanci i punës, jepet illogari, bëhet kritikë dhe autokritikë dhe shihet se kanë mjaft të meta e dobësi, në këto raste

propozohet që këta të mos jenë më në udhëheqje. Pas këtij bilanci, për zgjedhjen e atyre që do t'i zëvendësojnë duhet të bazohemi në orientimet e Byrosë Politeke, duke kërkuar që një përqindje e madhe e tyre të jenë me origjinë, gjendje dhe prejardhje punëtore, të tjerët kooperativistë dhe intelektualë. Në qoftë se në udhëheqje kemi mjaft intelektualë, mund ta zbresim më tej përqindjen e tyre për të sjellë në udhëheqje kooperativistë.

Do të sillen në udhëheqje punëtorë që i kanë cilësitë e kërkuara. Një punëtor revolucionar, me perspektivë, pavarësisht se nuk ka shumë dituri, Partia mund ta zgjedhë në udhëheqje edhe me shkollë 8-vjetare. Natyrisht edhe çështja e shkollës duhet parë, se në udhëheqje duhet të vijnë njerëz edhe me horizont të gjerë, po kjo nuk duhet të merret strikt dhe shabllon. Sjellja në udhëheqje varet jo vetëm nga shkolla, po edhe nga pjekuria dhe eksperienca individuale e secilit. Në rast se një punëtor komunist ka vetëm 8 vjet shkollë, po në punë të çan, ka aftësi drejtuese, mund ta lëmë jashtë udhëheqjes për të sjellë në vend të tij një punëtor komunist të zakonshëm, të padalluar, vetëm për faktin se ky i fundit ka shkollë? Të veprosh kështu, do të thotë t'i zbatosh orientimet e Partisë në mënyrë shabllone.

Te ne ecet në bazë të parimit që kudo udhëheq Partia. Kjo udhëheqje realizohet me njerëzit më të mirë të Partisë. Këta njerëz më të mirë vijnë, në radhë të parë, nga klasa punëtore. Një shok komunist punëtor të zotin mund ta vësh në një vend që të drejtojë,

ta zëmë, gjithë uzinën, sepse si komunist ai është udhëheqës masash, njeri i pararojës dhe revolucionar. Duke pasur këto cilësi, atë Partia e bën edhe drejtor të uzinës. Por, duke qëndruar në drejtim për disa vjet, i humbi vallë ky cilësitë si punëtor i pararojës? Logjikisht e në realitet jo. Të mos tërhiqemi nga rastet e veçanta kur dhe një ish-punëtor degjeron, bëhet arrogant, mendjemadh etj. Atëherë, si duhet të kuptohet çështja e përbërjes, që këtë komunist ta shohim thjesht si nëpunës dhe si të tillë të mos e zgjedhim se nuk realizohet përqindja e punëtorëve në plenum? Jo, po të veprohet kështu, do të thotë se orientimet janë kuptuar gabim.

Mua më duket se kështu duhet ta kuptojnë këtë çështje shokët e rretheve dhe jo ta marrin kallëp përqindjen lidhur me përbërjen, duke hequr nga forumet edhe shokë që punojnë dhe luftojnë mirë në udhëheqje. Mundet dhe duhet të hiqen vetëm ata që s'punojnë mirë, pavarësisht nga origjina, prejardhja apo gjendja shoqërore që kanë. Pikërisht në vendet që mbeten bosh nga një seleksionim duhet të përtérihet udhëheqja.

Gjithashtu duhet pasur parasysh që të mos hiqen nga udhëheqja shokë që janë të mirë si komunistë, të aftë si kuadro dhe punojnë shumë mirë, vetëm se do të sillet në vendin e tyre në udhëheqje një grua për hir të rregullimit të përqindjes që ka orientuar Partia. Një praktikë e tillë, mendoj unë, nuk është në rrugën e drejtë të Partisë.

Edhe një çështje tjeter duhet pasur parasysh. Fundi i fundit një kuadër që ka në udhëheqje shumë kohë

dhe pavarësishët se nuk ka gabuar kurrë, vjen momenti që nga ana fizike, nga pikëpamja e energjive, nuk është më në gjendje të vazhdojë të punojë si zakonisht, atëherë po, e heqim dhe ia themi arsyet, por ama jo për arsyet e origjinës.

Në çështjen e zbatimit të orientimeve të Byrosë Politike për përbërjen e forumeve të komiteteve të Partisë të rretheve, ka dy momente që kanë rëndësi të theksohen dhe të kuptohen mirë. Në përbërjen e plenumit, së pari, duhet të ketë më shumë me origjinë, prejardhje dhe gjendje punëtor, por duke ruajtur disa përpjesëtime. Së dyti, nga udhëheqja të mos përjashtohet asnjë njeri, i çdo origjine qoftë, në rast se e ka kryer dhe vazhdon ta kryejë detyrën në mënyrë shembullore.

Natyrisht, të gjithë anëtarët e Partisë nuk janë të prerë si me thikë, por presupozohet që të tërë të jenë bolshevikë. Origjina ka rëndësi, por ka komunistë me origjinë ose prejardhje fshatare ose intelektuale që mund të punojnë më mirë nga një që është punëtor. Nuk është një minus për Partinë kur ky komunist, pavarësishët nga përbërja, punon mirë. Por, në qoftë se ai bën gabime, atëherë Partia shikon edhe origjinën që ka. Ky mund të jetë me origjinë punëtor, pra me origjinë shumë të mirë, megjithatë degjeneroi. Po pse degjeneroi? Ka shumë arsyet këtu, po fakt është se degjenerimi ndodh më pak tek elementët e klasës punëtore. Një mundësi e tillë te këta është më e vogël sesa te borgjezi i vogël apo tek intelektuali. Këtë duhet ta kuptojmë drejt.

Edhe në ushtri, për shembull, të gjithë kuadrot e

drejtuesit janë me gjendje «nëpunës», por, duke u nisur nga kjo, të thuhet që ushtria jonë, arma e diktaturës së proletariatit, është në duart e nëpunësve, të jo-proletarëve, kjo nuk do të ishte as e vërtetë, as e drejtë të cilësohej kështu.

Për inteligjencien ne përdorim termin inteligjencia popullore. Ka midis tyre që kanë origjinë intelektuali, siç ka më shumë me origjinë punëtore apo kooperativisti. Mund të bëjnë gabime edhe njëri edhe tjetri. Por ai me origjinë punëtore mund të bëjë më pak, se është rritur në një varfëri më të madhe, ndërsa ai me origjinë intelektuali mund të gabojë më shpejt dhe më lehtë. Kështu qëndron kjo çështje, po ne nuk mund të themi për djalin e një punëtori, që shërben në ushtri, se nuk i përgjigjet origjinës ngaqë cilësohet me gjendje «nëpunës». Kështu, për nëpunësit, për inteligjencien duhet pasur parasysh se çfarë nëpunësish janë, se mos janë vetëm në kartela, sa për t'iu referuar gjendjes, ndërsa nga origjina osc nga prejardhja janë punëtorë apo koooperativistë. Prandaj mua më duket që kjo çështje ka nevojë të sqarohet mirë me shokët e rretheve që të mos bëhen gabime e të dëmtohet Partia.

Partia ka parime, ajo lufton që vazhdimisht të vijë gjak i ri në udhëheqje, po kjo jo të jetë formale. Ardhja e elementit të ri duhet të ndihmojë për forcimin e Partisë. Këto Partia, udhëheqja, Komiteti Qendror, Byroja Politike i ka parashikuar, ato janë të qarta, prandaj nuk ka arsyë që disa shokë të kenë paqartësi dhe ndodh që i zbatojnë në mënyrë shabllone orientimet e Byrosë Politike.

Një shkak mund të jetë kuptimi jo i drejtë i këtyre orientimeve nga disa punonjës të aparatit të Komitetit Qendror, të cilët kur shkojnë në bazë, bëjnë presion që përqindjet orientuese të treguesve të përbërjes së forumeve të zbatohen me çdo kusht. Ndërsa te shokët e bazës shfaqet edhe tendenca të mos bëjnë ndryshime në forume, të mos largojnë njeri prej tyre edhe kur këta gabojnë, sepse kanë familjaritet me njëri-tjetrin dhe e argumentojnë këtë duke thënë për ta se janë njërej të mirë. Pra, nga punonjësit e aparatit ndodh që shkohet nga e majta, vihen përpara përqindjet, kurse në rrethe ka raste që shkohet nga e djathta. Këto, shokë, janë karakteristika të sëmura dhe shumë të rrezikshme.

Duhet shpjeguar se është e domosdoshme ta kuptojnë mirë shokët e rretheve, të bëhen të qartë ata përsë ndahen komunistët sipas gjicës shoqërore në punëtorë, kooperativistë, nëpunës e të tjerë, dhe çfarë përfaqësojnë në realitet këto kategori. Një komunist që ka punuar për 15 apo 20 vjet punëtor, nuk i shlyhet qenia punëtor në rast se vjen koha dhe bëhet nëpunës, drejton, ta zëmë, një uzinë. Ai në këtë rast me gjendjen e re bëhet vërtet «nëpunës», por me prejardhje dhe nga mentalitetet mbetur punëtor, pse ka njojur vuajtjet, ka djersitur, ka provuar erën dhe shiu në kurri. Por në qoftë se elementët punëtorë që ngrihen në udhëheqje nuk janë akoma në atë numër që parashikon orientimi, të bëhet kujdes që të mos ketë sforcime përzbatimin drejt të orientimeve.

Në bazë të mësimave të Leninit dhe të Stalinit, lidhur me sa fola më lart, në drejtim të punëve shtetë-

rore duhet të ketë sa më shumë njerëz të paorganizuar në Parti, kurse në udhëheqjen e Partisë duhet të jenë medoemos të gjithë anëtarë partie dhe bile më të mirët. Parimi në këto udhëheqje është që në shumicë të jenë shokë me prejardhje dhe me origjinë nga klasa punëtore. Në fakt, në një masë të mirë ne e kemi arritur një gjë të tillë dhe tani udhëheqin gjithë këta shokë komunistë, të cilët janë kthyer edhe në funksionarë.

Partia ka nënvizuar kurdoherë që një komunist, i cili është punëtor, që zgjidhet në plenum, duhet të mbajë parasysh se është udhëheqës, pavarësisht se punon në prodhim. Duke qenë anëtar i plenumit të komitetit të Partisë të rrëthit, ai s'duhet të kufizohet duke punuar vçtëm në torno, fjala vjen, por të ketë sytë në gjithë repartin apo fabrikën, ku punon. Pra, detyra e tij është të punojë mirë personalisht, njëkohësisht të jetë kudo në tërë fabrikën. Me një fjalë të punojë si udhëheqës, sepse do të ishte shumë luks që një njeri kaq të zotin Partia ta lërë vetëm në kuadrin e një tornoje, punë të cilën mund ta bëjë fare mirë edhe një tornitor që nuk është anëtar partie. Këtë anëtar plenumi Partia e përgatit dhe pas një kohe mund ta çojë, fjala vjen, komandant brigade, ose kryetar kooperative, ku të shpjerë fryshtë e klasës dhe aftësinë e udhëheqjes. Të gjitha këto janë të thëna me kohë dhe drejt nga Partia, prandaj shokët që merren me çështjet organizative të Partisë duhet t'i kuptojnë mirë në gjerësinë dhe në thellësinë e teorisë marksiste-leniniste dhe të praktikës sonë revolucionare.

Orientimet që janë dhënë nga Byroja Politike për përmirësimin e përbërjes së udhëheqjeve të Partisë në qendër e në rrethe janë shumë të drejta, vetëm se duhet të kuptohen thellë. Kjo përgjithësisht është e qartë, por, siç shihet, duhet bërë akoma edhe më e qartë, sepse në disa raste ndodhin edhe gabime dhe na krijuhen situata të vështira, na dëmtohet puna e Partisë.

Tani dëshiroj të flas pak për problemet e Kongresit.

Ne duhet të kemi parasysh eksperiencën e Kongresit të mëparshëm, të rifreskojmë se çfarë masash kemi marrë dhe se si e kemi organizuar zbërtimin e detyrave që dilnin nga raportet në të gjitha fushat e aktivitetit të Partisë: politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake, organizative, kulturore etj., etj. Mendoj se, të paktën, nga aparati i Komitetit Qendror dhe nga ai i Qeverisë duhet të bëhet një analizë e hollësishme përkëto probleme. Pastaj, mbi këtë eksperiencë të përgatitim planin e detyrave të mëdha që do të na vëré përrapa Kongresi. Këto detyra vendimtare duhet të janë të qarta dhe të plota, se mbi bazën e tyre do të bëhet i gjithë zbërtimi deri në qelizat bazë të jetës së vendit. Me këtë dua të them që përgatitja e Kongresit të mos mbetet në llafe e në diskure propagandistike, pse ka rrrezik që tendenca e atyre që do të venë në rrethe të anojë nga frazeologjia rrëth raporteve dhe nga citatomia.

Përgatitjet përkëto punë, natyrisht, duhet të bazuhen në raportet e Kongresit e në diskutimet që do të bëhen. Por, këto përgatitje duhet të lidhen gjithmonë, konkretisht, me realizimin e planeve në të gjitha fu-

shat, nga të gjitha instancat dhe në mënyrë plotësisht të koordinuar.

Të marrim, fjala vjen, detyrat e bujqësisë. Për këto, natyrisht do të ketë orientime. Por, këto duhet të zbirthchen deri në fund dhe jo vetëm për rrethin, për kooperativën apo për sektorin, po të shkohet deri te çdo brigadë e kooperativist. Duke shtruar detyrat, të argumentohet përsë duhet të realizohen medoemos këto dhe të tregohen dhe rrugët që duhen ndjekur. Fjala vjen, që të arrihet objektivi i caktuar, do të merren medoemos këto rendimente në drithëra, qumësht, do të bëhet ky bllok i ri me pemë etj., etj. Dhe që të merren këto rendimente është e domosdoshme të shtrohen detyra konkrete se ç'duhet të bëjmë dhe kur duhet t'i bëjmë, ç'masa politike, ideologjike, organizative etj. duhet të merren e kështu me radhë.

Kjo nuk është çështje e një dite. Mendoj se ka rëndësi që të prekupohemi për ta filluar sa më mirë punën. Prandaj të përgatitemi si duhet e t'i detajojmë detyrat e vendimet dhe pastaj, me Partinë në krye, të mobilizohemi për realizimin e tyre në të katër anët e Shqipërisë, duke vënë në lëvizje të gjitha organet shtëtërore, kuadrot e masat punonjëse. Se si do ta bëjmë këtë punë, duhet të mendohemi. Materialet e Kongresit ne do t'u ja përmes gjithë komunistëve dhe punonjësve, të cilët do t'i lexojnë, do t'i studiojnë e do t'i komentojnë herë pas here dhe sipas rastit, do t'u referohen kur të kenë nevojë. Por, studimi, leximi e referimi duhet të kenë parasysh disa pika kardinale. Dikujt, për shembull, për fabrikën që drejton, në bazë

të orientimeve të Kongresit, i del detyrë që të vendosë një disiplinë të fortë proletare në punë dhe të prodhojë kaq për qind të veglave të ndërrimit. Për këtë atij i duhet, fjala vjen, të ketë, medoemos, norma teknike e të shfrytëzojç çelikun në masën jo më pak se 80 për qind. Tjetrit i duhet të ngrëjë cilësinë e këpucëve e kështu me radhë për të gjithë. Këto detyra duhet të mbahen parasysh vazhdimisht në jetën e çdo punëtori, të çdo brigadieri, të çdo drejtuesi, të çdo celule e të çdo komiteti dhe për secilën prej tyre të kërkohet llogari e të ushtrohet kontroll. Kjo të bëhet edukatë përkëdo. Me këto të lidhet gjithë puna e Partisë. Prandaj, detyrë e madhe pas Kongresit na del që të mendojmë se si ta fillojmë sa më mirë këtë punë, si ta zhvillojmë e ta kontrollojmë sistematikisht zbatimin e direktiveve të Partisë. Çështja është të mos na mbeten vendime përgjysmë, pa u realizuar.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ashtu është, siç thoni ju, shoku Enver. Duhet filluar qysh tani nga kjo punë.

SHOKU HYSNI KAPO: Kjo që na thoni ju, ka shumë rëndësi. Programi i punës duhet të bëhet duke filluar që këtu, në Komitetin Qendror, dhe deri në bazë. Ne do ta rishikojmë këtë punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet rishikuar jo vetëm nga ana e Partisë, por edhe nga ana shtetërore, sepse Partia udhëheq dhe punon. Por edhe pushteti drejton e punon; janë anëtarët e Partisë që punojnë e drejtojnë edhe atje. Kjo metodë studimi e zbërthimi i materialeve të Kongresit, që të shërbecjë për zbatimin e tyre, duhet të futet në të gjitha format e edukimit,

të punës dhe të kontrollit. Dikush mund të thotë që «në këtë drejtim hodhëm një hap përpara». Por rëndësi ka edhe se si e hodhën atë hap? E hodhën apo nuk e hodhën në bazë të direktivës së Kongresit? Ne duhet t'i edukojmë masat, komunistë dhe të paorganizuar në Parti, politikisht dhe ideologjikisht, duke u bazuar në raportet e Kongresit, ku pasqyrohet tërë vija e Partisë. Fjala vjen, del problemi përsë duhet ta kursejmë ne çelikun? Kjo nuk është vetëm një detyrë teknike, shtetërore. Jo, ajo ka brenda çështje politike të mëdha. Ose të marrim problemin e shfrytëzimit të materialeve apo atë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës së uzinave me njëra-tjetrën. Këto, gjithashtu, nuk janë vetëm detyra tekniko-organizative, por edhe problem politik e ideologjik, një çështje me rëndësi të madhe ekonomike që ka të bëjë me mbrojtjen e atdheut e me shfrytëzimin e të gjitha mundësive që ka vendi etj. Në qoftë se duam të bëjmë një përgatitje në të gjitha këto fusha, ekonomike, politike e ideologjike, atëherë duhet që të gjitha veprimtaritë tona t'i përqendrojmë në detyrat që na caktoi Kongresi.

Kjo përgatitje, më duket mua, duhet të bëhet nga Partia dhe nga pushteti, njëkohësisht. Këto punë, natyrisht kryhen duke i koordinuar me njëra-tjetrën. Fjala vjen, ministri i Industrisë ka për detyrë të drejtës industriën, por ai është në të njëjtën kohë edhe anëtar i Byrosë Politike dhe, si i tillë, duhet të vërë në lëvizje jo vetëm aparatin e komitetit të Partisë të rrëthit apo aparatin e Komitetit Qendror, por edhe gjithë organizatat e Partisë, në të gjitha ndërmarrjet e

industrisë e të minierave. Pra, ai, me punën e vet drejtuese, partie dhe shtetërore, duhet të shikojë, të kontrollojë dhe të japë ndihmë në të dyja anët, në mënyrë që vendimet e Kongresit të zbatohen kudo njëloj. Dhe, që të zbatohen këto vendime, duhet jo vetëm të organizohet puna mirë, por të ushtrohet edhe kontroll për realizimin e tyre. Kontroll të ushtrojë Partia e vëtë Komiteti Qendror, por kontroll të ushtrojë edhe Qeveria, shtabi i ministrisë e komiteti i Partisë i rrethit.

Këtu, më duket mua, duhet t'i gërshtetojmë mirë detyrat dhe të mos biem në shablonizëm. Për realizimin e planeve dhe të detyrave punohet vazhdimisht nga ana shtetërore, por punohet edhe nga ana e Partisë. Në të dy drejtimet, së bashku, do të punohet edhe për detyrat e reja që do të shtrojë Kongresi. Edhe puna ideologjike e Partisë i shërbën kryerjes së punëve shtetërore, por edhe kryerja e detyrave shtetërore i shërbën forcimit dhe edukimit komunist të Partisë dhe të masave punonjëse. Kur komunisti në një ndërmarrje nuk realizon detyrat e ngarkuara, do të thotë se nuk e ka kuptuar drejt vijën e Partisë. Pra, ka disiplinë shtetërore e teknike, nga njëra anë, por edhe ideologji e politikë, nga ana tjeter. Këto detyra janë të tëra të gërshetuara. E them këtë se kemi konstatuar që ndonjëherë njëri i bie gozhdës e tjetri potkoit. Sot Qeveria nxjerr një urdhëresë se duhet të bëhet një punë e rëndësishme e ditës, kurse tjetri bën mbledhjen e organizatës-bazë për një çështje që e ka vënë në plan para tetë muajve. Nuk duhet të bëhen kështu

këto gjëra, po të ketë gërshetim dhe bashkërendim të drejtë të detyrave.

Edhe në punën tonë kështu duhet vepruar. Për shembull, këtu, në aparatin e Komitetit Qendror puna duhet të organizohet në mënyrë të tillë që jo vetëm të marrim informata nga ministrat apo zëvendësministrat, por të vemi edhe vetë të shohim bazën, të ndjekim se si punon ky ose ai ministër në prodhim, ky apo ai drejtor në ndërmarrje; të informohemi se ç'hotë Partia në bazë për drejtuesit e qendrës. Pastaj të dalim me konkluzione e të vëmë në dijeni shokët përkatës për ato që konstatuam.

Këto punë duan edhe dinamizom, duan edhe një vështrim më në gjerësi e më në thellësi të problemeve mendoj unë. Të gjithëve na duhet të thellohem, se këto qenë vetëm disa mendime paraprake. Aktualisht ne jemi në valën e punëve për Kongresin, po edhe me këto probleme duhet të merremi. Mendja duhet të na punojë edhe për ato që do të bëjmë më vonë.

Tani ne po vemi në konferanca, ku duhet të kemi parasysh mjaft gjëra. Duke i dëgjuar shokët që do të diskutojnë atje, do të shohim se si i kanë kuptuar ata detyrat që duhen realizuar. Nëpërmjet diskutimeve ne do të shohim mendimin, gjithashtu, dhe efektin e punës edukuese e orientuese të Partisë. Çdo diskutim, në përgjithësi, ka ndonjë gjë pozitive. Por mundet që në diskutimin e ndonjë shoku të ketë shumë fraza apo mendime sempliste. Megjithatë, edhe nga ky diskutim mund të dalë ndonjë mendim racional apo problem

shqetësues që ne duhet ta kapim dhe të mos e lëmë të na kalojë.

Sigurisht, ju do të keni dhe shokë nga aparati që do t'ju shoqërojnë nëpër konferencat ku do të shkoni. Këta nuk do të bëjnë keq që më tepër të dëgjojnë e të mbajnë shënime, për të parë se si shtrohen problemet nga ana e diskutantëve dhe të mos mjaftohen vëtëm duke thënë në përgjithësi që ky ose ai diskutoi mirë, i shtroi problemet si duhet etj. Vërtet që dikush mund t'i shtrojë problemet mirë, por vallë a tha ndonjë gjë të re? Kjo na intereson neve, që të marrim sa më shumë gjëra pozitive nga baza.

*Botuar për herë të parë,
me shkurttime, në librin:
Enver Hoxha, «Për Partinë»*

(Përbledhje veprash),

vëll. 3, f. 287

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga biseda e inci-
zuar, që gjendet në AQP*

FJALËT E PËRGJITHSHME NUK E NDREQIN PUNËN E DOBËT

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

21 shtator 1976

Shoku Enver Hoxha kërkoi të informohej nga shokët sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë se si po shkonin punët për përgatitjet e konferencave të Partisë në rrëthet ku ata ishin të deleguar. Në fillim foli shoku Haki Toska për punimet e mbledhjes së byrosë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit, duke theksuar, ndër të tjera, se «në byro u kritikua edhe fakti që mëren shumë probleme në shqyrtim». Pastaj e mori fjalën

SHOKU ENVER HOXHA: Përse duhet të merret vendim për gjithçka në byronë e komitetit të Partisë të rrëthit dhe të mos zgjidhet çështja nga vetë sekretari në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror të Partisë dhe të vendimeve të byrosë së Partisë të rrëthit? Pse sekretari i komitetit të Partisë të mos i thërrësë instruktorët e sektorit të vet e të këshillohet me ta dhe pastaj t'i udhëzojë se si të bëhet kjo ose ajo punë?

Në qoftë se shokët sekretarë të komitetit të Partisë të rrëthit, për gjithçka, duan të pyesin byronë, që kjo t'u japë receta, atëherë duhet të dalim me konkluzionin se ata nuk e kryejnë mirë detyrën, se bëjnë një punë pa iniciativë, një punë rutinë. Ta kërkosh zgjidhjen e çdo problemi nga byroja, «për të siguruar mendime kolegjiale» dhe kjo të detyrohet të marrë vendime pas vendimesh për ato probleme konkrete për të cilat janë dhënë orientime të qarta, do të thotë se punonjësit e aparatit të komitetit të Partisë nuk janë në gjendje t'i zbërthejnë vetë këto orientime. Shokët sekretarë nuk duhet të presin gjithçka nga byroja, por t'i zbërthejnë vetë vendimet e orientimet dhe, në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të byrosë, që janë ngarkuar me ndjekjen e problemeve, sipas ndarjes së punës, të propozojnë dhe masa konkrete. Për të gjitha këto, sekretari raporton në mbledhjen e byrosë, ku shfaqin mendime e bëjnë vlerësime edhe shokët e tjerë, se si është zgjidhur ky ose ai problem nga sekretari.

Ky vlerësim pune bëhet edhe për sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrëthit, por duhet thënë se sekretari i parë nuk mund t'ia japë secilit detyrat «llokum në gojë». Në qoftë se ai, ta zëmë, nuk aktivizon në punë ndonjë anëtar të byrosë, po ky vetë, çfarë ka bërë për t'u aktivizuar? E di apo nuk e di ai detyrën që i është ngarkuar si anëtar i byrosë? Kjo çështje ka rëndësi të madhe. Në qoftë se sekretari i parë i komitetit të Partisë i ndalon shokët që të veprojnë me iniciativë, në qoftë se ai monopolizon pu-

nën e të tjerëve, atëherë kjo mund të kritikohet. Që sekretari i parë duhet t'i ndihmojë shokët e byrosë e të plenumit, kjo është absolutisht e nevojshme, por, të kritikohet ai se nuk aktivizon të tjerët, kjo duhet parë konkretisht se sa qëndron!

Anëtari i byrosë së komitetit të Partisë të rrethit ka kompetenca dhe detyra, që burojnë nga vetë funksioni i tij si i zgjedhur në këtë forum. Detyrat që i takojnë ai jo vetëm që i kryen vëçë, me iniciativën e tij, por as nuk duhet të pranojë kurrë që të tjerët t'i marrin ato funksione, të cilat i përkasin atij.

Për kritikat dhe autokritikat që bëhen të jemi të vëmendshëm e t'i vlerësojmë drejt. Diskutimet t'i orientojmë ashtu siç e kërkojnë interesat e punës së Partisë e jo të biem në rutinë.

Dëshiroj të di edhe një gjë, shoku Haki: Ata diskutuan secili për sektorin e punës së tij, apo folën si anëtarë të byrosë?

SHOKU HAKI TOSKA: Disa prej tyre diskutuan si anëtarë të byrosë.

SHOKU ENVER HOXHA: Më konkretisht dua të di se si i ngritën ata problemet. Kur diskutuan folën vetëm rreth qendrës së tyre të punës apo edhe për probleme në shkallë rrethi? Ky problem ekziston në një shkallë të gjerë.

SHOKU HAKI TOSKA: Kryetari i kooperativës bujqësore të Kozarës, që është anëtar i byrosë, nuk diskutoi vetëm për problemet e kooperativës që drejtton, por ngriti probleme edhe për ndërmarrjen e prodhimit të naftës.

Ose, një shofer, që është kandidat i byrosë së komitetit të Partisë të rrëthit, foli jo vetëm për punën e ndërmarrjes së tij të transportit, por edhe për punën e komitetit të Partisë e të aparatit të tij, për probleme të kooperativave malore e të tjera. Kështu mund të them se ata kanë dalë pak a shumë nga guaska e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: I bëri ky shok ndonjë kritikë Ministrisë së Komunikacioneve?

SHOKU HAKI TOSKA: Kritikë i bëri jo vetëm Ministrisë së Komunikacioneve, por edhe asaj të Industrisë e të Minierave, lidhur me ndërtimin e stacionit për transportimin e naftës që është zvarritur.

SHOKU ENVER HOXHA: Si e kishin kuptuar dhe zbatuar ata direktivën e Komitetit Qendror që qendra e gravitetit për shqyrtimin e problemeve më të rëndësishme të Partisë në rrëth të zhvendoset nga byroja në plenum? A i aktivizojnë apo jo anëtarët e plenumit?

SHOKU HAKI TOSKA: Disa nga shokët e plenumit atje u kritikuani se nuk aktivizohen sa duhet. Një pjesë e anëtarëve të plenumit janë aktivizuar edhe në studime.

Për sa u përket zonave kodrinore e malore, ata kanë filluar të marrin një varg masash. Në këto zona janë dërguar edhe kuadro drejtues e komunistë dhe, herë pas here, janë ndërmarrë edhe aksione nga punonjësit e qytetit. Përveç këtyre, në fshat kanë dërguar edhe 400 të rinj.

SHOKU ENVER HOXHA: A janë strahuar këta të rinj që janë dërguar nga qyteti në fshat?

SHOKU HAKI TOSKA: Një pjesë e mirë e tyre i kanë pasur familjet e veta në fshat, ndërsa për të tjerët po ndërtonin banesa të reja. Vajta edhe në Terpan, dhe pashë se, për të rinxjtë nga qyteti që do të shkonin atje, po ndërtonin një godinë të re.

SHOKU ENVER HOXHA: Kryesia mund të interesohet më shumë për njerëzit që do të punojnë për ndërtimin e këtyre banesave, si dhe për materialet e tjera të nevojshme. Ne thamë që të térheqim njerëz nga qyteti e t'i dërgojmë në fshat, por këtyre duhet t'u sigurojmë ndërtesat ku do të strehohen. Kur nuk ka punëtorë për t'i ndërtuar këto banesa, atëherë t'i kërkohen një fshati tjetër, se pallati duhet ngritur shpejt. Kjo mund të bëhet, se përpara fshatari ikte që nga Opari nëpër tërë Shqipërinë, dhe i binte bretku në punë për të fituar krodhën e bukës.

SHOKU HYSNI KAPO: Kurse sot, shokët drejtues të Beratit nuk i dërgokan as brenda rrithit?!

SHOKU ENVER HOXHA: T'i dërgojnë që ç'ke më të! Por, dua të di, nëse punojnë zyrat e punës apo nuk punojnë? Në këtë drejtim, mund të ndihmojë edhe rrathi. Na thonë që duam punëtorë këtu e duam punëtorë atje dhe zyrat e punës nuk lëvizin nga vendi për sistemimin e fuqisë punëtore. A ka vende më të bukura për të punuar e jetuar se në fshatrat tonë? Po të mos sistemojen në punë atje ku ka nevojë atdheu, ku do të venë, bie fjala, të rinj të Tiranës?! Në qoftë se nuk punojnë si duhet organizmat që kemi krijuar për këtë qëllim, kush do t'i zbatojë direktivat e Partisë për sistemimin në punë të të rinjve? Na thonë se nuk po

ndërtohen banesa në fshat! Po pse ndodh ky fenomen, kur ky problem është shtruar? Kur e shtrojnë dhe vendosin diçka Byroja Politike dhe Qeveria, kjo duhet zbatuar pa hezitim dhe deri në fund. Duhen nisur ekipe të tëra ndërtuesish nga qytetet për në fshatra. T'i heqim nga Tirana, nga Saranda, nga Gjirokastra etj. dhe t'i nisim në fshatra sipas një plani të përcaktuar, për të ngritur shtëpi. Ndryshe nuk bëhet. Të merren masa konkrete për të siguruar materialet e nevojshme si tulla, tjegulla, çimento, dru, gozhdë etj. për ndërtimet në fshat. Të sigurohen për këtë dhe fondet monetare.

SHOKU RAMIZ ALIA: Këto punë bëhen shpesh në mënyrë mekanike. Shoku Haki tha që po ndërtohen shtëpi banimi në Terpan, por, po të pyesësh tashti komitetin ekzekutiv të rrethit se sa të rinj ka parashikuar të shkojnë në Terpan, ka mundësi që ai të mos dijë se ç'të thotë, se nuk ka llogaritur asgjë dhe as se sa të rinj do të dërgojë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo ndodh se edhe ata të kooperativës nuk marrin mundimin një herë t'i telefonojnë rrethit e t'i thonë se sa punëtorë u duhen.

Këto punë nuk mund të ecin vetë, pa organizim, pa disiplinë, pa propagandë. Këtu nuk është vetëm problemi i ekonomisë, por duhet parë edhe ana politike e tij. Në qoftë se mbeten të rinj pa sistemuar në punë, mund të marrin edhe rrugë të keqe.

Po Kombinati i Tekstileve a punon mirë?

SHOKU HAKI TOSKA: Mirë punon; në përgjithësi ata e kanë rritur edhe cilësinë.

SHOKU ENVER HOXHA: S'ka disa ditë që lexova

një kritikë në gazetë, ku shkruhej se stofra me çmim 300 lekë metri shiten të konfekcionuara për kalamanët e për të rinjtël Kështu, për këto mosha një kostum kushton rrëth 600 lekë. Si është e mundur, thashë unë, që, për kalamanët dhe për të rinjtë, të bëhen konfekione me stofra që kushtojnë kaq shumë?

Pastaj u diskutua për mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në fermën e Maliqit, në krahasim me kooperativat bujqësore, krahët e punës janë më të paktë. Drejtori i kësaj ndërmarrjeje tha që, në qoftë se për ne prodhimi i sheqerit është problem kombëtar, atëherë le të bëjmë llogari: mos vallë na intereson të shtojmë fuqinë punëtore për panxharin dhe të marrim edhe deri 400 kuintalë për hektar? Rendimenti më i lartë e justifikon edhe shtimin e fuqisë punëtore. Kështu diskutoi ai si specialist, duke dhënë disa mendime të guximshme.

Shoku Jani Miho¹ ia preu menjëherë: «Pse nuk i ngrite këto çështje kur bëmë planin pesëvjeçar?»

SHOKU ENVER HOXHA: Po ja, i ngriti tashti.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ndërhyra edhe unë me këtë rast e i thashë: Duhet kujdes në trajtimin e këtyre çështjeve. Ja, për shembull, të shkonte mendja ty, shoku Jani, që të merreshin 50 kuintalë grurë për hektar në Plasë e gjetkë? Asnjërit nuk na shkonte në mendje një gjë e tillë. Por, tashti që ndodhi kjo gjë, të tërë

1. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës.

kemi të drejtë dhe detyrë që t'i rishikojmë mendimet tona; prandaj, si gjithë të tjera edhe ju, do t'i rishikoni mendimet tuaja. Këtu problemi shtronhet: E ka drejt apo nuk e ka drejt drejtori i ndërmarrjes, këtë të diskutojmë ne, e jo pse nuk e tha më përpara! Nuk e tha atëherë, por po e thotë sot, këtu s'ka asgjë të keqe. Unë mendoj se ideja ishte e drejtë, racionale dhe duhet të gjykohet mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: I duhet shtruar edhe shqes ministre të Bujqësisë kjo çështje, për ta parë me kujdes. Nuk është vetëm Ideja e drejtë ajo që e zgjidh problemin. Ideja duhet zbërthyer mirë dhe, në qoftë se pranohet si e saktë, për realizimin e saj praktik duhet të merren të gjitha masat e nevojshme se çdo punë ka një mori hallkash. Nuk mjafton të thuash se jemi dakord, por edhe të veprosh pa humbur kohë e jo të zvarritësh zgjidhjen e problemit si në kalendat greke.

SHOKU HYSNI KAPO: Në Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës u ngrit problemi se nuk bashkërendohet mirë puna midis rajoneve e rrethit, se byroja e komitetit të Partisë të rrethit nuk i ndihmon sa duhet rajonet për zbërthimin e direktivave. Pastaj u ngrit edhe çështja se dikasteret venë nëpër ndërmarrjet varëse dhe kthehen prapë aty, pa vajtur në komitetin ekzekutiv ose në komitetin e Partisë të rajonit dhe t'i bisedojnë problemet që u dalin. Uzinën «Enver», për shembull, e ka në juridiksionin e vet komiteti i Partisë i rajonit nr. 1, por, kur vete ndonjë ekip nga dikasteri përkatës, konstatimet i shpie në ministri, megjithëse e dinë që kjo uzinë përfshihet në këtë rajon. Këtë punë

e neglizhojnë. Kështu rajoni nuk di gjë fare se çfarë thotë ministri.

SHOKU ENVER HOXHA: E para e punës, kjo gjë ndodh se nga shokë të dikastereve dhe nga drejtues të aparatit shtetëror nënvlerësohet puna e aparatave të Partisë. Në qoftë se uzina «Enver» nuk realizon planin, nuk bën kursime në materiale e të tjera probleme si këto, kjo do të thotë se puna e Partisë atje është e dobët; prandaj, në qoftë se komiteti i Partisë i rajonit, ku përfshihet kjo uzinë, nuk e njeh situatën, kjo tregon se aty bëhet një punë rutinë. Në qoftë se ministri i Industrisë dhe i Minierave, për shembull, nuk i thotë komitetit të Partisë të rajonit që në uzinën «Enver» ka këto probleme, se atje duhet të ndryshojë situata për këtë e për atë arsy, atëherë punët nuk mund të ecin mbarë. Në këto neglizhenca të dikastereve duket nënvlerësimi i punës së Partisë dhe burokratizmi.

Në përgjithësi, ne nuk duhet të harrojmë eksperiencën e hidhur që kemi pasur për zbatimin e vendimeve. Tashti po merren mjaft vendime e zotime për pesëvjeçarin e ri, për të cilat, organizatat e Partisë të rrtheve po më dërgojnë edhe mua letra. Në qoftë se ne nuk organizojmë punën për kontrollin e zbatimit të vendimeve e zotimeve, do të ketë nga këto që do të mbeten pa realizuar. Ishte një kohë kur njerëzit ishin në garë: oburra, kush e kush të merrte zotime më të mëdha, që t'i dilte emri në gazetë dhe, kur vinte puna për kontrollin e realizimit të zotimeve të marra, ai që mburrej më tepër, ishte në fund të rrugës.

Zbërthimin e direktivave, zotimet që po merren dhe që janë me të vërtetë entuziazmuese, si dhe zbatimin e tyre korrekt, të mos e harrojmë për asnjë çast.

Hysniu përmendi diskutimin e një sekretari të Partisë, i cili ka thënë se ka njerçz që nuk janë të bindur për mundësinë e realizimit të detyrave. Ky fenomen negativ e shumë dëmprurës nuk është vetëm në një fshat apo në një ndërmarrje. Ata që nuk janë të bindur për realizimin e detyrave as nuk do të punojnë mirë e, me dashje ose pa dashje, si rrjedhim, do të frenojnë edhe prodhimin nëpër ndërmarrje e kooperativa bujqësore. Prandaj, në qoftë se nuk krijohen bindje të shëndosha e nuk detajohen planet, në qoftë se nuk ka disiplinë të hekurt në punë dhe kontroll për zbatimin e detyrave, objektivat që kemi vënë do të na mbeten vetëm si zotime. Këtë defekt të punës ta kemi kurdoherë parasysh që të mos na zërë këmbët.

SHOKU HYSNI KAPO: Në mbledhjen e byrosë të Komitetit të Partisë të Tiranës u tha se shpesh më shumë bëhet autokritikë sesa kritikë ndaj të tjerve.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ndodh që bëhet më shumë autokritikë. Secili gjykon: «Më mirë të bëj autokritikë!» Autokritika është e mirë, por nevojitet edhe kritika për shokun. Të të kritikoj unë ty, por të më kritikosh edhe ti mua për punën e dobët; kjo është diçka me shumë vlerë. Ky qëndrim parimor tregon guxim dhe ndershmëri.

SHOKU HYSNI KAPO: Sekretari i parë i komitetit të Partisë të rajonit nr. 4 në Tiranë, tha se organizata-bazë të Partisë në punën e tyre, disa herë janë spos-

tuar nga shokët e komitetit të Partisë të rajonit dhe nga kuadrot me përgjegjësi të rrethit. Këta shpesh, për probleme të ndryshme, nuk e pyesin organizatën-bazë, bisedojnë me kryetarin e kooperativës apo me ndonjë tjetër, por jo me organizatën-bazë. Në fakt, këta bëjnë atë punë që mund të bëhet edhe në rrugën shtetërore.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo frysë, në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër, është futur një çikë edhe këtë nga lart; nga ana qeveritare shpesh thuhet: «Ç'tha për këtë çështje shoku ministër? Çfarë thotë shoku filan?»¹ Është futur kjo frysë pa menduar se edhe këto mënyra pycjeje kanë rëndësi për vlerësimin e punëve. Kjo ndodh edhe se disa nga shokët sekretarë e kanë më të lehtë drejtimin e punëve në rrugë shtetërore, duke u dhënë urdhra e porosi të tjerëve, sesa të punojnë si punëtorë partie, si udhëhcqës, si mësues dhe edukatorë të masës së komunistëve e të punonjësve.

Sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit duhet të shkojnë në organizatat-bazë. Natyrisht, ata nuk mund të venë në të tëra organizatat e Tiranës, por në disa prej tyre po. Në qoftë se sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit nuk venë në rajone, ata nuk mund ta njohin saktë gjendjen e organizatave-bazë, aq më tepër

1. Ndonëse në këtë kohë, akoma nuk njihej veprimitaria armiqësore e Mehmet Shehut, në fakt, kjo kritikë i takon drejt-përdrejt atij, i cili gjithmonë orvatej të fuste frysë e egocentrizmit e të komandimit në punën e organeve shtetërore e të ekonomisë dhe të shhangte drejtimin e kontrollin nga ana e Partisë.

kur këto kanë probleme e kanë nevojë për ndihmën e tyre.

SHOKU HYSNI KAPO: Në mbledhje, një sekretar i komitetit të Partisë të rajonit nr. 4, tha se një pjesë e mirë e veprave ujitëse në Tiranë nuk funksionojnë. Ai nguli këmbë që të shikohet kjo gjë, sepse, tha ai, dyshoj që këtu mund të ketë dhe sabotim.

SHOKU ENVER HOXHA: Si mendon ti, shoku Hysni, kur ky tha që, sipas mendimit të tij, janë bërë sabotime në veprat ujitëse, a e marrin menjëherë në dorë këtë çështje organet kompetente, për të hetuar seriozisht dhe gjer në fund si qëndron kjo punë? E vënë ata në lëvizje aparatin për të konstatuar përsë nuk funksionojnë rezervuarët? E kam fjalën këtu që, këtyre punëve, t'u shkohet deri në fund. Në qoftë se ai shok hodhi një mendim (që mund të jetë ose jo i vërtetë ose mund të jetë gjysmë i vërtetë) a ka njeri që të merret me këtë punë nga ana e Partisë dhe e pushtctit, duke bashkëpunuar edhe me organet kompetente e të thotë: «Pa hajde ta verifikojmë dyshimin që ngrihet!»

Për këto punë bëhen mbledhjet, e jo formalisht, sa për t'u mbledhur. Kur vjen, për shembull, shoku Hysni Kapo dhe na raporton në udhëheqje për disa gjëra të rëndësishme, personat që janë direkt të lidhur me problemin, e mbajnë shënim dhe përnjëherë marrin masa për të vënë në zbatim porosinë e dhënë, sidomos për çështje që janë delikate.

SHOKU HYSNI KAPO: Pastaj, në lidhje me kontrollin, u tha se ka shumë karakter zyrtar, e jo masiv.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, kontrolli punëtor nuk po vihet në jetë si duhet.

SHOKU HYSNI KAPO: Ky kontroll, praktikisht, bëhet, por jo që të jetë në rendin e ditës.

SHOKU RAMIZ ALIA: Edhe në Korçë, po kështu dilte ky problem. Kontrolli punëtor nuk shkonte mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kontrolli punëtor nuk është për t'u pranuar vetëm nga ana formale. Vjedhjet, për shembull, ne nuk i evitojmë dot pa i bërë presion vjedhësit nga opinioni shoqëror i organizuar. Jo polici, por kontrolli punëtor ta shikojë mënyrën e administrimit të vlerave materiale e monetare. Nevoja e kontrollit punëtor duhet të bëhet edukatë edhe për atë që, kur konstaton thyerjen e ligjit, thotë: «Ku është polici?» Pra, kur ushtrohet siç duhet kontrolli punëtor, do ta kuptojë se e ka gabim edhe ai që kërkon ndihmën e policit për zbulimin e keqbërësit.

SHOKU HYSNI KAPO: Në mbledhje u tha se duhet të rritet autoriteti i komiteteve ekzekutive në fshatra dhe sidomos në lagje, se, në disa prej tyre punojnë njerëz të cilët janë bërë me të vërtetë të mërzitshëm për popullin.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, duhet ta shikojmë patjetër këtë punë. Ne kemi plot njerëz të mirë, të ndershëm e me eksperiencë dhe që mund të aktivizohen.

SHOKU HYSNI KAPO: Në mbledhje u tha, gjithashtu, se disa kuadro të lartë në fshat, në vend që të ndihmojnë, po futin pikëpamjet e tyre burokratike dhe teknokratike deri edhe në organizatat-bazë të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Për teknokratët nuk duhet të flitet në përgjithësi, por duhet vënë gishti se cilët janë këta, duke i përmendur me emër: ky në këtë kooperativë, ai në atë kooperativë; jo vetëm kaq, por të shpjegohet edhe konkretisht se çfarë bën dhe si e frenon punën njëri apo tjetri. Instruktori apo sekretari i komitetit të Partisë, që është i mirinformuar, bën një mbledhje të përgjithshme me punonjësit e kuadrot e kooperativës, ku i thotë edhe teknokratit se çfarë vërehen tek ai dhe kërkon që kjo punë të ndryshojë. Këto t'i dëgjojnë edhe shokët komunistë e kooperativistë. Shkencën që ka mësuar çdo kuadër duhet ta zbatojë në fryshtë revolucionare. Kështu duhet vepruar e jo të flitet në përgjithësi, se fjalët e përgjithshme nuk mund të shërbejnë për korrigimin e punës së dobët. Të shkojmë në bazë dhe atje t'i shkundim të gjithë burokratët dhe teknokratët!

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

FIJET E KOMPLOTIT ÇOJNË EDHE NË KINË

Shënimë

21 shtator 1976

Thirra ministrin e Punëve të Brendshme, Kadri Hazbiun, bisedova me të dhe ai më raportoi mbi zhvillimin e mëtejshëm të hetimeve rreth Abdyl Këllezit dhe tradhtarëve të tjerë. Si konkluzion, del se tradhtia e tyre është katërcipërish e vërtetuar, këtë e kanë pohuar edhe vetë të akuzuarit. Ata, me gojën e tyre, thonë se të gjitha veprimet i kanë bërë me ndërgjegje të plotë, sepse kanë qenë armiq të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të socializmit.

Një gjë tjetër me rëndësi që del nga zhvillimi i hetimeve të këtyre tradhtarëve është çështja se Kiço Ngjela, duke pohuar tradhtinë e tij, shpjegon se në këtë rrugë e ka futur Abdyl Këllezi. Koço Theodhosi ka pohuar, gjithashtu, se «unë, nga origjina dhe prejardhja kam qenë armik i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i socializmit me kohë», dhe ka shtuar se «u aktivizova këto vitet e fundit nga Abdyl Këllezi, i cili edhe më diktonte si të veproja. Ai, për shembull, më «kri-

tikonte» në Qeveri, kurse jashtë më thoshte: «Hajde se e rregullojmë këtë osc atë çështje» dhe, në fakt, e rregullonim, por në rrugë armiqësore».

E këshillova ministrin që këtë çështje ta thellojmë, jo më për të vërtetuar gjërat e njohura e të provuara, por për të hetuar ato çështje për të cilat jemi të bindur dhe që komplotistët nuk duan t'i pohojnë drejtpërdrejt, megjithëse nga thëniet e tyre nënkuptohen qartë. Të thellohet hctuesia që:

1) Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e të tjerët, para fakteve të pakundërshtucshme e të plotë, të pohojnë me gojën e tyre se bashkë me Beqir Ballukun, Hito Çakon e Petrit Dumen ishin të lidhur dhe së toku koordinonin veprimtarinë armiqësore.

2) Të zbulohen lidhjet e mundshme kryesore që këta armiq e tradhtarë kanë lënë pas dhe që me siguri ekzistojnë. Duhet vigjilencë revolucionare nga Partia dhe vëzhgim i kujdesshëm e i thellë nga organet e Sigurimit të Shtetit.

3) Të zbulohet, gjithashtu, me kë kishin lidhje jashtë këta komplotistë dhe si i mbanin këto lidhje. Kjo çështje ka rëndësi të madhe për ne, ta dimë dhe ta vërtetojmë, veç të tjerave, edhe duke e pohuar ata vëtë me gojën e tyre.

Për këtë, pikën e tretë, ministri më tha se lidhjet me agjenturën jashtë duhej t'i mbanin me njerëzit e tregtisë së jashtme, me Kiço Ngjelën, me Vasil Katin e të tjerë. Ai nënkuptonte lidhjet agjenturore me jugosllavët ose me sovjetikët. Ka plotësish mundësi të jetë edhe kështu, por kjo nuk është një lidhje e atillë

që Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi mund të mbanin në mënyrë serioze, në rang të lartë, për një punë kaq të rrezikshme që po përgatitnin të kryenin këta tradhtarë.

I thashë ministrit se sovjetikët dhe jugosllavët punonin në mënyrë subversive për të ndryshuar rendin socialist të vendit tonë dhe, me siguri, ishin në dijeni që këta tradhtarë po organizonin një komplot dhe mund që kishin lidhje me ta. Kjo është një rrugë e mundshme, por, gjithashtu, i vura në dukje që të mos harrojmë dhe lidhjet e tjera të këtyre tradhtarëve, lidhjet me revizionistët kinezë, dhe pikërisht me «të plotfuqishmin» Çu En Lai. Për këtë rrugë ne kemi të dhëna konkrete që flasin për veprimtari armiqësore nga ana e Çu En Lait.

Udhëheqja kineze ishte në kundërshtim me vlijën e Partisë sonë. Për këtë unë nuk mendoj të zgjatem, por dua të vë në dukje se kinezët nuk na kthyen dot në rrugën e tyre të gabuar dhe ndërmorën punën armiqësore kundër nesh. Çuja ka pasë zgjedhur Beqir Ballukun dhe Abdyl Këllezin si elementët kryesorë për të vepruar. Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi na kanë pasë raportuar në Byronë Politike që Çu En Lai u kishte thënë se «Shqipëria duhet të ndërtojë një mbrojtje elastike dhe, në rast se sulmohet, të heqë dorë nga mbrojtja frontale, të kalojë menjëherë në mal, të hidhet në luftë partizane dhe të merret vesh me jugosllavët e me rumunët, me të cilët të organizojë një mbrojtje të përbashkët».

Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi është këtë «po-

rosi» të Çusë në Byronë Politike për të tatuar pulsin tonë, por edhe për të mbjellë farën e përçarjes. Kur Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi panë se ne e shkelmuam këtë tradhti të Çusë, ata, natyrisht, për sy e faqe, u bashkuan me ne, por, në realitet, edhe Beqiri, edhe Abdyli kishin mbetur dakord me Çunë që të vepronin për të përmbysur gjendjen ekzistuese në vend. Me siguri Çuja u ka thënë atyre se do t'i ndihmonte, në fillim duke na blokuar ekonomikisht, me qëllim që të na gjunjëzonte dhe, kur tradhtarët të merrnin fuqinë, atëherë do të rifillonte ndihma nga ana e Kinës. Beqir Balluku punoi për «planin Çu En Lai në ushtri»¹. Dihen tezat e tij dhe si veproi ai. Nga ana e vet, Abdyl Këllezi veproi për decentralizimin e ekonomisë, për vendosjen e vetadministrimit titist. E gjithë kjo veprimitari e rrezikshme, që vërtetohet, ishte zbatimi i orientimit të Çu En Lait. Pra, me këtë vijë tradhtare dobësohej mbrojtja nga brenda, dobësohej ekonomia dhe hidheshin hapat për vetadministrimin revisionist titist, kurse nga jashtë ky aktivitet armiqësor ndihmohej nga veprimitaria armiqësore e kinëzëve. Këta filluan një tjetër kurs ekonomik kundër nesh: ngadalësuan ndërtimin e veprave, s'na dhanë kredi dhe as armatime. Kjo ishte ndihma nga jashtë që u vinte tradhtarëve, të cilët vinin në koren Çunë se si zhvillohej puna.

1. Orientimi vetëm për luftë partizane, në rast se Shqipëria sulmohej nga jashtë, dhe për t'u lidhur me jugosllavët dhe rumunët.

Me siguri këtë veprimtari e dinin edhe titistët, edhe revizionistët sovjetikë, të cilët ishin dakord me planin e Çusë dhe e gjenin si të vëtmin plan të mundshëm në këto momente, pa ndërhyrje nga ana e tyre. Kush ua kishte thënë këtyre këtë plan? Beqir Balluku, Abdyl Këllezi, Hito Çakoja, Kiço Ngjela dhe të tjerë, por mundet edhe Çuja me shokët e tij revizionistë.

Komploti u zbulua dhe komplotistët u arrestuan. Menjëherë filloi dhe po vazhdon kundër nesh bllokada ekonomike nga ana e Kinës, e cila do të shkojë edhe më tej. Për ne fijet e kompleteve janë të qarta, por porosita që hetuesia të vazhdojë hetimin dhe t'i pyesë Abdyl Këllezin, Koço Theodhosin, Kiço Ngjelën e të tjerë, për të gjitha ato fakte që janë të pakundërshtueshme, por që ata duhet t'i pohojnë gjerësisht me gojën e tyre.

Fakt është që ne mendonim (dhe mendonim drejt) se tradhtarët do të ndihmoheshin nga jashtë dhe do të vepronin kur të piqej situata për ta. Do të vinte sulm dhe ndihmë për ta nga Jugosllavia dhe nga Bashkimi Sovjetik? Sigurisht që po, por jo më parë se ata të përgatitnin terrenin dhe të bënin puçin. Por, për të realizuar këto qëllime, duhej të vinte, dhe u erdhi në fakt, më parë, ndihma e kinezëve, e Çu En Lait.

Po të fitonin komplotistët, kush do të fuste duart këtu, në vendin tonë? Të gjithë, në harmoni dhe në divergjenca, sepse tradhtarët ishin agjentë edhe të sovjetikëve, edhe të jugosllavëve, edhe të kinezëve, edhe të amerikanëve. Të tilla janë lidhjet e komplotistëve.

Koço Theodhosи ka thënë në hetuesi se, përvëç Abdyl Këllezit, tek ai ka bërë presion edhe Pirro Gushoja. Ky duhej të ishte agjent i amerikanëve, të cilit çdo muaj i vinin dollarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga banka ku gjoja i kishte depozituar babai i tij emigrant, por të lejuara nga Departamenti i Shtetit. Pirro Gushoja, i siguruar nga kjo anë, ushtronte ndikim të madh jo vëtëm mbi Koçon, por edhe mbi Beqir Ballukun e Lipe Nashin (i cili bëri tratativat me firmën amerikane për makinën që dihet). Koço Theodhosи në Plenumin e Komitetit Qendror u mundua të dredhonte, por më në fund u gjend nesër e gushtë dhe pohoi se, me të ardhur Lipe Nashi nga Berlini, kishte shkuar menjëherë në Fier dhe atje bënë mbledhje (që nuk ishte vendi) me Lipen dhe me Pirro Gushon. Pirro Gushoja thirrej, gjithashtu, në mbledhje të veçanta që bënte Beqir Balluku në Fier me disa kuadro ushtarakë, ku diskutonte tezat e tij-antimarksiste, pjesëmarrjen e të cilit në to asgjë nuk e arsyetonte, veçse qenja në një komplot. Tash së fundi mësova se edhe Vasil Kati e ka pasur babanë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por të gjitha këto mund t'i lidhnim edhe me një veprim në shkallë ndërkombëtare, që duhet ta ketë burimin te Kina, te Çu En Lai, te politika proamerikane e kinezëve.

E dimë kthesën 180° të politikës së Kinës drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dihet edhe politika jonë dhe kundërshtimi zyrtar që i bëmë Kinës. Afërsisht në këto kohë, kur Çuja, Beqir Balluku, Abdyl Këllezi e kompani po vepronin nën rrogoz, Shtetet e Bashkuara

të Amerikës dhe Anglia bënë jo një herë, por dy herë deklarata zyrtare se «ishin gati të vendosnin marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë». Ishte një fakt pa precedent ky, që këto dy shtete imperialiste arrogante t'i luteshin Shqipërisë «të lidhte marrëdhënie me to». Nuk ka asnjë dyshim se këtu ishte dora e Çu En Lait, pras'ka dyshim që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin në dijeni se ç'organizonte Kina kundër Shqipërisë socialiste, të cilën donte «ta pajtonte» njëherë me Shtetet e Bashkuara, pastaj të tjerat, mendonte Çuja, vinin njëra pas tjetrës.

Mirëpo ne ia shkelmuam planet. Ai e vazhdoi planin e tij të egër, por, me zbulimin dhe me dënimin e komplotistëve, ne bëmë që edhe ky plan t'i dështon te plotësisht. Shqipëria jonë socialiste, brenda tri dekadeve, në sajë të vigjilencës së Partisë, të unitetit të saj ideologjik të brendshëm dhe të unitetit me popullin, ka shpëtuar nga tri komplate të mëdha që rrezikonin qenien e saj si shtet socialist i pavarur dhe sovran.

Këto tri komplate erdhën njëra pas tjetrës: nga jugosllavët, nga sovjetikët, pas vdekjes së Stalinit, dhe nga kinezët. Të gjithë këta armiq, të nisur nga pozita të fshchta antimarksiste, komplotonin kundër Partisë sonë marksiste-leniniste dhe socializmit në Shqipëri, duke e filluar veprimtarinë e tyre me një armiqësi të egër, të maskuar me pseudomiqësi dhe me pseudoteori marksiste-leniniste.

Nën parullat e «internacionalizmit proletar dhe të miqësisë së singertë» jugosllavët filluan gjoja të na «merrnin nën sqetull» dhe të na «mbronin si ajo nëna

e mirë që interesohet për foshnjën sa të mëkëmbet». Kështu jugosllavët revisionistë, me Titon në krye, që u demaskuan ç'tradhtarë ishin, infiltruan te ne, organizuan rrjetin e tradhtarëve, flitnin se po na ndihmonin në çdo drejtim, por, në fakt, na rropën në fukarallëkun tonë, na sabotuan naftën dhe rindërtimin, na grabitet ushqimet dhe prodhimet bujqësore, u orvatën të rrëzonin udhëheqësit marksistë-leninistë të Partisë, punuan ta bënин Shqipërinë një republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe, më në fund, u përpoqën të na pushtonin edhe ushtarakisht. Por plani i tyre djallëzor dështoi, Partia e Punës e Shqipërisë e shpëtoi atdheun nga një rrezik i madh. Titizmi ishte revisionizmi modern, një agjenturë e imperializmit dhe e borgjezisë kapitaliste reaksionare.

Pas titistëve, vendit tonë socialist dhe Partisë sonë, pas vdekjes së Stalinit, iu turr revisionizmi sovjetik, po aq i egër dhe dinak sa edhe titizmi. Edhe ky veproi nën maskën e «miqësisë së madhe» e të «internacionalizmit proletar», edhe ky luajti rolin e «dados së mirë». Ndihma ekonomike dhe ajo e paktë ushtarake, që na u dha, u realizuan nga Stalini, sepse, me të vdekur ky, filluan menjëherë sulmet e Hrushovit e të Mikojanit me shokë kundër Partisë sonë. Çdo gjë merrte formën se «na donin të mirën», «Ç'ju duhet juve industria, ç'ju duhet juve të çani kokën të bëni bukën, bukën jua japim ne, ju mbillni pemë, agrume, zarzavate». Edhe naftën ata na e sabotuan, specialistët e tyre na fshihnin çdo gjë dhe të gjitha ia raportonin Moskës. Ne na kritikonin se «nuk dinim të ndërtonim, nuk di-

nim të rritnim bagëtitë, nuk dinim të qeverisnim, përderisa lejonim që fshatarët të mbanin qen në shtëpi, të cilët hanin bukën kot•!

E tërë kjo veprimitari shoqërohej me krijimin e agjenturës së hruščovianëve brenda vendit tonë. Ata synonin që portet, aerodromet, ushtria, ekonomia jonë dhe çdo gjë tjetër të ishte nën drejtimin e tyre, kurse ne të ishim një koloni e revizionistëve sovjetikë, të ktheshim në një plasdarm për ta dhe populli ynë të bëhej skllav i tyre. Mirëpo Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli ynë u rezistuan këtyre armiqve të tërbuar, ua çorën maskën dhe i shporrën nga atdheu. Partia jonë e shpëtoi kështu për të dytën herë Shqipërinë socialiste nga planet skllavëruese të revizionizmit modern, nga socialimperializmi i ri, po aq i egër sa edhe imperializmi amerikan dhe agjentura e tij, revizionizmi titist.

Sulmi i tretë, pra komploti i tretë kundër vendit tonë, është ai i kinezëve, që e kam analizuar. Edhe ky është një komplot i egër revizionist socialimperialist që sulmon Shqipërinë socialiste, vetë Kinën dhe revolucionin. Edhe ky komplot revizionist modern paraqitet me parulla pseudomarksiste, pseudosocialiste, pseudomiqësore. Revizionizmi kinez, pas vdekjes së Stalinit, u përpoq të merrte nën tutelë hruščovianët, u përpoq të ruante miqësinë me revizionistët, u përpoq të shuanë polemikën dhe të «pajtonte Shqipërinë me Hruščovin». Të gjitha këto u dështuan revizionistëve kinezë, ndërsa brenda u zhvilluan përleshje të mëdha që vinin në rrezik vetë Kinën. Shqipëria socialiste ishte i vetmi vend

në botë që e mbrojti deri në fund Republikën Populllore të Kinës dhe Partinë Komuniste të Kinës. Kina për një kohë u izolua dhe në këto kushte të vështira për të i vetmi mik dhe aleat besnik ngeli Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Kina e ndihmoi ekonomikisht Shqipërinë, por kjo ndihmë u dha me zor, se do të ishte gabim dhe revisionistët kinezë do të demaskoheshin po të bënин ndryshe, në një kohë që Shqipëria e ndihmonte moralisht Kinën me të gjitha fuqitë që kishte dhe sinqerisht. Megjithatë, Çu En Lai mbajti në çdo kohë një qëndrim jomiqësor ndaj vendit e Partisë sonë dhe më në fund i hodhi maskat. Ai përdorte vazhdimesht po ato formula të sovjetikëve: «Ç'ju duhet juve kaq industri, ju nuk ndërtoni mirë, ju nuk zhvilloni luftën e klasave, ju braktisët fshatin- etj., kur ne, në fakt, bënim të kundërtën e atyre që pretendonte ai. Ai prish, dhe ne ndreq. Çuja kishte plane djallëzore revisioniste për Kinën, për Shqipërinë dhe për vende të tjera.

Revisionistët kinezë dështuan me Shqipërinë, sepse Partia e Punës e Shqipërisë vigjilonte. Ajo pa se Kina e ktheu miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ndërmori veprime të tjera të këqija. Ne ua kundërshtuam këto veprime haptazi. Atëherë Çu En Lai organizoi blokadën ekonomike kundër nesh dhe nxiti puçistët në komplotin e tyre. Po ne këtyre u ramaë kokës.

Çuja vdiq, Teni, që ai solli në fuqi, u qërua. Kina tash ndodhet në kaos. Do të shohim si do të zhvillohet

situata, por asgjë për ne nuk është e papritur dhe asgjë nuk na tremb.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha, «Gji-
thmonë vigjilencë» (Përm-
bledhje veprash), vëll. II,
f. 458*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Gjithmonë
vigjilencë» (Përmbledhje ve-
prash), vëll. II, f. 458*

NE DO TË QËNDROJME NË POZITAT TONA TË DREJTA PAVAREŠISHT NGA PASOJAT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

23 shtator 1976

Për përgatitjen e raporteve që do të mbahen në Kongres është tërhequr mendimi i shumë shokëve të Komitetit Qendror të Partisë e të Qeverisë. Ne mendojmë se për përgatitjen e tyre është bërë një punë e kënaqshme. Raportet janë hartuar në mënyrë sintetike, duke shprehur rezultatet e arritura gjatë gjithë këtyre pesë vjetëve, në zbatimin dialektik dhe dinamik të orientimeve të Kongresit të 6-të të Partisë, duke përfshirë në to gjithë eksperiencën e fituar në periudhën ndërmjet dy kongreseve.

Këto dy raporte mund t'ju duken pak si të gjata,

1. Në këtë mbledhje u shqyrtuan projektet e dy raporteve, që do të mbaheshin në Kongresin e 7-të të PPSH: «Mbi veprimtarinë e KQ të PPSH» dhe «Mbi direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë për planin e gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së RPSH për vitet 1976-1980».

ndonëse u bënë shumë përpjekje për t'i «shtrydhur» sa më tepër dhe përsëri do të punohet në këtë drejtim. Por duhet pasur parasysh se problemet që trajtohen në to janë të rëndësishme dhe të shumta, prandaj edhe nuk mund të shkurtohen shumë.

Sic e shikoni, kësaj radhe është ndryshuar pak paraqitja dhe formulimi i çështjeve që ngrihen, por një ndryshim i tillë nuk e ndryshon aspak brendinë dhe fillin e orientimeve. Duke u dhënë më shumë rëndësi problemeve të brendshme të vendit, natyrisht, ne nuk lëmë pas dore çështjet ndërkombëtare. Nga kongreset e mëparshme në këtë drejtim nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor.

Në raportin e këtij Kongresi ka një çështje të veçantë, sic është ajo e Kushtetutës. Diskutimi i projektkushtetutës së re, që do t'i paraqitet Kuvendit Popullor për aprovim, është diçka e re dhe, njëkohësisht, një ngjarje me rëndësi, prandaj menduam që kjo të zërë vendin e parë në raport. Është Kushtetuta e dytë që aprovohet pas një periudhe të gjatë të jetës së lirë socialiste të vendit tonë nën udhëheqjen e Partisë. Sic dihet, Kushtetuta është Ligji Themeltar i shtetit; aty pasqyrohen direktivat dhe politika marksiste-le-niniste e Partisë sonë.

Edhe pjesët e tjera të raportit trajtojnë probleme të rëndësishme.

Dëshiroj të vë në dukje se në kapitullin e politikës së jashtme, për të cilin ju, natyrisht, kenë dijeni, është shtruar në të gjitha aspektet vija e Partisë sone, me vërtetësi dhe hapur, pa dorashka, në mënyrë mark-

siste-leniniste, ashtu siç e ka zakon Partia jonë, e cila ka ndjekur, ndjek e do të ndjekë edhe në të ardhmen vetëm këtë rrugë. Në projektraport janë thënë të vërtetat për problemet kruciale që preokupojnë vendin tonë dhe botën, pa marrë parasysh se çfarë mund të thotë njëri apo tjetri. Ne mendojmë se pikëpamjet politike dhe ideologjike të Partisë së Punës të Shqipërisë janë të drejta. Të tjerët, po të duan, le t'i kundërshtojnë; Partia jonë i ka marrë parasysh pasojat.

Dëshiroj ta theksoj këtu, në Byronë Politike, këtë çështje që ka të bëjë me politikën tonë të jashtme, për arsyen se me shokët kinezë kemi pasur dhe vazhdojmë të kemi kontradikta politike dhe ideologjike. Këto kontradikta me Partinë Komuniste të Kinës Partia jonë i ka trajtuar në dy rrugë: në rrugën shoqërore, nëpërmjet letrave që i kemi dërguar komitetit qendror të kësaj partie dhe në rrugën e bisedimeve. Për një varg problemesh Partia jonë e ka thënë hapur fjalën e saj me shtyp, pa atakuar drejtëpërdrejt Kinën. Ne duhet të mendojmë (dhe besoj se konkluzioni i përgjithshëm i gjithë shokëve të Byrosë Politike është ky), që shokët kinezë, pavarësisht se nuk e thonë hapur, por për ne është e qartë, ata nuk janë dakord me ne për një varg problemesh politike dhe ideologjike sidomos në politikën ndërkombëtare. Ne i kemi të qarta, si qëndrimet tona ndaj dy superfuqive, ashtu edhe qëndrimet e kinezëve ndaj këtyre. Në këtë çështje qëndrimet tona nuk puqen.

Kinczét vënë theksin në tezën se rrezikun kryesor dhe më të afërt për paqen dhe për socializmin e për-

bën sot socialimperializmi sovjetik. Në praktikë, cilido shtet, parti, grupim politik apo person që është kundër socialimperialistëve sovjetikë, pa marrë para-sysh se ç'pozitë ideologjike dhe politike mban, nga udhëheqësit kinezë konsiderohet si mik i Partisë Komuniste dhe i Republikës Popullore të Kinës. Ne jemi në kundërshtim me këtë vijë të shokëve kinezë dhe këtë ua kemi thënë, si në takime me ta, ashtu edhe botërisht, nëpërmjet shtypit tonë.

Këtej rrjedhin një varg qëndrimesh ideologjike e politike shumë të gabuara, antimarksisteleniniste të udhëheqësve kinezë. Ata përkrahin reaksionarët më të tërbuar, fashistë e racistë; ata përkrahin, gjithashtu, organizata të tillë, si «Evropa e Bashkuar», «Tregu i Përbashkët», dhe organizata të tjera të vendeve kapitaliste e deri te NATO-ja. Me këto qëndrime, natyrisht, ne jemi krejt në kundërshtim me ta.

Këto çështje pasqyrohen edhe këtu, në raportin që Komiteti Qendror do t'i paraqesë Kongresit. U vjen hidhur apo jo udhëheqësve kinezë, vija që ka ndjekur dhe do të ndjekë edhe në të ardhmen Partia jonë e tillë është, e patundur. Këtë vijë ne ia kemi bërë të qartë opinionit publik botëror, por e theksojmë edhe në Kongres, sepse çështjet, duke u trajtuar edhe këtu, marrin një rëndësi të veçantë për të gjithë popullin tonë dhe për të gjithë ata që do të na dëgjojnë.

Vija jonë e drejtë ka pasur rrjedhime në marrëdhëniet midis dy partive dhe dy qeverive tona. Këtu nuk është çështja për një kundërshtim thjesht formal. Kinezët, në fakt, këto kundërshtime nga ana e tyre ndaj

nesh i kanë manifestuar në rrugën e presioneve, si ekonomike, ashtu edhe ushtarake.

Deri në njëfarë periudhe, kur Kina ishte izoluar në arenën ndërkontinentare dhe vetëm Shqipëria kishte mbetur në mbështetje të saj, udhëheqja kineze i ka lavdëruar qëndrimet tona duke i quajtur të drejta, marksiste-leniniste. Gjatë zbatimit të politikës së saj kjo ishte diçka pozitive për ne dhe ne i kemi përvënë detur këto qëndrime të Partisë Komuniste të Kinës, sepse mendonim që ishin në rrugën e drejtë. Por, siç e shohim nga zhvillimi i ngjarjeve, na bëhet e qartë se qëndrimet e kinezëve kanë pasur vetëm karakter koniunktural; këtë ata e kanë bërë në baza leverdie. Më vonë ata nuk kanë vazhduar të ndjekin këtë vijë, por, që të dilnin hapur politikisht kundër nesh, nuk dilnin dot. As ne nuk dolëm hapur kundër tyre. Mirëpo, në shtyp, u pa se qëndrimet e kinezëve kishin ndryshuar njëqind e tetëdhjetë gradë kursin e tyre, kurse qëndrimet tona nuk ndryshuan. Këto ndryshime, në vijë, janë dukur hapur dhe gjithë bota i ka marrë vesh.

Kjo i tregon botës se udhëheqja kineze Shqipërinë dhe Partinë e Punës të Shqipërisë nuk arriti t'i sillte dot në rrugën e saj. Udhëheqja kineze mendonte se do të ndikonte te ne që të ndiqnim vijën e saj e të futeshim në atë rrugë që ju e dini, po nuk i doli parashikimi. Atëherë i mbeti arma e presionit. Në praktikën e revizionistëve ka ekzistuar dhe ekziston kjo: për t'ia arritur qëllimit ata i përdorin të gjitha rrugët, edhe të tillë presione; këto udhëheqësit kinezë i kanë bërë edhe konkretisht kundër nesh.

Deri në njëfarë momenti, qëndrimet e kinezëve ndaj Shqipërisë kanë qenë plot premtim. Para disa vjetësh ata na kishin dhënë fjalën se në vitet e ardhshme do të na jepnin një ndihmë shumë më të madhe se deri atëherë. Të tilla premtim i dëgjoje nga goja e çdo udhëheqësi kinez, duke filluar që nga Çu En Lai. Dhe gjithë ky qëndrim shoqërohej edhe me një propagandë të madhe në favor të Shqipërisë. Më pas, udhëheqja kineze filloi të ndryshonte kursin në qëndrimet e saj ndaj vendit tonë. Ajo vërtet nuk jepte asnjë lajm apo njoftim në popull, sipas të cilit, për shumë çështje, Partia e Punës e Shqipërisë ishte në kundërshtim me Partinë Komuniste të Kinës (për këtë edhe masat punonjëse të qytetit e të fshatit në Kinë vazhdojnë të ushqejnë një dashuri të madhe për ne), por, në praktikë, vetë ajo, udhëheqja, ka filluar ftohen me Shqipërinë. Udhëheqësit kinezë deri tash nuk kanë guxuar të shprehen botërisht për këto ndryshime dhe as të krijojnë përshtypjen më të vogël lidhur me to. Një qëndrim i tillë, që nuk e prishin me ne publikisht, çshtë takтикë e tyre. Edhe ne, publikisht, nuk kemi dalë kundër tyre, por ky qëndrim i udhëheqjes sonë nuk mund të konsiderohet oportunist. Ne edhe për Mao Ce Dunin kemi folur, por as këtë nuk e kemi bërë për oportunizëm, por për dy qëllime:

Së pari, t'u japim të kuptojnë kinezëve se ne vazhdojmë e do të vazhdojmë të qëndrojmë në pozitatona të drejta. Si marksistë-leninistë, ne u tregojmë atyre kështu se e kemi për detyrë ta bëjmë këtë, me-

qenëse nuk dëshirojmë që situata ndërmjet njëri-tjetrit të acarohet më tej.

Së dyti, këtë qëndrim e mbajmë edhe për intercessat e mëdhenj të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Në politikën e jashtme të Republikës Popullore të Kinës, siç thashë edhe më parë, kthesa është bërë prej kohësh. Përveç kësaj, presionet e udhëheqësve kinezë ndaj nesh u konkretizuan akoma më fort, kur ne zbuluam komplotet e Beqir Ballukut, Petrit Dumes, Hito Çakos dhe të Abdyl Këllezit. Ky presion u intensifikua edhe nga ana ekonomike. Bile, siç e dini, prej kohësh Çu En Lai i kishte thënë Beqir Ballukut që në të ndryshonim kursin e mbrojtjes, të mos ndiqnim atë vijë që kemi vendosur për mbrojtjen e Shqipërisë nga një sulm ose nga sulme të gjithanshme. Sipas Çu En Lait ne duhet të marrim malet, të bëjmë vetëm luftë partizane e të futemi në aleancë me Jugosllavinë dhe Rumaninë. Këto pikëpamje na i ka sjellë nga Kina Beqir Balluku¹. Ne i hodhëm poshtë menjëherë të tilla pikëpamje.

Pikëpamjet e Çu En Lait na ranë në sy që atëherë. Po të kishim kuptuar që në këto ujëra notonte edhe Beqir Balluku, do ta kishim dënuar qysh atëherë dhe këtë. Çu En Lai i përsëriti këto orvatje edhe kur shkoi :

1. Këto pikëpamje të Çu En Lait, Beqir Balluku i shprehu pas vizitës që bëri në Kinë në muajt shtator-tetor 1968. (Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 419-420.)

delegacioni ynë qeveritar në Kinë¹, pikërisht në kohën kur Beqir Ballukun me shokë i kishim dënuar. Për-sëritja që i bëri ai delegacionit për t'i falur ata, se përndryshe nuk do të merrnim kredi, që një paralajmërim për ne. Kështu, kur panë se ne nuk ua dhamë përgjigjen, në mbledhjen e mëpasme me delegacionin ata e njoftuan se na e kishin prerë kredinë dhe për këtë kishte vendosur vetë Mao Ce Duni.

Mao Ce Dunit, që ne e kemi respektuar derisa vdiq, i patëm dërguar tri mesazhe dhe ai nuk na dha asnjë përgjigje. Mund të mendohet se ai nuk dinte gjë fare për këto qëndrime që mbaheshin ndaj Shqipërisë, po vihet pyetja: përsë të mos i dinte? Pastaj, edhe në qoftë se nuk i dinte, atij nuk i lejohej një gjë e tillë, sepse Shqipëria ka qenë i vetmi aleat i Kinës në periudhat nga më të vështirat për të. Këtë Mao Ce Duni e ka shprehur edhe në mesazhet që na ka dërguar neve. si në Kongres, ashtu edhe në raste të tjera. Prandaj, edhe kur të tjerët nuk e vinin në dijeni në një moment, ai duhej të interesohet e të pyeste se ç'po bëhet me Shqipërinë dhe të informohej se si ishte situata. Në këtë rast do të viheshin në pozitë elementët që po bënin sabotime në marrëdhënict e Kinës me vendin tonë.

Edhe një diçka tjetër. Pikërisht në momentet kur Kina mbante të tilla qëndrime ndaj vendit tonë, dy perandoritë më arrogante gjatë historisë së njerëzimit,

1. Delegacioni ekonomik qeveritar i RPSH vizitoi RP të Kinës në muajt qershor-korrik 1975.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia, i kanë propozuar Shqipërisë së vogël të lidhin marrëdhënie diplomatike, gjë që nuk është aspak në praktikën e tyre. Megjithatë ato e bënë këtë, e ulën hundën. Po përse e bënë një gjë të tillë? As kjo nuk ka qenë diçka e vogël.

Lidhur me marrëveshjet ekonomike, ju jeni në dijeni se udhëheqësit kinezë kërkojnë të na imponojnë që të nënshkruajmë një dokument të përbashkët, sikur gjoja veprat e planit të pestë pesëvjeçar, që kanë mbetur akoma pa u realizuar nga ana e tyre, të vonohen (të futen në «kalendat greke»), duke e justifikuar këtë vonesë nga ana e tyre, me tërmelin që ndodhi në Kinë, se, gjoja, ky u paska shkaktuar një dëm kaq të madh, saqë i ka detyruar të vonojnë furnizimet tonë, të mbështetura në marrëveshje dhe kjo jo vetëm për gjashtë repartet e Kombinatit Metalurgjik, por edhe për gjithë planin pesëvjeçar! «Shqipëria të na kuptojë për këtë», thonë ata. Për shkak se ne nuk e kemi pranuar këtë propozim, kinezët kanë mbajtur deri në tre muaj e gjysmë delegacionin që dërguam në Pekin për të sqa ruar me palën kineze çështjen e veprave të pesëvjeçarit të pestë dhe kryesisht për Kombinatin Metalurgjik. Ky është një veprim që nuk shkon. U nënshkruan vetëm tri-katër dokumente e pastaj u hap dera e avionit për shokët e delegacionit tonë.

Këto qëndrime që Kina ka mbajtur dhe mban kundër nesh, ne akoma nuk i shpallim publikisht, por vazhdojmë të bëjmë të qartë botërisht vijën e drejtë

të Partisë sonë. Prandaj, në botë, çdokush nuk ka se si të mos i kuptojë divergjencat që ekzistojnë midis dy palëve. Për këtë, ndonjë ditë do të bien me siguri trumchet veçanërisht ato të revisionistëve, kur një gjë e tillë do t'u interesojë.

Çfarë mund të ngjasë tani në Kinë? Dy rrugë janë:

Udhëheqësit kinezë do të vazhdojnë t'i shtojnë akoma më tej presionet ekonomike kundër nesh, që të na detyrojnë të flasim ne të parët, të hedhim «hapin e parë», siç e kanë zakon ata në teorinë dhe në praktikën e tyre: «Hidhni ju një çap, hapin e parë» thonë ata, «pastaj hedhim ne dy». «Hapin e parë e bëtë ju», — u thoshin ata dikur revisionistëve sovjetikë, — «pastaj ne bëmë të dytin». Me këto qëndrime ata synojnë të kenë «argumente» për të thënë se «marrëdhëni i prishë shqiptarët», se «me ta ne kemi qenë bujarë, u kemi dhënë ndihma», me një fjalë të justifikohen përpara popullit të tyre.

Por, mundet, dhe kjo akoma nuk është një çështje e humbur e pa shpresë, që shokët marksistë-leninistë, që duhet të ketë me siguri në radhët e Partisë Komuniste të Kinës, ndoshta do të mund të dominojnë mbi të djathtët. Siç duket, tani atje është duke u zhvilluar një fushatë, por këtë ne nuk e kemi të qartë. Duket sikur elementët marksistë-leninistë e kanë marrë fuqinë, por unë mendoj se po ta kishin marrë, nuk kishte arsyë përsë të shkonin duke u ashpërsuar marrëdhëni me ne.

Sic biseduam mbrëmë me disa shokë, në fjalën e Hua Kuo Fenit, megjithatë, duken disa vija të qarta në horizont. Në këtë fjalim thuhet që Kina do të luftojë edhe në frontin antiimperialist. Zihej në gojë lufta, si kundër imperializmit amerikan, ashtu edhe kundër socialimperializmit sovjetik, megjithëse këtë të dytin e kanë vënë të parin.

Vec kësaj, në këtë fjalim nuk thuhet më siç ka folur Ten Hsiao Pini që «ne bëjmë pjesë në botën e tretë», por «jemi në unitet me botën e tretë». Deri ku ka arritur puna, do ta shohim gjatë zhvillimit të ngjarjeve.

Megjithatë, ne asgjë nuk ndryshojmë në vijën tonë, kurdoherë do të jemi syhapur dhe vigilentë. Por hapat tanë në marrëdhëni me Kinën, do të jenë si kurdoherë të matur, marksistë-leninistë. Ata asnjëherë nuk duhet të jenë oportunistë dhe, në qoftë se deri tash kemi bërë ndonjë lëshim, këtë e shpjegova. Byroja Politike dhe Komiteti Qendror mund të vendosin që në të ardhmen të mos bëjmë më asnjë lëshim tjetër. Në emër të Partisë dhe të Qeverisë sonë, udhëheqësve të qeverisë kineze u janë dërguar letra të drejta por edhe të ashpra, duke u folur hapur se ne jemi krejtësisht të pakënaqur nga qëndrimet e tyre ndaj nesh dhe se nuk i kuptojmë këto qëndrime që mbajnë. Ky është momenti kyç i këtij problemi.

Më së fundi dëshiroj të theksoj se në nuk do t'i pushojmë asnjëherë përpjekjet që miqësia me Kinën, pa shkelur parimet, pa shkelur vijën tonë, të ndërtohet

në rrugën marksiste-leniniste. Në këtë drejtim ne do t'i bëjmë të gjitha përpjekjet, por kjo nuk varet vetëm nga ne, varet edhe nga ata. Me sa jemi në dijeni, atje ekziston një situatë kaotike. Këtë e bën akoma më kaotike vdekja e Mao Ce Dunit, por mundet që edhe ekzistenza e Maos, mendimet e tij, të kenë ndikuar në krijimin e këtyre situatave.

Pastaj, në raport, vjen problemi jugosllav. Aty ne mbajni qëndrim ndaj revisionistëve të Beogradit, por flasim edhe për çështjen e Kosovës. Këtë, mendoj unë, duhet ta vëmë. Qëndrimet që mbajnë tanë udhëheqësit jugosllavë ndaj Kosovës nuk janë të hapëta, si në kohën e Rankoviçit. Megjithatë, me metoda dhe forma të tjera të reja, titistët përpiken t'i persekutojnë kosovarët, t'i përçajnë, t'i shkombëtarizojnë dhe Kosovën ta varfërojnë. Marrëdhëniet reciproke që janë vendosur aktualisht midis Shqipërisë dhe Kosovës, nuk i kanë dashur kurrë revisionistët titistë jugosllavë. Por, gjatë momenteve të vështira nga kaloi regjimi i titizmit, kohët e fundit titistët u detyruan t'i zbutin qëndrimet e mëparshme me Kosovën dhe i dhanë asaj disa të drejta. Por, siç shihet, tanë përpiken dhe jo vetëm përpiken, por edhe marrin masa për t'i frenuar këto lëshime dhe bëjnë çmos që t'i diskreditojnë kosovarët. Ata udhëheqës shqiptarë kosovarë që janë agjentë të titistëve, bëjnë sulme të drejtëpërdrejta kundër popullit patriot kosovar.

Atëherë, t'ia paraqesim Plenumin të Komitetit

Qendror këtë raport të Kongresit për ta aprovuar? Jeni dakord shokë?

(Të gjithë shokët përgjigjen: «Dakord!».)

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

PËR KANDIDATURAT E REJA GJYKIMET TË JENË SA MË OBJEKTIVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

23 shtator 1976

Pasi u miratuan dy raportet e Kongresit të 7-të të Partisë dhe u caktua data e mbledhjes së ardhshme të Plenuminit të KQ të PPSH, e mori përsëri fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

Tani kisha vetëm një gjë. Ju e dini që jemi përpara Kongresit dhe të gjithë shokët e Komitetit Qendror do të venë të marrin pjesë në konferencat e Partisë të rretheve. Vajtja sidomos e shokëve kryesorë do t'u japë konferencave të Partisë në rrethe një eksperiencë të çmueshme, por nuk e kam këtu fjalën. Desha të theksoj atë që ju, duke qëndruar atje, të shikoni edhe kuadrot, cilët janë më të mirët, elementët më të devotshëm të klasës punëtore, të fshatarësisë sonë kooperativiste, specialistë e kuadro të ndryshëm që mund të zgjidhen në Plenumin e ri të Komitetit Qendror që do të dalë nga Kongresi.

Kjo është e nevojshme të bëhet nga ju, për arsyen se një numër anëtarësh të Plenumit aktual i kemi përjashtuar ose kanë vdekur dhe disa të tjerë mund të mos zgjidhen përsëri. Sigurisht kjo është një punë që do ta bëjë Kongresi, por ne jemi anëtarë të Byrosë Politike dhe mendime mund të kemi dhe duhet të japim për disa anëtarë ose kandidatë të Komitetit Qendror që nuk e kanë justifikuar qenien e tyre në këtë organ të lartë të Partisë. Pra, shqetësimi ynë në konferencat e Partisë të rretheve nuk duhet të konsistojë vetëm në çështjen që atje të diskutohet gjallërisht dhe në mënyrë revolucionare për detyrat dhe problemet aktuale e të perspektivës. Kjo, natyrisht, është kryesorja, por krahas kësaj pune duhet parë edhe cilët janë në rrethe anëtarët më të dalluar të Partisë. Për këtë mendoj se ka rëndësi shumë të madhe që ju të merrni të dhëna të studiuara.

Dihet që Partia në rreth merr herë pas here të dhëna për komunistët dhe këto, zakonisht, vijnë nga një gjykim kolektiv, por ka edhe raste që të dhënat vijnë për këtë apo atë kuadër dhe nga një gjykim subjektiv. Prandaj, duke pasur edhe nga ju të dhënat për kandidaturat e reja, do të jetë akoma më mirë për Partinë. Shikimi dhe vlerësimet tuaja për komunistët, s'ka dyshim që do të jenë të matura, të drejta dhe sa më objektive, sepse ato do të jenë gjykime prej udhëheqësive eksperiencë të madhe partie, prej anëtarë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror, që di të gjykojë jo nga pozita thjesht subjektive, por di të dallojë mirë që ky ose ai komunist i ka kushtet për të ardhur në udhë-

heqje, se është i drejtë, parimor, militant i vendosur, pavarësisht se mund të jetë nga kjo apo ajo shtresë. Një shikim i tillë nga ana juaj do t'i vlejë shumë Kongresit, pse bashkë me mendimet që do të merren në konsultimet me komitetet e Partisë të rretheve, në-përmjet degëve të kuadrit, kjo punë do t'i lejojë përfaqësisë së Kongresit që të rekomandojë me siguri shokë nga më të mirët e më të vendosurit që duhet të vijnë në udhëheqje për gjallërimin e forcimin e mëtejshëm të Komitetit Qendror, por mundet edhe të Byrosë Politike, duke sjellë në krye të Partisë disa kuadro të rinj energjikë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP

KRAIAS PUNËS EDUKUESE, EDIIE KONTROLLI I RREPTË PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

27 shtator 1976

SHOKU HYSNI KAPO: Në plenumin e Komitetit të Partisë të Tiranës, nga të gjithë shokët që diskutuan, vetëm disa prej tyre bënë vlerësim të situatës politike. Kur përmendën rastet e shfaqjeve të huaja, të mungesës së disiplinës etj., nuk nxorën prej tyre konkluzione e detyra.

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, nuk nxjerrin konkluzione të përgjithshme në bazë të situatave që po kalojmë, për të ndikuar si udhëheqës në kuptimin dhe në vlerësimin realist të detyrave që shtrohen nga Partia.

SHOKU HYSNI KAPO: Po, kështu është, shokët kapen më tepër pas problemeve praktike.

Në plenum foli dhe komisari i një njësie të Tiranës. Ai, përgjithësisht, diskutoi mirë, por në mendimet e qëndrimin e tij vihej re njëfarë vetëkënaqësie.

SHOKU ENVER HOXHA: Në një raport që kam

lexuar, kritikohej edhe kjo njësi për dobësi në punë. Në këtë raport, që unë e lexova me vëmendje, kam bërë një varg vërejtjesh. Por raporte duhet të bëjnë dhe shokët që merren me ushtrinë këtu, në aparatin e Komitetit Qendror.

SHOKU HYSNI KAPO: Kanë bërë edhe ata një raport për gjashtëmujorin, por nuk jua kam dhënë juve akoma.

SHOKU ENVER HOXHA: Do ta shikoj edhe unë këtë material, se kjo e kompleton shkallën e njohjes sime për gjendjen e vërtetë në këtë sektor.

Në atë raport që kam lexuar, bëhet fjalë edhe për komisarët. Këta kanë edhe detyra komande e jo vetëm detyra partie. Duhet njobur se, që të jesh komisar i mirë, duhet të jesh njëkohësisht edhe komendant i mirë.

Vetëm një gjë dua të theksoj: Të evitohen vogëlsirat në raportime. Është fakt se instruktorët tanë kanë tendencë të futen edhe në hollësirat më të vogla kur raportojnë. Neve, në udhëheqje, nuk na duhen vogëlsirat. Prandaj, të spastrohen llafet pa bukë, se, që të mund të shohim pyllin, nuk duhet të na pengojnë fletët. E them këtë, duke u nisur edhe nga diçka që më tha Nexhmija, e cila kishte vërejtje për konferencën e Partisë të rrethit të Durrësit. Raporti që qe mbajtur atje synonte të analizonte detyrat për mbrojtjen. Nexhmija vuri re se në raport nxihet fare puna e Partisë në ushtri. Për çdo gjë thuhej: «Kjo nuk është kështu», «Ajo tjetra shkon ashtu», «Njëri i ka leshrat kështu» e, për të gjitha gjërat, nën vizoheshin vetëm të metat. «Jo, — i thashë unë, — nuk janë ashtu ushtria dhe mbrojtja

jonë!». «Edhe unë mendoj që s'janë kështu, — tha ajo, — prandaj çuditem pse paraqitet kështu një gjendje e tillë».

E kam fjalën këtu, që, në raportet e Këshillit të Mbrojtjes, të evitohen gjërat e vogla dhe të na dalin në pah çështjet kryesore. Kur na raportohet, për shembull, për Shkollën e Lirë, komanda na informon se janë organizuar kaq shkolla, që janë pajisur kështu e ashtu dhe, pastaj, na evidencohen disa të meta, në përgjithësi. Sekretari i komitetit të Partisë etj., duhet të na informojë jo vetëm që u ngritën këto shkolla, por edhe se çfarë programi mësimor zhvillohet në to; në çfarë niveli ideopolitik jepen mësimet nga kuadrot oficerë; përgatiten mirë këta apo jo; cili është interesimi i pjesëmarrësve për të mësuar etj.? Pra, ka plot gjëra që nёve na interesojnë t'i dimë në këtë drejtim, që të mund të themi pastaj se ç'masa të merren për këtë apo për atë çështje.

SHOKU HYSNI KAPO: Një shok tjetër theksoi se, kur venë shokët e rajonit tek ata, kanë tendencën të merren më tepër me problemet ekonomike sesa me ato të organizatave-bazë të Partisë e të punës edukative me njerëzit.

SHOKU ENVER HOXHA: Drejt e ka ai. Ne kemi plot organizma që punojnë në ekonomi, siç janë sektionet ekonomike në komitetet ekzekutive, ndërmarrjet, kooperativat, institucionet etj., etj. Edhe aparatet e Partisë duhet të dinë për detyrat e ekonomisë, por ato duhet të jenë veçanërisht të interesuara për politikën ekonomike të Partisë, të njihen me shfaqjet ne-

gative në Parti dhe t'i luftojnë ato për t'i zhdukur në-përmjet edukimit të njerëzve.

SHOKU HYSNI KAPO: Nga disa kuadro mendohet se Partia na i thotë të gjitha në shtyp, në radio etj. Kjo është e vërtetë, por kjo nuk do të thotë që të nën-vlerësohen format e tjera që na rekomandon Partia, si biseda, debate etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, Partia vërtet ka krijuar tërë ato mjete të gjithanshme të komunikimit e të propagandës, por disa kuadro e komunistë mendojnë se, meqë janë ato, s'kanë ç'bëjnë më shumë. Edhe kjo çështje është e lidhur me nënvlérësimin e nevojës për propagandimin e direktivave të Partisë. «Pënderisa Partia na i shkruan në gazetë ato që duhet të bëjmë, ç'na mblidhni e na bëni konferencë, që të na lodhni koi për gjëra që i dimë?» mendojnë disa shokë që nuk e kuptojnë drejt këtë problem.

SHOKU HYSNI KAPO: Në plenum më tërhoqi vëmendjen edhe kritika që bëri sekretari i parë i rinisë së rrithit. Në format e edukimit të rinisë që u hapën në disa qendra pune, tha ai, asnjë nga komunistët nuk mori pjesë në mbledhjet që u organizuan për këtë qëllim.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këtë mënyrë, duke manifestuar praninë e Partisë me pjesëmarrjen e tyre, komunistët do t'i inkurajonin të rintjtë.

SHOKU HYSNI KAPO: Komitetet e Partisë të rajoneve nuk interesohen, nuk ndihmojnë dhe nuk kontrollojnë sa duhet punën me rlininë e sidomos punën që bëhet për edukimin e saj. Ka një tendencë të gabuar

që puna me rininë të bëhet me urdhra e jo nëpërmjet edukimit e bindjes.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po. Ky defekt i punës së Partisë me rininë ka kohë që është vënë re; përtë, disa herë, janë bërë edhe vërejtje.

Kanë ndodhur vazhdimisht indisiplinime në punë, sidomos nga të rintjtë që nuk kanë detyrime familjare, të cilët, herë vijnë e herë nuk vijnë në punë. Po të jenë në krye të detyrës drejtuesit e ndërmarrjeve, mund të ndikonin shumë te köta të rindë. «Ti, more djalë, — mund t'i thonë ata një të riu të padisiplinuar, — mungovë gjashtë ditë pa arsy. Po e bëre edhe një herë tjetër këtë gjest indisiplinimi, unë do të veproj në bazë të Kodit të Punës». Në qoftë se punëtori, me gjithë paralajmërimin e dhënë, e përsërit fajin për herë të dytë, atëherë mund edhe të pushohet nga puna.

SHOKU HYSNI KAPO: Në plenum u fol edhe për disa ndërmarrje që nuk realizuan fitimin e planifikuar, megjithëse, si rrëth, Tirana e ka tejkaluar atë.

SHOKU ENVER HOXHA: Tatimfitimi i ndërmarrjeve ekonomike mund të jetë shlyer edhe në mënyrë fiktive, duke marrë ndërmarrjet kredi në bankë dhe mallrat të mbeten stoqe. Pra, mund të ndodhë që tatimfitimin ndërmarrja e paguan, por mallrat vazhdojnë të rrinë stok. ,

SHOKU HYSNI KAPO: Në plenum, u hodh mendimi se do të ishte më mirë sikur të bëjmë rregull që sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rajoneve të janë edhe anëtarë të byrosë së rrëthit.

SHOKU ENVER HOXHA: Puna më e rëndësishme

e Partisë në rrethin e Tiranës, lidhur me bazën, mbësh-tetet te rajonet, të cilat udhëheqin drejtpërdrejt organizatat-bazë, duke u orientuar nga komiteti i Partisë i rrethit, i cili nga ana e vet bashkërendon dhe kontrollon punën e rajoneve. Kur bëmë ndarjen e komiteve të Partisë në rajone, ne e kishim hallin që të siguroheshin lidhjet e drejtpërdrejta të këtyre komiteve me organizatat-bazë të Partisë. Në qoftë se komiteti i Partisë i rrethit lidhet në mënyrë indirekte me rajonet, ose u jep këtyre, jashtë mbledhjes, disa vendime të marra *ex cathedra*, kjo nuk është e drejtë. Sekretarët e parë të rajoneve mund të mos janë të gjithë anëtarë të byrosë të Tiranës, por mirë është të marrin pjesë në mbledhjet e saj. Të kemi parasysh se janë sekretarë partie të rajoneve të Tiranës, që barazohen me rrethet. Nuk duhet të harrojmë se një rajon ka dhjetëra mijë banorë. Ata vërtet mund të janë të rinj, por, këta shokë, Partia i ka vënë në poste drejtuese dhe janë drejtues të mirë. Ai që është anëtar i byrosë së rrethit nuk përgjigjet vetëm për problemet e rajonit që drejton, por edhe për problemet e rajoneve të tjera. Kur të flitet në byro për çështjet politike, për çështjen e kooperimit etj., sekretarët e parë të rajoneve, duke qenë të pranishëm, japid mendime se me kë do të kooperohet ky, ai etj. Atëherë, në Byronë Politike, sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit do t'i sjellë më të plota mendimet e bazës; ai do ta ketë në dorë situatën, në të gjitha uzinat, fabrikat, ndërmarrjet e institucionet.

Në dhënen e udhëzimeve dhe të eksperiencës nuk

duhet të jemi dogmatikë. Eksperiencia e Partisë nai ka mësuar shumë gjëra. Por duhet të kemi parasysh që kuadrot, të vjetrit edhe të rinxjtë, t'i mësojmë që, vetëm duke përvetësuar marksizëm-leninizmin, direktivat kryesore dhe eksperiencën shumëvjeçare të Partisë, ata do të mund të zgjidhin drejt problemet që shtron Kongresi, Komiteti Qendror i Partisë, Byroja Politike, organizata-bazë dhe vetë jeta.

Për zgjidhjen e drejtë të problemeve që dalin, jepen orientime të përcaktuara. Por, jeta zhvillohet në mënyrë dinamike; në rrjedhën e saj dalin çështje të papritura, të thjeshta e të koklavitura, për zgjidhjen e të cilave nuk mund të jepen receta. Eksperiencën e pasur që ka Partia jonë nuk është e lehtë ta ketë çdo komunist apo udhëheqës partie në pëllëmbë të dorës për trajtimin e një problemi që kërkon zgjidhje, prandaj kërcohët iniciativë dhe vetëveprim në gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë, në bazë të parimeve marksiste-leniniste, në bazë të orientimeve kryesore dhe të eksperiencës së Partisë.

Nuk duhet t'u lidhim duart shokëve e t'i udhëzojmë për gjithçka, duke u thënë: «Po të doli problemi kështu, vepro kështu; po të doli ndryshe, vepro ndryshe!», siç mund të kemi vepruar edhe ne në ndonjë rast, para shumë vjetësh. Edhe në probleme të tillë nuk mund të mos përfillet faktori kohë: komunisti o kuadri sot nuk duhet të zbatojnë në mënyrë shabllone ato porosi që janë dhënë, për shembull, në vitin 1947 ose në vitin 1952. Për atë kohë dhe situatë, zgjidhjet e dhëna kanë qenë të drejta, kurse sot është një kohë

më e avancuar, janë kushte më të mira. Ne, më përpara, kishim sistemin e grumbullimit të detyrueshëm të drithërave të bukës, të mishit dhe të leshit, por sot, me sukseset e arritura nga ekonomia jonë, me forcimin e kooperativave bujqësore, me rritjen e prodhimeve bujqësore e blegtoreale etj., këtë sistem e kemi hequr dhe praktikojmë grumbullimin e prodhimeve me anë kontratash. Në atë kohë ne jepnim urdhra e direktiva të hollësishme për shumë gjëra, dhe mirë bënim, sepse edhe kuadrot tanë nuk ishin shumë të ngritur. Por tash, në këto situata pozitive të ecjes përpara, nuk mund të jepen vetëm urdhra, sepse Partia shtron detyrën që më parë duhet t'i bindësh njerëzit. E kam fjalën këtu që, eksperiencia e mëparshme e Partisë të shfrytëzohet, por të mos kopjohet. Sido që problemi mund të jetë miaft i ndërlikuar, duhet gjetur kohë për t'u njobur me dokumentet e Partisë. Vetëm kështu do të gjenden zgjidhjet e duhura për këtë apo atë çështje, e nuk do të bëhen gabime.

SHOKU HYSNI KAPO: Pra, duhet të vlerësosh më parë situatën, që të aplikosh pastaj drejt eksperiençën e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është. Prandaj në instruksionin që keni menduar të dërgoni për këto probleme, të kihen parasysh këto çështje.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

PËR RENDIMENTE TË LARTA, RËNDËSI TË MADHE KA EDHE FARË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

30 shtator 1976

SHOKU HAKI TOSKA: Pas mbledhjes së byrosë e të plenomit të komitetit të Partisë mora pjesë edhe në konferencën e Partisë të rrethit të Beratit. Në diskutimet që u bënë në këto forume të Partisë, përgjithësisht u vunë në dukje si anët negative, ashtu dhe ato pozitive të punës, pra, u evidencuan sukseset e arriitura dhe të metat që janë dukur.

SHOKU ENVER HOXHA: Sikurse më kanë informuar edhe shokët, këto janë vërtetuar edhe në konferencat e tjera, raportet dhe diskutimet kanë qenë të mira.

SHOKU HAKI TOSKA: Ndër të tjera, në konferencë u tha se sivjet, në disa sektorë u morën deri 70 kuintalë misër për hektar dhe në një sipërfaqe goxha të madhe.

SHOKU ENVER HOXHA: Ky është një rezultat

i mirë, për arritjen e të cilit ka ndikuar shumë edhe fara. Rëndësinë e farës duhet ta kuptojnë mirë koooperativistët. Puna dhe shërbimet kanë rëndësinë e tyre të madhe dhe këtë ne nuk duhet ta nënvlefësojmë në asnjë mënyrë. Por, krahas atyre, nuk duhet nënvleftësuar as roli i farës. Prandaj fara duhet të ruhet, të spastrohet dhe të ndiqet dy, tre dhe katër vjet rendimenti që merret. Po u ul rendimenti, fara duhet të ndërrohet. Kur shikon që nga toka pa ujë të merren 40 kuintalë për hektar, në një kohë kur nuk merrnim veçse fare pak misër, kjo është një kënaqësi e veçantë. Më përpara këto toka digjeshin prej thatësirës. Kështu e pësonin misrat e Salarisë, të Bënçës¹ e të fshatrave të tjera që, kur shkoje e i shikoje, të vinte për të qarë.

SHOKU HAKI TOSKA: Në konferencë u fol edhe për nevojën e një ndihme më të madhe që duhet të jetet për ujitjen nga ana e SMT-ve dhe si mund të shfrytëzohen më mirë hauzet e rezervuarët për këtë qëllim. Se, konkretisht, deri tashti, në rrëthim e Beratit kanë harxhuar vetëm 30-40 për qind të fondeve të caktuara për ujitje. Kështu ngjet edhe në rrëthe të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Më fal që po të pres fjälën, shoku Haki. Të njëjtën gjë më raportoi dje dhe Rita [Marko] për Sarandën. Ai më tha se fonda ekzistojnë për kanalin ujitës të Sasajt dhe për tharjen e bishtit të Vrinës, gjatë liqenit, por detyra nuk është kryer! Kjo punë, tha shoku Rita, mund të ketë rrëth 15 vjet që është filluar. Kur e pyeta pastaj se për ç'ar-

1. Fshatra në rrëthim e Tepelenës.

sye nuk e kanë bërë akoma, mësova se justifikohen duke thënë që u mungojnë forcat e punës! Po ç'kërkojnë më këta njerëz? Mos duan t'uadërgojmë nga Dukagjini forcat e punës?!

«Kur shkova andej nga Hoxhajt!, — më thoshte Rita, — pashë një grup të madh me gra e vajza që po vinin që nga lart. Se ku kishin qenë nuk e kuptova, — tha ai, — ndaj i ndala në rrugë dhe i pycta: — Ku po shkoni?» «Ja, po kthehem nga puna». «Po sa orë ju duhet për të ardhur që andej e gjer këtu?» — i kishte pyetur përsëri Rita. «Na duhet një orë e gjysmë» — i qenë përgjigjur ato. Një orë e gjysmë për të vajtur e një orë e gjysmë për t'u kthyer! Kjo do të thotë që gratë ishin të detyruara të ngrihen e të niseshin për punë që në orën tre e gjysmë ose katër të mëngjesit. Ja, pra, shokë, si e organizojnë punën disa dhe thonë pastaj se «Nuk kemi forca pune që t'i bëjmë këto gjëra!»

Para pak kohësh më kishte ardhur një letër nga një vajzë e re fshatare. Pasi e lexova, shënova mbi të: «Ke shkruar shumë bukur!». Letërshkruesja thoshte: «Shoku Enver! Jam një vajzë e re; mbarova dhe shkollën. Gjyshi im, pas Çlirimt u cilësua kulak. Babai im punon mirë, unë i dua Partinë dhe atdheun, se gjaku im është tjetër dhe ndryshon nga ai i gjyshit. A është e drejtë që mua më kanë përjashtuar nga pjesëmarrja në çetat vullnetare? Këtë gjë nuk e duroj dot!», thotë vajza.

1. Tani fshati Livadhja në rrëthim e Sarandës.

Shikoni pra, atë nuk e lënë të stërvitet në çetat vullnetare! Po si do të luftojë ajo, pa u stërvitur, në rast se atdheu do të ketë nevojë? Si është e mundur të ndodhë kështu?!

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

TREGTIA TA INKURAOJOJE E JO TA PENGOJE SHTIMIN E PRODHIMEVE BUJQESORE

*Nga biseda nē takimin ditor tē sekretarëve
tē KQ tē PPSH*

1 tetor 1976

SHOKU ENVER HOXHA: Si i zhvilloi punimet konferanca e Partisë e rrethit tē Korçës?

SHOKU RAMIZ ALIA: Në përgjithësi ajo u zhvillua në një nivel shumë tē lartë; më bëri përshtypje fakti që kishte një frymë tē shëndoshë partie, me kritikë dhe autokritikë, pér dobësitë dhe tē metat në punë. Në diskutime nuk kishte raportime; tē gjithë i kishin diskutimet problematike.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një kthesë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, kjo është një kthesë me kuptimin e plotë tē fjalës, që tregon rritjen e nivelit ideopolitik tē komunistëve tē këtij rrethi.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, ky nivel nuk mund tē arrihet kudo menjëherë, diku është arritur, diku akoma jo.

Lidhur me atë që the ti pak më parë, pér diskutl-

met problematike, kjo do të thotë që edhe shtypi ynë ka bërë një efekt të mirë si në këtë çështje, ashtu edhe në gjithë punën e Partisë. Por, sa më tepër të theksohet ky problem në shtyp, aq më mirë është, për arsyе se komunisti ose edhe çdo punonjës tjetër gazeten e merr çdo ditë. Duke i folur vazhdimisht në gazetë për zhduket e frazeologjisë dhe të raportimeve të përgjithshme, aq më tepër ai edukohet që të kapë kaun nga brirët dhe i largohet nga mendja ai rregull që kur përgatitet për të diskutuar, të bëjë hyrje, parathënie, pasthënie dhe më në fund mbyllje. Dhe... ç'mbeti nga gjithë kjo? Thua jse asgjël!

SHOKU RAMIZ ALIA: Në qendër të vëmendjes së konferencës, kishin kryesisht punën e Partisë në sektorin e ekonomisë, veçanërisht në bujqësi.

Pastaj, shoku Ramiz Alia, përmendi shifra e fakte që tregonin për sukseset e arritura nga punonjësit e bujqësisë të rrëthit të Korçës.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto rezultate janë arritur edhe në sajë të zbatimit të shkencës dhe të përhapjes së eksperiencës së përparuar.

SHOKU RAMIZ ALIA: Për t'ia arritur këtyre, shokët e Korçës kanë filluar nga puna konkrete dhe e organizuar duke mos përdorur sloganë, siç ndodh me disa. Ashtu sikurse folën edhe në konferencën e Partisë, ata, për edukimin profesional të punonjësve të bujqësisë, kanë krijuar kurse kualifikimi.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këto kurse që bëjnë, trajtohen edhe tema për procese pune të veçanta si për prashitjen, për tharjen etj.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, tamam për to. Me një fjalë shkenca nuk mbetet stoli e atyre që kanë mbaruar shkollën, por u jepet konkretisht edhe kooperativistëve.

Një ditë para konferencës, unë vajta në Plasë dhe u binda që atje çshtë bërë me të vërtetë një gjë shumë, shumë e mirë. Megjithëse nuk jam specialist bujqësie, por i pashë konkretisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Vërtet nuk jemi specialistë, por jemi bërë të tillë, se kemi kaq vjet që mëremi me problemet e bujqësisë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ne e njohim të gjithë Ilo Priftin¹ si shok të matur, të mirë dhe që e njeh mirë bujqësinë. Iloja, kur biseduam me të, na tha kështu: «Ruga e zhvillimit të bujqësisë sonë çshtë ajo që ka bërë Plasa; dhe ne, sot apo nesër, atje do të vemi!»

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, që të aplikohet në të gjithë Shqipërinë ajo që ka bërë Plasa, nuk arrihet dot brenda një viti, po do kohë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në konferencë ata ngritën edhe çështjen që të bëhet një studim në nivel rrethi për një shpërndarje sa më të drejtë të bimëve bujqësore midis ekonomive të ndryshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe atë e kemi thënë, që në rreth duhet të bëhet kjo ndarje dhe, mbasandaj, nga rrethi duhet të kalojmë në të gjithë republikën. Neve vërtet na duhet drithi, por na duhen edhe prodhimet e tjera bujqësore. Po kush do t'i prodhojë ato?

1. Në atë kohë, drejtor i Ndërmarrjes Bujqësore të Malit

Kjo tē shikohet! Tani e bējnē tē tērē, por, kur tē bēhet një shpérndarje e planifikuar, atēherē do tē thuhet se ku na leverdis më shumë tē mbillet kjo apo ajo bimë. Pēr studimin e Plasës po punohet dhe gjetkë apo jo?

SHOKU HAKI TOSKA: Punohet, shoku Enver. Atē e kanë marrë me seriozitetin më tē madh drejtuesit e rinj tē Ministrisë së Bujqësisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk kishin pōrse tē mos e merrnin me seriozitet shokët e ministrisë. Sekzioni i bujqësisë i rrethit, nga ana e vet, duhet ta shikojë studimin edhe nē perspektivë, atē që tha Ramizi, nē shkallë rrethi. Tani kemi caktuar që tē zbatohet nē Pojan dhe nē Plasë; por më vonë do ta zbatojmë edhe nē kooperativa tē tjera. Po sikur ta zbatojmë pa e studiuar dhe pa e llogaritur mirë çdo gjë, atēherë mund tē na mbetet diçka pa mbjellë e tē na mungojnë prodhime tē ndryshme. Po kujt do t'ia planisikojmë ato pēr t'i mbjellë, se prodhimet i do shteti, po mund t'i dojë edhe vetë rrethi? Ja pra, pse duhen bërë mirë llogaritë. Prodhimet që marrim ne edhe mund t'i kompensojmë me njëri-tjetrin. Por, çështja qëndron këtu, se kur vijmë te puna e hambarit, duhet ta kemi tē tērë sasinë që kemi llogaritur. Por, mund që edhe tē mos e kemi. Atēherë, nē qoftë se nuk e kemi nē grurë, duhet tē marrim më tepër misër, më shumë prodhime nga lopët, fjala vjen, kështu që e kompensojmë me misër, me qumësht ose me pjellshmërinë e lopëve, me lëkurët, me leshin etj. Por, nē qoftë se nuk merr as qumështin, as grurin, as misrin, do tē thotë se angazhimin që ke marrë, nuk e realizon as si global. Kështu, nuk na dalin

mirë llogaritë, dhe kjo për ne paraqet rrezikshmëri.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në kuadrin e futjes së shkencës në bujqësi, në kooperativa bëhen studime të vazhdueshme agronomike dhe pedologjike.

SHOKU ENVER HOXHA: Se toka varfërohet, po edhe pasurohet.

SHOKU RAMIZ ALIA: Një specialist i bujqësisë, kur diskutoi tha se blegtoria nuk e siguron plehun e nevojshëm; me një fjalë, ai ngriti çështjen që zhvillimi i mëtejshëm i blegtorisë është një domosdoshmëri edhe për vetë zhvillimin e bujqësisë. Ai kritikoi edhe komitetin ekzekutiv të rrethit, sepse në planifikim nuk balancohet mirë baza ushqimore e blegtorisë me prodhimet e tjera. Ne flasim për zhvillimin e blegtorisë, por nuk ia kemi siguruar si duhet bazën ushqimore kësaj blegtorie.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, këto duhet t'i shikojnë se, në përgjithësi, u është lënë një sasi sipërfaqje si bazë për blegtorianë, por s'marrin rendimentet e duhura; ndaj duhet luftuar edhe për ngritjen e rendimenteve.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në rrethin e Korçës pikë e dobët mbeten zonat malore. Tendenca që ka qenë në këto zona për t'u larguar nga fshati, mund të themi se është zhdukur. Ju kujtohet, shoku Enver, që ju ka ardhur njëherë një letër, ku djemtë e këtyre zonave ankokeshin se nuk gjenin vajza për t'u martuar?!

SHOKU ENVER HOXHA: Ata detyroheshin t'i merrnin nuset larg, andej nga Skrapari.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kurse tani faktori ekono-

mik ka bërë që djemtë të rrinë në fshat; pér pasojë, me këtë zgjidhen edhe probleme të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Po pemët si ishin?

SHOKU RAMIZ ALIA: Frutat në përgjithësi ishin mirë. Mollët qenë dëmtuar pak, por si sasi ka.

SHOKU ENVER HOXHA: Është interesant se nganjëherë më sjellin ndonjë mollë shumë të bukur nga pamja e jashtme, kurse brenda del e prishur. Disa herë kështu më ka ndodhur. Nuk e di nga cili sektor i kanë marrë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Lidhur me pemëtarinë në plenum pati një kritikë ndaj organeve të tregtisë. Shumë prodhime, thanë ata, na u kalbën, se nuk na i tër-hoqi tregtia.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne duhet ta inkurajojmë shtimin e prodhimit, sidomos në pemëtari. Në vend që të bëjnë këtë, shokët e tregtisë merren me llafe të kota: «Kemi kontrata pér kaq, kemi kontrata pér aq». Atëherë u duhet thënë rreptë: «Blini mollët, pse i lini të kalben! Shitini aty, në fshat, apo dhe gjetkë, në qoftë se nuk keni vend pér t'i ruajtur. Jepjani pullit t'i hajë».

SHOKU RAMIZ ALIA: Më duket se nga kjo pikëpamje, organet qendrore, duhet t'i ndryshojnë një çikë metodënd dhe konceptet e tyre mbi tregtimin e frutave. E kam fjalën pér një organizim dhe shpërndarje më të mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo një çikë, po do organizim shumë më të mirë, si në pemëtari, ashtu dhe në zarzavate. Shokët që merren me tregtimin dhe

shpërndarjen e tyre duhen kritikuar rëndë. Jo të rrinë frutat e të kalben, ose t'ua hedhim lopëve apo t'i bëjmë uthull, por t'i tregtojmë në kohë që ato t'i hajë populli.

SHOKU RAMIZ ALIA: Edhe për patatet për farë u ngrit problemi që nuk po ua tërheq Ministria e Bujqësisë. Mirëpo këto ekonomi dëmtohen rëndë, në qoftë se nuk u përgjigjesh në kohë për prodhimet e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Kooperativat nuk mund të mbajnë patate për farë për türë kooperativat bujqësore të rrëthit, sepse patatja lëshon sytha dhe prishet. Në qoftë se do farën e patates së Korçës, atëherë duhet të marrësh masa ti, si ministri, dhe t'ia bësh asaj të gjitha shërbimet e duhura që të mos prishet!

SHOKU RAMIZ ALIA: Shokët e zonave malore ngriten problemin e transportit. Këtu është fjala për të gjitha llojet e transporteve, që nga ato më primitivet, me kárro dhe me qe e deri tek automjetet.

SHOKU ENVER HOXHA: Kemi edhe automjete që na lëvizin kot. Ne kemi nxjerrë një urdhëresë që Ministria e Komunikacionit të mos lejojë përdorimin e automjeteve në ato zona ku kalon hekurudha, por kjo urdhëresë nuk po zbatohet. Ministria duhet t'i blokojë automobilat kur përdoruesit e tyre e shkelin këtë urdhëresë, e t'i futë në park. Ne e kemi llogaritur që rrëthi, ndërmarrja apo kooperativa, të ketë kaq apo aq autombila; po të duash të tjerë, unë nuk t'i jap. Këto që grumbulloj në park, do të t'i lëshoj kur të vijë koha e frutave, fjala vjen, kur të fillojë vjelja e mollëve ose e dardhave në Korçë, me shumicë të madhe. Flasim ne

edhe për mjetet e tjera të transportit, si me qe, me kuaj ose me karro, po as këto nuk i kemi aq sa janë mundësitë. Por, në fund të fundit, edhe ato që i kemi nuk i administrojmë mirë. Pse kërkojmë ne që të administrohen mirë qetë e karrot, kur nuk administrojmë siç duhet automobilat tanë shtetërorë? Në teori pranohet se urdhëresat e vendimet janë të drejta, por, në praktikë duhet të shikojmë mirë shfrytëzimin rigoroz të mjeteve të transportit, se ka edhe shkelje.

SHOKU RAMIZ ALIA: Këto ishin në përgjithësi problemet për bujqësinë. Për industrinë nuk ka ndonjë problem. Më tërhoqën vëmendjen punëtorët. Një pjesë e madhe kishin mbaruar shkollën e mesme, kurse një pjesë tjetër ishin regjistruar me korrespondencë në shkollën e lartë.

SHOKU ENVER HOXHA: Punëtorëve që janë me shkollë të mesme t'uа japim të drejtën të vazhdojnë shkollën e lartë, natën ose me korrespondencë. Por kjo nuk do të thotë që kush mbaron shkollën e lartë, duhet medoemos t'i gjendet vendi i punës si kuadër i lartë në atë qendër pune ku është. Jo. Ai mund të qëndrojë me punë edhe atje ku është, punëtor apo më vonë mund të bëhet edhe brigadier, por, si kuadër i lartë, njësoj si të tjerët, të punojë ku të ketë nevojë atdheu. Por duhet parë që gjithë kjo të bëhet brenda mundësive. Kemi trupë arsimore në universitet e në institute që të përballojnë gjithë kërkesat? Prandaj, kjo duhet theksuar që të bëhet brenda mundësive.

SHOKU RAMIZ ALIA: Dakord, shoku Enver, sepse kjo varet nga mundësitë që kemi ne si shtet.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu që duhen parë dhe kriteret që kemi pasur më parë. Për atë kohë, ato ishin të pranueshme, sepse atdheu kishte shumë nevojë për kuadro me arsim të lartë, kurse tani kërkesat janë më të mëdha, se nuk është më ajo gjendje. Ata që pranohen në universitet, me shkëputje nga puna, duhet të kenë disa karakteristika më të plota nga ata që e ndjekin natën. Për këta të natës nuk kërkohet që të kenë notën mesatare aq të lartë sa ata të ditës. Teorikisht, ky që vete me notë mesatare të lartë, për shembull, 10, duhet të dalë më mirë dhe, ta zëmë, del. Por, në jetë, ai mund që të mos e justifikojë atë. Ai tjetri që ka marrë gjashtën ose shtatën, e që e mbaron universitetin natën ose me korrespondencë, në jetën praktike mund të tregohet shumë më i zoti dhe ia kalon atij që ka marrë 10. Kjo është e vërtetë, se edhe ka ndodhur. Një që ka mbaruar universitetin me dhjeta, për shembull, e emërojnë agronom. Vjen në fshat, por nuk bën gjë. Atëherë, unë që drejtoj kooperativën, i them: «Pa largohu ti!». Pastaj i drejtohem atij tjetrit, që e ka mbaruar universitetin me korrespondencë i cili vërtet nuk e ka mbaruar atë me nota shumë të mira, por është treguar zhivë në punë dhe këtë e caktoj agronom. Domethënë jeta do ta vërtetojë edhe këtë, edhe atë. Por, deri tani, në bazë të rregullave që kemi, në fillim, e ka radhën ky që mbaron universitetin ditën. Kështu duhet parë kjo.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në konferencë u fol edhe për ngritjen e gruas në përgjegjësi. Pati dhe kritika direkt me emër.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë drejt, që e kanë ngritur këtë problem, se është rrethi që ka qenë dhe është nga më të përparuarit dhe tani të tërhiqesh për ngritjen e gruas në përgjegjësi, nuk bën. Ta bëjë një gjë të tillë zona malore, nuk duhet lejuar, aq më pak në zonën fushore. Të shohim nëse do t'i zbatojnë këto që kanë thënë.

Ishte Miha [Lako] në konferencë?

SHOKU RAMIZ ALIA: Po ishte. Keni shumë të fala.

SHOKU ENVER HOXHA: Është mirë me shëndet?

SHOKU RAMIZ ALIA: Më bëri përshtypje, shoku Enver, se është një komunist me partishmëri të lartë. Kjo më tërroqi vëmendjen. Bisedova një çikë me të për Grupin e Korçës, meqë lexova një artikull në gazeten «Përpara», i cili nuk u mbetej besnik precizimeve që ka dhënë Historia e Partisë. Apostafat i thashë dhe Mihas. Për këtë, u tërroqa vëmendjen shokëve të gazetës, të cilët duhet t'u përbahen vlerësimet që ka bërë Partia në dokumentet e saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Kryesori i Grupit Komunist të Korçës ka qenë Miha Lako. Ishte edhe më i sigurti dhe bashkëpunëtor i Ali Kelmendit. Kurse të tjerët, si Koço Tashkoja, që u hoq si i luftës, nuk i dëgjonte njeri. Miha Lako ishte në grup bashkë me ata të vjetrit. Pastaj erdhi Koço Tashkoja që thoshte se «unë vij i dërguar nga Kominterni» etj., por këto s'ish-in gjë tjetër veçse pretendime të tij.

SHOKU RAMIZ ALIA: Miha është njeri shumë i mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur isha njëherë me një delegacionin tonë në Bukuresht, Miha ishte atje ambasador. Kur u takuam më thotë se udhëheqësit rumanë nuk janë marksistë-leninistë. Atëherë, Dezhi akoma nuk kishte dhënë shenja se kush qe në të vërtetë, ndaj unë i thashë: «Dale, Miha, mos u nxito!». «Dëgjomë mua, — më thotë ai, — këta s'janë në rregull duke filluar që nga Dezhi dhe të tjerët, nuk janë të mirë!» «More Miha, mbahu një çikë, — i thashë unë, — mos fol kështu!». Megjithatë ai prapë ngulte këmbë në të tijën. Kur u kthye nga Rumania, unë e takova prapë Mihan dhe i thashë se kishte pasur të drejtë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

PO TË SHQETËSOHESH PËR FURNIZIMIN E KOOPERATIVISTËVE, E GJEN RRUGËN E ZGJIDHJES

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

4 tetor 1976

SHOKU HEKURAN ISAI: Mora pjesë në konferencën e Partisë të rrethit të Shkodrës. Në këtë rreth ka një situatë mjaft optimiste që shprehej edhe në realizimin e detyrate.

Një diskutant, drejtori i ndërmarrjes së ndërtimit, kritikoi ministrinë për vonesën e ardhjes së projekteve.

SHOKU ENVER HOXHA: Më fal se po të pres fjalën. Pashë një emision në televizionin tonë. Isha me Klemin¹. Pa na trego, i thashë, se cilët janë këta që po shohim këtu në televizor? «Këtë, — më tha Klemi për njërin, — e kanë dërguar për inxhinier, megjithëse është arkitekt». Po përsë e kanë dërguar inxhinier? Sigurisht, kur janë në një ndërmarrje, mund të thonë

1. Klement Kolaneci, arkitekt.

se mjaft e kemi një, kurse ti tjetri shko tani e puno si inxhinier. Këtë e bëjnë se u kemi dërguar dy arkitektë, kurse ndërmarrjes i duhet vetëm një. Ata shokë, që merren me kuadrin e që ua dërgojnë tepër, nuk shqetësohen fare nëse arkitektët u duhen edhe rretheve të tjera, ose edhe Tiranës, në ndonjë ndërmarrje tjetër.

SHOKU HEKURAN ISAI: Në diskutimin e tij ky shok kritikoi edhe komitetin ekzekutiv të rrëthit për veprat nënkuqi, sepse ka mundësi që ato të projektohen dhe të mbarojnë sa më shpejt, kurse, në fakt, planifikohen dhe mbarohen me zvarritje.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, ky nuk ka mundësi ta marrë fjalën në mbledhjen e komitetit ekzekutiv dhe t'u thotë: «Pa dale një çikë, more shokë, të ndalemi në këto punë»? Se, nuk mjafton që të bëhen kritika dhe pretime. Po ai kë pret, kur e di që këto vepra mund t'i ndërtojë më shpejt, sepse ai vetë po i ndërton? Mund të thotë: «Pse po i zvarritim këto?», në qoftë se zvarriten, këto mund t'i zvarrit unë, por jo ti! Ti, punëdhënësi, po, duhet të m'i japësh një çikë më shpejt dhe të më kritikosh atëherë kur unë nuk i ndërtoj në kohë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Në konferencë dolën edhe disa probleme tek të cilat ia vlen të ndalesh për t'i studiuar, si për shembull: Mos duhet bërë brenda rrëthit një kombinim e një organizim më i mirë për kulturat bujqësore në mënyrë që bimët të kultivojen atje ku merret rendimenti më i mirë?

SHOKU ENVER HOXHA: Ne kemi studimin e kooperativës bujqësore të Plasës, në rrëthin e Korçës.

Në qoftë se Vermoshi, fjala vjen, merr prodhime më të larta në patate për hektar, atëherë jepja pataten për ta kultivuar kësaj kooperative. Dajçi, fjala vjen, merr 40 kuintalë patate për hektar dhe i planifikohet që të mbjellë një sipërfaqe prej 20 hektarësh. Po pse të mos i vihet detyrë kësaj kooperative që të mbjellë një sipërfaqe prej 10 hektarësh me patate e të bëjë ç'është e mundur për të marrë 120 kuintalë për hektar dhe të përballojë medoemos të gjitha nevojat e kooperativës me patate. Kështu duhet të veprohet! Se ne kemi eksperiençë që kjo bimë është nënveftësuar. Ç'është për kooperativën e Dajçit një sipërfaqe prej 10 hektarësh? Hiçgjë. Po ai e mbjell dhe s'i bën as shërbime dhe as e çan kokën për të furnizuar popullin me këtë prodhim. Kurse ti mund t'i planifikosh që të mbjellë 20 hektarë dhe ai nuk bën përpjekjet e nevojshme, por kënaqet me 30 kuintalë patate për hektar. Ne, për këto probleme nuk mund të nxjerrim ligje pse drejtuesit e kooperativave apo edhe të rrethit nuk i vënë rëndësi kultivimit të patates. Unë jam dakord që të bëhet një kombinim e planifikim më i mirë brenda rrethit, por pataten duhet ta prodhojë kooperativa. Jo vetëm kaq, por mund t'i thuash edhe: «Më prodho edhe tre-katër kuintalë fasule për hektar, meqenëse mbjell kaq hektarë me misër. Pra, pa më merr edhe fasule në tokat e mbjella me misër, ose më mbill veç patateve e fasuleve edhe qepë, bamje e perime të tjera!». Mangësitë që vihen re tregojnë se s'ka kokëçarje për furnizimin e kooperativistëve, se po të ketë kokëçarje medoemos e gjen rrugën e zgjidhjes.

SHOKU HEKURAN ISAI: Unë isha në Prosek të Mirditës; kooperativa po u shiste anëtarëve fasule me 3 lekë kilogramin, kurse një kooperativë tjetër ua jep-te me 5 lekë. Në treg të lirë fasulja shitet deri në 10 lekë kilogramin. Këto mos krijojnë ndonjë shteg për spekulim, se kooperativisti, ato që merr, mund t'i she-së në pazar me dyfishin e çmimit që i ka blerë ose më tepër.

SHOKU ENVER HOXHA: Kriteret që kemi vënë për çmimet, mendoj unë, nuk lënë shteg për spekulim, përkundrazi janë në dobi të kooperativistëve. Kooperativa ua shet anëtarëve me një çmim më të ulët, se ajo është vetë prodhuese dhe kooperativisti nuk na bën konkurrencë, pasi shteti e merr nga kooperativa atë sasi që kemi për të marrë. Çfarë t'i themi ne kooperativës, që t'ua shesë anëtarëve më shtrenjtë se 10 lekë kilogramin? Kooperativa e Vermoshit, fjala vjen, do t'ua shesë patatet kooperativistëve të vet më lirë sesa ua shet kooperativa e Shllakut që mezi i prodhon. Fshatari mund t'i blejë në kooperativë me 3 lekë ki-logramin dhe nuk i konsumon vetë, por kërkon t'i shesë. Po mirë, po të dojë, le të mos i hajë, e t'i shesë dhe le të fitojë 6 lekë për kilogram, por, ama të vejë t'ia japë shtetit me 10 lekë, dhe jo t'i shesë me çmim më të lartë vetë, se në këtë rast ai ushtron tregun e zi. Ne kemi lejuar një limit çmimesh në çdo rrëth. Diferencën e çmimeve ua kemi lënë në kompeten-cë komitetet e ekzekutive, të cilat, sipas kohës dhe zo-nës, i vendosin ato, prandaj ne nuk duhet të futemi deri në këto gjëra.

SHOKU HEKURAN ISAI: Në kooperativat me nivel të ulët, ka tendencë për t'i shpërndarë prodhimet, duke arsyetuar që, meqenëse nuk marrin lekë shumë, të marrin prodhime.

SHOKU ENVER HOXHA: Ata, në radhë të parë, duhet të punojnë më shumë që të rritin prodhimet, se kështu rriten të ardhurat e kooperativistëve.

Unë këtë e kuptoj kështu. Kooperativat japin prodhim aq sa kanë angazhimet ndaj shtetit dhe pjesën tjetër e shesin.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në qoftë se kooperativa ka prodhime që t'u japë anëtarëve, kjo do të thotë që ajo ka edhe para se, në vend që t'ia japë prodhimin anëtarit, atë ajo ia shet shtetit me para, të cilat ua shpërndan anëtarëve, domethënë, është e njëjta gjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Marrëdhëniet midis anëtarëve, për sa u takon çmimeve, shpërndarjes së prodhimeve e të tjera, janë çështje të komitetit ekzekutiv dhe s'ka përse të futet ministria. Çfarë do të bëjë ajo? Kështu mendoj unë, nuk ka pse të futet as ministria e Bujqësisë dhe as ajo e Tregtisë, vetëm për arsyen se kjo e dyta ka atje dyqanet e shitblerjes. Ajo e porosit shitësin që të blejë sa të jetë e mundur më shumë prodhime, me çmimet që kemi caktuar, pra, i thotë jo vetëm shit, por edhe bli. Ne kemi shitës të mirë e të dalluar, emrat e të cilëve i kemi parë edhe në gazeta, të cilët u venë fshatarëve deri në shtëpi dhe ua blejnë vezët e prodhimet e tjera që kanë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Problem janë dhe ndër-

timet në fshat. Kështu si është lënë ky problem, u hapet shteg vjedhjeve dhe shpërdorimeve.

SHOKU ENVER HOXHA: Në kooperativat bujqësore janë ngritur skuadrat e muratorëve që merren me ndërtimet dhe mceremetimet e shtëpive, nën drejtimin e kryesisë së kooperativës dhe të këshillit populor të fshatit. Bile ata i kanë të caktuara edhe normat, domethënë, ditët e punës. Tani atyre ne u kemi vënë detyrë që të ndërtojnë edhe shtëpitë që bën shteti në fshat.

SHOKU HEKURAN ISAI: Kështu është vendosur, por konkretisht, në fshat, me rregullimin e shtëpive të kooperativistëve nuk merret njëri, se skuadra e muratorëve nuk ia del dot, siç tha një kryetar kooperative, të rregullojë objektet e kooperativës dhe jo të ndërtojë e të meremetojë shtëpitë e kooperativistëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo varet nga kushtet konkrete. Në qoftë se në një kooperativë, bie fjala, ndërtohen stalla për blegtorinë, kooperativisti duhet të presë, se, në radhë të parë, do t'i japim precedencë zhvillimit të prodhimit. Në qoftë se duan fshatarët të zgjerohen dhe të ndërtojnë 20 apo 30 shtëpi të reja, atëherë, të krijohen skuadra të tjera muratorësh, por jo të hiqen nga punët e kooperativës, se kjo është e dëmshme. Për sa i përket vendit, ato nuk duhen ndërtuar jashtë atij terreni që është caktuar. Si do ta bësh shtëpinë ti, kjo është puna jote; bëje me dy kate, ose me një; me tri dhoma, ose me dy; me çardhaqe ose pa to, se atje nuk ka kërkesa nga urbanistika, si në qytet, por ama të bëhen brenda kufirit të caktuar.

SHOKU HEKURAN ISAI: Unë e kam fjalën për materialet: ku i gjen ai këto materiale?

SHOKU ENVER HOXHA: Derisa e bën shtëpinë, ai ka menduar edhe për ato. Ku dhe si do t'i gjejë, këtë punë duhet ta organizojë komiteti ekzekutiv.

SHOKU HEKURAN ISAI: Shumica e atyre që ndërtojnë shtëpitë, materialet i gjejnë në rrugë të shtrembër.

SHOKU ENVER HOXHA: Për këtë po, jemi dakord që duhet të shqetësohem. Prandaj themi se komiteti ekzekutiv duhet të vëré rregulla të forta. Por, në fakt, kooperativisti i gjen materialet. Komiteti ose ka rezerva, ose lë pa ndërtuar objekte të tjera që ka caktuar në plan. Nuk përjashtohet që këtu luan edhe hatëri. Kjo, po, qëndron. Veçse kjo nuk mund të thuhet e prerë, se jo të gjithë ata që meremetojnë ose ndërtojnë shtëpi të reja në fshat, i marrin materialet në rrugë jo të rregullt ose i vjedhin, për arsyen se shteti ka parashikuar dhe ka nxjerrë në treg një sasi materialesh ndërtimi përfshatin, pra, ka kontingjente e plane.

SHOKU HEKURAN ISAI: Atje u shpreh dhe shqetësimi se, duke prerë dru fshatarët për të bërë shtëpi, po na dëmtohen shumë pyjet.

SHOKU ENVER HOXHA: Për këto punë janë caktuar rregulla dhe sanksione. Megjithatë ndodh që fshatari vete në pyll dhe pret dru fshehurazi. Me sa duket ose dikush e lejon këtë, ose ai vetë i shkel rregullat që janë vendosur. Ne kemi edhe vende të caktuara ku kooperativa mund të presë lëndë druri për nevojat e saj e të anëtarëve, sigurisht, në fillim, të atyre që janë

më nevojtarë. Por, siç thashë, ka edhe raste që bëhen favore ose që shitet lënda e drurit nën dorë. Të tilla gjëra na bëhen edhe në qytete. Deri dje, kur ishin Abdyl Këllezët me shokë, shumë gjëra bëheshin jastë planit e rregullave të caktuara dhe ato kapnin miliona. Ju keni qenë vetë në këto analiza. «Shtëpi do ti? — i thoshte Abdyl Këllezi atij që i interesonte, — të rregulloj unë!».

SHOKU HEKURAN ISAI: Për bagëtitë e imëta doli se janë shtuar më shumë ato të oborreve personale sesa ato të kooperativave.

SHOKU ENVER HOXHA: Po të janë shtuar brenda normave të caktuara, kjo na intereson dhe këtë nuk duhet ta ndalojmë, sepse e kemi caktuar me ligj, me statut. «Kisha pesë krerë, — thotë ndonjëri, — kurse tani i bëra 10!» Të lumtë, se kjo na sjell përmirësimë, pavarësisht se nuk shtohen ato të kooperativës.

SHOKU HAKI TOSKA: Bagëtitë personale edhe ndahan.

SHOKU HEKURAN ISAI: Ndarja, që thotë shoku Haki, nuk bëhet jashtë normave që cakton statuti. Në fakt, kjo shtesë është si rezultat i ndarjes, i shpërbërjes së familjes patriarchale.

SHOKU ENVER HOXHA: Ata s'janë më një familje, por janë të ndarë në tri familje. Në qoftë se do t'i konsiderojmë përsëri një familje, atëherë po, nuk duhet t'i lejojmë që secili të ketë nga 20 krerë. Po me se i ushqejnë ata këto bagëti? Ky është një problem, që e vlen të diskutohet, për arsyen e ajo tokë që ka secili, nuk i mjafton për të ushqyer bagëtitë e imëta që

ka, dhe lopën. Atëherë, do të detyrohet t'i ushqejnë nëpër tokat e kooperativës dhe për këtë, bëjnë veshin e shurdhër të gjithë anëtarët e tjerë. Ky është edhe një nga shkaqet që nuk shtohen sa duhet bagëtitë e kooperativës.

SHOKU HEKURAN ISAI: Ashtu është, si thoni ju shoku Enver, prandaj, edhe shokët ngritën problemin e sigurimit të bazës ushqimore.

SHOKU ENVER HOXHA: Të krijojnë tufat kolektive, të shtojnë foragjeret në ato toka që kanë dhe të spastrojnë edhe kullotat ekzistuese — kjo është rruga më e drejtë, sidomos në zonat e malësisë, ku kemi një numër më të madh bagëtish në oborret, sepse u kemi lënë më shumë bagëti të imëta për familje. Këtë ne nuk e kemi bërë kot, por sepse kemi parë interesin e kooperativistit dhe e kemi parë drejt. Kooperativisti i malësisë thotë se është në kushte më të vështira, se tokën e ka në gërxhe. Mirëpo tani edhe tokat në gërxhe janë bërë pjellore, ashtu sikurse janë bërë pjellore edhe në zonat e tjera. Në qoftë se nuk i ke bërë pjellore, do të thotë që ti nuk ke punuar sa duhet, pra, ke bërë edhe pak ditë-punë në vit, në kooperativë. Bagëtitë e imëta të oborrit fshatari i kullot lirisht dhe: «Rroftë prona personale», kurse për pronën e përbashkët të kooperativës nuk përpinqet ta zhvillojë. Por do të vijë një kohë që oborri personal do të shkurtohet.

Kooperativave malore, t'u vëmë si detyrë që të bëjnë tarraca, të hapin toka të reja etj., etj., që të kenë mundësi të mbjellin sa më shumë drithëra, patate, pe-

rimë etj., dhe të shtojnë bagëtitë e tufës kolektive. Shtimi i bagëtive të kooperativës vetveti do të thotë që të shkurtohen ato të oborreve, për arsyen se nuk ka ku t'i kullotësh. Kjo do të vijë në mënyrë dialektike kur të krijohen kushtet e përshtatshme. Atëherë Partia dhe pushteti do t'i thotë kooperativistit: «Pa dale, se tani erdhën të tjera situata, tani ti ke më shumë të ardhura, nevojat të plotësohen në rrugën e pronës kolektive, prandaj duhet të kalosh në një kategori tjetër e nuk ka nevojë të kesh aq krerë sa ke pasur, por më pak».

Fjalën e kam këtu që këto probleme nuk zgjidhen menjëherë, me një të diskutuar. Këto janë probleme ekonomike e shoqërore, të rëndësishme për zonat mëalore. Të shihet zhvillimi ekonomik i këtyre zonave dhe, lidhur me këtë, të ndryshojnë edhe normat që janë caktuar, se në kohën kur janë vendosur ato, ishte e natyrshme që të bëheshin ashtu. Ky nuk është një problem që ka lindur tani, spontanisht, por i vazhdueshëm e i përgjithshëm. Në parim, këto probleme nuk duhet t'i shikojë rrethi, se nuk janë në kompetencën e tij, e si të tilla, ai nuk mund t'i zgjidhë. Kurrkujt nuk i lejohet të marrë masa të pastudiuara. Prandaj është e kотë të ngrihet ky problem, meqenëse «u shtua numri i bagëtive të oborrit». Le të shtohet! Të luftojmë që të shtohet edhe bagëtia e kooperativës, se këtë nuk po është dot. Ja, këtu është e keqja.

SHOKU HEKURAN ISAI: Lidhur me arsimin kanjë shqetësim. Në Shkodër ka dy shkolla të mesme bujqësore. Ata ngrenë problemin nëse duhet t'i kemi

këto shkolla bujqësore në këtë qytet, kur të tilla kemi edhe në rrëthet e tjera.

SHOKU RAMIZ ALIA: Unë mendoj se shkolla për pyjet nuk ka pse të kemi në të gjitha rrëthet, por na mjafton vetëm një shkollë siç është ajo e Shkodrës. Por në këtë qytet, në kemi, thonë ata, edhe një shkollë bujqësore, ku vijnë nxënës me bursë nga gjithë Shqipëria, në një kohë kur shkolla bujqësore janë hapur gati në çdo rrëth. Pra, nuk është më logjike që shteti t'u paguajë bursë nxënësve nga rrëthet e tjera që të venë për të ndjekur shkollën bujqësore në Shkodër, në një kohë që atë e kanë edhe në rrëthin e tyre. Këtë çështje ngre Hekurani.

SHOKU ENVER HOXHA: Në asnjë mënyrë, të mos u japim bursa, në qoftë se kjo shkollë nuk është speciale dhe në qoftë se si ajo kanë edhe rrëthet e tjera. Nxënësit t'i ndjekin këto shkolla në rrëthin e tyre.

SHOKU RAMIZ ALIA: Unë kam biseduar me shokët e Shkodrës që në qytet të ketë shkollë bujqësore edhe për vetë nxënësit e qytetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, për qytetarët e Shkodrës le të ketë shkollë bujqësore. Nxënësi të banojë në shtëpinë e tij e të vazhdojë edhe shkollën.

SHOKU HYSNI KAPO: Për shkollat e mesme të profilizuara, që përmendi Ramizi, unë them se mund të kemi disa të tilla, për disa specialitete, si, për shembull, për veterinerë, zooteknikë, për miniera, ndërtimë etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Dhe në këto shkolla të mos venë vetëm ata të rrëthit, por nga e gjithë Shqipëria.

përia. Pasi t'i mbarojnë ato, shpërndahen përsëri në rrethet e tyre.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

TRAGJEDIA E KINËS

Shënimë

12 tetor 1976

Tragjedi e madhe në Kinë. Ato që parashikonim se do të ngjisnin në Kinë, pas vdekjes së Mao Ce Dunit, ndodhën dhe bile ngjarjet u zhvilluan me një shpejtësi të rrufeshme. Mendonim se të dy korrentet, edhe të djathët, edhe të majtët, do të vazhdonin «të bashkëjetonin në divergjenca», ashtu siç kishte bërë gjithë jetën Maoja dhe siç i këshillonte bashkëpunëtorët të vepronin edhe pas vdekjes së tij, e kurdoherë. Vetëm se «timonieri i madh» i dy ose më shumë vijave kishte krijuar një autoritet të atillë, që mund të mbante zigarenë në dorë. Por çfarë zigareje? Asnjëherë të vërtetë dhe konsekiente marksiste-leniniste.

Mao Ce Duni fliste me formula revolucionare për «revolucionin», për «luftën e klasave» dhe për çështje të tjera parimore, por në praktikë ai ishte një liberal, një ëndërrues, një centrist në drejtim të manipulimit dhe të balancimit të korrenteve të ndryshme që bënин pjesë dhe intrigonin në Partinë Komuniste të Kinës

dhe në shtetin kinez. Mao Ce Duni, me të tilla karakteristika, influencohej kollaj nga njëri ose nga tjetri korrent; një herë mbështete njërin, një herë tjetrin.

Çka është e vërtetë dhe e dukshme, Çu En Lai ishte «Jagoja» më i madh i dramës shekspiriane kineze. Ai ishte i djathtë, ishte një mandarin, ishte borgjez, ishte pseudomarksist. Në manipulimet që bënte Maoja, Çu En Lai ka manovruar me mjeshtëri. Kur mbytej vaporë i një korrenti reaksionar, ku Çuja ishte brenda, ky linte me të shpejtë vaporin dhe fshihej nën flamurin e Maos.

Duhet ritheksuar se Maoja vë në dukje në revolucion rolin primordial të fshatarësisë dhe në këtë drejtim del që ai nuk është dakord me rolin udhëheqës dhe hegjemon të klasës punëtore. Idetë e tij të lëkundshme, siç janë ato mbi fshatarësinë, pasqyrohen në të gjithë vijën liberale të Mao Ce Dunit.

Maoja, në teori, pranonte disa parime bazë të marksizmit. Në shkrimet e tij zyrtare këto parime dhe disa çështje të tjera, në përgjithësi, janë formuluar drejt. Por në praktikë Maoja ka formuluar e ka mbrojtur teza jomarksiste siç është teza që theksohet edhe në nekrologjinë e tij: «Fshati duhet të rrrethojë qytetin». Nekrologjia thekson se «pa vepruar kështu, nuk mund të bëhej revolucioni! Kjo do të thotë që revolucionin proletar duhet ta udhëheqë fshatarësia. Kjo tezë është antileniniste.»

Por Maoja ka parashtruar edhe teza e pikëpamje të tjera, me të cilat ne s'kemi qenë dhe s'jemi dakord. Ai ka shkruar shumë për luftën e klasave, për kon-

tradiktat etj.; por lufta e klasave në Kinë, sidomos në praktikë, nuk është bërë e ashpër dhe me konsekuencë. Edhe në këtë drejtim Maoja është treguar liberal dhe moderator. Ai lejonte të merrnin fuqinë dhe të zinin rrënje të thella' në parti, në pushtet e kudo elementë të djathtë revizionistë. Maoja bashkëjetonte me ta, i bënte sehir, shumë herë i aprovonte. Më në fund ai rrëzonte disa krerë të këtyre rrymave, por bazën e tyre e linte të paprekur. Autoriteti i tij i krijuar gjatë luftës dhe pas fitores bënte që fraksionet «të dështonin», por zgjidhja mbetej në mes të rrugës dhe gjendja vazhdonte kurdoherë e moderuar, liberale. Mao Ce Duni ishte një centrist, ai mbante asër njerëz të rrymave të ndryshme që quhen marksistë, por që nuk ishin të tillë dhe luftonin në vijën e tyre, nën ombrellën e Mao Ce Dunit. Kur këta e prishnin ekuilibrin, Mao Ce Duni ndërhynte dhe «vinte rregull».

Në mendimet dhe në veprimet e Maos kishte pa-qëndrueshmëri, dhe unë mendoj se interpretimi dhe zbatimi i marksizmit nga ana e tij është bërë disi në mënyrë fantaziste, si t'i pëlgente atij. Kjo, natyrisht, «shpjegohej» e «justifikohet» me «kushtet e Kinës».

Maoja, edhe shumë vjet pas çlirimt, nuk i përmbyssi bazat e klasave të pasura e shfrytëzuese kapitaliste si në qytete, ashtu edhe në fshatra dhe nuk i likuidoi privilegjet e tyre, duke pretenduar se «kjo ishte një taktikë derisa të stabilizonte gjendjen». Por kjo «taktikë» nuk duhej kthyer në teori dhe në strategji, sipas së cilës kapitalistët «të integrohen në socializëm», të marrin dividende dhe kjo gjë të vazhdojë me dhjetëra

vjet, siç po ngjet akoma në Kinë. Këta kapitalistë na janë kthyer në «komunistë» dhe janë bërë një pjesë e «borgjezisë në parti», për të cilën flet Maoja.

Edhe Partia Komuniste e Kinës nuk i ka të qarta parimet bazë të teorisë marksiste-leniniste; përkundrazi, i ka zëvendësuar me idetë eklektike të Maos. «Borgjezia është në parti dhe ju nuk po e shikoni», thotë Maoja. Dhe kjo është e vërtetë. Mirëpo kush e ka lejuar këtë borgjezi të rrojë këmbëkryq në parti? Këtë e ka lejuar vetë Maoja me idetë e tij, e ka lejuar mungesa e një ndërtimi të drejtë organizativo-politik dhe ideo-logjik marksist-leninist të partisë. Maoja lejoi lulëzimin e shumë vijave, të oportunizmit, të prakticizmit dhe të liberalizmit.

Në «kthesat» e Partisë Komuniste të Kinës, Mao Ce Duni nuk është mbështetur te partia, por tek ushtria, tek inteligjencia dhe te studentët. Në këto «kthesat» punëtoria dhe fshatarësia ose kanë qenë në dorë të kundërrevolucionarëve, ose kanë qëndruar mënjanë.

Shtrohet pyetja: Pse Maoja nuk u bënte thirrje në momente të vështira partisë, klasës punëtore dhe fshatarësisë? Sepse ato forca ose nuk do t'i bindeshin, ose ai nuk i llogariste, se do të derdhej gjak. Në një kohë kur Maoja bërtiste: «Pushteti lind nga gryka e pushkës», reaksiioni po e rrëmbente këtë pushtet.

Revolucionin Kulturor, thonë se e shpërtheu dhe e udhëhoqi Maoja, i cili ngriti miliona hunveibinë me parullën: «Sulmoni shtabet!». Kurse ushtria dhe Lin Biaoja, thonë, lidhën duart. Mirëpo faktet flasin krejt ndryshe. Lin Biaoja ishte në krye të revolucionit bashkë

me Maon, Kan Shenin, Çen Po Tanë, Çian Çinin, Jao Ven Juanin, Çan Çun Çiaon e të tjerë. Sipas të dhënavë që kemi, Lin Biaoja dy milionë ushtarë i veshi civilë. Me këta «gardistë të kuq» ai sulmoi shtabet dhe i theu, kurse meritat, të gjitha, i mori Maoja. Ky shpëtoi Çu En Lain e shumë të tjerë dhe Ten Hsiao Pinin e konservoi në vilë.

Mirëpo Çuja manovroi shumë mirë dhe një mëngjes Lin Biaoja na u bë «tradhtar, agjent i sovjetikëve dhe komplotist kundër jetës së Maos». Dhe, gjoja për t'i vërtetuar këto, u tha se Lin Biaoja mori një avion, me të cilin u arratis në Mongoli, ku «avioni u dogj». Të gjithë ata që ishin brenda u vranë. Thuhet se Çuja dhe Maoja qenë vënë në dijeni, por Maoja paska thënë: «Le të ikë! Gjëra të çuditshme!

Pra, Lin Biaoja, si element i rrezikshëm për Çunë, u likuidua. Bashkë me të, pësoi të njëjtin fat edhe Çen Po Taja. Po Revolucionin Kulturor si ta likuidonte? Kjo ishte e zorshme për Çunë, se prekej Maoja, prandaj për të vazhdoi të flitej si më parë. Kan Shenin u plak e u sëmur rëndë, por mbetën të tjerët, të rinjtë, si Çian Çini dhe Van Hun Veni me shokë. Këta e filluan dhe e vazhduan revolucionin, por natyrisht, aq sa i lejonte «kryetari». Maoja i ndau rolet. Të majtëve u la në dorë shtypin dhe radion, kurse të djathëve, me Çu En Lain, u la pushtetin, ekonominë, ushtrinë dhe sigurimin. Nga kjo kuptohet qartë se si e shikonte revolucionin dhe ndërtimin e socializmit «timonieri i madh».

Maoja dhe Çuja ndërtuan edhe politikën e jashtme.

Politika e jashtme kineze e Maos dhe e Çu En Lait ka qenë e mbeti një politikë jomarksiste, jorevolucionare, ajo është një politikë fluide, që merr formë nga koniunkturat politike ndërkombëtare dhe zë pozita të rrezikshme për socializmin dhe revolucionin.

Gjatë kësaj kohe Çuja punonte për të lënë zëvendësin e tij dhe tok me Maon nxorën në skenë «Hrushovin numër dy» të Kinës, të cilin e bënë zëvendëskryeministër të parë, zëvendëskryetar të partisë etj. Tre vjet me radhë, sa ishte sëmurë e derisa vdiq Çu En Lai, Teni mori forca. Mirëpo, siç duket, të majtët ua vunë këmbët në një këpucë «timonierit» dhe Tenit. Këtij të fundit i ngritën këmbët dhe filloi demaskimi i tij. «Timonieri» atëherë manovroi «me gjenialitet» dhe, sipas zakonit të tij të dozimit të korrenteve, sa ishte gjallë, solli në fuqi Hua Kuo Fenin, njeri deri tash i panjohur, udhëheqës i sigurimit të shtetit dhe i moderuar me fjalë, por i djathjtë me vepra.

Maoja vdiq dhe në Kinë ndodhi tragjedia e madhe. Sapo kishte mbyllur sytë «timonieri», e djathta, me Hua Kuo Fenin në krye, bëri puçin dhe qëroi Çian Çinin, Van Hun Venin, Çan Çun Çiaon dhe Jao Ven Juanin. Këta të katër u arrestuan. Sot të djathjtët, duke përdorur fjalët e Maos, po vrasin, po burgosin të majtët e revolucionarët, po rehabilitojnë të djathjtët e dënuar dhe kundërrevolucionarët.

Nuk mund të imagjinohet kurrë se si fjalët e një «revolucionari marksist-leninist» mund të shërbijnë edhe në dobi të kundërrevolucionarëve, siç po ngjet në Kinë me të thënët e Maos!

Ç'nuk po thotë për Kinën shtypi borgjez kapitalist! Se radikalët me Çian Çinin në krye «komplotuan», se gjoja nipi i Maos e kishte kthyer trupin e Maos të së-murë nga ana e majtë, kundër këshillave të doktorëve etj., etj., dhe me këtë, gjoja, duan të vërtetojnë se «këta komplotistë vranë edhe Maon». «Lin Biaoja u orvat të vriste Maon tri herë», u trumpetua disa vjet përpara, kurse tash po trumpetohet se «komplotistët e vranë Maon dhe se donin të vritnin edhe Hua Kuo Fenin». Por komplotistët e vërtetë janë njerëzit e Çu En Lait, të Li Hsien Nienit, të Ten Hsiao Pinit, të Hua Kuo Fenit etj.

Asgjë nuk po botojnë zyrtarisht këta komplotistë, por po përgatitin dalngadalë masat që ta hanë këtë trillim tragjik. Reaksiuni kinez, i veshur me maska, hiqet si «revolucionar dhe marksist-leninist» dhe nën këtë maskë po grin revolucionarët dhe komunistët. Hrushovianët e Kinës po vrapijnë më nxitim të forcojnë pozitat. Ata përpiken të forcojnë pozitat me terror dhe me siguri do të arrijnë në atë që jo vetëm nuk do ta citojnë më Maon, por edhe ato që ky ka lënë me ndonjëfarë vlere, do t'i shkelin me këmbë. Me transformimin e Kinës në një vend kapitalist do të ngrihet figura e Liu Shao Çisë, e Çu En Lait, e Pen Çenit, e Ten Hsiao Pinit etj.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Shënimë për Kinën», vëll.
II, f. 276*

*Botohet sëpas librit:
Enver Hoxha, «Shënimë për
Kinën», vëll. II, f. 276*

KAOS I MADH NË KINË

Shënimë

13 tetor 1976

Kaos i madh në Kinë. Ka dy-tri ditë që agjencitë perëndimore dhe revizioniste të lajmeve, thonë se në Kinë është bërë një grusht shteti dhe kanë ardhur në fuqi «të moderuarit», siç i quajnë Huua Kuo Fenin dhe shokët e tij, me të cilët është dukur edhe Li Hsien Nieni. «Të moderuarit» përf me janë partizanët e Çu En Lait, janë ata revizionistë që ideologjinë marksiste-leniniste e kanë shkelur gati në të gjitha çështjet, duke u maskuar me një demagogji shurdhuese. Ata kanë zbatuar dhe po zbatojnë një politikë shoviniste të shtetit të madh, ndjekin një politikë të jashtme proamerikane. Kjo politikë që ka ndjekur Çu En Lai, ishte njëkohësisht edhe politika e Maos.

Nuk mund të ndahet Maoja nga Çu En Lai. Ata kanë vepruar së toku. Të dy ishin liberalë dhe përpinqeshin që, nën maskën e marksizëm-leninizmit, të krijonin një fuqi të madhe dhe të bënin një «politikë të madhe» në arenën ndërkombëtare, të përshtatshme me

madhësinë e Kinës. Me fjalë të tjera, ata synonin që Kina të bëhej një forcë ndërmjetëse që të balanconte peshën e dy superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik.

Siq kam shkruar edhe në shënime të tjera të këtij Ditari, Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë udhëheqja kineze e partisë dhe e shtetit, e cila kurdoherë ka lufuar nën flamurin e Mao Ce Dunit, kanë qenë kundër Stalinit, kundër Bashkimit Sovjetik leninist, kundër Partisë Bolshevikke dhe kundër Kominternit, por të gjitha këto qëndrime të tyre i mbanin të maskuara. Më vonç, pas vdekjes së Stalinit, këto qëndrime dhe pikëpamje që i ushqenin dolën në shesh. Udhëheqja kineze kishte për qëllim që të ndihmonte Hrushovin dhe hrushovianët për t'u mëkëmbur pas grushtit të shtetit që bënë ata në Bashkimin Sovjetik për të rrëzuar idetë e marksizëm-leninizmit. Qëllimi i Mao Ce Dunit, i Çu En Lait e i të tjerëve ishte njëkohësisht që, me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, Kina të bëhej një fuqi e madhe dhe Mao Ce Duni të zinte vendin pas Leninit, domethënë të hynte në radhën e klasikëve të mëdhenj të cilët, sipas tyre, ishin Marksi, Engelsi, Lenini, Mao Ce Duni. Për këtë gjë, natyrisht, ai duhej ta përkëdhelte Hrushovin dhe ta ndihmonte. Këtë e bëri jo vetëm fshehtazi, por edhe haptazi; jo vetëm nëpër kuluare, por edhe përpara mbledhjeve ndërkombëtare të partive komuniste dhe punëtore, ku asistonim edhe ne. Ne dëgjuam me veshët tanë çfarë tha Mao Ce Duni për veprimet e Hrushovit. Vetëm mburrje.

Mirëpo, me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e

ngjarjeve, nuk ndodhi ashtu si mendonte Mao Ce Duni. Hrushovi ishte me të vërtetë një kloun, antimarksist dhe intrigant i madh, por nuk ishte aq budalla sa ta fuste Bashkimin Sovjetik nën sqetullat, nën krahët e Kinës dhe të Mao Ce Dunit. Përkundrazi, ai donte dhe punoi që Bashkimi Sovjetik të bëhej një fuqi imperialiste me një potencial të madh luftarak dhe të kthehej kështu në një partner të fortë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me të cilat të ndanin botën e ta shfrytëzonin për interesat e tyre.

Pra, me gjithë përpjekjet që bënë, Mao Ce Dunit dhe Çu En Lait nuk u doli ëndrra. Të dy ëndërruan, me një fjalë, me sy hapur. Atëherë, siç e kam shpjeguar edhe herë të tjera, ata bënë një kthesë 180 gradëshe, kthyen «bateritë e topave» kundër Bashkimit Sovjetik revizionist, gjë që na interesonte edhe neve, por një-kohësish ata kthyen fytyrën nga imperializmi amerikan dhe i nderën dorën presidentit fashist, Niksonit. Pra ëndrra tjetër e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait ishte që, në bashkëpunim të ngushtë me imperializmin amerikan dhe duke u mbështetur te ky, Kina të bëhej një fuqi e madhe socialimperialiste.

Nuk do të zgjatem në lidhje me çështjen e Revolucionit Kulturor etj., etj., sepse kam folur shumë në shënimet e mia, vetëm dua të them se një gjë është e sigurt: Mao Ce Duni dhe Çu En Lai janë ata që kanë kurdisur planin e likuidimit të Lin Biaos, të Çen Po Tasë etj. Ne dyshuam shumë në fillim për këtë veprim të papritur të Lin Biaos, që Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë propaganda kineze e paraqitën tradhtar, si-

kur Lin Biaoja ka dashur të bënte komplot për të zhdukur Mao Ce Dunin dhe për t'i zënë këtij vendin. Por, me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e ngjarjeve aktuale, ne shohim se komplotet në Kinë e Mao Ce Dunit janë një praktikë e zakonshme, gjë që do të thotë se puna e Partisë Komuniste të Kinës rezulton të jetë shumë e dobët dhe jo në binarët e marksizëm-leninizmit. Në propagandën e kësaj partie ka plot fjalë të tillë si «revolucionarë», «marksiste-leniniste», «proletariat» etj., por në fakt shohim se Mao Ce Duni, i cili hiqej si «marksist-leninist i madh», jo vetëm që nuk rezulton të jetë i tillë, por ai është shkaktari i gjithë këtyre fenomeneve negative, që kanë ngjarë dhe po ngjasin në Kinë.

Ngjarjet në lidhje me Liu Shao Çinë, Lin Biaon, Ten Hsiao Pinin e tash grushti i fundit që ndodhi në Kinë, janë rezultat i një vije liberale oportuniste jo-marksiste të Mao Ce Dunit. Ky ka lejuar dobësi të theksuara në vijën organizative dhe politike të Partisë; ka lejuar të lulëzojnë në parti e në popull dy e më shumë vija; ka bërë gjoja së fundi luftë kundër Konfucit. Por, duke pasur një vijë të shtrembër parimore për çështjet bazë të diktaturës së proletariatit, lufta e klasseve, qoftë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, qoftë kundër mbeturinave mikroborgjeze, fesë etj., etj. në Kinë ka qenë inekzistuese, ose është bërë me fushata për të rrëzuar njërin e për të ngritur tjetrin, për të rrëzuar e rirrëzuar njërin e për të ngritur a ringritur tjetrin.

Liu Shao Çinë dhe Ten Hsiao Pinin, që kishin gabuar shumë herë në jetën e tyre, Maoja i mbajti për-

katësisht nënkyrjetar dhe sekretar të përgjithshëm të partisë, derisa në kohën më të zjarrtë të Revolucionit Kulturor, i cilësoi «Hrushovi numër një» e «Hrushovi numër dy i Kinës». «Hrushovi numër dy» (Ten Hsiao Pini) u thirr nga Mao Ce Duni e u ngrit prapë në të gjitha funksionet që kishte, bile u bë nënkyrjetar i partisë (natyrisht me bekimin, të mos themi me sugjerimin, e Çu En Lait). Ndoshta këtë «fat të lumtur» do të kishte dhe Liu Shao Çia, po të mos kishte vdekur. (Por edhe pas vdekjes, ndoshta, miqtë e tij nuk do ta harrojnë.) Këto ngjitje e zbritje të armiqve në poste të larta shtëtërore e partie, si dhe shumë akte të tjera të shëmtuara, nuk janë veprime marksiste-leniniste.

Të mos zgjatemi, agjencitë e huaja të lajmeve ka dy-tri ditë që flasin se Hua Kuo Feni ka marrë fuqinë në Kinë. Hua Kuo Feni, i cili ishte udhëheqësi i sigurimit të shtetit dhe ministër i Brendshëm, zëvendësoi Ten Hsiao Pinin. Ky i fundit ishte dënuar nga Revolucioni Kulturor. Sipas udhëheqësve kinezë, çdo gjë që ka bërë Revolucioni Kulturor është «e drejtë» dhe mbrohej me pasion nga Mao Ce Duni e nga gjithë adeptët e tij. Është e vërtetë se ky Revolucion Kulturor kishte edhe njerëz që me bindje të plotë dhe, duke ruajtur flamurin e Maos, dëshironin të forconin pozitat komuniste të Kinës. Mirëpo në këtë revolucion kishte edhe armiq të fortë dhe të shumtë, që, siç e kam shkruar shumë herë në këtë Ditar, grumbulloheshin rrëth Çu En Lait. Ky u bashkua fort me Maon dhe intrigoi tek ai. Maos i nevojitej Çu En Lai. Kjo do të thotë se Mao Ce Duni kurdoherë mendonte dhe vazhdonte të bënte

një politikë të balancimit dhe një nga këta që mund ta bënte këtë politikë balancimi, derisa Mao Ce Duni të ishte gjallë, ishte Çu En Lai. Ky i adaptuhej Maos, se i kuptonte fare mirë psikologjinë dhe pikëpamjet e tij jomarksiste. Çuja diti të grumbullojë rreth vetes dhe të vërë në pozita kyç në pushtet, në ushtri, në parti, deri në Komitetin Qendror, elementë antimarksistë, njerëz që, në momentin e përshtatshëm, të merrnin fuqinë në dorë dhe të likuidonin elementët e shëndoshë marksistë-leninistë. Për këtë qëllim Mao Ce Duni dhe Çu En Lai rehabilituan gati të gjithë ata elementë që gjoja qenë persekutuar. Në të vërtetë, këtu nuk është fjala për njerëz të persekutuar, por për ata që qenë dënuar.

Çu En Lai, që me siguri kishte dijeni të plotë për sëmundjen e tij të kancerit, e përgatiti për tre vjet rresht Ten Hsiao Pinin, që do ta zëvendësonte dhe, kur pluhuri i Çusë u shpërnda në të gjithë Kinën, Ten Hsiao Pini mbajti *De profundis-in* e Çu En Lait. Mirëpo ky *De profundis* ishte edhe i veti. Teni nuk u bë dot kryeministër, se u skartua dhe u demaskua si revisionist dhe armik, si udhëheqës i djathtistëve, si armik i Mao Ce Dunit, armik i socializmit etj., etj. Filloi kështu një fushatë e rreptë kundër tij, fushatë e drejtë, por vetëm me shtyp, me propagandë dhe me radio. Siç duket, Çian Çini, Jao Ven Juani, Van Hun Veni dhe Çan Çun Çiaoja, kishin në dorë vetëm shtypin. Kur filloi kjo fushatë, Mao Ce Duni ishte akoma gjallë dhe mendohej se këta të katër kishin edhe mbështetjen e tij.

Por e kishin vallë këta katër elementë atë fuqi në popull, në parti dhe në ushtri për ta vazhduar në prak-

tikë Revolucionin Kulturor, për të spastruar, me fjalë të tjera, radhët e partisë, të pushtetit dhe të ushtrisë nga elementët e reaksionit, të cilët vepronin të maskuar nën petkun e komunistëve, nga njerëzit e Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit, Çu En Lait dhe të Pen Çenit? Bindja jonë ka qenë se ata të katër nuk e kishin këtë fuqi. Këta ishin kuadro të rindjeve vullnet, por tëpër të papjekur, kurse ujqit e vjetër në Partinë Komuniste të Kinës kishin hedhur rrënji të thella dhe këto rrënji ishin ushqyer nga ideologjia jomarksisteleniniste e Mao Ce Dunit, i cili mendonte se, në mos ai, mendimet e tij, do të rronin me shekuj.

Pra, këta katër udhëheqës bënин vetëm propagandë. Ten Hsiao Pinin e eliminuan nga udhëheqja, mirëpo Mao Ce Duni, që akoma ishte gjallë, këshillonte palët në konflikt të ecnin «urtë e butë e plot tigani», «të mos ziheshin me njëri-tjetrin», «të merreshin vesh me njëri-tjetrin» dhe «të linin grindjet». Të gjitha këto parulla ishin të çuditshme, jorevolucionare dhe lëshoheshin nga një njeri që hiqej si «marksist-leninist i madh». Mao Ce Duni e quante veten marksist, por ai ishte një «marksist» me pikëpamje mikroborgjeze. Derisa ai mendonte, shkruante dhe vepronte duke vënë fshatarësinë si «faktorin kyç të revolucionit», të cilin nuk mungonte ta quante «proletar», në pikëpamjet e tij ideologjike dhe politike nuk mund të pasqyroheshin veçse tiparet mikroborgjeze të fshatarësisë, siç janë lëkundjet e saj djathtas e majtas. Pra, Maoja bashkohej herë me një grup ose me një shtet dhe herë me një tjetër. Të nesërmend braktiste këta dhe bashkohej me të tjerë. Nën

ombrellën e Maos rronin dhe vepronin të gjithë: borgjezë, kapitalistë, proletarë, dhe Maoja ishte i kënaqur për popullaritetin e tij. Ai përdorte në thëniet dhe në shkrimet e tij edhe ide e citate të Marksit e të Leninit, por këto ishin fasadë. Idetë e Marksit dhe të Leninit të shprehura në shkrimet e Maos, po të studiohen me kujdes, do të vërehet se janë redaktuar sikur i ka pjellë ky nga koka e tij.

Maoja predikonte pajtimin, por nga ana tjetër bërtiste: «Çfarë kërkoni? Nuk e shikoni se armiku është brenda në parti?». Por ky armik brenda në parti duhej goditur për vdekje. A e bëri Maoja këtë? Jo, ai nuk veproi kështu. Këtë frazë vetëm sa e thoshte, se në praktikë ai zbatonte parullat: «Mos u grindni», «pajtohuni», «mos bëni komplotë», dhe nga ana tjetër thoshte: «jini kundër revizionizmit», «jini pro marksizmit»! Pra që të gjithë në Kinë, marksistë e antimarksistë, përdornin këto fraza të Mao Ce Dunit. Ky, me siguri, nuk lejoi që elementët e shëndoshë të merrnin fuqinë dhe ta vendosnin Kinën në binarë të drejtë.

Në këtë kaos të madh, ne e kemi të vështirë të afirmojmë, por nga sa kemi parë se çfarë ndodhi dhe si ndodhi në Kinë, mund të themi se elementët e rinj dukeshin më revolucionarë e më përparimtarë nga grupi i Çu En Lait. Kështu që Mao Ce Duni «për të pajtuar» njerëzit dhe duke e parë veten mjaft të sëmurë e afër vdekjes, para se të shkonte «te zoti», siç i kishte thënë Edgar Snout, gjeti «zgjidhjen e përshtatshme», vuri Hua Kuo Fenin në krye të punëve. Kush ishte ky Hua Kuo Feni? Njeri pa autoritet të madh dhe i pa-

njohur. Mirëpo atë e njihte Mao Ce Duni dhe e pranonte krahu i djathët që kishte shpresat te ky njëri, se të paktën ky do të ishte i moderuar. Dhe ky erdhi në udhëheqjen e lartë pa u zgjedhur. Pas vdekjes së Çu En Lait ai u bë kryeministër dhe zëvendëskryetar i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Kjo do të thoshte se, pas vdekjes së Maos, do të ishte, sigurisht, ky që do të bëhej kryetar i partisë.

Nuk kaluan shumë kohë nga këto operacione të alambikuara dhe Mao Ce Duni vdiq. U mbajt zi, u vunë nëpër krahë shirita dhe nuk kaluan as dy-tri javë, ose e shumta një muaj (hajde llogariti këto gjëra), dhe plasi kaosi i madh në Kinë, plasi ajo që parashikonim.

Çfarë parashikonim ne? Ne parashikonim që të dy korrentet e dukshme do të ndesheshin me njëri-tjetrin se kush e kush të merrte fuqinë (dhe mendonim kështu se fuqinë e kishin në dorë të djathët, partizanët e Çu En Lait, për arsyet që tregova më lart, kurse kundërshtarët e tyre kishin në dorë vetëm shtypin dhe propagandën, prandaj, në rast se vihej çështja se kush do të merrte fuqinë, këtë do ta merrnin elementët jorevolucionarë), por mendonim, gjithashtu, se mund të zgjatej ca «mbretëria» e Mao Ce Dunit. Por ky, Hua Kuo Feni, që mbante në dorë zigarenë, nuk ishte Mao Ce Dun. Huaja ishte larg autoritetit që kishte krijuar Maoja në Kinë dhe në botë. Hua Kuo Feni e tregoi ftyrën çfarë ishte. Para tri ditësh agjencitë e huaja të lajmeve kanë njoftuar se një mëngjes ai arrestoi në shtëpitë e tyre Çian Çinin, Jao Ven Juanin, Van Hun Venin dhe Çan Çun Çiaon, domethënë gjithë ele-

mentët kryesorë të krahut të majtë, të cilët ata i quajnë «radikalë». Fuqinë e morën në dorë Hua Kuo Feni me Li Hsien Nienin, ish-dora e djathë e Çu En Lait. Gjithashtu ka zëra se Ten Hsiao Pini u soll në Pekin dhe, në qoftë se hëpërhc nuk bëhet zëvendëskryeminstër, prapëseprapë rruga që po merr Kina duhet ta sjellë medoemos Ten Hsiao Pinin në një post me rëndësi, mundet dhe sekretar të përgjithshëm të partisë, detyrë, të cilën ai e ka kryer që në kohën e Liu Shao Çisë e të Mao Ce Dunit dhe ka pasur eksperiencë.

Pra, aktualisht Kina rron në momente të vështira dhe jo vetëm Kina. Në rast se të gjitha ato që thonë agjencitë e huaja për Kinën janë të vërteta, kjo do t'u shkaktojë një dëm kolosal revolucionit botëror dhe socializmit. Vetë Kina do të ecë drejt rrugës së fuqisë së madhe socialimperialiste. Ajo do të mbështetet aktualisht te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por nuk është çudi që, më vonë, ajo do të bëjë po atë politikë që po bën Titoja, domethënë, për t'ia arritur këtij objektivi, t'i nderë dorën edhe Bashkimit Sovjetik. Kjo, gjithashtu, është një fitore për Bashkimin Sovjetik, pavarësisht se Kina tani bën një propagandë «shurdhuese» kundër revizionizmit modern hrushovian. Këtë propagandë nësër dalngadalë ajo mund ta ulë. Duke u bërë Kina një fuqi e pavarur, me një industri të madhe, që po rritet me teknologjinë amerikane, me një sasi bombash atomike inferiore nga ato të Bashkimit Sovjetik, por me një ushtrë të madhe numerikisht dërrmuese në krahasim me atë të Bashkimit Sovjetik, ka të ngjarë, dhe mendoj se kështu mund të ndodhë, që në botë të krijo-

hen tri superfuqi dhe që të tria do të dëshirojnë të kenë zenat e tyre të influencës. Kontradiktat, natyrisht, do të shtohen midis tyre, do të vijë një kohë që ato të acarohen dhe ne do të asistojmë në këtë acarim, i cili mund të çojë edhe në një luftë tjetër botërore.

C'do të bëjë tani populli kinez? Do të ngrihet vallë, apo do të pranojë me apati përrallat e Hua Kuo Fenit e të Mao Ce Dunit? Do të jetë ai dakord me eliminimet që po bëhen në Partinë Komuniste të Kinës? Do ta pranojë Shangai, nga i cili kanë dalë gjithë këta elementë, këtë gjendje, që Hua Kuo Feni, Ten Hsiao Pini dhe Li Hsien Nieni me shokë të dominojnë në Pekin, të bëjnë ligjin në Kinë dhe ta çojnë këtë drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose drejt Bashkimit Sovjetik? Ky është një problem që duhet ta vëzhgojmë.

Vallë ka mundësi që në Kinë të ngjasin turbullira? Ka mundësi. Në Bashkimin Sovjetik Nikita Hrushovi veproi më me prudencë, nuk i precipitoi në këtë mënyrë punët. Pas vdekjes së Stalinit kaluan disa vjet dhe veprimtarinë e tij kundërrevolucionare ai e ndërmori në mënyrë «të butë», shkarazi, u mori krahët armiqve të tij, përgatiti opinionin e brendshëm dhe të jashtëm dhe, më në fund, spastroi ata elementë gjoja progresistë, por që nuk u treguan as progresistë, as dreq. Sidoqoftë Hrushovi e spastroi rrugën jo brenda një muaji, siç po bën Hua Kuo Feni. Populli sovjetik u përgatit me një demagogji të madhe për atë kthesë regressive që do të ndodhte, dhe ngjarjet që u zhvilluan, ai i quajti si gjëra normale, që bëheshin «brenda normave leniniste të partisë». Ai nuk e pa të vërtetën sepse nuk e lanë ta shi-

konte atë. Kurse klika e djathëtë revizioniste në Kinë po vepron me shpejtësi, me ngut, kështu që një vepriptari e tillë ka mundësi që të krijojë reaksion në popull. Populli kinez u ngrit në Revolucionin Kulturor, natyrisht, sepse i bëri thirrje Maoja, por në fakt u ngrit dhe goditi. Po të mos e kishte frenuar Maoja, ky revolucion do t'i kishte spastruar të gjitha këto qelbësira që tash vijnë në fuqi. Populli kinez përsëri mund ta bëjë një gjë të tillë. Sa do ta bëjë, kjo nuk dihet dhe a do ta bëjë, as këtë nuk mund ta themi me siguri, se popullin kinez e kanë fanatizuar me emrin e Mao Ce Dunit.

Sipas agjencive të huaja të lajmeve, të gjithë thonë se elementët e krahut të djathët, me Hua Kuo Fenin në krye, pretendojnë se kanë shtypur një «grusht shteti» të kryesuar nga Çian Çini, Jao Ven Juani e të tjerrë. Ky është një blof. Sipas agjencive të huaja, Hua Kuo Feni ka deklaruar se këtë «grusht shteti», «katershja» e përgatiti «duke shtrembëruar mendimet e Mao Ce Dunit». Kjo do të thotë se «gjithë propagandën kundër Ten Hsiao Pinit, pro diktaturës së proletariatit etj., etj., e ka shtrembëruar ky grup komplotistësh». Janë, pra, këta, sipas Hua Kuo Fenit, që «kanë shtrembëruar idetë e Mao Ce Dunit». Hua Kuo Feni do ta propagandojë në popull citatin e Mao Ce Dunit: «Mos komplotoni!». Po kush komplotoi? «Çian Çini me shokë», — do të thonë Hua Kuo Feni, Li Hsien Nieni, Ten Hsiao Pini e të tjerrë, të cilët duan të paraqiten sikur po shpëtojnë Kinën nga të tillë «elementë reaksionarë», që shkelin idetë e Mao Ce Dunit, flamurin e të cilit po e tundin fort, se kështu ua do puna.

Në qoftë se populli kinez do ta hajë këtë manovër, atëherë në Kinë nuk do të ketë kryengritje. Po nuk e hëngri, populli do të ngrihet dhe atëherë do të ketë luftë civile. Në Revolucionin Kulturor u përlleshën edhe populli, edhe punëtorë, pavarësisht nje cilin grup ishin. Edhe në ushtri qëlluan me top e me mitraloz njëri-tjetrin dhe janë vrarë njeröz. Gjë më shumë nuk dimë. Të shohim më vonë.

Por një gjë mund të themi me siguri: kjo që ndodhi në Kinë është një katastrofë për të dhe një dëm i pallogaritshëm për revolucionin botëror, për komunizmin. Imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare fërkojnë duart. Kjo katastrofë është një vepër e tyre. Ata që sollën një situatë të tillë në Kinë, janë bashkëpunëtorë të tyre, siç ishin dlie siç janë bashkëpunëtorë të tyre edhe Hrushovi, Brezhnjevi, Suslovi, si dhe gjithë banda revizioniste e Titos dhe e një sërë kundërrevolucionarësh e lakenjsh të tyre në botë.

Për sa na përket neve, shqiptarëve, natyrisht ne e kemi të qartë se situata e krijuar në Kinë nuk na sjell të mira, po vështirësi. Këtë situatë ne e kishim paçashikuar me kohë, që më 1960, kur udhëheqësit kinezë gjoja na mbrojtën kundër hrušovianëve. Ne e pamë se ata ishin të lëkundshëm dlie në të vërtetë nuk na mbrojtën kurrë. Ata, me Çu En Lain në krye, u përpoqën që sovjetikët të shuanin polemikën kundër nesh dhe të mbyllej kjo çështje. Mirëpo Hrushovi, si një potentat¹, nuk

1. Frëngjisht — njeri që merr qëndrim të një autoriteti sovran.

pranonte të përulej përpara shqiptarëve. Ai nuk e pranoi këtë tezë të Çu En Lai dhe të Mao Ce Dunit. Çu En Lai me Mao Ce Dunin kishin shpresat e mëdha se Hrušovit do t'u jepte bombën atomike dhe do t'i ndihmonte ekonomikisht që Kina të bëhej një fuqi e madhe, prandaj, edhe kur konflikti u hap, ata u përpoqën ta zbutnin. Këto çështje i kam shkruar në Ditar dita me ditë gjatë zhvillimit të ngjarjeve dhe nuk janë përfundime që nxjerr tash.

Pra kjo situatë ne nuk na gjeti të papërgatitur. Ka disa vjet, dhe veçanërisht gjatë pesëvjeçarit që kaloi, që Çu En Lai ka vepruar kundër nesh. Në çështjet ekonomike ai na ka sabotuar. Këtë sabotim ne e kemi parë konkretisht dhe kemi luftuar kundër tij. Çuja është gjendur në një situatë që nuk kishte çfarë të bënte tjetër veçse të adoptonte metodën e shtyrjes së realizimit të veprave, meqenëse nuk mund të zbatonte atë të prerjes së kredive. Çu En Lai nuk ndoqi taktilën e Hrushovit, që preu përnjëherë urat me ne, por ndoqi këtë taktilë: të mos na dërgonte në kohë makineritë e vepravo me rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë sonë, të cilat duhej të kishin mbaruar dy vjet apo dy vjet e gjysmë më parë. Për këtë arsy, ato akoma nuk kanë mbaruar. Kjo jo për shkak se Kina është «e varfër» e përralla të tjera që thonë revizionistët kinezë. Jo, këto qëndrime vinin dho vijnë nga arsyet politike: Çu En Lai me Mao Ce Dunin shikonin që Shqipëria qëndronte në pozitat e veta marksiste-leniniste dhe kishte, siç ka, një politikë të saj të pavarur, për të

cilën shprchet haptazi, pa druajtje nga kurrkush, gjë që nuk u pëlqente dhe nuk u pëlqen kinezëve.

Kinezëve nuk u pëlqente, gjithashtu, që Shqipëria e vogël po mbronte Kinën e madhe në arenën ndërkomëtare. Mundet që vetë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai mbrojtjen e Kinës nga ana jonë e konsideronin si një turp, se, sipas gjykimit të tyre, si mundej që një vend i vogël të mbronte një vend të madh? Sidoqoftë ajo që bëhej nga ne ishte një mbrojtje të cilën ata nuk mund ta mohonin, por atyre nuk u pëlqente një situatë e tillë.

Kohët e fundit u duk qartë se udhëheqësit kinezë na bënë presione të hapëta e të drejtpërdrejta që të shpëtonin Beqir Ballukun dhe Abdyl Këllezin, të cilët ishin bashkëpunëtorë të tyre në komplotin e kurdisur kundër Shqipërisë, për të rrëzuar udhëheqjen tonë. Por ata nuk ia arritën dot qëllimit, prandaj edhe i shkurtuan jashtëzakonisht ndihmat e tyre ekonomike, gjithashtu edhe ndihmat ushtarake, se tjetër gjë nuk kishin çfarë të na bënin.

Pra, ne jemi të përgatitur në këtë drejtim. Jemi të përgatitur, sepse Partia jonë ka kaluar gjithë këto dallgë dhe është kalitur. Ajo nuk ka frikë se mbetet vetëm. Dhe në fakt, në këtë rast, ne vetëm mbetemi e bëjmë një politikë unikale marksiste-leniniste, si një parti në fuqi e cila është në kundërshtim me imperialistët amerikanë, me socialimperialistët sovjetikë, me socialimperialistët kinezë, me borgjezinë reaksionare, me fqinjët dhe me djallin e me të birin. Por Shqipëria dhe Partia e Punës qëndrojnë të patundura e kështu do të qëndrojnë vazhdimisht.

Tashti, ekipi që erdhi në fuqi në Kinë, do ta vazhdojë më hapur armiqësinë kundër nesh? Do të shohim. Ne do të jemi vigjilentë dhe vigjilenta jonë duhet të jetë e madhe. Interesi ynë e do që, edhe duke ndjekur ata metodën e tyre të shtyrjes së realizimit të plotë të këtyre veprave, nga ana jonë ne të mos i ndezim zjarret me ta, por të mbajmë vijën tonë marksiste-leniniste dho të mos shkelim mbi parimet, pavarësisht se Kina mund të na presë kreditë. Le ta bëjë ajo këtë, ne do të rrojmë me forcat tona, do të punojmë me thonj e me dhëmbë, do të rrojmë, e do të rrojmë më mirë. Ne do të kemi njëkohësisht mbështetjen e gjithë botës përparimitare, të të gjithë marksistë-leninistëve të vërtetë, të gjithë proletariatit dhe të revolucionarëve në botë, të cilët do të shohin se si një vend i vogël i qëndron besnik marksizëm-leninizmit, nuk trembet, por ecën përpara, rron dhe përparon. Kështu do të ngjasë.

Natyrisht, qëndrimi armiqësor i Kinës kundër nesh do t'i kënaqë armiqqtë tanë, ata do ta shtojnë veprimtarinë e tyre si jashtë, edhe brenda vendit kundër shtetit dhe Partisë sonë, por ne jemi një forcë e madhe që edhe armiqve të jashtëm do t'u bëjmë ballë me sukses, edhe armiqqtë e brendshëm do t'i shtypim. Prandaj duhet të presim me gjakftohtësi, t'i ndjekim si kurdoherë me vëmendje situatat në botë, veçanërisht të ndjekim situatat në Kinë.

Një herë ne duhet të presim të vërtetohen ose jo ato që thotë shtypi botëror, se asgjë nuk thuhet nga shtypi zyrtar në Kinë. Zaten, kinezët një metodë të tillë ndjekin. Qoftë kur likuiduan Liu Shao Çinë, ashtu

edhe kur likuiduan Lin Biaon e më vonë Ten Hsiao Pinin e të tjerë, e të tjerë, u desh një kohë e gjatë sa të flitnin haptazi ku e kishin hallin. Ka shumë mundësi që edhe në këtë rast të ngjasë e njëjtë gjë, sepse që nga Çian Çini e deri te Çan Çun Çaoja, pavarësisht se janë relativisht të rinj, ata janë personalitetë. Megjithatë, mendoj se ne duhet të jemi shumë prudentë, të mbrojmë vijën tonë dhe të mos hapim polemikë më kinezët, në qoftë se vërtetohen këto që fliten nga shtypi botëror. Në nuk duhet të hapim polemikë për aq kohë sa ta shohim të arsyeshme se nuk po sulmohet publikisht viaj jonë marksiste-leniniste, se ndryshe në atë moment bateritë duhet t'i kemi si kurdoherë ngritur. Por edhe interesin ekonomik duhet ta shikojmë, pavarësisht se kinezët mund t'i ngadalësojnë furnizimet që duhet të na dërgojnë, sipas kontratave të firmuara që ekzistojnë. Ne, pra, duhet të jemi prudentë dhe njëkohësisht vigjilentë, të ndjekim me kujdes se ç'rrugë do të marrin punët në Kinë.

Në Kinë çdo gjë është e papritur. Në një kohë jashëtëzakonisht të shkurtër ngjasin gjithë këto gjëra dhe të tërave u ngjinin etiketën «grusht shteti», «puç», «komplotë kundër jetës së Mao Ce Dunit» etj., etj. Nesër mund të vërtetohen ngjarje të tjera, prandaj këtu, brenda vendit tonë, duhet të jemi vigjilentë ndaj specialistëve kinezë. Punonjësve të ambasadës kineze në Tiranë ne do të vazhdojmë t'u flasim sinqerisht për miqësinë e popullit dhe të Partisë sonë me popullin kinez dhe me Partinë Komuniste të Kinës në baza marksiste-leniniste, megjithatë nuk e dimë çfarë njerëzish janë si

funksionarët e ambasadës, ashtu edhe specialistët kinezë që punojnë në vendin tonë.

Nga informatat që kemi rezulton se ambasadori i tyre i sotëm, i cili ka qenë edhe në Moskë, është një nga elementët e kritikuar nga Revolucioni Kulturor. Pra, ky duhet të jetë njeriu i Ten Hsiao Pinit, i Liu Shao Çisë e i Çu En Lait, i djathjtë. Ai nuk ka ardhur te ne për të ndihmuar vendin tonë, por për të sabotuar, për të intriguar, për t'u informuar jo si mik, po në shërbim të të djathjtëve që crdhën në fuqi në Kinë. Ai ka ardhur me qëllime jo të mira, prandaj ka mundësi që ai dhe kinezët të fillojnë të futin hundët në punët tona të brendshme.

Ne nuk mund t'i ndalojmë dot punonjësit e ambasadës kinezë që të mos venë në ndërmarrje të ndryshme, ku punojnë specialistë kinezë, për të marrë kontakt me ta. Sidoqoftë, sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve, kryeinixhinierët, drejtorët e instituteve, të fabrikave e të kombinateve ku punojnë specialistë kinezë, duhet të jenë vigjilentë, të ruhen, sepse ne e kemi pësuar shumë herë, nga titistët, nga revisionistët sovjetikë e mund ta pësojmë edhe tash nga kinezët.

Interesi i madh i atdheut dhe i Partisë e do që në këto momente të paqëndrueshme e kaotike për Kinën dhe të rrezikshme për revolucionin botëror, vëçanërisht për Shqipërinë socialiste, ne të forcojmë situatën brenda në Parti, të forcojmë unitetin e radhëve të saj, të forcojmë unitetin e Partisë me popullin, ta bëjmë më aktive përgatitjen për mbrojtjen e vendit dhe tō jemi vigjilentë, të realizojmë me sukses, bile

edhe të tejkalojmë planet tona ekonomike. Kjo është detyrë themelore për ruajtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të sovranitetit të atdheut tonë. Të gjithë duhet të mendojmë, — dhe këtë duhet t'ua bëjmë të qartë në një mënyrë ose në një tjetër Partisë, komunistëve, mbarë popullit, — se Shqipëria socialiste është e fortë si brenda, edhe jashtë kufijve të saj. Jashtë, vendi ynë ka miq të shumtë dhe besnikë. Këta miq janë jo vetëm revolucionarët e përparimtarët, por edhe njerëz që, pavarësisht se janë në kundërshtim me rendin tonë ekonomiko-shoqëror, kanë respekt për politikën e Shqipërisë socialiste dhe për kurajën e shtetit tonë.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Shënimë për Kinën», vëll.
II, f. 281*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Shënimë për
Kinën», vëll. II, f. 281*

ÇDO KONGRES I PARTISE ëSITË MOMENT HISTORIK PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT NË VENDIN TONË

Fjala në Plenumin e 10-të të KQ të PPSHⁱ

14 tetor 1976

Të dashur shokë e shoqë,

Ju morët dhe studiuat të dy raportet e Komitetit Qendror, që janë hartuar për t'ia paraqitur Kongresit të 7-të të Partisë. Këto raporte, siç e patë dhe vetë, pasqyrojnë në mënyrë reale luftën që ka bërë Partia gjatë këtyre pesë vjetëve të fundit për të vënë në jetë direktivat dhe detyrat që iu vunë asaj nga Kongresi i 6-të. Në të dy raportet janë sintetizuar në mënyrë konkrete jo vetëm fitoret, por edhe gabimet e fajet, si të forumeve, ashtu edhe të individëve të veçuar ose të

1. Në këtë Plenum u shqyrtuan e u miratuan raportet «Mbi veprimtarinë e KQ të PPSH» dhe «Mbi direktivat e Kongresit të 7-të të PPSH për planin e gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së RPSH për vitet 1976-1980».

atyre që kanë vepruar në grupe. Me fjalë të tjera, janë bërë përpjekje për të pasqyruar gjithë veprimtarinë e Partisë dhe të organeve të shtetit tonë socialist gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare dhe, këto dy raporte janë përgatitur në nivelin që i patë.

Sic e dini, puna e Partisë dhe ajo shtetërore, në luftë të përditshme për realizimin e detyrave, është forcuar. Partia, gjatë gjithë kësaj kohe, ka përballuar vështirësi të panumërtë, objektive dhe subjektive; ajo ka përballuar, gjithashtu, me sukses presionin e madh e të egër armiqësor të jashtëm rrëth kufijve tanë, si dhe rrëthimin tjetër mbi rrëthimin e parë, atë të imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik dhe të të gjithë borgjezisë e reaksionit ndërkombëtar. Në këto kushte, Partisë sonë i është dashur të luftojë dhe në këtë luftë të zbulojë e të likuidojë edhe grupet e rrezikshme armiqësore që vepruan në kokën e Partisë dhe të pushtetit, të përbërë nga tradhtarët Fadil Paçrami, Todi Lubonja, Beqir Balluku, Hito Çako, Petrit Dume, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Kiço Ngjela e të tjerrë që bashkëpunuan me ta.

Partia jonë ka bërë, gjithashtu, një luftë të madhe edhe kundër mbeturinave mikroborgjeze, brenda dhe jashtë radhëve të saj, të cilat kanë qenë një pengesë tjetër për arritjen e sukseseve akoma më të mëdha nga ato që kemi realizuar. Këto pikëpamje kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në ndërgjegjen e atyre njerëzve, tek të cilët ato nuk janë luttuar sa duhet politikisht dhe ideologjikisht. Kështu këta elementë bëhen bartës të ideologjisë së huaj dhe ndih-

mojnë presionin e madh armiqësor që ushtrojnë fuqitë imperialisto-rezisioniste dhe armiqtë e brendshëm kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe pushtetit tonë popullor.

Nuk kam ndër mend t'u ribëj këtu një analizë raporteve, të cilat në vetvete janë analiza të thella, por dëshiroj të theksoj se lufta e klasave, që çon përpara ndërtimin tonë socialist dhe që çdo vit e më shumë i jep një fuqizim të paparë ekonomisë sonë popullore, arsimt e kulturës, mbrojtjes së atdheut dhe pastrimit të ndërgjegjes së njerëzve, ka qenë e ashpër dhe fryt-dhënëse. Asaj i dedikohen gjithë këto suksese të mëdha. Po të ishte vepruar ndryshe, rendi ynë socialist do të dobësohej e do të kalbej; armiqtë, nga jashtë e nga brenda, do të ngrinin krye, do të vepronin dhe do të na luftonin, derisa të merrnin më së fundi pushtetin në duart e tyre për të rikthyer në vendin tonë kapitalizmin. Por ata kësaj as nuk ia arritën dhe as nuk do t'ia arrijnë dot kurrë, sepse Partia jonë ka ecur e do të ecë vazhdimisht në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, duke përvetësuar gjithnjë e më thellë e duke zbatuar me konsekuençë teorinë tonë në të gjitha fushat e drejtimet.

Gjithë përpjekjet e Partisë sonë, qofshin këto politike, ideologjike apo ekonomike, janë kurdoherë të mbrijtura me teorinë e pavdekshme marksiste-leniniste. Pikërisht te mbështetja fort në këtë teori qëndron forca e Partisë. Ajo çdo vendim që ka marrë, të rëndësishëm ose më pak të rëndësishëm, e ka parë në prizmin e drejtë e real të materializmit dialektik dhë

historik, duke pasur kurdoherë parasysh edhe kushtet e zhvillimit dinamik të vendit. Kjo, shokë, ka bërë që ne të korrim vazhdimisht suksese, në industri, në bujqësi, në arsim, në kulturë e në art, si dhe në forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut.

Krahas sukseseve janë vërtetuar edhe gabime e të meta, të cilat janë zbuluar e janë korrigjuar, ndërsa ndaj njerëzve që i kanë kryer ato, janë marrë masa për t'i edukuar. Kur ka pasur raste nga ata që e kanë tpjuefuar, janë marrë masa e vendime të përshtatshme sipas shkallës së fajit, ndërsa kundër elementeve armiq, siç e dini, janë dhënë edhe dënimë të rënda.

Duhet njobur se te disa njerëz, të komprometuar nga puna e armiqve, ekziston akoma sëmundja e rrezikshme e indiferentizmit. Ka ndër ata që janë futur me kohë në rrugën armiqësore dhe që punojnë sistematikisht për të térhequr pas vetes edhe elementë të tjerë gjatë veprimtarisë që zhvillojnë kundër Partisë, popullit e socializmit.

Te disa të tjerë ekziston, gjithashtu, pikëpamja e gabuar e kultit të udhëheqjes, që Partia jonë e ka kritikuar vazhdimisht si të dëmshme dhe fort të rrezikshme. Beqir Balluku dhe shokët e tij tradhtarë e kanë shfrytëzuar kultin e personit të tyre për të vepruar në mënyrë të organizuar në dëm të Partisë, duke u fshehur me maskën e qenies anëtarë të Byrosë Politike e duke folur në emër të saj dhe të udhëheqjes kryesore të Partisë. Shumë njerëz naivë, me vese e sëmundje të tillë, që në pamjen e jashtme hiqeshin sikur qenë të ngritur politikisht e ideologjikisht, në realitet ishin në

stadin krejt foshnjor, pavarësisht nga qenia e tyre anëtarë partie e pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare ose në atë për ndërtimin e socializmit. Te këta ishin bërë dominuese konceptet e ideologjisë borgjeze mbi konceptet marksiste-leniniste të Partisë sonë. Është e qartë se të tillë elementë do të binin lehtë, sikurse edhe ranë, në grackën e një komploti të rrezikshëm.

Këto që ndodhën u bënë një mësim jashtëzakonisht i madh për Partinë tonë. Veprimitaria armiqësore që ishte duke u zhvilluar vinte në rrezikun më të madh ekzistencën e atdheut tonë socialist, të lirë, të pavarur e sovran. Armiqtë, të cilëve Partia u dha dënimin e merituar, nëpërmjet një organizimi të tërë, qenç pleksur në një komplot të jashtëm të kurdisur nga imperialisto-revisionistët, një komplot ky i stërholluar me forma të dukshme dhe të padukshme, të cilin vetë Partia dhe udhëheqja e saj e zbuloi dhe e shpartalloi. Por duhet të njohim se ky komplot duhej të zbulohet më parë, gjë që ne nuk e bëmë dot. Faji ishte i të gjithë neve, këtu, në Komitetin Qendror, i anëtarëve të Byrosë Politike, i shokëve drejtues të komiteteve të Partisë e të pushtetit, në terren e në ushtri. Të gjithë ne nuk vlerësuam sa duhet disa shenja e shfaqje të huaja, që viheshin re te disa, megjithëse akoma jo aq të dukshme për rrezikshmërinë e tyre. Është fakt që shfaqje të tillë ne, kur ka qenë rasti, i kemi vënë në dukje e i kemi kritikuar shokët që i manifestonin ato. Por, në të njëjtën kohë, ne duhej të ndiqnim me kujdes nëse autokritikat e tyre ishin me të vërtetë të thella, kishin shër-

byer për t'i korrigjuar, apo qenë formale. Në këtë drejtim nuk kemi qenë aq të kujdeshëm.

Siq thashë më lart, ne shkojmë në Kongresin e 7-të të Partisë me plot fitore. Këto i dedikohen vijës së drejtë revolucionare marksiste-leniniste të Partisë, vullnetit të çeliktë të komunistëve, të mbarë popullit tonç, i dedikohen shpirtit të sakrificës, frysës organizuese në rritje, punës së madhe politike që po zhvillon kudo Partia me të gjitha mundësitë dhe mjetet që ka në dispozicion. Ato i dedikohen ideologjisë sonë, e cila mësohet në të gjitha format në mënyrë të përshtatshme me nivelin arsimor e kulturor të njerëzve në të gjitha anët e vendit, në fabrika, në ara, në shkolla, në ushtri e kudo. Në këtë drejtim Partia ka bërë përpjekje të lavdërueshme. Natyrisht, këto përpjekje nuk kanë arritur akoma perfeksionin, prandaj na duhet të punojmë akoma më shumë, sepse vetëjeta, ndërtimi i socializmit, ngjarjet që zhvillohen krijojnë vazhdëmisht kushte të reja dhe bëjnë që edukimin e njerëzve tanë, qofshin anëtarë partie ose jo, t'ua adaptojmë në mënyrë krijuese situatave që krijohen. Pra, jo ta ndryshojmë teorinë marksiste-leniniste siç bëjnë revisionistët modernë, sovjetikë, tilistë, francezë, italianë e të tjerë, por, duke u bazuar fort në parimet themelore të saj, me zgjuarsi dhe zhdërvjelltësi çdo ide të çmuershme bazë të mësuesve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, ta zbatojmë në kushtet e vendit tonë. Që të arrihet kjo, që zgjidhja e problemeve të ndryshme që nxjerr përpëra jetë të bëhet drejt, duhet të mbahen kurdoherë parasysh dhe të

jenë si busull këto mësime të vlefshme. Vetëm kështu mund të themi se pasurohet marksizëm-leninizmi.

Teoria jonë marksiste-leniniste nuk pasurohet duke shkuar në rrugën e Kautskit e të Trockit, siç bëjnë revisionistët modernë, por duke u mbështetur fort e pa u lëkundur në teorinë revolucionare, mbi të cilën ndërtohet socializmi në një botë që po pëson ndryshime kolosale, në një botë krizash e demagogjish të imperializmit dhe të revisionizmit, në një luftë të ashpër klasash. Në këtë zhvillim fiton vazhdimi i terren ideologjia jonë, por kur marksizëm-lenisizmi aplikohet në mënyrë të drejtë në rrethanat konkrete të çdo vendi, atëherë shikohet që rezultatet janë pozitive, siç ndodh në vendin tonë. Dhe ky është një kontribut në pasurimin e mëtejshëm të ideologjisë së marksiste-leniniste.

Të marrim bujqësinë tonë. Kolektivizmi te ne u krye dhe është ndërtuar në bazë të zbatimit në praktikë të teorisë leniniste dhe staliniane të ndërtimit të socializmit në fshat, e përshtatur konkretisht në kushtet e vendit tonë. Ne vctë e kemi parë se si bujqësia jonë ngjiti hap pas hapi shkallët e saj drejt modernizmit, drejt rritjes së pandërprerë të rendimenteve. Por fitorja më e rëndësishme është se u mund mentaliteti mikroborgjez i fshatarit dhe u ngjall tek ai besimi për pronën e përbashkët kooperativiste. Kjo u arrit me një punë të dendur politike e ideologjike, e cila u shoqërua edhe me një organizim të shëndoshë, brendapërbrenda kooperativave. Më pas ky organizim u perfektionua edhe më tepër me bashkimin e disave prej tyre e deri te

krijimi i kooperativave të tipit të lartë, për të kaluar më vonë në shndërrimin e tyre në ndërmarrje bujqësore.

I gjithë ky zhvillim nuk ka qenë i lehtë për t'u arritur. Ai nuk ka qenë një zbatim shablon i ndërtimit të socializmit në fshat si në vendet e tjera. Ai ka hasur edhe në mjaft vështirësi e pengesa, të cilat janë kapercyer njëra pas tjetrës në rrugë të drejtë. Duhej kohë që fshatari ynë, i ushqyer me një mentalitet të prapambctur nga e kaluara, ta kuptonte drejt rëndësinë e këtij vendimi historik të Partisë. Fshatari ynë u bind ca më mirë për këtë kur pa konkretisht qëjeta ekonomike, arsimore, kulturore e sociale e fshatit tonë filloj të përmirësohet si pasojë e këtij kolektivizimi, ndryshe nga vendet e tjera revisioniste, ku socializmi u përmbyt dhe në fshat u rivendos kapitalizmi. Në disa nga këto vende, qysh në fillim, nuk u zbatua fare vija marksiste-leniniste në zhvillimin e bujqësisë, kurse në disa të tjera u shtrembërua. Pra, nga një anë, shohim ngritjen e pandërprerë, nga çdo pikëpamje, të fshatarësise sonë kooperativiste dhe, nga ana tjetër, degjenerimin, demoralizimin, mungesën e ushqimeve në vendet ku sun-
dojnë revisionistët, për të mos folur për vendet kapitaliste, ku, ashtu si edhe në vendet revisioniste, ekzistojnë kaosi, kriza, papunësia, ngritja e çmimeve etj., etj. Me një fjalë, atje vërtetohen të gjitha ato që kanë thënë Marks, Engels, Lenini dhe Stalini se imperializmi (aktualisht edhe socialimperializmi sovjetik) është në kalbëzim. Kapalistët e vjetër dhe të rinj të botës borgjezo-revisioniste nuk mund t'i shpëtojnë dot revoltës gjithnjë në rritje të klasës punëtore e fshatare.

Për të gjitha ato që janë realizuar te ne, mund të themi në mënyrë modeste se Partia jonë po e pasuron marksizëm-leninizmin. Ajo më e rëndësishmja lidhur me këtë problem jetik për të sotmen dhe për të ardhmen, është se te ne po konsolidohen ato që janë fituar, po ecet gjithnjë pa u ndalur përpara për të korrur fitore të reja në rrugën e marksizëm-leninizmit, që na krijoi gjithë këto të mira. Përsëri në rrugën e marksizëm-leninizmit duhet t'i zhvillojmë ne më tej fitoret e ardhshme; gjithashtu po në rrugën e marksizëm-leninizmit na vihet detyrë edhe t'i mbrojmë ato me çdo kusht, sepse armiqtë tanë janë të shumtë, të egër dhe të djallëzuar. Vetëm duke qëndruar të patundur përballë veprimtarisë së tyre, të hapët ose të fshehtë ne do të çajmë përpara dhe do të çajmë me sukses, në rast se vijen e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë e bëjmë të masave, në qoftë se me ideologjinë e saj mbrujmë shpirtrat e njerëzve tanë, në qoftë se do të vazhdojmë të ngjallim me ritme të larta patriotizmin e masave, atë patriotizëm të zjarrtë socialist që ka në bazën e vet pronën e pörbashkët të mjeteve të prodhimit, që mban parasysh luftën e klasave, luftën pa mëshirë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, luftën kundër mbeturinave dhe për forcimin e unititetit.

Uniteti ka qenë dhe është i fortë në Parti, në udhëheqjen e saj e në mbarë popullin tonë. Armiqtë tanë, ashtu sikurse në të kaluarën, do të vazhdojnë të bëjnë përpjekje të mëdha për ta përçarë këtë unitet, me qëllim që të na dëmtojnë, prandaj na vihet për detyrë ta ruajmë fort dhe ta kalitim vazhdimisht atë. Por uni-

teti ruhet vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Ai nuk forcohet duke u fërkuar krahët atyre që bëjnë gabime, që punojnë keq, apo që lidhin duart dhe qëndrojnë indiferentë. Jo, uniteti ruhet duke kritikuar hapur ata që gabojnë; duke u vënë gishtin në plagë kur janë prekur nga sëmundjet qoishin ato sado të vogla, por që duhen shëruar, duke solur me ta si shokë, si miq, si vëllezër dhe duke kërkuar prej tyre që të vënë më parë interesin e atdheut, të popullit, të Partisë e të socializmit e pastaj atë të vëllait, të motrës, të gruas, të kushërit, të farefisit etj. Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve tanë duhet të ndërtohen vetëm në baza të shëndosha marksiste-leniniste. Në familjet tona apo midis shokëve, ndërmjet të gjithë njerëzve tanë, është e domosdoshme të krijohet ajo dashuri e bazuar jo vetëm në atë që jemi bij dhe bija të një trungu, por se jemi bij e bija të këtij populli që ka vuajtur, që ka luftuar, që ka fituar dhe kërkon të fitojë përparrë armiqve më të egër, që dëshiron të jetojë i lirë dhe të ndërtojë socializmin. Prandaj, kur njëri gabon, shoku e ka për detyrë t'i heqë veshin, ashtu sikundër secili duhet t'ia heqë veshin cilitdo, sa herë që gabon dhë me gabimin e tij bën që këto interesa të përgjithshëm të cenohen.

Shokë dhe shoqe,

Sic e patë, në këto dy raporte ngrihen shumë probleme të rëndësishme. Në to ka kritikë të hapët dhe të singertë, sic ka edhe autokritikë të shëndoshë e revo-

lucionare, duke filluar që nga baza dhe deri në Komitetin Qendror të Partisë. Është e drejtë dhe marksiste që, krahas sukseseve të arritura, ne t'i raportojmë Kongresit të 7-të edhe për gabimet që janë vërejtur. Duke ia thënë Partisë, ky qëndrim e ngrë më lart autoritetin e udhëheqjes dhe të vetë Partisë sonë, i jep kësaj forcë, ndërsa gjithë njerëzve, kudo që janë, anëtarë partie ose të paorganizuar në Parti, i mëson që përpara interesave të atdheut të flitet gjithmonë hapur.

Në raportin e Komitetit Qendror, ndërmjet problemeve të rëndësishme, është edhe ai që lidhet me projektkushtetutën. Kushtetuta është një dokument me rëndësi të madhe historike. Në të mishërohet vija e drejtë e Partisë sonë. Kushtetuta e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë nuk është gjë tjeter veçse ajo pasqyrë reale e rrugës që ka ndjekur dhe që do të ndjekë Partia jonë marksiste-leniniste dhe Republika Populllore e Shqipërisë, rrugë që përshkohet, drejtohet e fryshtohet nga teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, rruga e proletariatit, e diktaturës së tij në të gjitha hallkat dhe në të gjitha shfaqjet. Kjo do të ngrejë akoma më lart entuziazmin e masave tona punonjëse, të cilat në këtë dokument historik do të shohin qartë detyrat dhe të drejtat që u takojnë, do të kuptojnë ç'rëndësi ka përfatet e vendit që këto detyra të zbatohen dhe që të drejtat, që sanksionohen në të, gjithashtu të ruhen dhe të mbrohen nga diktatura e të mos shkelen. Kushtetuta me nenet e saj do t'i tregojë po kështu mbarë botës kuptimin e lartë që kanë Partia e Punës e Shqipërisë dhe shiqti ynë i diktaturës së pro-

Ietariatit në çështjet kardinale të politikës së jashtme, për marrëdhëniet që duhet të ekzistojnë midis shteteve socialiste dhe si duhet të ndërtohen ato me shtetet që kanë rende të ndryshme ekonomiko-shoqërore. Ajo u tregon qartë armiqve edhe fatin që i pret, në rast se do të orvaten të sulmojnë atdheun tonë socialist.

Më së fundi Partia jonë, si kurdoherë, do të thotë në Kongres mendimin e saj edhe mbi situatën ndërkombëtare. Komunistët dhe mbarë populli ynë janë të bindur për pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste që ka shfaqur kurdoherë Partia jonë për këtë çështje të rëndësishme. Duke e bërë këtë, ne nuk mendojmë t'i japim kurkujt mësimë, por është e drejta dhe detyra jonë të shprehim botërisht pikëpamjet tona për një sërë problemesh ndërkombëtare.

Duke vepruar kështu ne jo vetëm që bëjmë të ditur kurdoherë se nuk jemi dakord me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik, që janë dy nga armiqtë më të egër të njerëzimit, të socializmit dhe të komunizmit, por, gjithashtu, shprehim pikëpamjet tona politike edhe për një sërë ngjarjesh e veprimesh, që janë zhvilluar kohët e fundit, sidomos gjatë periudhës pesëvjeçare që ndan dy kongreset. Këtu, natyrisht, bëhet fjalë edhe për qëndrimet që mbahen, si nga pseudomarksistët e nga shtetet pseudosocialiste, ashtu edhe nga ato vende e shtete borgjeze që janë në kundërshtim me imperializmin amerikan e me socialimperializmin sovjetik. Për rrugët dhe për politikën që kanë formluar dhe që ndjekin këto shtete ne nuk mund të mos themi mendimin tonë pozitiv, pavarësisht se me mjaft

prej veprimeve e qëndrimeve të tyre politike nuk mund të jemi dakord. Pra, siç e patë në raport, ne jemi me ta, jemi për luftën e tyre kundër shtypjes kapitaliste, imperialiste e socialimperialiste, në përgjithësi, por, konkretisht, me format e luftës dhe me të gjitha veprimet e këtyre shteteve, që quhen «bota e tretë», «bota e pa-angazhuar», «bota e varfér». etj., ne nuk mund të pajtohem. Për të gjitha këto çështje Byroja Politike është përpjekur të gjejë formulime sa më të përshtatshme dhe në rrugën e vërtetë klasore marksiste-leniniste.

Edhe për sa i përket lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare na duhet të mbajmë qëndrim në disa çështje kapitale, mbasi Byroja Politike konstaton se në radhët e kësaj lëvizjeje, nën maskën e teorisë marksiste-leniniste, është krijuar një konfuzion i rrezikshëm. Marksizëm-leninizmi po deformohet jo vetëm nga revizionistët sovjetikë, jugosllavë, italianë, francezë, spanjollë etj., por edhe nga të tjerë. Këtu, shokë, jemi në Komitetin Qendror, flasim hapur dhe mund t'i themi me emër edhe ata që e deformojnë, pavarësisht se në raport nuk flitet kështu.

Çështja është që ne nuk mund të jemi dakord me një sërë qëndrimesh politike dhe ideologjike të disa partive komuniste e punëtore, si dhe me Partinë Komuniste të Kinës, si, fjala vjen, lidhur me kuptimin që ka ajo për «botën e tretë», në të cilën ka deklaruar se bën pjesë edhe vetë. Ndarjen e botës në këtë mënyrë, si dhe pjesëmarrjen e Kinës në «botën e tretë», kur vetë Kina pretendon se është një vend socialist, ne e kon siderojmë gabim parimor nga ana e saj. Gjithashtu

nuk mund të jemi dakord me udhëheqjen kineze që pretendon, propagandon dhe vepron në bazë të tezës që mbron, sikur rreziku kryesor për socializmin dhe për popujt vjen kryesish nga socialimperializmi sovjetik, kurse rreziku nga imperializmi amerikan vjen në radhë të dytë. Siç e ka përcaktuar Partia jonë dhe siç po e zbaton me besnikëri Komiteti Qendror i saj, të dy këta imperializma janë njëloj armiq të egër e të rrezikshëm, prandaj duhen luftuar pa mëshirë në të njëjtën kohë. Nuk mund të mbështetesh te njëri për të luftuar tjetrin. Udhëheqësit kinezë, për ta realizuar në jetë këtë vijë që kanë adoptuar, përgatitin formulime dhe kryejnë veprime të tillë sa mjafton që dikush të jetë kundër Bashkimit Sovjetik (duke përfshirë pa dallim deri edhe ata me tendenca fashiste), dhe atë e quajnë se është me Kinën. Kurrën e kurrës Partia jonë nuk mund të jetë dakord me të tillë pikëpamje!

Duke ecur në këtë vijë, Kina ka mendimin se duhen mbrojtur edhe NATO-ja, edhe Tregu i Përbashkët Evropian, edhe «Evropa e Bashkuar» etj. Por dihet se të gjithë këta organizma janë krijesa të imperializmit amerikan dhe të borgjezisë së madhe reaksionare kapitaliste evropiane, shfrytëzuese dhe shtypëse të klasës punëtore të të gjitha vendeve të Evropës. Duke përkrahur ato, do të thotë të forcosh pozitat e imperializmit amerikan dhe të borgjezisë reaksionare botërore. Partia jonë, gjithashtu, nuk mund të jetë kurrsesi me një vijë të tillë!

Vijën e saj marksiste-leniniste Partia e Punës e Shqipërisë asnjëherë nuk e ka mbajtur fshehur. Ko-

miteti Qendror në të gjitha qëndrimet e tij mendimin e vet e ka shprehur botërisht dhe hapur, pa druajtje, pa frikë nga kurrikush. Llogaritë e qarta bëjnë miq të mirë. Nga ana tjeter, në gjithë propagandën tonë ne nuk e kemi prekur me emër Partinë Komuniste të Kinës që ndjek një vijë të kundërt me tonën, pavarësisht se një vijë të tillë ne e kemi luftuar. Bota, në fund të fundit, bar nuk ha, njerëzit këtë e kuptojnë dhe flasin.

Në takimet që kemi pasur me shokët kinezë kemi folur hapur me ta. Ne u kemi dërguar edhe mesazhe me shkrim dhe jo vetëm një, por më shumë, bile të gjata e prej shumë faqesh. Në to ne u kemi folur në mënyrë shoqërore, marksiste-leniniste, dhe kemi trajtuar probleme të mëdha parimore, përbajtjet e të cilave ju i dini mirë. Por, për mesazhet që ne i kemi drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje. Edhe në bisedimet që kemi pasur me udhëheqësit kinezë që më 1956 (kur vajtëm për herë të parë në Republikën Popullore të Kinës, ashtu edhe më vonë), pikëpamjet tona për revizionizmin, titizmin, hrushovizmin, luftën e klasave, politikën tonë bujqësore apo industriale, politikën e jashtme etj., ne ua kemi parashtruar kur doherë haptazi atyre, ashtu si edhe çështjet për të cilat nuk kemi qenë dakord me ta. Ka pasur edhe çështje për të cilat politika jonë e jashtme puqej me politikën e jashtme kineze, por më vonë erdhën momente që politika jonë për shumë gjëra nuk puqej më dhe kjo jo përfajin tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë ushqen një miqësi të

thellë e të singertë për popullin e madh vëlla kinez, dhe ajo nuk ka lëvizur asnjë fije nga vija e saj e drejtë e konsekiente marksiste-leniniste. Për ta vërtetuar këtë ekzistojnë dokumente të panumërtë e të njo-hura botërisht. Është vija e Partisë Komuniste të Kinës ajo që ka ndryshuar. Në nuk mund të ndjekim vijën vazhdimisht të lëkundshme të Partisë Komuniste të Kinës, ne kemi vijën tonë të drejtë e të patundur. Por, si shokë, si komunistë e si popull, ne e kemi mbrojtur dhe do të vazhdojmë ta mbrojmë Republikën Popullore të Kinës. Edhe në këtë raport të Kongresit, siç e patë, vazhdohet të flitet për miqësinë e madhe e të singertë të popullit tonë me popullin e madh kinez.

Ne i kemi kërkuar tri herë me radhë zyrtarisht Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe qeverisë kinëze për të dërguar në Pekin një delegacion partie dhe qeverie të nivelit të lartë për bisedime dhe për të sqa-ruar të gjitha çështjet për të cilat kemi mosmarrëveshje parimore. Po bëhen gati tre vjet që ata i kanë shtyrë kërkeshat tona të përsëritura, duke na dhënë arsyë të pa-qena, në një kohë që nuk lënë njeri pa pritur, duke fillouar që nga Niksoni dhe deri te Markosi i Filipineve etj.

Ne nuk mund të veprojmë siç thoshin dhe siç vazhdojnë të bëjnë thirrje revizionistët hrushovianë, që «të lëmë mënjanë çka na ndan dhe të ecim së bashku me ato që na bashkojnë». Jo, ne nuk i lëmë mënjanë ato që na ndajnë, përkundrazi i vëmë mirë në dukje për interesin e madh të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Pavarësisht se jemi një vend i vogël dhe Kina është një vend i madh, pavarësisht se Partia Komuniste

e Kinës është një parti e madhe në numër në krahasim me Partinë tonë të Punës, ne, me sa na është e mundur, dëshirojmë dhe bëjmë përpjekje të influencojmë pér të mirë te shokët kinezë. Kjo është një detyrë internacionaliste, pérderisa pranohet teza e drejtë marksiste-leniniste se nuk ka dhe nuk mund të ketë «parti të madhe» dhe «parti të vogël». Mbrojtja e marksiszëm-leninizmit duhet të bëhet me konsekuençë: kush ka të drejtë, të vazhdojë të ecë në rrugën që ka nisur, ndërsa kush ka gabim, të bëjë përpjekje ta njohe atë dhe të korrigohet. Në rast se nuk dëshiron të korrigohet, ai, në radhë të parë, i bën dëm vetes, por, në të njëjtën kohë, edhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Qysh pardje, agjencitë e ndryshme perëndimore të lajmeve, po transmetojnë vazhdimisht përditë njoftime sensacionale, se «në Kinë është kryer një grusht shteti dhe kanë marrë fuqinë në dorë Hua Kuo Feni dhe Li Hsien Nieni». Flitet, gjithashtu, se «janë arrestuar Van Hun Veni, Çian Çini, Çan Çun Çiao dhe Jao Ven Juanii». Agjencitë e lajmeve flasin, gjithashtu, se, i shoqëruar nga kryekomandanti i trupave të garnizonit të Kantonit (pér ta mbrojtur), është kthyer në Pekin Ten Hsiao Pini. Po sipas këtyre agjencive, kjo ka ndodhur se gjoja të katër të arrestuarit «kishin përgatitur një grusht shteti» dhe «kishin shtremberuar direktivat e porositë e Mao Ce Dunit».

Këto lajme janë dhënë nga agjencitë e huaja. Por Partia jonë, duke parë me vigjilencë dhe duke i gjykuar kurdoherë me sy kritik marksist-leninist ndodhitë në Kinë dhe në botë, mendon se këto turbullira dhe

vendime në forma puçiste e revizioniste, për të cilat flitet, duhet të kenë ndodhur. Nuk do të vonojë dhe koha do t'i vërtetojë së shpejti të gjitha këto.

Komunistët dhe mbarë masat punonjëse të vendit tonë duhet të janë vigjilentë e gjakftohtë, të ruajnë kompaktësinë e të forcojnë unitetin e çeliktë Parti-popull. Asnjë eveniment, sado i madh e negativ qoftë, nuk i tremb dhe nuk i trondit Partinë tonë të Punës dhe Shqipërinë socialiste. Ne vazhdimisht u kemi bërë ballë të gjitha furtunave të egra që na janë turrur, i kemi mposhtur ato dhe kemi dalë fitimtarë. Vija e Partisë sonë gjithnjë ka ndritur, se ka qenë dhe është e kulluar si kristali. Pavarësisht çfarë po ngjet në Kinë dhe çfarë rruge do të marrë ajo, Republika Popullore e Shqipërisë, me Partinë e saj heroike në krye, do të ecë kurdoherë përpara në rrugën që na kanë caktuar Marksit, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Thashë më lart se duhet të ruajmë gjakftohtësinë. Kjo, si në çdo rast, edhe gjatë këtyre ngjarjeve, është e nevojshme. Qëndrimet e Partisë sonë përballë karakterit që do të marrin ndryshimet në Kinë, duhet të janë të patundura dhe të mbështetura si kurdoherë në mark-sizëm-leninizmin. Ne do të ecim hap pas hapi me kujdes, pa u shpejtar, por edhe pa u vonuar. Partia jonë, sikurse është në karakterin e saj, nuk do të shkelë kurrrë mbi parimet, por gjatë ecjes sonë me kujdes në mbajtjen e qëndrimeve politike dhe ideologjike, në rast se vërtetohen që këto ngjarje kanë karakter revisionist fashist, nevë do të na duhet të kemi parasysh edhe pasojat që mund të rrjedhin në fushën e marrë-

dhënicve ekonomike që ekzistojnë në mes vendit tonë dhe Republikës Popullore të Kinës.

Për këto çështje Komiteti Qendror, kuadrot dhe gjithç komunistët në bazë, duhet të orientohen çdo ditë, në punën dhe në qëndrimet e tyre, nga shtypi i Partisë. Do të ketë njerüz që edhe mund të flasin jo drejt. Prandaj nuk duhet të qëndrojmë indiferentë dhe të lejohet që armiqtë, të inkurajuar nga këto ngjarje, të ndikojnë sadopak në mendjet e njerëzve të lëkundshëm për t'i kthyer ata në rrugën e tyre. Me kujdesin që thashë, masat e gjera të popullit të edukohen për të forcuar akoma më shumë besimin në vijën e drejtë të Partisë sonë. Edhe tani, si kurdoherë, populli do të tregohet i guximshëm dhc heroik përparrë kësaj furtune të madhe që po duket në horizontin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ne duhet të kemi parasysh mësimin e Marksit, se fitorja e revolucionit vjen me luftë dhe arrihet nëpërmjet zigzagesh, përmes ngritjeve dhe uljeve të saj. Ngjarjet që po ndodhin në Kinë, janë një minus i madh për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, por ne kemi bindjen e plotë se komunizmi do të triumfojë në botë.

Neve, komunistëve shqiptarë, na bie barra dhe detyra që me modesti, por me heroizëm e këmbëngulje, ta mbajmë lart flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, që ka qenë dhe mbetet flamuri i lavdishëm i Partisë sonë. Ne jemi të bindur se me vijën tonë të drejtë revolucionare do të janë gjithë popujt revolucionarë të botës, gjithë njerëzit përparimtarë dhe, në radhë të parë, marksistë-leninistët dhe partitë e tyre

të vërteta; se me ne do të jetë edhe populli i madh vëlla kinez. Në këtë vështrim, Partia jonë e Punës dhe Shqipëria socialiste kanë në botë një mbështetje e forcë kolosale. Ato i përngjasin atij shkëmbi në mes të oqeanit, por me bazamente të çelikta, të cilit i vërsulen valë të njëpasnjëshme, por asnjëra prej tyre nuk është e nuk do të jetë dot në gjendje që ta tundë nga vendi.

Shokë dhe shoqe,

Kjo është mbledhja e fundit e Plenumit të Komitetit Qendror që doli nga Kongresi i 6-të i Partisë. Analiza e bërë në raportet tregon se, në përgjithësi, veprimtaria e këtij Plenumi ka qenë pozitive. Ky Plenum nuk ka gabuar në çështjet politike, ideologjike, ekonomike dhe luftarake të Partisë sonë. Përkundrazi, ai ka lutfuar kurdoherë me guxim, pjekuri, frymë të lartë sakrifice e heroizmi për të zbatuar me konsekuençë vijën e Kongresit. Nga radhët tona dolën edhe elementë armiq, të cilët Komiteti Qendror, Partia dhe populli i demaskuan dhe i dënuan.

Por, pavarësisht se në punën tonë e përgjithshmja ka qenë pozitive, janë vërtetuar edhe një sërë të metash e gabimesh, të cilat ne nuk i kemi fshehur asnjëherë. Vetë Komiteti Qendror i Partisë i pari ka dhënë shembullin e një autokritike marksiste-leniniste përpara Partisë dhe masës. Krahas kësaj, ai nuk ka munguar të kritikojë, bille me ashpërsi, të gjithë ata që nuk e kanë zbatuar vijën e saj, që i shmangeshin zbatimit të drejtë

e me konsekuencë të kësaj vije, si dhe të gjithë ata që janë treguar të mefshtë e nuk e kanë justifikuar qenien e tyre si anëtarë partie apo si kuadro të saj. Komiteti Qendror mund të afirmojë me bindje të plotë se të gjitha këto janë bërë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, duke zbatuar drejt dhe duke mbrojtur normat që caktohen në statut, ligjet dhe rregulloret e Partisë. Por punën tonë si forum le të na e gjukojë Kongresi i ardhshëm i 7-të i Partisë. Ai le të gjukojë edhe secilin nga ne nëse e meritojmë apo jo, si individë, të jemi përsëri në forumin kryesor të Partisë, domethënë, këtu, në Plenumin e Komitetit Qendror të saj.

Ata që do të vijnë në Komitetin Qendror të ri, natyrisht, do t'i zgjedhë Kongresi i Partisë. Por, siç është zakon, Kongresit ia parashtron kandidaturat përfaqësia që zgjedhin delegatët. Ne duhet të jemi plotësisht të bindur si revolucionarë dhe si anëtarë të një partie marksiste-leniniste si kjo jona, se zgjedhja e këtyre kandidaturave nuk mund të ketë kurrë karakter subjektiv. Kjo do të thotë se njerëzit e rinj ose ata që nga të vjetrit do të zgjidhen përsëri në Komitetin Qendror, nuk do të vijnë aty pse dashka njëri ose tjetri. Kam bindjen se të gjithë shokëve të Plenumit, deri edhe anëtarëve më të thjeshtë të Partisë sonë, kurrë nuk u shkon në mendje një gjë e tillë. Veprimet e Partisë kanë qenë kurdoherë në rrugë konsekiente, marksiste-leniniste, revolucionare, të bazuara, në radhë të parë, në interesin e Partisë e të popullit, në interes të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Prandaj e kemi për detyrë, veçanërisht ne që kemi

qenë në udhëheqje, që, në rast se zgjidhemi në përfaqësi, të sjellim aty mendimin tonë kolegjial. Në mbledhjen e përfaqësisë nuk do të predominojë mendimi i shokëve të udhëheqjes kryesore (dhe ne nuk do ta lejojmë asnjëherë këtë), por, në radhë të parë, mendimi i përgjithshëm i Partisë. Aty do të shoshitet me kujdes të gjithanshëm veprimitaria e gjithë atyre që janë zgjedhur nga Kongresi i mëparshëm, nëse do të qëndrojnë ose jo në Komitetin Qendror, si dhe e atyre që do të vijnë të rinj në udhëheqje, me të gjitha karakteristikat, me të mirat dhe me të metat e tyre, të cilat i ka vënë në dukje jeta dhe eksperienca e Partisë.

Pra, siç shihet, do të ketë anëtarë të këtij Plenumi që do të rizgjidhen përsëri, por do të ketë edhe të tjerë që mund të mos zgjidhen më. Dëshiroj të theksoj me këtë rast që anëtarët e tanishëm të Plenumit të Komitetit Qendror, që nuk do të zgjidhen nga Kongresi,asnjëherë të mos mendojnë se moszgjedhja e tyre në Plenum bëhet për arsy politik. Këtu flasim haptazi, prandaj, po të kishte të tillë arsy, këto do të qenë vënë patjetër në dukje me kohë, qoftë në mbledhjet e ndryshme të Plenumit që kemi bërë pas Kongresit të 6-të të Partisë, qoftë atje ku shokët militojnë në organizat-bazë ose në komitetet e Partisë. Kjo nuk është vetëm në teori, por kështu veprohet te ne edhe në praktikë. Moszgjedhja e disave mbështetet në arsyet e tjera, si për shkak moshe, për arsyet plogështie, ose për shkak se ndonjëri nuk e ka justifikuar si duhet atë bindje që pati Kongresi i mëparshëm. Me këtë dua të them që ndonjëri nuk ka treguar atë hov dhe

shpirt revolucionar në kryerjen e detyrave e në zgjidhen e problemeve, me të cilat ka qenë ngarkuar, se ka qenë i mëfshtë, apo se tek ai ose ajo janë dukur mjaft karakteristika mikroborgjeze, të cilat, edhe pse nuk kanë arritur deri në stadin e një veprimtarie armiqësore, kanë penguar punën e Partisë.

Dëshiroj të vë në dukje, gjithashtu, se vetë shokët që nuk do të zgjidhen të kenë parasysh atë që ka theksuar vazhdimit Partia dhe që e dëshirojnë dhe e mbështetin me gjithë shpirt tërë komunistët, që udhëheqja e Partisë të jetë kurdoherë e re, me eksperiencë, e çeliktë, e pjekur; që tek ajo të ketë gjak të vjetër, por të futet edhe gjak i ri, duke formuar kështu të dyja palët një beton të çeliktë.

Ardhja në Komitetin Qendror, krahas shokëve të vjetër, e njerëzve të rinj, që ka rritur dhe edukuar Partia, që ka ngritur puna dhe revolucioni, që kanë treguar zotësi të shquara, pjekuri e kanë bërë sakrifica të mëdha, është e domosdoshme, jctike dhe shpëtimtare për Partinë. Të tillë njerëz duhet të vijnë në udhëheqje.

Por, shokët që nuk do të rizgjidhen, të mos ulin kokën dhe të mos dëshpërohen. Ata duhet të jenë të qetë, jo vetëm në vetvete e në familjen e tyre, por edhe jashtë, sepse janë kuadro të vjetër e besnikë të Partisë. Si të tillë ata do të vazhdojnë të punojnë përsëri në institucione apo në sektorë të tjera të punës dhe atje të bëhen shembull për zbatimin me konsekuençë të vijës së Partisë. Këta shokë kurrë të mos grumbullojnë në zemër dhe në ndërgjegje ndjenja të dësh-

përimit dhe pikëpamje mikroborgjeze, gjë që do të gërryente ndërgjegjen e tyre. Armiku i ruan këto situata dhe përpinqet t'i shfrytëzojë, t'i fryjë e t'i zmadhojë. Ai mund edhe t'u sillet rrotull njerëzve tanë e, direkt ose indirekt, edhe mund t'u thotë: «Ej, ja, edhe ty të shtrydhën dhe, më së fundi, të hodhën poshtë si lëvozhgë limoni!». Komunistët, sidomos ata që kanë qenë në udhëheqje, kurrë dhe në asnjë mënyrë të mos bien në kurthin e të tillë elementëve apo e të tilla pikëpamjeve! Kjo, natyrisht, varet nga ndërgjegjja dhe nga kuptimi i drejtë i qenies në Plenumin e Komitetit Qendror, që duhet merituar plotësisht. Kur këtë nuk e meriton, nuk do të thotë se nuk je komunist i mirë, por, si udhëheqës ke treguar dobësi, mefshtësi, apo nuk i ke zbatuar si duhet detyrat. Megjithatë je dhe qëndron besnik i Partisë, se je kuadër, ke merita dhe eksperiencë dhe këto nuk të hidhen poshtë kurrë. Përkundrazi, ato duhet e do të shfrytëzohen nga Partia.

Në Kongres, rëndësi të madhe kanë edhe diskutimet e shokëve, të cilat duhet të jenë të një niveli sa më të lartë. Në to të flitet për luftën e Partisë sonë, për sukseset që janë arritur në lëmin politik, ideologjik, ekonomik e ushtarak etj., por natyrisht, jo me hollësi. Edhe për fakte konkrete do të flitet, se kanë rëndësi të madhe, por, para së gjithash, diskutimet duhet të ngrenë probleme.

Në emër të Byrosë Politike dhe timin shpreh bindjen e plotë se Kongresi i ardhshëm do të jetë një ngjarje e madhe historike, ashtu siç kanë qenë historike të gjitha kongreset e mëparshme të Partisë. Ato-

jo vetëm që kanë caktuar vijën për atë perspektivë që hapej përpara çdo etape, por me pjekuri e drejtësi, në bazë të marksizëm-leninizmit, kanë bërë vlerësimë të drejta edhe për një sërë problemesh kyç kombëtare e ndërkombëtare. Çdo kongres është një moment historik për Partinë, për popullin dhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Ai është njëkohësisht edhe një kontribut sado modest në thesarin e marksizëm-leninizmit. Në sajë të teorisë sonë ne shohim se si një Shqipëri e vogël, e rrethuar nga të gjitha anët nga një det armiqsh, po çan përpara dhe ecën kryelartë, duke zbatuar me vendosmëri dhe duke mbrojtur pa u epur marksizëm-leninizmin. Kjo ndodh te ne, sepse në fuqi është populli, sepse udhëheq klasa punëtore me dikaturën e saj, duke pasur në krye Partinë e Punës të Shqipërisë.

Jemi dakord për miratimin e raporteve?

(Të gjithë shokët u shfaqën dakord.)

Atëherë, shokë, e mbyllim Plenumin. Mirupafshim në Kongres!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

KËSHITU DUHET TË KETË NDODHUR ME «KATERSHEN»

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

23 tetor 1976

Unë e lexova me vërejtje informacionin mbi një qarkore të KQ të PK të Kinës. Sipas mendimit tim del se të tëra ato që thonë kinezët, janë profka dhe gënjeshtëra.

Në tetor 1974, shkruhet në këtë qarkore, Van Hun Veni paska vajtur te Mao Ce Duni dhe paska «akuzuar» Çu En Lain. Sipas meje, Van Hun Veni ka vepruar drejt dhe një gjë e tillë është e lejueshme nga ana e normave të partisë.

Çdo anëtar i Komitetit Qendror, bile çdo anëtar partie, ka plotësisht të drejtë të shkojë te kryetari ose te sekretari i parë i KQ të Partisë dhe t'i shfaqë atij mendimin e vet për një anëtar të udhëheqjes ose për cilindri komunist, në çfarëdo funksioni që të jetë ky. Ky veprim konsiderohet rregull partie. Në praktikën e përditshme shumë njerëz, anëtarë partie osc persona të paorganizuar në parti, i drejtohen Komitetit Qendror, kryetarit ose sekretarit të parë të Komitetit Qendror

me letra me firmë ose edhe anonime, duke e informuar atë për veprimtarinë e atyre njerëzve që bëjnë gabime.

Kështu, një anëtar i udhëheqjes së partisë, siç ishte Van Hun Veni, duke shkuar te kryetari i Komitetit Qendror për të kritikuar veprimet e një anëtarë të Byrossë Politike, nuk mund të konsiderohet se ka bërë ndonjë faj dhe ca më shumë komplot, përkundrazi një gjë e tillë është diçka e rregullt. Vetëm ata që dëshirojnë që veprimtaria e tyre jo e rregullt apo gabimet që kanë të mos u njihen nga udhëheqja mund të mendojnë dhe ta cilësojnë këtë gjë ndryshe. Në mënyrë të veçantë në rastin e Mao Ce Dunit, i cili qëndronte i mbyllur në zyrë dhe priste që të tjerët t'i vinin dhe t'i shfaqnin mendime për punët dhe për njerëzit, qofshin këto kolektive ose individuale, të veçanta, një veprim si ky që ka bërë Van Hun Veni, ishte krejt normal. Prandaj akuza që i bëhet Van Hun Venit, është pa baza dhe e dënueshme. Për ne është e qartë se kjo bëhet me ligësi nga ata që e kanë trilluar.

Si nënkyrjetar i Komitetit Qendror, Van Hun Veni, siç thashë, kishte plotësisht të drejtë të shkonte te Mao Ce Duni si kryetar i Komitetit Qendror të Partisë dhe t'i shprehte këtij mendimin për një anëtar të Komitetit Qendror. Mirëpo udhëheqësit aktualë kinezë e akuzojnë rëndë Vanin, si «komplotist». Duke e njobur cili ishte Çu En Lai dhe çfarë veprimtarie zhvillonte ai, mendoj se Van Hun Veni ka bërë mirë që ka vajtur dhe i ka folur Mao Ce Dunit për Çunë. Me këtë na bëhet e qartë se ata që akuzohen tani nga Hua Kuo Feni me shokë, kanë pasur një pikëpamje të njëjtë, dhe

të drejtë, për Çu En Lain, për veprimet, për krimet dhe për intrigat e tij.

Informacioni nga Pekini nuk thotë gjë, po ka mundësi që Van Hun Veni të ketë shkuar te Maoja për të kritikuar Çu En Lain, pasi është konsultuar me shokët e tjerë për t'i shprehur pikëpamjen e përbashkët për të.

Për ne është e qartë se Van Hun Veni nuk duhet të jetë mjaftuar me kaq. Këtë përqapje lidhur me veprimet në rrugë jo të drejtë marksiste-leniniste nga ana e Çu En Lait, ai e ka bërë edhe zyrtarisht. Fakti që këtë problem ai e shtroi haptazi edhe në Plenumin e 2-të të KQ të PKK, të zgjedhur nga Kongresi i 10-të i PKK, dhe në sesionin e parë të Asambleës Popullore të Legjislaturës së IV, siç përmend qarkorja që na është bërë e njohur, vërteton se as Van Hun Veni, as shokët e tij, që po persekutohen tanj atje, nuk vepronin aspak si «komplotistë», por, përkundrazi, si të tillë kanë vepruar këta që erdhën në fuqi.

SHOKU RAMIZ ALIA: Më falni se po ju ndërpres shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Fol, shoku Ramiz!

SHOKU RAMIZ ALIA: Plenumi i 2-të i KQ të PK të Kinës, për të cilin bën fjalë qarkorja e kinezëve, është ai plenum ku Ten Hsiao Pini u zgjodh nënkyretar i partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht kështu është. Kjo do të thotë, se këta elementë, sipas mendimit tonë, kanë reaguar drejt, por kundërrevolucionarëve nuk u ka ardhur për osh ndërhyrja e Van Hun Venit, prandaj kanë kundërvepruar. Siç del, Maoja nuk i ka pranuar

propozimet e akuzat e clementëve të së majtës dhe, jo vetëm kaq, por, sipas asaj që thuhet në qarkore, Maoja e paska qortuar Van Hun Venin për propozimet e tij, të cilat ia rrëzoi.

Kjo tregon se Mao Ce Duni, së bashku me Çu En Lain e grupin e tij, mbështetnin elementët e djathëtë revizionistë dhe reaksionarë, të cilët qëndronin të struktur në aparatet e partisë dhe të shtetit ose që u rehabilituan prej tyre, si Ten Hsiao Pini.

Në një informacion që vjen nga një burim kinez, thuhet se Çian Çini kishte kohë që e kundërshtonte Çu En Lain në veprimtarinë e tij revizioniste dhe kapitulluese. Jo vetëm kaq, por ajo vinte, gjithashtu, në dijeni Maon për pikëpamjet e saj mbi Çu En Lain dhe një gjë e tillë ishte e drejtë. Por tani na del, sipas qarkores që na bëhet e ditur, se Mao Ce Duni e paska kritikuar Çian Çinin si «ambicioze», se i çante atij kokën duke i servirur «çështje të vogla» dhe jo probleme të mëdha. Nga kjo mund të dalim në konkluzionin se çdo kritikë që bëhej nga të tjerët kundër Çu En Lait, ishte e papranueshme nga ana e Mao Ce Dunit. Maoja e mbronte revisionistin Çu En Lai.

SHOKU HYSNI KAPO: Dhe nga sa mbajmë mend, për një periudhë kohe Van Hun Veni nuk është dëgjuar fare.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ashtu është. Tani vihet pyetja: Çfarë komploti ka këtu? Nuk paskan të drejtë disa anëtarë të Byrosë Politike të ngrihen dhe të shfaqin haptazi në Komitetin Qendror një mendim, të bëjnë një propozim, makar edhe të kritikojnë një

person si Çu En Lain apo cilindo tjetër anëtar të udhëheqjes qoftë? Ne, duke u bazuar në normat e Partisë, nuk shohim asnjë shkelje, përkundrazi konstatojmë dogmatizëm dhe autoritarizëm jomarksist nga vetë Maoja, i cili i kritikon për «dogmatizëm» këta clementë. Komplotistët e marrin si një armë në favor të tyre atë që thotë Maoja, se kundërshtarët e tyre janë «dogmatikë», por i tillë është vetë Mao Ce Duni, i cili i detyronte shokët të vepronin vetëm ashtu si thoshte dhe si vendoste ai.

Më vonë, më 3 shkurt, Çan Çun Çiaoja, thuhet në qarkore, paska shkruar një artikull, me të cilin ka kundërshtuar në mënyrë të tërbuar propozimin personal të Maos. Se çfarë propozimi është ky dhe për cilën çështje është fjala, këtë nuk e kemi të qartë; po, sipas puçistëve, edhe në këtë rast duhej prapë t'i mbyllej goja atij që guxonë të kritikonte, se për gjërat që vendoste Maoja, nuk duhej kritikuar. Mbështetje këtu bëhet aluzion për sjelljen në udhëheqje të Ten Hsiao Pinit ose të kuqido tjetër, që çarkorja nuk e përcakton. Ka mundësi që pikërisht për të kritikuar këtë propozim ka botuar artikullin Çan Çun Çiaoja, artikull që, sigurisht, nuk ka qenë i mbështetur në mësimet e Maos etj. Në qarkoren e fundit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës botimi i këtij artikulli konsiderohet krim, mbasi kundërshtohej Maoja.

Ky kundërshtim mundet që kishte të bënte edhe me emërimin e Hua Kuo Fenit në funksionin që kishte menduar Maoja si nënkyretar të partisë dhe kryetar të Küshillit të Shtetit. Kjo do të thotë se të katër shokët e

udhëheqjes që u dënuan, nuk e kanë pranuar propozimin e Mao Ce Dunit për caktimin e Hua Kuo Fenit në postet që iu ngarkuan, dhe mbase, për një gjë të tillë, ata kanë shprehur pikëpamjen e tyre publikisht në këtë artikull. Kjo konsiderohet, gjithashtu, nga puçistët si një «komplot», gjë që natyrisht, nuk mund të pranohet, sepse komploti nuk bëhet në këtë mënyrë.

Një ambasador i Kinës në një shtet perëndimor, pasi i foli ambasadorit tonë për «komplotin e të katërve», duke e informuar gjoja në konfidencë, u shpreh kështu: «Po ta them në intimitet se Çan Çun Çiaoja është agjent i Guomindanit dhe se të katër komplotistët Mao Ce Duni që mië përpara i njihte ç'njerëz të këqij ishin, por ai i lejoi vetë që të vinin në Pekin dhe të eaktoheshin rë Komitetin Qendror, deri edhe në Byronë Politike». Ç'nuk trillojnë për këta të katër! Po dhe çfarë leshkosh janë!! Nuk e kuptojnë se kështu demaskojnë vetë Maon?! Apo e bëjnë këtë me qëllim, pikërisht si revizionistë e reaksionarë që janë, të «shkurorëzojnë» Maon për ato që kanë pësuar nga lëkundjet e tij dhe për planet e tyre ultrarevizioniste e reaksionare në të ardhmen. Ec e merri vesh këto kinezëri!

Veçanërisht Çian Çinin revizionistët puçistë kanë arritur ta cilësojnë «grua të rrugëve» dhe shpërndajnë kundër saj broshura, në të cilat shkruhet me termë aq të ndyrë, sa e quajnë «putanë». Bëhet pyetja: Si mund të qëndronte për 33 vjet me radhë kjo «putanë» grua e Mao Ce Dunit, të lindte fëmijë me të, të zgjidhej anëtare e Komitetit Qendror dhe e Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste të Kinës? Ku ishin këta «trimë»

që tani shpisin të tilla monstruozitete, sa as literatura më e ndyrë pornografike e Perëndimit nuk është në gjendje të shkruajë në një mënyrë të tillë? Kuptohet vetveti se vetë këta njerëz janë agjentë të imperializmit dhe me anën e Çian Çinit përpinqen të diskreditojnë personalisht Maon, gjoja duke ruajtur flamurin e tij, natyrisht derisa të kapërcejnë lumin. Edhe ato pak gjëra të mira që ka bërë Maoja për Kinën, revisionistët puçistë po ia njollozin me të tilla veprime.

Më poshtë në qarkore puçistët vazhdojnë të bëjnë akuza të përgjithshme në adresë të elementeve të majtë sepse këta po punonin për të prishur planet komplotuese të krahut revisionist, me Çu En Lain, Ten Hsiao Pinin, Hua Kuo Fenin e të tjerë. Këto akuza në seri janë për gjëra fare të kota, të shpifura, për gjëra të rëndomta. Këto, sipas mendimit tim, janë vënë në qarkore nga ana e puçistëve me Hua Kuo Fenin në krye, se ata nuk kanë çfarë akuze tjetër të vënë, që t'i nxjerrin si «komplotistë» udhëheqësit e krahut të majtë. Të gjitha veprimet dhe lusta që po bënin këta kundër reaksionit, u prishte qetësinë revisionistëve, të cilët i mbështeste Maoja. Revisionistët kishin krijuar një bazë të fortë në parti dhe në shtet. Ata kishin në dorë kyçet dhe vendosnin kudo njerëzit e tyre. Në këtë gjendje të favorshme që kishin krijuar për veten e tyre, ata nuk donin që të trazoheshin nga të tjerët. Mirëpo qetësinë atyre ishin duke ua prishur «të majtë» me artikuj dhe me forma të tjera, duke përfshirë edhe një sërë kritikash. Të gjitha këtyre revisionistët u vinin ngjyrën e një «komploti». Komplotin revisionist që këta e ki-

shin përgatitur me kohë vetë, përpiken t'ua hedhin atyre personaliteteve që po i quajnë radikalë, po që neve, me kaq sa dimë, na duket se ishin në pozita më të shëndosha, me gjithë gabimet e të metat që mund të kenë.

Unë shpreh bindjen se Çu En Lai, i mbështetur nga Maoja, kishte arritur të grumbullonte rrëth vetes gjithë revizionistët dhe reaksionin, me një fjalë tërë partizanët e Liu Shao Ci tradhtarit. Ai i futi këta të gjithë me radhë e gradualisht në aparatet e partisë, të shtetit, të ushtrisë dhe kudo. Pasi ia arriti këtij qëllimi, Çu En Lai iu vu punës për të spastruar njërin pas tjetrit gjithë kundërshtarët, prandaj kurdisi në fillim çështjen e Lin Biaos, që ishte kundërshtari kryesor i tij. Me kurthin që ai i ngriti Lin Biaos, e likuidoi këtë. Pas këtij iu vunë punës për të likuiduar kundërshtarët e tjerë që kishte nxjerrë Revolucioni Kulturor, me Kan Shenin dhe të tjerë në krye. Por Kan Shenin u sëmur dhe vdiq, ndërsa para Lin Biaos u likuidua Çen Po Taja.

Mbeteshin tani këta të katër, Van Hun Veni, Jao Ven Juani, Çian Çini dhe Çan Çun Ciaoja, të cilët ishte e zorshme për Çu En Lai që t'i eliminonte. Por, si një organizator e komplotist i madh revizionist që ishte, duke pasur mbështetjen e Maos, Çu En Lai arriti të rehabilitonte dhe të sillte përsëri në udhëheqje Ten Hsiao Pinin, të cilin punoi me të madhe ta përgatiste si zë-vendës të tij. «Katërsja» do ta ketë kundërshtuar menjëherë rehabilitimin e Ten Hsiao Pin revizionistit, por

ngritja e tij do t'i jetë imponuar nga Maoja. Jam i bindur se të katër këta nuk duhet ta kenë pranuar ardhjen e **Ten Hsiao Pinit** në udhëheqje të partisë dhe të shtetit. Atyre duhet t'u ketë thënë Maoja që të bëhet siç propozonin Çuja me shokë.

Mendoj se Çuja duhet t'i ketë këshilluar bashkë-punëtorët e tij që, sa të ishte Maoja gjallë, të mos vepronin. Mirëpo, pas vdekjes së Çusë, vepruan këta të katër, kështu që, në sajë të rezistencës së këtyre, Teni nuk u emërua dot në vendin e Çusë si kryetar i Këshillit të Shtetit. Lindi kështu nevoja që të zhvillohej më tej Revolucioni Kulturor. Mirëpo Maoja, duke qenë në kundërshtim me këta të katër, thirri Hua Kuo Fenin, të cilin e bëri nën kryetar të partisë, e vuri edhe në krye të qeverisë. Maoja e dinte mirë se Hua Kuo Feni ishte partizan i Çu En Lait. Këtë gjë e dinin mirë, gjithashtu, edhe Van Hun Veni, Çan Çun Çiaoja, Çian Çini dhe Jao Ven Juani, prandaj këta duhet ta kenë kundërshtuar ardhjen e Hua Kuo Fenit në udhëheqje, por sjelljen e tij si nën kryetar të partisë dhe kryetar të Këshillit të Shtetit ua ka imponuar Maoja.

Pas vdekjes së Maos «katërshtja» duhet ta ketë kundërshtuar përsëri ardhjen e Hua Kuo Fenit në krye të partisë dhe të shtetit, por ky kundërshtim është kon sideruar «komplot» nga ana e revizionistëve. Duke i ciliësuar këta të katër si njerëz «që kanë luftuar kundër partisë, që kanë kundërshtuar Mao Ce Dunin dhe vendimin që mori vetë ai për sjelljen e Hua Kuo Fenit në krye», pa mbledhur as Komitetin Qendror, as Byronë Politike etj., etj., i arrestuan. Mendoj se kështu duhet

të jetë realiteti, ndryshe nuk ka si kuptohen ngjarjet që kanë ndodhur.

Duke lexuar informacionin që na erdhi, duket qartë se çfarë shpifjesh dhe akuzash false janë kurdisur kundër «katërsheve». Tradhtarët revizionistë i akuzojnë ata se «kanë biseduar me dhjetëra herë me njerëz të huaj, kanë mbajtur lidhje me ta», pa i përmendur me emër cilët janë. Këta harrojnë se, duke filluar që nga vetë Maoja e Çu En Lai dhe gjithë pjesëtarët e tjerë të grupit revizionist, janë takuar e kanë biseduar kushtësi sa herë me të huaj të kalibrave të tillë si Kisingerët, Niksonët, me derrin dhe me dosën, me ditë dhe me net të tëra. Dhe, që të mos i akuzojnë për këto takime që i dinte gjithë bota, revizionistët akuzojnë «katërshe» se paskan biseduar me njerëz të huaj! Me këtë ata duan të thonë se këta të katër «ishin agjentë të të huajve». Kështu e cilësojnë ata takimin e Çian Çinit me një gazetare a shkrimtare amerikane që shkruan për të.

Me këta të katër, revizionistët veprojnë njëlloj sikurse vepruan me Lin Biaon, duke i akuzuar si «agjentë», por se të kujt, këtë nuk e thonë. Me siguri që do ta thonë nesër dhe, në këtë drejtim, ka shenja që tani sikur kanë qenë «agjentë të sovjetikëve», ashtu sikurse thanë për Lin Biaon. I njëjti ambasador kinez, që përmenda pak më parë, i ka treguar ambasadorit tonë, përveç sa thashë, edhe se «këta të katër, hëpërhë, nuk mund ta themi se janë agjentë të sovjetikëve, por asgjë nuk na siguron për këtë, dhe nesër ne mund të zbulojmë se janë njerëzit e tyre». Me siguri revizionistët

kinezë, pasi të kurdisin dokumente false, kanë për ta thënë edhe këtë.

Nga ana tjeter, po ky ambasador kinez e informoi ambasadorin tonë se «Perëndimi i cilëson të katër komplotistët si radikalë të majtë, po nuk është ashtu», se, sipas tij, «ata janë ekstremistë të djathët, por të fshehur nën petkun e radikalëve të majtë». Natyrisht, ata nuk thonë dot se këta të katër janë agjentë të amerikanëve, sepse vetë e kanë grurë me imperialistët janki.

Kuptohet, megjithëse jo drejtpërdrejt, që puçistët, me Çu En Lain në krye, kanë qenë kundër Revolucionit Kulturor. Bile ata e atakojnë këtë revolucion, që demaskoi shtabet e reaksionit brenda në parti, kur pohojnë se Maoja ka kritikuar Çian Çinin dhe tre të tjerët, sepse «gjatë zhvillimit të Revolucionit Kulturor u kanë vënë kapele në kokë disa udhëheqësve» etj., etj. Me këtë duan të thonë se përkrahësit e Revolucionit Kulturor etj., etj., kanë goditur partinë, i akuzojnë ata se «kanë bërë krime» që «u kanë vënë kapele në kokë» kundërrevolucionarëve, se «kanë rrëzuar kë të mundnin» etj., etj.

Duket se, menjëherë pas vdekjes së Maos, katër të akuzuarit duhet të kenë ngritur çështjen se cili do të zgjidhej në udhëheqjen e re. Mirëpo, për puçistët e Hua Kuo Fenit kjo konsiderohet «intrigë», «komplot». Po përse na qenka intrigë apo koniplot derisa ata e kanë kundërshtuar zgjedhjen e Hua Kuo Fenit si udhëheqës kryesor, qysli kur ishte gjallë Maoja?

Akuzat e puçistëve janë aq banale saqë, për të bindur të tjerët, mundohen të gjejnë qimen në vezë. Ja çfarë thonë këta në qarkore: Maoja, në prill të vitit

1976, ka theksuar se «duhet ecur sipas kursit të së kaluarës», kurse këta të katër e paskan «shtrembüuar» këtë, duke përdorur formulën «të veprojmë sipas kursit të përcaktuar». E ku qëndron këtu ndryshimi? Zor ta dallosh, por, po të mendosh thellë, edhe thënia e Maos «të ndjekim kursin e së kaluarës» përmendet me qëllim nga revizionistët. Kjo duhet marrë me mend se me kursin e vjetër kuptohet vija e ndjekur prej Maos, Çu En Lait dhe Ten Hsiao Pinit me shokë në të gjitha drejtimet. Sipas këtyre, «elementët më të mirë janë njerëzit e rivendosur në pushtet dhe në parti, e jo ata që kanë dalë nga Revolucioni Kulturor». Ky revolucion përpuçistët tani mori fund, prandaj bëjnë thirrje «të drejtoheni nga kursi i vjetër, të mos ngrihet krye kundër atyre që u rehabilituan, se ata janë më të mirët».

Pra, ngritjen e problemit të zgjedhjes së udhëheqjes së re nga ana e «të majtëve», renegatët e cilësojnë «krim». Me këtë shpjegohet edhe shfrytëzimi i thënies së Maos «bashku dhe mos u përça... mos komploto dhe mos intrigo!». Të tëra këto që thotë Maoja, puçistët i përdorin për të mbrojtur këtë kurs dhe akuzojnë «katërshen» sikur ka shtrembüuar thëniet e Maos. Në fakt, këtë parullë Maoja e ka hedhur që në kohën e Revolucionit Kulturor, kurse puçistët aktualë përpinqen të vërtetojnë sikur ai e paska thënë tani dhe posaçërisht kundër këtyre të katërve. Shihet qartë hileja e puçistëve për të gënjer masat e gjera të partisë dhe të popullit, derisa përpinqen të bindin njerëzit sikur Maoja e paska thënë këtë gjë tani. Sidoqoftë e ka lëshuar Maoja tani

apo gjatë Revolucionit Kulturor këtë thënje, prej saj nuk del si duhet fryma revolucionare dhe klasore.

«Mos komploto», thotë Maoja, po në realitet cilët janë ata që komplotojnë? Po të analizosh veprimtarinë e këtyre të katërve del se këta s'kanë bërë komplot. Ata që kanë dashur ta ndryshojnë fare regjimin në Kinë, dhe këtë ndryshim janë përpjekur ta realizojnë, janë Liu Shao Çia, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Pen Çeni e të tjerë. Disa prej tyre ishin mënjanuar gjatë Revolucionit Kulturor, por erdhën përsëri në fuqi, prandaj duheshin demaskuar dhe luftuar për veprimtarinë kundërrevolucionare që po zhvillonin. Po kush do t'i lufkonte ata? Natyrisht, elementët revolucionarë me një parti marksiste-leniniste. Mirëpo njerëzit që kishin fuqinë në dorë në Kinë, siç ishin Çu En Lai me shokë, të cilët nuk i kishte fshirë dot vala e Revolucionit Kulturor dhe që dëshironin ta mbanin e ta përjetësonin këtë fuqi, i akuzojnë elementët e së majtës si «komplottistë». Puçistët e shfrytëzojnë këtë shprehje për të mbrojtur veten e tyre. Tani të tërë këta kanë ardhur në fuqi dhe i akuzojnë të katër si shkelës të direktivave të Maos.

I akuzojnë, gjithashtu, këta të katër se kanë shkruar një artikull kundër revizionizmit, ku bëhet thirrje për të vepruar «sipas kursit të përcaktuar nga kryetari Mao». Ky artikull konsiderohet si një sulm antiparti kundër Komitetit Qendror. Shumë mirë kanë bërë këta të katër që e kanë sulmuar Komitetin Qendror, në qoftë se ky ka qenë në rrugën revizioniste. Në artikull, duke shtruar luftën kundër pragmatizmit, flitet edhe

kundër revizionizmit. Pragmatizmi dihet se përfaqësohej nga Çu En Lai, nga metoda e veprimitarisë së tij. Zbatimi i pragmatizmit nga ana e tij do të thotë veprimtari kundër marksizëm-leninizmit.

Në një bisedë që ka bërë me shokët tanë, kur këta kanë qenë në Pekin, Mao Ce Duni u ka thënë këtyre: «Në qostë se revisionistët ndonjëherë do të uzurpojnë udhëheqjen në Kinë, marksistë-leninistët e vendeve të tjera duhet po këshfu t'i demaskojnë me vendosmëri këta revisionistë dhe të bëjnë kundër tyre luftë, duhet ta ndihmojnë klasën punëtore dhe masat e popullit të Kinës të luftojnë kundër revizioniznit».

Çan Çun Çiaoja e akuzojnë se ka mbajtur një mbledhje me komisarët e ushtrisë etj., ku ka vënë në dukje si çështje të dorës së parë luftën kundër pragmatizmit, dhe këtë ide ai e ka mbrojtur në këtë mbledhje. Se si e ka bërë këtë, ne nuk dimë gjë, por duket se ka theksuar që «ne, marksistët, duhet ta mbrojmë teorinë marksiste-leniniste, por njëkohësisht edhe ta zbatojmë në praktikë, dhe këtë ta bëjmë jo duke hedhur poshtë paramet e saj». Sipas puçistëve, «Çan Çun Çiaoja me shokë e kishin hedhur poshtë marksizëm-leninizmin». Edhe kjo është një akuzë tjetër e rreme që u bëhet atyre.

Maoja ka thënë se «për të mbrojtur marksizmin, duhet të shkosh edhe kundër rrymës». Në fakt Van Hun Veni, Çan Çun Çiaoja, Çian Çini dhe Jao Ven Juani, pavarësisht nga kundërshtimet e forta të revizionistëve, kanë luftuar kundër revizionizmit. Janë pikërisht këta që i goditën revisionistët brenda radhëve të par-

tisë, kurse puçistët i akuzojnë për «tradhti ndaj Maos, Komitetit Qendror, revolucionit» etj.

Elementët e «katërsjes», sipas revizionistëve, «kanë shtrembëruar strategjinë e Maos në luftën kundër Lin Biaos dhe Konfucit». Po cila është kjo strategji e Maos? Këtë revizionistët nuk na e thonë. Në qoftë se ata të katër e «kishin shtrembëruar këtë strategji», po këta me Maon në krye ku qenë? Përse nuk e ngritën në kohë këtë çështje? Derisa ishte puna kështu, përse nuk thirrën një mbledhje të udhëheqjes për t'u ngritur këmbët atyre që po bënin «shtrembërimë»? Derisa Lin Biaos dhe Çen Po Tasë ua ngritën këmbët, nuk ua ngrinin dot vallë edhe këtyre? Pse nuk vepruan, gjithashtu, që atëherë kundër Çian Çinit? Po këtë ata nuk e bënin dot, se në kohën e Revolucionit Kulturor ishin, me nder, të...

Kundër Çian Çinit puçistët thonë një mijë gjëra. Revizionistët nxjerrin sikur Maoja i paska thënë në këtë dhe në atë kohë që «ti je ambicioze, ti kërkon të marrësh fuqinë, ti je e tillë e ti je e atillë, ti mbron një pakicë, ju jeni një katërsje» etj., etj. Mirëpo këto çështje, sipas tyre, kishin dalë në shesh vite më parë dhe, Maoja, siç thuhet në qarkore, i paska thënë këto gjëra edhe në mbledhje. Derisa qenka kështu, është e çuditshme përse nuk është mbajtur qëndrim si ndaj Çian Çinit, ashtu dhe kundër tre të tjera? «Ja, shiko, ti ke gabime», i paskej thënë Maoja Çian Çinit, «po shokët nuk t'i vënë në dukje këto. Ti merresh me gjëra të vogla, me të cilat vjen e më shqetëson mua dhe nuk më flet për gjërat e mëdha». Këto i digjnin Maos.

Sipas puçistëve, «katërshja» «ka bërë krimë që në kohën e demaskimit të Lin Biaos, duke hedhur tri shigjeta. Shigjeta e parë ishte ajo kundër Lin Biaos, e dyta kundër Konfucit dhe e treta kundër hatëreve», ose «futjes nga dera e pasme». Po kjo ç'do të thotë? Përse e nxjerrin këta tanë çështjen e luftës kundër hatëreve? Përse u djeg kjo? Cilët ishin vallë ata që bënin hatëre? Me siguri ata që kishin fuqinë në dorë, duke filluar që nga Çu En Lai, në radhë të parë, e deri te Ten Hsiao Pini, që kishin grumbulluar rrëth vetes në vendet kyç njerëzit e tyre dhe bënin hatëre politike, ekonomike etj. Shiko se çfarë akuzash bëjnë revizionistët! Ata i aku zojnë të tjerët, sepse janë të krimbur vetë. Shigjeta që i atribuojnë «katërshes» për Maon, për Çunë dhe për shokët e këtij, është futur apostafat për të dobësuar dy shigjetat e para kundër Lin Biaos dhe Konfucit. Të tillë gjykime sofistike bëjnë puçistët.

Edhe në këtë rast të njëjtat taktika përsëriten. Për Lin Biaon revizionistët thanë se «donte të zëvendësonë Maon». Edhe për Çian Çinin thonë se ajo «është orvatur si Lini, që të merrte në dorë udhëheqjen e partisë». Këto akuzë puçistët i kanë rregulluar në mënyrë të tillë, që sa po t'i lexosh, pa u thelluar në gjithë këto trillime, mund të thuash: «More, po këta të katër pas-kan qenë me të vërtetë kriminelë të mëdhenj!». Por, po të thellohesh vetëm pak, del vetiu pyctja: Kur Çian Çini ishte kaq e keqe dhe disa herë Maoja e kishte kritikuar kaq rëndë, përse nuk e përjashtuan të paktën nga udhëheqja? S'ka dyshim se Çian Çini ia vinte në dukje Maos mashtrimet e mëdha që bëheshin në pra-

paskenë nga ana e revizionistëve, i bënte vërejtje nga ana e saj, por Maoja, nga Olimpi, nuk lejonte të prekeshin mendimet e tij «të pagabueshme».

Njëlloj si Lin Biaoja akuzohet gjithashtu Van Hun Veni, sikur «donte ta zëvendësonte Maon, si Çian Çini që synonte të udhëhiqte partinë».

Të gjitha këto tregojnë se të djathët, të përkrahur nga vetë Maoja, kanë luftuar për një kohë të gjatë për të mbajtur me çdo kusht fuqinë në duart e tyre.

Të katër të majtët akuzohen se «janë hedhur në luftë kundër empirizmit» (kuptohet, kundër Çu En Lait) dhe gjoja «nuk luftonin kundër revizionizmit». Edhe kjo është një shpifje. Empiristët në Kinë janë njëkohësisht revizionistë dhe këta janë Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni e të tjera. Është e kuptueshme se revizionistët e sipërpërmendur, me luftën që i bëhej empirizmit nga ana e të majtëve, janë prekur në kallo.

Revizionistët në qarkore vënë në dukje edhe thënen, sipas së cilës «Maoja kërkon disiplinë dhe bindje», dhe kjo thënie, për të djathët, në kushtet e tanishme është e padiskutueshme dhe duhet të zbatohet.

Konkluzioni i tyre është që «katérshja» dhe pasuesit e saj janë «borgjezia në parti», siç e ka thënë Mao Ce Duni, sipas puçistëve, kurse këta vetë, me Hua Kuo Fenin në krye, janë «marksistë-leninistë».

Lëre pastaj që asnjë fjalë, as më të voglën akuzë, nuk bëjnë në qarkore për Ten Hsiao Pinin. Kësaj rade këtë nuk e zënë fare në gojë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po vutë re edhe një gjë,

shoku Enver?! Në fund thuhet se Maoja, tamam lidhur me komplotin, u ka thënë puçistëve që, në mos e bëfshin dot komplotin brenda 6 muajve, ta bënин në gjashëtëmujorin tjetër. Kjo do të thotë se ky komplot ka qenë i përgatitur me kohë nga ana e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, kështu u ka thënë: «në mos u bëftë këtë vit, të bëhet vitin tjetër!». Sigrisht, komploti ka qenë i përgatitur prej kohësh dhe në e analizuam këtë çështje.

Tani jemi të qartë edhe për faktin se komploti i Beqir Ballukut në vendin tonë ka qenë i sinkronizuar me këtë komplot që po kurdisej nga revisionistët kinezë. Ata thonë që më 1971 kanë filluar përgatitjen e puçit, domethënë qysh kur Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi kanë biseduar me Çu En Lain. Për këta elementë antirevolucionarë, «ishim ne antirevolucionarë dhe, në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër, duhemishim likuiduar». Çu En Lai duhet t'i ketë orientuar tradhtarët e Partisë sonë që të organizonin puçin në Shqipëri. Këtë gjë mbase nuk ua kanë thënë kaq hapur Beqir Ballukut e Abdyl Këllezit, por mund t'u kenë thënë se, ashtu si po punohej e po veprohej në Shqipëri, nuk mund të ecej; se Kina nuk mund të vazhdonte t'i jepte ndihma Shqipërisë, përderisa në krye të Partisë dhe të shtetit shqiptar të ishim ne. Ata duhet të kenë biseduar edhe vetë me Çu En Lain, kur kinezët donin që Rumania të lidhej me Jugosllavinë dhe ai do t'u ketë rekomanduar atyre që edhe ne «të lidhemishim me rumunët dhe jugosllavët». Ai duhet t'u ketë thënë Beqir Ballukut dhe Abdyl Këllezit që, «në qoftë

se ngjet ndonjë sulm nga sovjetikët kundër Shqipërisë, ju mbështetuni te Jugosllavia, se edhe ne jemi në dijeni për këtë çështje». Kjo do të thotë që «ne, kinezët, kemi biseduar me udhëheqësit e këtyre dy vendeve, prandaj ju këshillojmë që të lidheni me ta». Kjo do të thotë gjithashtu, se «ne kinezët, s'ju vijmë dot menjëherë në ndihmë; këtë do t'jua japim më vonë».

Por, vihet pyetja: kush duhet ta bënte në fillim puçin, kinezët apo Beqir Balluku me shokë në Shqipëri? Mendja ta do që puçin ta bënин më përpëra te ne Beqir Balluku me shokë, sepse Shqipëria dhe Partia jonë e Punës kanë ngelur si një halë në sytë e revizionistëve. Kështu, mendojnë kinezët, «ne u themi me këtë edhe kundërshtarëve tanë në Kinë se ja, në Shqipëri po i qërojnë dogmatikët» dhe me këtë u linin atyre të kuptionin se «kështu do ta pësoni edhe ju këtu».

Ne i zbuluam puçistët dhe u treguam vendin. Por, për shpëtimin e tyre Çu En Lai bëri presion te shokët tanë bile, jo vetëm një herë, që të mos i dënonim ata, se, përndryshe, do të na pritnin ndihmat. Kështu, derisa paralajmërimi i tyre nuk u mor parasysh nga ana jonë, kinezët, frap, filluan të na i pritnin ndihmat.

Kjo çështje u zhvillua në kohën që u sëmura unë, domethënë në vitin 1973, kur erdhën edhe doktorët kinezë për të më parë. Mjekët tanë, natyrisht, s'dinin gjë nga ngjarjet që po zhvilloheshin, po ç'është e drejta ata u treguan shumë vigjilentë për sa u përket sëmundjes sime dhe kurave që më bëheshin. Doktorët tanë u thanë hapur atyre se nuk ishin dakord me kurën që propozonin dhe e ndaluan menjëherë. Pikërisht, në kë-

të kohë Beqir Balluku shkoi në Pekin me gjithë Petritin [Dumen].

SHOKU HYSNI KAPO: Më fal se po të ndërpres shoku Enver, Beqiri erdhi me ngut që të më bindte mua se në atë kohë duhej vajtur nga ana e tij në Kinë për të biseduar për çështjet e armatimit të ushtrisë etj., etj., por, siç duket, ai shkonte atje për qëllime të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk e di, ndoshta ai shkonte atje edhe për të mësuar se si do të bëhej për diagnozën time, në përgjithësi. Kurse mjeku kinez ngulte këmbë në një plan «të tij»: që unë ta filloja punën gati pas një viti. Sipas tij, brenda kësaj kohe të veja për pushime dhe, pas gjithë këtyre, të qëndroja shumë i qetë. Edhe në qoftë se do të dilja ndonjëherë në zyrë, të mos punoja më shumë se ndonjë orë (!). Një regjim i tillë, donte të thoshte, me një fjalë, që unë të lidhja duart, gati sa të hiqja dorë nga puna e Partisë. Pra, na del se edhe Çuja duhet të ketë gisht në organizimin e komplotit që po kurdisej te ne dhe synonte që me një të shtënë të vriste dy zogj: edhe ne të na likuidonte, edhe kundërshtarët e tij, brenda në Kinë t'i qëronte, gjithashtu.

SHOKU HYSNI KAPO: Po ta shikosh veprimtarinë e Çu En Lait dhe të shumicës së udhëheqësve të tjerë kinezë në drejtim të Shqipërisë, qysh nga viti 1960 e derisa është arritur në organizimin e këtij komploti, del se ata vazhdimisht kanë ndjekur me kujdes shokët tanë, për të parë se cilët midis tyre nuk u vennin pas qejfit. Këtë ne e pamë edhe vetë kur shkuam në Kinë, në Komitetin Qendror të tyre, ku ramë në

kundërshtim me Ten Hsiao Pinin. E njëjtë gjë na ndodhi edhe me Çu En Lain dhe me Liu Shao Çinë. Sigurisht, gjatë kësaj kohe ata do ta kishin bërë studimin e radhëve tona dhe do të kishin krijuar mëndimin se mbi cilin duhej vënë dorë, siç vërtetohet tanë. Me sa duket, si elementë të përshtatshëm, për tu vënë në shërbim të tyre, gjatë Beqir Ballukun, Abdyl Këllezin dhe ndonjë tjeter.

SHOKU ENVER HOXHA: Revisionistët kinezë nuk ishin të vendosur si ne kundër revisionistëve hrushovianë, sepse ishin vetë të tillë. Ata donin që me Bashkimin Sovjetik të vazhdonin marrëdhënie miqësore jo-nënshtruese, por me divergjenca. Mirëpo, në mës ishte çështja e personalitetit të Maos. Ky nuk arriti dot që Bashkimin Sovjetik të Hrushovit ta fuste nën sqetull. Maoja pa se Hrushovi me shokë mbështetnin Liu Shao Çinë, prandaj i hodhi dorën Lin Biaos. Ky, sipas tij, duhej të ishte njeri i mirë dhe Maoja lëshoi parullën: «Të sulmojmë shtabet», «ndryshe, ka menduar Maoja, mbaroi partia edhe socializmi në Kinë e bashkë me ta, mbaruam edhe ne!». Lin Biaoja i zhveshi kudërshtarët e tij ushtarakë e i bëri civilë, nxori me dhjetëra e me qindra mijë njerëz në demonstrata në rrugë dhe shtypi kundërrevolucionarët. Në këto situata, Çuja rrëshqiti si ngjalë, manovroi dhe priti me gjakstohësi për një periudhë kohe sa të qëtësoheshin gjakrat, të arrinte të bindte Maon, të neutralizonte kundërshtarët, të fuste kuadrot e tij në parti dhe në shtet dhe, si të arrinte këto, të organizonte komplotin kundër Lin Biaos. Pasi realizoi gjithë këtë plan të madh përgatitor, ai mblodhi

pas vetes elementë revizionistë si Ten Hsiao Pinin me shokë, me të cilët vendosi që të qëronte këta të katër. Por, natyrisht, për këtë duhej pritur momenti i volitshëm.

Kështu, mendoj unë, duhet të ketë ndodhur. Zor se gjen tjetër shpjegim për këto ngjarje që janë zhvilluar në Kinë.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtim, në librin:
Enver Hoxha, «Shënime për
Kinën», vëll. II, f. 300*

*Botohet i plotë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar, që gjendet në AQP*

NE KOMITETIN QENDROR TE PARTISE TE ZGJEDIIM SHOKË NGA MË TE MIRET

*Fjala në mbledhjen e Përfaqësisë së Kongresit
të 7-të të PPSH*

26 tetor 1976

Përfaqësia e Kongresit të 7-të të PPSH zhvilloi mbledhjen e saj për përpilimin e listave të kandidaturave për në organet e larta udhëheqëse të Partisë nga data 26-28 tetor 1976. Në seancën e parë, më datën 26 tetor, shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm lidhur me kriteret e ndjekura për caktimin e kandidaturave, me procedurën e diskutimit një përnjë të tyre.

Si jeni shokë? Na afroi dita e fillimit të punimeve të Kongresit, ditë historike për Partinë e Punës dhe për popullin tonë. Partia del përpara popullit me këtë Kongres e nderuar dhe më e fortë se kurrë, e kalitur, e lidhur me popullin dhe në gjendje që të zhvillojë më tej në mënyrë konsekuente ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut. Ajo shpartalloi këto kohët e fundit komplotin armiqësor e të rrezikshëm kundër Par-

tisëc dhe atdheut, të B. Ballukut e të A. Këllezit etj.

Kongresi i 7-të, ashtu si edhe kongreset e tjera, për Partinë është një ngjarje kaq e shënuar në historinë e Partisë dhe të popullit. Kongresi fillon të hënën, kurse ne, anëtarët e përfaqësisë po e fillojmë punën, që na është ngarkuar, që sot. Por, para se ta fillojmë punën tonë, dëshiroj të them disa fjalë.

Ne, shokë dhe shoqe, po bëjmë sot mbledhjen e përfaqësisë së Kongresit të 7-të, e cila përbëhet nga shoqe dhe shokë që kanë zgjedhur organizatat e Partisë të çdo rrethi. Ne, si përfaqësues të Kongresit, të caktuar për hartimin e projektlistës së kandidaturave, duhet ta diskutojmë dhe ta miratojmë këtë, me qëllim që t'ia paraqitim Kongresit, i cili, si organi suprem i Partisë, do të vendosë se cilët shokë dhe shoqe do të zgjidhen në udhëheqjen e re.

Është e kuptueshme se të gjithë ne e ndiejmë thellë se na është ngarkuar një detyrë e rëndë dhe më shumë përgjegjësi, të cilën duhet ta kryejmë me ndërgjegje të pastër revolucionare, duke u bazuar në normat marksiste-leniniste të Partisë. Kjo do të thotë të kujdesemi që të zgjedhim për anëtarë dhe për kandidatë të Komitetit Qendror shokë nga më të mirët e nga më besnikët e Partisë, njerëz të sakrificës, të punës dhe të luftës dhe që gjatë gjithë jetës së tyre kanë dhënë prova si militantë të shquar të Partisë sonë të Punës.

Në qoftë se në këtë detyrë të madhe, që na është ngarkuar, udhëhiqemi nga këto parime bazë të Partisë, në qoftë se nuk tregohemi as oportunistë dhe as sektarë, në qoftë se diskutojmë hapur dhe vëmë në dukje drejt

si të mirat, ashtu dhe dobësitë e çdo kandidati që është propozuar këtu, në mbledhje të përfaqësisë, atëherë jemi të sigurt se kandidaturat që do t'i propozojmë Kongresit do të janë njerëzit nga më të mirët e Partisë. Duke vepruar në këtë mënyrë, si në cilindër nga kongreset e mëparshme, udhëhcqja e re e Partisë ndërmjet dy kongreseve, doinethënë, Plenumi i ri i Komitetit Qendror, do të jetë një udhëheqje e kalitur, do të jetë një udhëheqje marksiste-leniniste revolucionare, që do t'i qëndrojë besnike popullit tonë, socializmit, do t'i qëndrojë kurdoherë besnike Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ideologjisë së saj, marksizëm-Jeninizmit. Dhe të gjithë ne, që jemi mbledhur këtu, jemi të bindur se këtë detyrë me kaq përgjegjësi të lartë do ta kryejmë me sukses.

Komiteti Qendror, komitetet e Partisë të rretheve dhe aparatet e tyre kanë studiuar një numër të madh kuadrosh, dua të them me këtë, biografitë dhe aktivitetin e tyre revolucionar, besnikërinë ndaj Partisë dhe vijës së saj. Në kandidaturat e mundshme që do të paraqiten, janë pasur parasysh të gjitha këto kërkesa që ne jemi munduar që nga gjithë të mirët të zgjedhim më të mirët.

Kriteret që na kanë udhëhequr për studimin dhe për zgjedhjen e kandidaturave, që do të paraqitim janë:

1. Besnikëria politike, pastërtia e biografisë dhe e figurës morale të komunistëve.
2. Janë mbajtur parasysh sidomos orientimet e Byrosë Politike të Komitetit Qendror lidhur me përmirësimin e përbërjes së organeve udhëheqëse të Par-

tisë, domethënë, origjina, gjendja dhe prejardhja e kandidatëve.

3. Rezultatet në punë, duke vënë në listë ata që kanë pasur rezultatet më të mira. Siç e kemi parë, ka nga kandidatët që janë deputetë në Kuvendin Popullor, heronj të punës socialiste ose të zgjedhur në organet e Partisë dhe të shtetit.

4. Niveli i përgjithshëm ideologjik, kulturor dhe arsimor.

5. Janë bërë përpjekje të zgjidhen kandidatura nga sektorët më të rëndësishëm të Partisë e të shtetit, si dhe nga industria, bujqësia, ushtria dhe sektorë të tjerë.

6. Është mbajtur deri diku parasysh edhe nevoja e përmirësimit të shpërndarjes sipas rretheve nga janë e ku punojnë kandidatët që janë paraqitur, si dhe midis qendrës dhe bazës.

Para së gjithash dëshiroj të vë në dukje dhe të theksoj se diskutimet, si dhe vendimet që do të marrim përfundimisht në mbledhje të përfaqësisë, kanë karakter sekret, shumë sekret, jo vetëm deri në momentin që do t'ia propozojmë Kongresit, por karakteristikat e secilës kandidaturë që do të lexohen këtu, që do të paraqiten në Kongres, por edhe më vonë, kanë kurdoherë karakter sekret. Ato i di dhe duhet t'i dijë vetëm Partia. Nuk i lejohet kurrkujt që këto karakteristika të bëhen çështje pazari, ca më shumë diskutimet e ndryshme që mund të bëhen këtu përnjërin apo për tjetrin kandidat që do të propozohet. Ne e dimë se armiku gjurmon, hap veshët, përpinqet të

gjejë dhe të njohë dobësitë e njerëzve tanë dhe t'i fryjë e t'i zmadhojë këto, me qëllim që të krijojë situata të vështira për Partinë. Prandaj edhe një herë e theksoj që ta ruajmë fort dhe vazhdimesh sekretin e Partisë. Ato që do të lexojmë në dokumentet, si dhe ato që do të thuhen gjatë diskutimeve që do të bëjmë, nuk duhet të dalin jashtë mbledhjes së përfaqësisë.

Në mbledhjen tonë janë thirrur edhe shokë të aparatit të Komitetit Qendror, me qëllim që të ndihmojnë për të na svaruar për karakteristikat që ekzistojnë për shokët e ndryshëm në Parti. Natyrisht ata nuk kanë të drejtë vote këtu, por kanë të drejtë dhe detyrë t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve që mund t'u drejtohen nga secili shok që bën pjesë në përfaqësi.

Dëshiroj, gjithashtu, të vë në dukje se këtu jemi përfaqësues nga të gjitha organizatat e Partisë të rretheve dhe nga sektorë të ndryshëm të punës, prandaj gjithsecili ka të drejtë të thotë fjalën e tij haptazi, pa druajtje, pa dorashka, për cilindë kandidat që propozohet, qoftë nga rrathi i tij osc nga çdo rreth tjetër. Kështu, për cilindë kandidat, mund dhe duhet të bëhen pyetje prej kujtdo nga ne dhe, kur e njeh vetë, të shprehë për të mendimin e tij. Gjithë diskutimi këtu, pra, duhet të marrë karakter revolucionar.

Eshtë e natyrshme dhe e domosdoshme dhe një formë e drejtë organizative, që ka praktikuar Partia jonë qysh nga lindja e vet, që në mbledhje të përfaqësisë aparati i Komitetit Qendror paraqit një listë kandidaturash për diskutim. Kështu u bë edhe kësaj radhe. Por kjo listë, natyrisht, nuk duhet konsideruar

si e vjetmja. Çdo shok i përfaqësisë që ka një propozim të arsyeshëm për një person, që nuk figuron në listën që do t'ju paraqitet, ka plotësisht të drejtë ta para-shtrojë propozimin e vet në mbledhje dhe ne e kemi për detyrë ta diskutojmë. Ne mund dhe duhet të kërkojmë në këtë rast me urgjencë nga aparatet përkatëse të Partisë të dhëna suplementare mbi personin që mund të propozojë cilido prej nesh jashtë listës së paraqitur nga aparatit i Komitetit Qendror.

Lista paraqitet nga aparatit i Komitetit Qendror, për arsyen se në përgjithësi në kartotekat e Partisë ekziston gjithë dokumentacioni për kuadrin, ekziston në dosjet përkatëse biografia e çdonjërit prej nesh, dosje këto që pasurohen vazhdimisht, edhe kur secili komunist punon mirë, edhe kur ai bën ndonjë gabim, edhe kur kryen ndonjë faj, pra, si kur lavdërohet, ashtu edhe kur i jepet një masë ndëshkimore. Baza kryesore reale e zgjedhjes së kandidaturave, pra, është Partia, që regjistron të dhënat për kuadrot. Ky regjistrim, deri në njëfarë shkallë, nuk bëhet në mënyrë automatike, por, siç e ka shpjeguar Komiteti Qendror dhe siç përpinqet ta vëré në jetë gjithë Partia, megjithëse për këtë në praktikë nuk ia ka arritur përsosmërisë, kuadrin Partia e shikon në punë, në luftë, në përpjekjet për kapërcimin e vështirësive, në realizimin e detyrave, në mendimet që shpreh dhe në veprimet që kryen ai, në hovin e tij revolucionar ose në tërheqjen nga ky hov revolucionar.

Vallë, mund të themi se këto të dhëna janë të plota? Këtë është e zorshme ta themi, pasi eksperiencia na

ka treguar shumë gjëra. Në Plenumin e Komitetit Qendror, ashtu sikurse në udhëheqjet e Partisë të rretheve, kanë ardhur shokë që, në përgjithësi, kanë pasur anë pozitive, megjithatë janë nënveftesuar disa anë negative të tyre. Lufta që kanë bërë këta shokë i ka errësuar disi këto anë negative të tyret. Mirëpo ka pasur edhe raste që koha ka vërtetuar se disa nga këta shokë nuk kanë ecur në mënyrë konsekiente në rrugën revolucionare të Partisë. Ka pasur momente që te këta janë dukur shfaqje të sëmura mikroborgjeze, që rridhnin nga origjina, nga lidhjet familjare ose nga disa të meta të këtyre njerëzve, që ne i kishim nënveftesuar, pse, në kohën që janë propozuar, predominojnë tek ata pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste. Me fjalë të tjera, dëshiroj të them se ne kemi pasur shokë që në një moment paraqiteshin të mirë, por më vonë tek ata janë ringjallur shfaqjet e sëmura dhe ata nuk e kanë vërtetuar e justifikuar kështu besimin që u kanë pasë dhënë kongresi ose konferenca e Partisë e rrethit.

Nga ana tjetër, në Komitetin Qendror kanë pasë ardhur njerëz me karakteristika të mira, por që më vonë kanë degjeneruar. Kanë ardhur në udhëheqje edhe disa të tjerë që deri në atë moment kanë treguar aktivitet revolucionar, ndërsa më pas, si të thuash, pjesërisht ata «janë plakur», janë bërë të mefshtë, me një fjalë nuk e kanë merituar më qenien në udhëheqje, sepse nuk kanë ecur në mënyrë konsekiente për të kryer si duhet detyrat me rëndësi që u kanë pasë ngarkuar kongresi ose konferenca e Partisë e rrethit.

Për çdo emër, për çdo kandidaturë ju do të njiheni me të dhënrat e Partisë, në të cilat duhet të mbështetemi kryesisht. Rreth këtyre të dhënavë gjithsecili duhet të japë mendimin e vet haptazi, të kërkojë shpjegime, kurse për ata që njeh, të thotë mendimin e vet kritik, për të mirat dhe për dobësitë që mund të ketë. Ai të japë gjithashtu mendimin se ky apo ai kandidat, që propozohet, ka këtë të metë ose dobësi, por që ka edhe shumë anë të tjera pozitive revolucionare për të qenë në udhëheqje dhe ka mundësi e forca që këto dobësi ose diçka tjetër të vogël negative që mund të ketë në veprimtarinë e tij në punë, t'i kapërcejë. Me mendimet tona ne duhet t'i plotësojmë të dhënrat për shokët që janë propozuar. Gjithashtu është detyrë të marrim në diskutim një nga një edhe propozimet e vencanta që mund të bëjë cilido prej nesh.

Juve do t'ju jepen materialet për Komitetin Qendror, për anëtarët e kandidatët e tij, të zgjedhur nga Kongresi i 6-të. Këtë listë ne e kemi këtu. Siç e dini, Komiteti Qendror bëri mbledhjen e fundit në mes të muajit tetor, por me çeljen e Kongresit ai nuk ekziston më. Të gjitha fuqitë e udhëheqjes supreme të Partisë tash i merr Kongresi. Ky udhëheq vetë gjatë gjithë periudhës që vazhdon në mbledhje. Siç do ta shihni, në këtë listë të Komitetit të vjetër Qendror figurojnë edhe elementë tradhtarë e armiq, si Begir Balluku e Abdyl Këlczi me shokë, të cilët ka kohë që janë përjashtuar nga Komiteti Qendror dhe nga Partia, iu dhanë gjyqit dhe morën dënimin e merituar. Në këtë listë figurojnë gjithashtu 4 shokë të mirë, njëri prej të

cilëve kandidat dhe tre të tjera anëtarë të Komitetit Qendror, që gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare kanë vdekur.

Në fjalimin që mbajta në mbledhjen e fundit të Plenumit të Komitetit Qendror, që zhvilloi punimet nga data 12 deri më 14 tetor, unë theksova se, në përgjithësi, Komiteti Qendror i zgjedhur nga Kongresi i 6-të luftoi me të gjitha forcat në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Gjatë veprimtarisë së tij ai nuk gaboi në vijën politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarakë të caktuar nga Partia dhe, në përgjithësi, tërë bilanci i punës së tij është pozitiv. Ky Komitet Qendror ka marrë një sërë masash për forcimin e Partisë, për forcimin e unitetit në udhëheqje dhe në Parti, për forcimin e unitetit të popullit me Partinë, për ngritjen e masave në një hov të papërshkruar revolucionar. Partia jonë gjatë këtyre pesë vjetëve të fundit e ka brumosur më tej popullin me një patriotizëm të pashoq marksist-leninist, e ka përgatitur atë ushtarakisht më mirë për të përballuar me sukses çdo rrezik që mund t'i turret atdheut, për të përballuar çdo orvatje nga ana e imperialistëve amerikanë, socialimperialistëve sovjetikë, titistëve dhe e armiqve të tjera të vendit tonë.

Por, duhet vënë në dukje, se përveç atyre që tradh-tuan e janë përjashtuar nga Komiteti Qendror dhe nga Partia, ka pasur edhe anëtarë të tjera të Plenumit që në veprimtarinë e tyre si udhëheqës jo kurdoherë janë treguar në nivelin e lartë të udhëheqjes, jo në atë nivel që ka kërkuar prej tyre puna dhe detyra e cak-

tuar nga Partia dhe nga kongresi. Ka midis tyre nga ata që kanë treguar dobësi në punë, te disa ka pasur mefshtësi dhe paaftësi, te disa të tjerë janë shfaqur tendenca mikroborgjeze të tillë, si ajo e rehatisë, e indiferentizmit, e nepotizmit, e hatëreve etj. për të cilat ata janë kritikuar. Veçse dëshiroj të theksoj që këto dobësi e prirje te këta shokë nuk janë trashur deri në atë shkallë sa të bëheshin të rrezikshme për Partinë, por e vërteta është se këto karakteristika gjatë punës së tyre janë dukur dhc duhet njojur se ato nuk kanë qenë aspak pozitive, po negative. Prandaj në mbledhjen e fundit të Plenumit të Komitetit Qendror, që përmenda më lart, theksova se kjo është një çështje dialektike, marksiste-leniniste, se Kongresi i 7-të do të gjykojë si për punën e mirë, ashtu edhe për të metat e gabimet e gjithsecilit prej nesh, pasi ai është i vetmi gjykues i drejtë, si për ata shokë nga të vjetrit, që do ta meritojnë të qëndrojnë përsëri në Komitetin e ri Qendror, ashtu edhe për ata tek të cilët janë vërejtur dobësitë që përmenda. Është Kongresi i Partisë ai që do të vendosë t'i zgjedhë apo të mos i zgjedhë. Ne e kemi për detyrë që, duke mos i vënë në listë këta, t'ia bënim të ditur përfaqësisë këto dobësi të tyre, që përmenda.

Natyrisht, nuk është e nevojshme të hyjmë këtu në detaje për këto dobësi, por dëshiroj të theksoj se, në rast se ndonjë shok i përfaqësisë do që të dijë diçka konkrete për secilin nga këta, ne jemi gati t'i përgjigjemi. Një gjë mendoj të vë në dukje me këtë rast që, duke përjashtuar tradhtarët, të gjithë këta shokë kanë

qenë, janë dhe do të mbeten besnikë të Partisë. Këta nuk kanë gabuar politikisht dhe ne nuk i kemi vënë në listë jo pse kanë bërë të tilla gabime. Në asnjë mënyrë! Kjo duhet të kuptohet drejt nga të gjithë shokët e përfaqësisë. Këta shokë nuk janë vënë në listë vetëm pëarsyet që parashtrova, si përmefshëtësi, disave u kaluar mosha, disa të tjera kanë treguar dobësi në punë, por që të tërë kurdoherë kanë qenë besnikë të Partisë. Bile në mbledhjen e fundit të Plenumit të Komitetit Qendror theksova që, në rast se Kongresi nuk zgjedh ndonjërin prej nesh, ky nuk duhet të dëshpërohet, por të vazhdojë të punojë me besnikëri dhe deri në fund ndershmërisht përm Partinë dhe asnjëherë të mos epet, përkundrazi, t'i krycë mirë detyrat, në çdo vend që do ta caktojë Partia, qoftë nënë aparatet e në organet e Partisë, qoftë nënë punët shtetërore o në prodhim, të ecë si kurdoherë me besnikëri ndaj direktivave të Partisë.

Theksova, gjithashtu, se shokët, që nuk do të bëjnë pjesë më në plenumin e ri të Komitetit Qendror, ta ruajnë ndërgjegjen komuniste të pastër dhe të mos bien në intrigat e armiqve, të cilët janë gati dhe nuk do të mungojnë të orvaten që moszgjedhjen ta interpretojnë sikur deri tanë «ata u shtrydhën dhe po hidhen poshtë si cefël limoni». Pikërisht kështu jam shprehur në mbledhjen e fundit të Plenumit të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 6-të. Prandaj, shokët që Kongresi nuk do t'i rizgjedhë më në plenumin e tij të ardhshëm, duhet të konsiderohen si komunistë që kanë shumë anë të mira në veprimtarinë e tyre,

por që kanë edhe të meta, kanë edhe dobësi. Të mirat e tyre nuk i harron kurrë Partia, kurse dobësitë dhe të metat që kanë, ajo është përpjekur e do të përpinqet deri në fund që t'ua korrigjojë me punë dhe në jetë.

Çështja tjetër me rëndësi të madhe është edhe ajo që vazhdimisht kongreset dhe Komiteti Qendror i Partisë kanë theksuar që në udhëheqje dhe në Parti duhet të vijë gjak i ri. Ky gjak i ri është jetik dhe duhet të bashkohet me gjakun e vjetër si një beton çeliku, që ta forcojë akoma më shumë Partinë, ta mbajë këtë kurdoherë të re, të freskët, vazhdimisht të paplakur, revolucionare, marksiste-leniniste, të gatshme dhe të zonjën të kryejë çdo detyrë nga më të rëndat e më të vështirat që do t'i dalin përpara, që të jetë shembull vetëmohimi, lufte, heroizmi e sakrifice përrapa gjithë Partisë. Prandaj, krahas shokëve të vjetër, në këtë Kongres është gjykuar e nevojshme të vijnë në plenumin e ri të Komitetit Qendror edhe elementë të rinj nga më të mirët, nga më të shëndoshët, nga më dinamikët.

Në plenumin e ri duhet të vijnë, në radhë të parë, shokë nga klasa jonë punëtore heroike, e cila është zmadhuar, është kalitur ideologjikisht, politikisht dhe teknikisht, është pajisur me dituri dhe ka një guxim edhe një hov të papërmbajtur për të kryer me nder detyrat e mëdha dhe rolin e saj udhëheqës, rolin e saj konsolidues të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë. Në plenumin e ri të Komitetit Qendror duhet të vijnë njerëz nga fshati, nga kooperativat, ku bujqësia jonë socialiste ka marrë një hov të madh, ku po

përparon e zhvillohet me sukses vija e drejtë e Partisë. Këtë ne e shohim në ndryshimin e njeriut të fshatit tonë, në botëkuptimet e tij, në punën e tij, në rezultatet e punës së tij, në mendimet e qarta politike dhe ideologjike, në unitetin e tij të çeliktë me Partinë dhe me klasën. Në plenumin e ri të Komitetit Qendror duhet të vijnë njerëz edhe nga radhët e inteligjencies sonë popullore, nga ushtria, nga rinia, të vijnë gjithashu gra revolucionare.

Pasi jep përmirësimet e kandidaturave të mundshme për plenumin e ri nga pikëpamja e përbërjes shoqërore, e rritjes së nivelit arsimor, e rritjes së numrit të punëtorëve, të shoqeve, e uljes së moshës mesatare etj.. shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në këtë vështrim lista që do t'ju paraqitet i ka pasur parasysh të gjitha këto kritere që thashë, po, nëse ia kemi arritur si duhet qëllimit apo jo, këtë do ta provojë puna që do të bëjmë dhe që do të vuloset nga Kongresi, i cili do të gjykojë nëse ne kemi punuar mirë, nëse kemi menduar mirë dhe nëse i kemi zgjedhur mirë kandidaturat.

Tash propozoj të bëjmë pushim, por ju lutem juve, shokë, që një pjesë nga ne anëtarët e Byrosë Politike për arsyen se po na ngushtohet koha dhe kemi shumë punë të tjera për të kryer, të na lejoni të mos marrim pjesë. Megjithatë këtu, tok me ju, do të qëndrojnë shoku Hysni, shoku Hekuran dhe shokë të tjerë të aparatit të Komitetit Qendror, me të cilët do të procedoni me leximin e studimin e kandidaturave. Pasi ta mbaroni këtë punë mendoj se nuk është nevoja të thoni që ky

kandidat të mbetet ose të mos mbetet në listë pse, pasi të bëni studimin, secili ka të drejtë të bëjë propozime për ata që mendon të jenë, kur të bëjmë mbledhjen përfundimtare ku do të jemi të gjithë. Atje do t'i shoshitim kandidaturat, pastaj përfundimisht do të vendosim në Kongres.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit. që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PËR KANDIDATURAT, SECILI MUND DHE DUHET TË BËJË VËREJTJE E TË JAPË MENDIME

*Fjala në mbledhjen e Përfaqësisë të Kongresit
të 7-të të PPSH*

28 tetor 1976

Seancën e ditës së tretë të mbledhjes së Përfaqësisë së Kongresit të 7-të, e drejtoi shoku Enver Hoxha, i cili në fjalën e tij tha:

Shoku Hysni me shokun Hekuran na kanë raportuar me imtësi për punimet që u zhvilluan gjatë një ditë e gjysmë pune të mbledhjes së Përfaqësisë. Ne u gëzuam jashtëzakonisht që janë diskutuar një nga një, hollësisht, kandidaturat që do t'i paraqiten Kongresit, për të cilat shokët e Përfaqësisë thanë këtu mendimet e tyre hapur, bënë vërejtjet që kishin për to, si për anët e mira, ashtu dhe për dobësitë e kandidatëve.

Na gëzoi pa masë të gjithë çështja që përgatitja e listave nga ana e komiteteve të Partisë të rretheve dhe nga qendra, nga shokët e organizatave-bazë dhe nga gjithë Partia ishte bërë me kujdes të madh, me

atë kujdes që Partia kurdoherë na këshillon. Partia dëshiron që të zgjedhim kurdoherë në udhëheqje një-rëzit e saj të mirë, të mirë nga më të mirët. Është e qartë për ne se në Partinë tonë nuk janë vetëm këta, pse të tillë shokë ka jo me qindra, po me mijëra, pasi Partia jonë lufton e punon që çdo komunist të jetë në pararojë.

Të jesh komunist pararojë do të thotë, në radhë të parë, të kesh thellësisht në shpirt, në zemër dhe në mendime ideologjinë marksiste-leniniste. Kjo filozofi komunistin duhet ta udhëheqë në veprim, në jetë, në aksione, në mbrojtjen e pastërtisë së Partisë dhe të atdheut. Ne besojmë se Kongresi, si organi suprem i Partisë, do të thotë fjalën e tij, por mendimi ynë është se listat kanë qenë të përgatitura mirë. Sot, mendoj se na mbetet të vëmë dorën e fundit, si me thënë, tëaprovojmë me radhë, një nga një, cilët nga kandidatët do të mbeten në listë, duke filluar më parë nga anëtarët e Komitetit Qendror, pastaj nga të tjerët e më në fund të shohim kandidaturat për të gjitha organet e Kongresit. Kjo nuk do të thotë që ndokush që mund të ketë ndonjë vërejtje kritike, të mos e bëjë. Jo, të tilla vërejtje të bëhen dhe jo vetëm këtu, por edhe në Kongres. Sidoqoftë, kjo mbledhje mendoj të jetë e fundit për formulimin e projektlistës që do t'i paraqitet Kongresit. Tani, po të jemi dakord, s'mbetet veçse t'ia japim fjalën shokut Hysni.

Pasi shoku Hysni Kapo paraqiti një nga një kandidaturat, e mori përsëri fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

Në emër të një grupei shokësh propozojmë që Kongresin e 7-të të Partisë ta hapë shoku Miha Lako, një nga komunistët më të vjetër të vendit tonë, luftëtar i papërkultur për formimin e Partisë dhe për komunizmin. Ai ka qenë shok i ngushtë dhe shumë i afërt i Ali Kelmendit, ka qenë kryetar i Grupit Komunist të Korçës, luftëtar i paepur kundër trockistëve dhe arqiomarksistëve, si Aristidh Qendroja, Andrea Zisi, Niko Xoxi, Zef Mala, Anastas Lula e të tjerë. Prandaj, në qoftë se jeni dakord për këtë propozim, ngrini dorën.

(Të gjithë shokët u shprehën dakord.)

Besoj se këto detyra që na ka ngarkuar Kongresi i mbaruam, por e përsëris edhe një herë që këto diskutime që u bënë këtu të mbahen sekret, të mos dalin që këtej, sepse janë çështje partie.

Tani, të vemi ballëlart në Kongresin e 7-të të Partisë sonë të lavdishme e më të fortë se kurrë, si një Parti e kalitur, në unitet të plotë, lidhjet e së cilës me popullin janë të çelikta, prandaj armiqjtë e shumtë s'kanë ç'të na bëjnë. Lart e më lart!

Mirupafshim në sallën e Kongresit!

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Përfaqësisë së Kongresit të 7-të të PPSH, që gjendet në AQP

NUK KA FORCË NË BOTË QË TA MPOSHTË KOMUNIZMIN

*Fjala në pritjen e dhënë për delegacionet e miqtë e huaj,
që kishin ardhur për të marrë pjesë në punimet
e Kongresit të 7-të të PPSH*

30 tetor 1976

Të dashur shokë dhe shoqe,

Jemi të emocionuar dhe të gjëzuar që ju, shokë dhe miq, keni ardhur në vendin tonë në këto ditë të shënuara për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për popullin shqiptar.

Partia jonë është në pragun e dy evenimenteve me rëndësi: Kongresit të 7-të dhe festës së 35-vjetorit të themelimit të saj. Me këtë rast, në emër të Partisë, të Komitetit Qendror dhe të gjithë popullit shqiptar, falënderoj partitë motra, komitetet e tyre qendrore dhe luftëtarët komunistë të të gjitha vendeve, që luftojnë pa u epur, me guxim dhe heroizëm për socializmin e për revolucionin, kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër revisionizmit modern, me atë sovjetik në krye, si dhe kundër gjithë reaksionarëve.

Më lejoni t'ju falënderoj edhe ju, shokë e shoqë marksistë-leninistë, që punoni në ilegalitet dhe që keni bërë një rrugë të gjatë plot rrcziqe për të ardhur gjer këtu, në Shqipëri. Shumë prej jush jo vetëm kanë ndër-prerë punën dhe luftën për të na gjuar me praninë e tyre në Kongresin e Partisë sonë, por me trimërinë që u ka hije komunistëve, kanë kapërcyer shumë kur-the të ngritura nga armiku.

Me gjithë reaksionin e madh kundër marksistë-leninistëve, armiqtë janë të pafuqishëm për t'i mposhtur. S'ka forcë në botë që të ndalojë triumfin e marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit. Nuk ka forcë në botë, sado e armatosur të jetë, që ta mposhtë komunizmin. Ne do të fitojmë!

Komunistët nuk tremben nga propaganda që hipbolizon fuqinë goditëse të armiqve. Fuqinë e armikut ne nuk e nënvleftësojmë, por jemi të bindur se proletariati dhe popujt që duan liri dhe revolucion, janë më të fortë se armiqtë.

Pasnesër fillon punimet Kongresi i 7-të i Partisë sonë. Ky Kongres ka një rëndësi të jashtëzakonshme për komunistët dhe për popullin shqiptar. Raportet që do t'i paraqiten Kongresit, sikurse do të shikoni, pas-qyrojnë mendimin marksist-leninist dhe veprimin revolucionar të Partisë e të popullit tonë. Ashtu si të gjitha raportet në kongreset tona të mëparshme, edhe këto raporte do të përbajnë kritikë dhe autokritikë të hapët, ashtu siç na mësojnë marksizëm-leninizmi, mësuesit tanë të mëdhenj Marks, Engels, Lenini e Stalini. Çështjen e kritikës e të autokritikës së hapët

ne e konsiderojmë me rëndësi parimore. Partia nuk lejon në asnjë mënyrë që komunistët brenda radhëve të saj, si dhe masat e popullit të nanurisen me mburrje e lëvdata. Në Kongres do të flitet edhe për fitoret e arritura, edhe për dobësitë, sepse pa bërë bilancin e punës, me arritjet e të metat e saj, nuk ndihmohet revolucioni, nuk ndihmohet fitorja e plotë e socializmit në vendin tonë, nuk ndihmohen as marksistë-leninistët revolucionarë, që ndodhen sot këtu.

Jua them sinqerisht, shokë, se ardhja juaj në Shqipëri është ndihmë e inkurajim për Partinë dhe për popullin tonë. Ju na sillni eksperiencën dhe zërin e vërtetë marksist-leninist revolucionar të partive tuaja, përvojen e zërin e popujve tuaj. Ne do të mësojmë si gjithmonë nga kjo eksperiencë. Marks mëson se partitë e vërteta të proletariatit botëror, për të fituar ndaj borgjezisë së egër, duhet të shtrëngojnë radhët me njëra-tjetrën, ndryshe, duke praktikuar një mijë mënyra, ajo do të përpinqet t'i përcajë ato. Këtë mësim me vlerë të madhe të Marksit populli shqiptar e shpreh bukur me një figurë artistike: «Të jemi të bashkuar sup më sup si malet!». Ardhja juaj i shërben pikërisht këtij bashkimi, prandaj, ne e konsiderojmë me kaq rëndësi praninë tuaj në Kongres dhe për këtë ju falënderojmë nga zemra.

Pjesëmarrja juaj në punimet e Kongresit të 7-të të Partisë sonë dhe në festimet e 35-vjetorit të themelimit të saj s'ka dyshim që nuk çshtë aspak çështje formale. Ju nuk keni ardhur këtu thjesht për të dalë në tribunë, për të përshëndetur Partinë e Punës të

Shqipërisë dhe për t'u duartrokitur nxehësisht prej saj. Qëllimi i pranisë suaj këtu është i kuptueshëm. Me këtë rast, ju do të dëgjoni zërin e Partisë sonë, zërin e anëtarëve të saj, do të shikoni forcën, pjekurinë dhe nivelin e saj ideologjik, politik e kulturor.

Partia jonë mendon se ato parti që i kanë mundësitë objektive, duhet të marrin pjesë në kongreset e partive marksiste-leniniste motra në kontinentet e ndryshme. Kjo pjesëmarrje është e domosdoshme, ajo është shprehje në praktikë e internacionalizmit proletar në ideologji dhe në luftën revolucionare.

Partia jonë i ka hapur për ju të gjitha portat në Shqipëri. Kudo që do të dëshironi, në fabrika, koperativa etj., mund të shkoni, bile mund të kërkonit të mblidhen komunistët dhe masat e paorganizuara në Parti që të flisni me ta për gjithçka që keni interes.

Në shumë nga vendet tuaja ka fabrika të mëdha, shumë më të mëdha nga këto tonat, atje ka një proletariat luftarak, por këtu ju do të njiheni nga afër me klasën punëtore të një vendi socialist, ku punëtorët kanë marrë fuqinë në dorë, edukohen me idetë e mark-sizëm-leninizmit, që është ideologji sunduese te ne, ecin kurdoherë përpara dhe dinë të mbrojnë fitoret e të ndërtojnë të ardhmen e tyre të bukur.

Natyrisht, të gjitha sa ne kemi ndërtuar, nuk janë të përsosura. Gjatë rrugës për ndërtimin e socializmit kemi korruar fitore, por kemi pasur e kemi edhe dobësi e të meta që i kapërzejmë me punë e me luftë. Ne dëshirojmë që edhe fitoret dhe të metat tona ju t'i shikoni. Kontaktet e komunistëve dhe të punonjësve

tanë me ju do të na ndihmojnë më shumë, do të na forcojnë më tepër.

Ne, shqiptarët, jemi një popull i vogël që tok me ju, shokë komunistë të partive marksiste-leniniste, luf-tojmë në një oqean të madh armiqësor, prandaj kemi nevojë për ndihmën e shoqi-shoqit. Ne kemi qenë dhe jemi dakord të bëhen takime bilaterale ose midis tri a më shumë partive marksiste-leniniste. Këto takime duhet të bëhen se janë të nevojshme.

Prandaj, të dashur shokë, le të brohorasim:

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Rrofshin partitë tuaja!

Mirë se na erdhët! Mirë se na erdhët!

Gëzuar të gjithëve!

Botohet për herë të parë si-pas origjinalit, që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TREGUESI I LËNDËS

A

Akumulimi dhe fondi i akumulimit — 25-27, 30, 247-248. Armiqëtë; veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 16-18, 43, 45, 295, 301, 307, 322, 349-350.

Arsimi — programet, lëndët mësimore; shkollat e mesme profesionale; kriteret e pranimit të nxënësve në shkollat e larta — 2-5, 258, 271-272.

B

Banka e Shtetit Shqiptar dhe këshilli i saj — 71-73.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — ardhja në fuqi dhe shtrirja e revizionizmit në ES; strategjia dhe taktikat — 282, 290-291;

— veprimtaria armiqësore kundër RP të Shqipërisë — 213, 217, 218-219.

Bindjet dhe roli i tyre — 206.

Elegtoria — politika e Partisë për zhvillimin e saj; lopa, qerë. Baza ushqimore, kullotat — 117-118, 170, 254, 268-270. Britania e Madhe dhe qëndrimi ndaj RP të Shqipërisë — 217, 229-230.

Bujqësia — politika e Partisë për zhvillimin e saj. Studimet në fushën e bujqësisë. Rajonizimi dhe specializimi në bujqësi — 90, 97, 166, 167-170, 252-254, 262-263;

— agroteknika dhe shërbimet në bujqësi. Rendimentet, rritja e prodhimit bujqësor. Farërat — 89, 91, 116-117, 168-170, 174-175, 246-247, 256;

— toka dhe trajtimi shkençor i saj. Mekanika bujqësore, mekanizimi i bujqësisë. Ujitja, veprat ujitetëse — 40-41, 98, 106-110, 120, 129-131, 177, 208;

— drithërat, perimet, patatja, bimët industriale —

119-120, 168-169, 170-171,
256, 262-263;
— permëtaria. Ulliri — 86-91,
118-120, 171, 255.

Burokratizmi, liberalizmi, teknokratizmi dhe lufta kundër shfaqjeve të tyre — 73, 76-77,
138, 162, 210.

C

Çmimet e prodhimeve bujqësore e blegtore; çmimet në kooperativat bujqësore — 264,
265.

D

Demokracia; liria e mendimit — 60-62.

Diktatura e proletariatit — 43.

Disiplina e planit dhe ajo e punës — 35-36, 139.

E

Edukimi komunist; edukimi ideopolitik. Metoda e bindjes; puna e diferençuar me njerëzit — 16-19, 42-45, 80-82, 244-245, 304-306, 307.

Ekonomia politike e socializmit; njohja dhe zbatimi i li-

gjeve të saj — 135, 148, 171.
Ekonomia populllore — politika e Partisë për zhvillimin, forcimin dhe qëndrueshmërinë e saj — 95-96, 135, 149-150.
Engels, Fridrih — 281, 304, 306,

303, 318, 317, 364.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 6-7, 22, 89, 248,
260, 342.

F

Financat — subvencionet nga shteti — 135.

Fshatarësia kooperativiste — 305-306, 357-358.

Fuqia blerëse e popullsisë dhe mbulimi i saj me mallra — 156-157, 172.

Fuqia punëtore — zënia me punë, sistemimi dhe përdortimi me efektivitet i saj — 54, 139-141, 155, 201-202, 243.

Furnizimi, shpërndarja e produkteve — stoqet dhe mallrat me qarkullim të ngadalshëm —

138, 150-151, 157-158, 172-173,
242.

G

Grumbullimet — politika e Partisë për grumbullimin e produkteve bujqësore e blegtore — 245.

*Grupet armiqësore antiparti
dhe lufta për shpartallimin e
tyre — 144, 300, 346-347;*

II

- grupi armiqësor komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. në ushtri — 16, 17, 59, 144, 213-214, 228, 300, 302-304, 341-343;
- grupi armiqësor, sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit, K. Ngjelës etj. në ekonomi dhe në sektorin e naftës. Tendencat vetad-ministruese të tij — 16, 17, 34-37, 59, 80, 107, 113-114, 136, 137, 144, 147, 152, 154-155, 156, 211, 214, 228, 268, 300, 303-304, 341-342;
- strategjia dhe taktitat; agjentura në shërbim të shteteve të huaja, lidhjet dhe bashkëpunimi ndërmjet grupeve — 14-15, 34-37, 211-216, 217, 228-229, 294, 303, 341-343;
- zbulimi, gjykimi dhe dënnimi i tyre — 80-81, 211, 217, 303, 342, 353.

Grupi Komunist i Korçës — 259, 362.

Historia ushtarake — 3-4.

I

- Idetë dhe roli i tyre — 204. Industria e rëndë — industria minerale, nxjerrëse dhe përpunuuese. Minierat e bakrit — 40, 114, 128-129, 166-167;*
- industria e qymyrgurit — 127-128;
 - industria mekanike; prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit, i makinerive dhe i fabrikave — 40, 95, 96, 98, 107, 108-110, 114-115.

Shih edhe: Nafta...

Inteligjencia — 187.

*Interesi i përgjithshëm dhe at
vetjak — 122.*

*Investimet — politika e Partisë
në fushën e investimeve;
përdorimi me efektivitet i tyre
— 25-27, 102-103, 106, 121-
122, 129-131, 155, 247-248.*

GJ

*Gjeologjia; kërkimet gjeolo-
gjike — 135-136.*

J

*Jetesa dhe mirlëqenia në sho-
qërinë tonë socialiste — 94,
146.*

Jugosllavia, vetadministrimi jugosllav. Veprimitaria armiqësore kundër RP të Shqipërisë — 8, 213, 217-218, 233.

K

Kapitalizmi dhe kriza e tij — 148-149, 306.

Këshillat popullorë; komitetet ekzekutive dhe aparatet e tyre; metoda dhe stilli në punë, kompetencat — 62-63, 109, 176, 201, 209, 264, 265, 266, 267.

Këshilli i Ministrave (Qeveria) — 11, 21, 25, 28-29, 32, 33-34, 36, 92, 112, 119, 120, 121, 124, 125, 127, 129, 133, 142, 160, 190, 194, 202.

Kina — gjendja e brendshme kaotike dhe luftha e grupave për pushtet. Revolucioni Kulturor në Kinë — 171, 231, 233, 273-279, 280-289, 292, 296, 315-316, 332, 334, 344-345:

- Partia Komuniste e Kinës; shtrirja e revisionizmit. Vijat e grupet në parti dhe luftha ndërmjet tyre. «Katërsjja» dhe dënim i saj — 224, 231, 273-274, 276, 283, 290-292, 313, 324-340;
- politika e jashtme koniunkturale. Përpjekjet

për t'u kthyer në superfuqi — 232, 277-278, 280-281, 282, 289-290;

— shtrembërimi i marksi-zëm-leninizmit dhe përpjekjet për të minuar lëvizjen m-l dhe punëtore ndërkombëtare — 274-276, 278, 280-281, 287, 289-290, 292;

— marrëdhëniet e kontradiktat me BS dhe afrimi e lidhjet me ShBA, me imperializmin dhe reaksionin — 216-217, 225, 281, 282, 289-290, 292-293, 312, 344;

— presionet politike e ekonomike dhe veprimitaria armiqësore kundër RP të Shqipërisë — 171, 213-214, 216-217, 219-220, 225-233, 292-295, 297, 313, 341-343.

Klasa punëtore — cilësitë, karakteristikat; edukimi arsimor dhe profesional i saj — 157, 257-258, 357, 366.

Klasat dhe luftha e klasave; luftha e klasave forcë kryesore lëvizëse në zhvillimin e shoqërisë — 43, 145, 161-162, 301-303;

— luftha kundër qëndrimeve oportuniste e sektare në zhvillimin e luftës së klasave. Diferencimi në pro-

cesin e luftës së klasave — 16-19, 76-84, 275-276, 283-287.

Kolektivizimi socialist i bujqësisë; politika e Partisë për transformimin socialist të fshatit. Marrëdhëniet e kooperativave bujqësore me shtetin — 264, 265, 305-308;
— sektori i blegtorisë në kooperativat bujqësore. Kooperativat bujqësore të zonave malore — 268-270.

Komunikacionet — organizimi i punës dhe shfrytëzimi me efektivitet i mjeteve të transportit — 98, 131-132, 256-257. Komunisti; cilësitë e tij; militantizmi — 44, 47, 50-51, 58-59, 62, 186, 188, 189, 360-361. Kontradiktat joantagoniste; domosdoshmëria e njohjes dhe rrugët e zgjedhjes së tyre — 157-158.

Kontrolli i Partisë, i shtetit dhe i klasës punëtore — 139, 175-176, 193-194, 203, 209.

Kosova — politika shoviniste e revisionistëve jugosllavë ndaj saj — 233.

Kostoja e prodhimit dhe domosdoshmëria e uljes së saj — 124, 131-132, 133, 134.

Kritika dhe autokritika — 58-59, 63-64, 206, 303.

Kuadrot — politika e Partisë ·

me kuadrin; lufta kundër qëndrimeve sektare e oportuniste në punën me kuadrin — 57-61, 62-66, 70, 71, 73-80, 82-84;
— edukimi dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja te kuadrot — 16-17, 59, 65-66, 71, 73-75, 77-78, 244;
— kuadrot e Partisë — 62-63, 64-66, 67-68, 83-84, 180-190, 235-237, 319-322;
— përgatitja, zgjedhja, shpërndarja dhe vendosja e kuadrove; rregullimi i raportit kuadro të rinj dhe të vjetër — 57-58, 62-63, 68, 73-74, 89, 258, 261-262, 357;

— ngritja e kuadrove nga radhët e klasës punëtore — 75-76, 180-190, 357;
— plotësimi i dokumenteve të kuadrit, kartotekat, sektorët e kuadrit — 66-68, 73.

Kushtetuta — Projektkushtetuta e RPSSh — 223, 309-310.

L

Lenin, Vladimir Illich — 147-148, 188-189, 281, 287, 304, 306, 309, 316, 317, 364.

Letrat, kërkësat, ankesat e po-

pullit — 12, 21-22, 61, 78-79, 248-249.

Lëvizja marksiste-leniniste — partia m-l dhe normat e saj; përkrahja internacionaliste për PPSH — 311, 324-325, 364, 365-367.

Lidhja e përgjithshme dhe vartesa reciproke; trajtimi konkret historik i fenomeneve — 166, 194, 244-245.

M

Marksizëm-leninizmi — busull dhe udhëheqje për veprim; studimi, mbrojtja dhe zbatimi krijues i tij nga PPSH — 6-9, 45, 301-302, 304-307, 311, 315, 317-318.

Marks, Karl — 99, 159, 281, 287, 304, 306, 309, 316, 317, 364, 365.

Masat popullore. Roli i masave dhe i individit në shoqëri. Lufta kundër kultit të individit — 58-59, 60-62, 302-303.

Mbështetja në forcat tona — 93, 96, 97-98, 112-113, 145-146.

Mbrojtja e atdheut — 297-298.

Metoda dhe stili në punë — 11-13, 138-139, 244-245.

Ministrítë dhe kuadrot e tyre; metoda dhe stili në punë — 26, 27, 29, 33, 39, 71, 100-

-101, 122, 125, 193-194, 265;

— Komisiþni i Planit të Shtetit — 25, 27, 28-29, 30-33, 34-36, 39, 88-89, 100-101, 125, 158, 159, 160;

— Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 31-32, 40, 46, 52;

— Ministria e Bujqësisë — 10-11, 106, 107, 175-177, 204, 253, 256, 265;

— Ministria e Ndërtimit — 37, 133-134, 167;

— Ministria e Komunikacioneve — 200, 256-257;

— Ministria e Tregtisë — 265.

N

Nafta — organizimi dhe drejtimi i punës në sektorin e naftës. Studimet dhe shpim-kërkimet për naftë e gaz. Inxhinierët dhe punonjësit e tjerë të naftës — 45-49, 113-114.

Ndërmarrjet socialiste; ndërmarrjet bujqësore — 177, 242.

Ndërtimet — organizimi, drejtimi dhe kontrolli i punës në fushën e ndërtimeve — 132-133, 161, 261-262;

— projektet, preventivat, investitorët, zbatuesit — 25, 26-27, 37-39, 121, 127;

- ndërtimi i objekteve industriale e bujqësore dhe i rrugëve, hekurudhave e portave — 40-41, 96-97, 102-103, 126-132;
- ndërtimet në fshatra e në kooperativa bujqësore — 201-202, 266-267.

O

Opinioni shoqëror — 18-19, 81.

Oportunizmi, centrizmi, sektarizmi dhe lufta kundër tyre — 18-17, 18-19, 76-79, 81, 82-84, 188, 273-274, 276, 283, 286-287.

Organizata-bazë e Partisë — roli udhëheqës, ndërtimi dhe organizimi i saj — 50-53, 56-58, 143-144, 162-163;

— mbledhjet, gjallërimi, revolucionarizimi. Dhënia llogari para saj — 58-59, 62, 63-64, 70-71, 78, 79;

— organizatat-bazë të Partisë në sektorin e naftës dhe të bujqësisë — 42, 50-51, 177-178;

— protokollet e organizatës-bazë — 19-23.

Organizimi dhe drejtimi

shkencor — 34-37, 45-48, 57, 132-133, 190-196.

P

Paraja dhe qarkullimi monetar; mbulimi i saj me mallra — 123, 136, 150, 171-172.

Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e klasave në Parti

— qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementeve që gabojnë e bëjnë faje — 10-19, 59-60, 63-66, 76, 79-80, 82-83, 84-85, 153, 302, 303-304, 308-309, 318-319, 354-357;

— përjashtimet nga Partia; qëndrimi ndaj të përjashtuarve — 19, 80, 82-83.

Partia e Punës e Shqipërisë — marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj partive dhe forcave marksiste-leniniste — 311, 363-367.

Partia e Punës e Shqipërisë — ndërtimi dhe jetë e brendshme

— roli udhëheqës dhe organizues i Partisë. Karakteristikat m-l revolucionare të saj — 162-163, 165-166, 184-185, 357, 366;

— uniteti në Parti dhe në udhëheqje — 307-308;

- iniciativa dhe vetëveprimi. Kolegjialiteti — 57-58, 197-199, 244;
- zgjedhjet për organet udhëheqëse të Partisë — 235-237, 319-322, 347-359, 360-361;
- kritika dhe autokritika — 63-64, 303-304, 308-309, 318-319, 364-365;
- kapja pas hallkës kryesore — 45-46, 168;
- informimi në Parti. Letrat e popullit — 12, 16-17, 21-24, 61;
- kartotekat e Partisë — 351;
- lufta kundër spostimit të organeve e organizatave të Partisë nga organet e pushtetit — 207.

Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore e lokale

- Kongresi i Partisë — organi më i lartë udhëheqës i Partisë — 323, 347, 353, 355, 361;
- Kongresi VI i PPSH (1-7 nëntor 1971) — 144-145, 299, 353, 356;
- Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976). Përsaqësia e tij — 141, 190-196, 222, 223, 225, 233-234, 235-237, 299, 309,

- 310, 319-320, 322-323, 346, 347, 349-351, 353, 355-356, 358-359, 360, 361, 362, 363, 364-365;
- Plenumi i 9-të i KQ (19-20 korrik 1976) — 143-144;
- Plenumi i 10-të i KQ (12-14 tetor 1976) — 299-323, 354, 355, 356;
- Komiteti Qendror; Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ — 12, 21-24, 25, 28, 33-34, 53, 57, 58, 67, 70, 91, 105, 111, 112, 125, 131, 141, 160, 164, 167, 180, 181-182, 187, 190, 202, 224, 232, 235-237, 243, 299, 309, 311, 318, 319-322, 347-359;
- përbërja shoqërore e organeve udhëheqëse — 179-190, 348-349, 352, 354-355, 357-358;
- aparati i KQ dhe instruktorët; Organizata-bazë e Partisë në të — 10, 11-13, 19, 23-24, 56-57, 63, 66, 69-70, 73, 83, 85, 92, 183, 190, 195, 196, 239, 350-351, 358-359;
- ndihma dhe kontrolli përbazën — 10-13, 14, 15, 19-24, 62-64, 69-70, 84-85, 195-196;

- konferencat, plenumet, byrotë dhe sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve — 13, 22-23, 51-53, 67, 143-144, 162-163, 179-180, 182-190, 195-196, 197-200, 207-208, 210, 235, 236, 348, 352;
- aparatet e komiteteve të Partisë në rrethe dhe instruktorët e tyre — 64-65, 68, 197, 210, 240-241, 348, 351-352;
- raportet, studimet dhe materialet për organet udhëheqëse — 33-34, 105-106, 120-121, 124-126, 160, 222-225, 239-240, 299-300, 301, 308-309, 364;
- komitctet e Partisë të rretheve të Durrësit, Elbasanit dhe të Gramshit — 11-14, 15-16, 62-64, 179-180, 239-240;
- Konferenca e Partisë e Rrethit të Korçës — 250-259;
- Organizata, Komiteti dhe byroja e Partisë e Rrethit të Tiranës. Komitetet e Partisë të rajoneve — 205, 207-208, 209-210, 238, 242-243.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- vija, vendimet, direktivat; përvetësimi dhe zbatimi i tyre — 57, 190-195, 201-202, 205-206, 241, 318-319.
- Pasuritë natyrore; vlerësimi, efektiviteti i përdorimit dhe aktivizimi në vend i tyre* — 93-94, 96-97, 128-129.
- Përvaja e përparuar; njohja dhe përgjithësimi i saj* — 160-161, 243-245, 251-253.
- Planet, planifikimi i ekonomisë popullore* — përbajtja e tyre — 147-148;
- zhvillimi harmonik e përpjeshëtimor i ekonomisë — 99-100, 136-137, 153-156;
- përsosja e metodologjisë, e parimeve dhe e metodave kryesore të planifikimit — 27-29, 33-34, 125-126, 145-147, 153-159;
- pjesëmarrja e masave në planifikim dhe në plotësimin e planeve; mundësia e përmirësimit të planeve kur zbulohen rezerva të reja — 116-117, 123-124, 163-164;
- parimi i partishmërisë, i karakterit shkencor dhe ai i mbështetjes në forcat e veta — 97-98, 112-113, 129, 145-146, 147, 151-157;

- metoda bilancuese dhe ajo e krahasimit — 116-117, 126, 159-160;
 - argumentimi i planeve me aftësi prodhuese, burime materiale, financiare e njerëzore — 28-30, 31-34, 87-89, 90, 121, 129;
 - plotësimi i planeve në sasi, cilësi dhe llojshmëri — 135, 136, 154;
 - planet, planifikimi në bujqësi dhe në kooperativat bujqësore; lufta për realizimin e tyre — 87-88, 97, 115-117, 160-161, 168;
 - lufta kundër orvatjeve armiqësore dhe të metave në planifikim dhe në realizimin e planeve — 102-103, 147, 150-151, 153-157, 162;
 - organet e planifikimit — 101, 158-159;
 - plani i pestë pesëvjeçar (1971—1975) — 30, 144-145, 162;
 - projektplani i gjashtë pesëvjeçar (1976—1980). Planet prognozë — 25, 29-30, 33-34, 92-98, 99-101, 105-106, 111-142, 143-144, 145-146, 152-164.
- Politika dhe ideologjia; kuptimi politik i problemeve — 43-45, 146, 194-195.*
- Politika e jashtme parimore e RPSH — 223-224, 233, 293-296, 310-311, 312;*
 - qëndrimi parimor ndaj Kinës — 95, 219-221, 224-233, 296, 311-317;
 - përkrahja e RPSH nga popujt dhe forcat përparrimtare të botës. Të huajt, miqtë për Shqipërinë — 298, 317-318.
 - Politika ekonomike e Partisë — 135, 148, 150, 166.*
 - Prodhimi material — prodhimi dhe riprodhimi socialist — 94-95, 157-158, 159;*
 - sasia dhe cilësia e produkteve. Llojshmëria — 157, 172-173.
 - Prona — oborri kooperativist dhe kufizimi i mëtejshëm i tij — 268-270.*
 - Propaganda dhe shtypi në RPSH — 44-45, 226, 227-228, 241, 251, 313, 317.*
 - Propaganda, shtypi, radiotelevizioni borgjezo-revisionist — 148, 226, 227, 279, 283, 285, 291, 295-296, 315, 328, 329-330, 364.*
 - Psikologjia mikroborgjeze — 141, 300-301, 305-306.*
 - Puna — organizimi i punës; puna vullnetare — 45-48, 169-170, 177.*

Pyjet dhe ruajtja e tyre; pyllëzimet — 175, 267-268.

moniste dhe kontradiktat ndërmjet tyre — 149, 239-290.

R

Regjimi i kursimit — 124, 156. Revolucioni proletar; dialektika e zhvillimit të tij — 317. Rinia — edukimi komunist dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja. Iniciativa e rinisë për të punuar e jetuar në fshat — 200-201, 242.

SH

Shkollat e lira ushtarake. Shkollat ushtarake — 1, 2-4, 5, 240. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe qëndrimi i tyre ndaj RP të Shqipërisë — 216-217, 229-230.

RR

Rrethimi, bllokada, presioni borgjezo-revisionist dhe lufta për përballimin e tyre — 44-45, 134-135, 149-151, 300-301.

T

Teoritë e pikëpamjet borgjezo-revisioniste dhe kritika ndaj tyre

— kritikë teorive dhe pikëpamjeve të revisionistëve kinezë për luftën e klasave, për revolucionin dhe forcat lëvizëse të tij dhe për rolin e fshatarësisë — 273-277, 286-287;

— kritikë pikëpamjeve të revisionistëve kinezë të mbështetjes te një imperializëm për të luftuar tjetrin dhe mbi «tri botët» — 224-225, 311, 312.

S

Sekreti dhe ruajtja e tij — 349-350.

Stacionet e makinave dhe të traktorëve — 106-107, 108-110.

Stalin, Josif Visarionoviç — 159, 188-189, 218, 281, 290, 304, 306, 309, 316, 317, 364.

Statistika — 32-33.

Superfuqitë; politika hegje-

Tregtia e brendshme; shpërndarja e prodhimeve bujqë-

sore dhe furnizimi i popullit
 — 137-138, 255-256, 264, 265.

Tregtia e jashtme; eksporti, importi; forcimi i bilancit aktiv tē tregtisë së jashtme — 92-94, 95-96, 98, 122-123, 137-138, 170-171;
 — konjunkturat e çmimeve në tregun e jashtëm; kontratat me firmat e huaja — 99, 123, 136-137, 150-151.

U

Uniteti i popullit; uniteti Parti—popull — 307-308.

Ushtria Popullore — komitetet e Partisë në ushtri. Kuardrot politikë e ushtarake. Komandat. Xhenio — 2, 186-187, 239-240.

V

Vendet revizioniste dhe kriza e tyre — 148-149, 306. Vigjilanca revolucionare — 15, 16-17, 19, 59, 61, 134-135, 152, 212, 217, 232, 295, 296, 303, 316-318.

Vija e masave — tērheqja e mendimit tē masave — 60-62.

Z

Zotimet dhe luftha për zbatimin e tyre — 169-170, 205-206.

ZH

Zhvillimi dialektik; uniteti dhe luftha e tē kundërtave si burim zhvillimi — 244-245, 306, 307-308, 317.

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 1-2, 3, 4-5, 7, 8, 101-102, 103, 192, 202, 203-204, 209, 250, 251, 252, 253, 254-255, 256, 257, 258, 259, 271, 326, 340-341.

Arapı, Mynyr — 49.

B

Bakunin, Mihail — 8.

Balluku, Beqir — 16, 59, 144, 212, 213-214, 215, 216, 228, 229, 294, 300, 302, 341-342, 343, 347, 353.

Bonaparti, Napoleon — 3.

Brezhnjev, Leonid — 292.

C

Çako, Hito — 59, 144, 212, 215, 228, 300.

Çan Çun Ciao — 277, 278, 285, 288-289, 296, 315, 328, 329, 331-332, 337-338.

Çen Po Ta — 277, 282, 331, 338.

Çian Çin — 277, 278, 279, 285, 288-289, 291, 296, 315, 327,

329-330, 331-332, 333, 337-328, 339-340.

Cipi, Pëllumb — 50.

Çu En Lai — 213-214, 215, 216, 217, 220, 227, 228-229, 274, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 284-285, 286, 287, 288, 289, 292, 293, 297, 324, 325, 326, 327, 328, 330, 331, 333, 334, 335, 336, 337, 339, 340, 341-342, 343, 344-345.

D

Dezh, George Georgiu — 260.

Dodbiba, Mihal — 11, 12, 15.

Dodbiba, Pirro — 40, 175, 176.

Dode, Petro — 27, 34, 38, 39-40, 41, 92, 160.

Durne, Petrit — 16, 59, 144, 212, 228, 300, 343.

G

Cusho, Pirro — 216.

GJ

Gjokoreci, Sterjo — 89.

H

Hoxha, Nexhmije — 179, 239-
-240.

Hazbiu, Kadri — 211.

Hrushov, Nikita — 218, 281-
-282, 290, 292-293, 344.

Hua Kuo Fen — 232, 278, 279,
280, 284, 287-288, 289, 290,
291, 315, 325, 328, 329, 330,
332-333, 334, 340.

I

Isai, Hekuran — 12, 14, 19, 20,
23, 37, 42, 43, 44, 47, 48, 49-
-50, 53, 54, 108, 181, 261, 262,
264, 265-266, 267, 268, 269,
270-271, 358, 360.

J

Jekova, Tuk — 18.

Jao Ven Juan — 277, 278, 285,
288-289, 291, 315, 331-332,
337-338.

K

Kapo, Hysni — 4, 7, 16, 36, 37,
40, 48, 52-53, 54, 87, 89, 90, 91,
98-99, 102, 103, 108, 192, 201,
204-205, 206-207, 208-209, 238,
239, 240, 241-242, 245, 271,
327, 343-344, 358, 360.

Kanapari, Shyqyri — 108.

Kan Shen — 277, 331.
Kati, Vasil — 18, 137, 212, 216.
Kautski, Karl — 305.
Kelmendi, Ali — 259, 362.
Kellezi, Abdyl — 16, 18, 34-35,
36, 59, 80, 136, 144, 147, 156,
211, 212, 213-214, 215, 228,
268, 294, 300, 341-342, 347,
353.
Kisinger, Henri — 333.
Klauzeviç, Karl fon — 3.
Kolaneci, Klement — 261-262.
Konfuci — 283, 339.

L

Lako, Miha — 259, 260, 362.
Li Hsien Nien — 279, 280, 289,
290, 291, 315.
Lin Biao — 276-277, 279, 282,
283, 296, 331, 333, 338, 339,
340, 344.
Liu Shao Ci — 279, 283-284,
286, 289, 295, 297, 331, 336,
344.
Lubonja, Todi — 144, 300.
Lula, Anastas — 362.

M

Marko, Rita — 247-248.
Magjistari, Petraq — 175.
Mala, Zef — 362.
Mao Ce Dun — 227, 229, 233,
273, 274-275, 277, 278, 279,
280, 281, 282, 283, 284-285,

- 286-287, 288, 289, 290, 291,
293, 296, 313, 315, 324, 325,
326-327, 328, 329, 330, 332,
333, 334-335, 337, 338, 339,
340, 344.
- Markos, Ferdinand — 314.
- Miho, Jani — 203.
- Mikojan, Anastas — 218.
- Nashi, Lipe — 216.
- Ngjela, Kiço — 18, 36, 59, 137,
144, 147, 211, 212, 215, 300.
- Nikson, Riçard — 282, 314,
333.
- Paçrami, Fadil — 144, 300.
- Pen Çen — 279, 286, 336.
- Peristeri, Pilo — 40.
- Prifti, Ilo — 252.
- Qendro, Aristidh — 362.
- Rankoviç, Aleksandër — 233.
- Snow, Edgar — 287.
- Suslov, Mihail — 292.
- Treguesi, Haki — 37, 86, 87, 88,
90, 102, 197, 199-200, 201, 202,
246, 247, 253, 268.
- Tashko, Koço — 259.
- Ten Hsiao Pin — 220, 232, 277,
278, 279, 283-284, 285, 286,
289, 290, 291, 296, 297, 315,
327, 328, 330, 331-332, 335,
336, 339, 340, 345.
- Tito, Josip Broz — 8, 218, 289,
292.
- Trocki, Lev — 305.
- Theodhosi, Koço — 16, 36, 59,
80, 107, 136, 144, 147, 156,
211, 212, 216, 300.
- Thomai, Themije — 175, 177.
- Xoxi, Niko — 362.
- Zisi, Andrea — 362.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMERTIMEVE TË TJERA

A

Ambasada e RP të Kinës në
RP të Shqipërisë — 296.

B

Berat — 201, 246-247.

Berlin — 216.

Bëngë (Tepelenë) — 247.

Bukuresht — 260.

D

Diga e Spatharës (Shkodër) —
103-104.

Drejtoria e Përgjithshme e
Naftës, Fier — 45-46, 52.

Durrës — 99, 179-180, 239-240.

E

Elbasan — 69.

Evropa, «Evropa e Bashkuar»
— 225, 312.

F

Fabrika e Çimentos, Tiranë —
98.

Fabrika e Pasurimit të Hekur-
-Nikellit e Gurit të Kuq, Po-
gradec — 166-167.

Fabrika e Pasurimit të Kro-
nit, Burrel — 128.

Fier — 216.

G

Gramsh — 11-14, 15-16, 19.

Guomindan (Partia Naciona-
liste) — 329.

GJ

Gjirokastër — 202.

H

Hekurudha Fier-Vlorë — 131.

Hekurudha Përrenjas-Guri i
Kuq — 167.

Hoxhë [Livadhja] (Sarandë) — 248.

I

Instituti i Studimeve dhe i Projektiveve të Urbanistikës dhe të Arkitekturës, Tiranë — 39.

Instituti i Studimeve të Naftës [Instituti i Studimeve dhe i Projektiveve Gjeologjike të Naftës e të Gazit], Fier — 42, 46, 52.

K

Kanali ujës i Sasajt (Sarandë) — 247.

Kanton (Kinë) — 315.

Këshilli i Mbrojtjes i RP të Shqipërisë — 240.

Kodi i Punës — 242.

Kolonjë — 13.

Kombinati i Tekstileve, Berat — 202-203.

Kombinati Metalurgjik [Kombinati Metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 96, 102-103, 114, 167, 230.

Kooperativa Bujqësore e Dajçit, Shkodër — 263.

Kooperativa Bujqësore e Gorrresë, Lushnjë — 116.

Kooperativa Bujqësore e Këmishtajt, Lushnjë — 116.

Kooperativa Bujqësore e Pojanit, Korçë — 253.

Kooperativa Bujqësore e Terpanit, Berat — 201.

Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Plasës, Korçë — 252, 253, 262.

Korçë — 253, 256, 259.

L

Lufa e Dytë Botërore (1939—1945) — 4, 148.

Lushnjë — 116.

M

Miniera e Hekur-nikelit dhe e Nikel-silikatit, Korçë — 114-115.

Miniera e Hekur-nikelit e Gurit të Kuq, Pogradec — 166-167.

Miniera e Qymyrgurit e Alarupit, Pogradec — 168.

Mongoli — 277.

Moskë — 297.

Myzeqe — 107.

N

NATO (Pakti i Atlantikut Verior) — 225, 312.

Ndërmarrja bujqësore «8 Nentori» e Maliqit, Korçë — 203-204.

Ndërmarrja e Sizmikës — 45-
-46, 47.

O

Opar (Korçë) — 201.

P

Pallati i Brigadave (Tiranë) —
89.

Pekin — 230, 315.

Përmet — 13.

Plenumi i 2-të i KQ të Kon-
gresit të 10-të të Partisë Ko-
muniste të Kinës — 326.

Pogradec — 165-171.

Porti Detar i Durrësit
[Porti detar i Durrësit
«Enver Hoxha»] — 131.

Porti Detar i Vlorës — 131.

R

Rezervuari i Mallakastrës
(Fier) — 41.

Rumani — 260, 341.

S

Salari (Tepelenë) — 247.

Sarandë — 12, 202, 247.

Skrapar — 108, 254.

SH

Shangai — 290.

Shkodër — 13, 270-271.

Shkolla e bashkuar e oficerëve
«Enver Hoxha», Tiranë — 1-5.
Shkolla e Ministrisë së Punëve
të Brendshme, Tiranë — 3.

T

Teknikumi i Naftës, Qyteti
Stalin — 53-55.

Tiranë — 202, 205, 207-208,
209-210, 238, 242-243.

Tregu i Përbashkët Evropian
— 225, 312.

Tropojë — 107.

Tuneli hekurudhor i Qafës së
Thanës — 167.

U

Universiteti i Tiranës [Univer-
siteti i Tiranës «Enver Hoxha»]
— 2, 257.

Uzina «Enver», Tiranë — 205.

Uzina e Përpunimit të Thellë
të Naftës, Ballsh — 26.

Uzina e Plehrave Azotike
[Uzina e prodhimeve të azotu-
ara «Gogo Nushi»], Fier — 26.

V

Vrinë (bishti ~, Sarandë) —
247.

Z

Zadrimë (Shkodër) — 104.

LËNDA

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 58-TE

V-IX

1976

STUDENTËT USHTARAKË TË PAJISEN EDIIE ME KULTURE TË PERGJITHSHUME — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (1 qershor 1976)	1—5
VEPRAVE TË KLASIKËVE T'U RIKTHEHEMI VA-ZHIDIMISHT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (4 qershor 1976)	6—9
KUR SHKOHIET NË BAZË, TË KUJDESEMI PËR TË ZBULUAR GJENDJEN REALE TË PUNËVE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (14 qershor 1976)	10—24
PA PROJEKTE E STUDIME PARAPRAKE, NUK KA PLANIFIKIM SIIKENCOR — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (16 qershor 1976)	25—41
PA ORGANIZIMIN E VOGËL, NUK MUND TË KENI NË RREGULL AS ORGANIZIMIN E MADH — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (17 qershor 1976)	42—55

KUR SHKOHER PËR NDIHMË E KONTROLL, SYTË NË RADHË TË PARË TË DREJTOHEN TE NJERËZIT — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë (21 qershor 1976)	56—85
QE ULLIRI TË JAPË SA MË SHUMË PRODHIM KËRKOHET PUNË E PALODHUR DHE SHKENCE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (23 qershor 1976)	86—91
NGA REALIZIMI I PLANEVE VARET MIREQENIA E POPULLIT — Nga biseda në takimin ditor të sekre- tarëve të KQ të PPSH (24 qershor 1976)	92—104
TE SHTOJMË KUJDESIN PËR MEKANIZMAT NË BUJQESI, SIDOMOS PËR NJERËZIT QE I PËRDO- RIN ATA — Nga biseda në takimin ditor të sekreta- rëve të KQ të PPSH (25 qershor 1976)	105—110
REALIZIMI I PLANIT KËRKON VETEMOHIM, SA- KRIFICA E DISIPLINË SHEMBULLORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (12 korrik 1976)	111—142
NE KETE PESEVJEÇAR TE MBAHET PARASYSH EDHE MË FORT ORIENTIMI BAZË I MBËSHTET- TJES NË FORCAT E VETA — Fjala e mbylljes në Plenumin e 9-të të KQ të PPSH (20 korrik 1976)	143—164
DUKE ZBATUAR POROSITË E PARTISË ARRIHET ÇDO GJË — Nga biseda me kuadro drejtues të Partisë e të pushtetit të rrethit të Pogradecit (1 gusht 1976)	165—173
NE SEKTORIN E BUJQËSISË TE FORCOHEN OR- GANIZIMI, PUNA EDUKUESE DHE KONTROLI — Shënimë (3 gusht 1976)	174—178

ORIENTIMET E BYROSE POLITIKE PER PERMIRESIMIN E PERBERJES SE FORUMEVE TE KUTOHEN THELLÈ, JO NE MËNYRË MEKANIKE — Nga biseda ne takimin ditor te sekretareve te KQ te PPSH (16 shtator 1976)	179—198
FJALËT E PERGJITHSHME NUK E NDREQIN PUNËN E DOBËT — Nga biseda ne takimin ditor te sekretareve te KQ te PPSH (21 shtator 1976)	197—210
FIJET E KOMPLOSTIT COJNE EDHE NE KINE — Shënime (21 shtator 1976)	211—221
NE DO TE QËNDROJME NE POZITAT TONA TE DREJTA PAVARESISHT NGA PASOJAT — Diskutim ne mbledhjen e Byrosë Politike te KQ te PPSH (23 shtator 1976)	222—234
PER KANDIDATURAT E REJA GJYKIMET TE JENE SA MË OBJEKTIVE — Diskutim ne mbledhjen e Byrosë Politike te KQ te PPSH (23 shtator 1976)	235—237
KRAHAS PUNES EDUCUESE, EDHE KONTROLLI I RREPTË PER ZBATIMIN E RREGULLAVE — Nga biseda ne takimin ditor te sekretareve te KQ te PPSH (27 shtator 1976)	238—245
PER RENDIMENTE TE LARTA, RËNDESI TE MADHE KA EDHE FARÄ — Nga biseda ne takimin ditor te sekretareve te KQ te PPSH (30 shtator 1976)	246—249
TREJTIA TA INKURAOJË E JO TA PENGJOË SHTIMIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE — Nga biseda ne takimin ditor te sekretareve te KQ te PPSH (1 tetor 1976)	250—260

PO TË SHQETËSOIIESH PËR FURNIZIMIN E KOO- PERATIVISTËVE, E GJEN RRUGËN E ZGJIDIJES — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSII (4 tetor 1976)	261—272
TRAGJEDIA E KINËS — Shënimë (12 tetor 1976)	273—279
KAOS I MADH NË KINË — Shënimë (13 tetor 1976)	280—298
ÇDO KONGRES I PARTISË ëSHTË MOMENT HIS- TORIK PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT NË VEN- DIN TONË — Fjala në Plenumin e 10-të të KQ të PPSH (14 tetor 1976)	299—323
KËSHIT DUHET TË KETË NDODHUR ME «KA- TËRSHEN» — Nga biseda në takimin ditor të sekre- tarëve të KQ të PPSII (23 tetor 1976)	324—345
NË KOMITETIN QENDROR TË PARTISË TË ZGJE- DHIM SHOKË NGA MË TË MIRET — Fjala në mbledhjen e Përsaqësisë së Kongresit të 7-të të PPSII (26 tetor 1976)	346—359
PËR KANDIDATURAT, SECILI MUND DHE DUILLET TË BEJË VEREJTJE E TË JA PËMENDIME — Fjala në mbledhjen e Përsaqësisë së Kongresit të 7-të të PPSH (29 tetor 1976)	360—362
NUK KA FORCE NË BOTË QË TA MPOSHTË KO- MUNIZMIN — Fjala në pritjen e dhënë për delega- cionet e miqtë e huaj, që kishin ardhur për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 7-të të PPSII (30 tetor 1976)	363—367
TREGUESI I LËNDËS	371
TREGUESI I EMRAVE	383
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMERTIMEVE TË TJERA	387

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tirane, 1988